

CIKLI I TRETË I STUDIMEVE - STUDIMET E DOKTORATËS



**“LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS - ASPEKTE KRAHASUESE ME
INSTRUMENTET JURIDIKE TË KËSHILLIT TË EVROPËS”**

Mentori:

Prof.Dr. Besa ARIFI

Kandidati:

Adrianit IBRAHIMI

shkurt, 2023

PËRMBAJTJA:

PARATHËNIE.....	5
ABSTRACT.....	7
LISTA E AKRONIMEVE.....	9
LISTA E TABELAVE.....	10
LISTA E FIGURAVE.....	11
 HYRJE	
1. Objekti, qëllimet dhe metodologjia e hulumtimit.....	12
 PJESA I	
KAPITULLI I KUPTIMI I KORRUPSIONIT DHE ZHVILLIMI HISTORIK I TIJ	
1. Kuptimi i korrupsionit.....	20
2. Zhvillimet historike me rëndësi.....	22
3. Korrupsioni në Republikën e Kosovës.....	24
3.1. Korrupsioni si faktor shtytës për “ <i>ikjen e trurit</i> ” nga Kosova.....	29
 KAPITULLI II ASPEKTI JURIDIK I PËRCAKTIMIT TË KORRUPSIONIT	
1. Korniza juridike për luftimin e korrupsionit në Republikën e Kosovës.....	35
2. Korniza juridike ndërkombëtare për luftimin e korrupsionit.....	37
2.1. Instrumentet juridike të Kombeve të Bashkuara për luftimin e korrupsionit.....	37
2.2. Instrumentet juridike të Këshillit të Evropës për luftimin e korrupsionit.....	41
2.2.1. Konventa Penale kundër Korrupsionit.....	42
2.2.2. Konventa Civile kundër Korrupsionit.....	45
 KAPITULLI III ZBATIMI I INSTRUMENTEVE TË KËSHILLIT TË EVROPËS NË SHTETIN E KOSOVËS	
1. Obligimet për zbatimin e instrumenteve juridike të Këshillit të Evropës.....	47
2. Rëndësia e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Këshillin e Evropës.....	51
 PJESA II	
KAPITULLI IV KORRUPSIONI NË SEKTORIN PUBLIK	

1. Korrupsioni në sektorin publik sipas Konventës Penale kundër Korrupsionit.....	52
2. Korrupsioni në sektorin publik sipas legjislacionit në Republikën e Kosovës.....	56
3. Ballafaqimi i Republikës së Kosovës me korrupsionin në sektorin publik.....	59
3.1. Sfidat dhe vështirësitë për luftimin e korrupsionit në sektorin publik.....	60
3.1.1. Specifikat e rasteve të korrupsionit kur të dyshuar janë zyrtarët policor.....	62
KAPITULLI V KORRUPSIONI NË SEKTORIN PRIVAT	
1. Korrupsioni në sektorin privat sipas Konventës Penale kundër Korrupsionit.....	68
2. Ballafaqimi i Republikës së Kosovës me korrupsionin në sektorin privat.....	72
2.1. Korrupsioni në media në Republikën e Kosovës.....	78
KAPITULLI VI KORRUPSIONI PËRMES KRIPTOVALUTAVE	
1. Kuptimi i korrupsionit përmes kriptovalutave.....	80
1.1. Legjitimiteti i kriptovalutave.....	81
2. Përcaktimi juridik i korrupsionit përmes kriptovalutave.....	84
2.1. Kriptovalutat si mjete të kryerjes së korrupsionit.....	86
3. Lufta kundër korrupsionit përmes kriptovalutave.....	89
KAPITULLI VII MBROJTJA E VIKTIMAVE TË KORRUPSIONIT	
1. Mbrojtja e viktimave të korrupsionit.....	90
1.1. Përcaktimi juridik i mbrojtjes së viktimave të korrupsionit.....	91
1.2. Raporti i Konventës Civile kundër Korrupsionit me instrumentet tjera ndërkombëtare...	95
2. Mbrojtja e viktimave të korrupsionit në Republikën e Kosovës.....	98
2.1. Mbrojtja e viktimave të korrupsionit në Kosovë gjatë pandemisë Covid-19.....	102
3. Kompensimi i viktimave të korrupsionit.....	104
KAPITULLI VIII KONFISKIMI I PASURISË SË PAJUSTIFIKUESHME	
1. Kuptimi i pasurisë së pajustificueshme.....	107
2. Sistemet për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme.....	110
2.1. Barra e provës në procedurën për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme.....	111
3. Zbatimi i konfiskimit <i>in rem</i> të pasurisë së pajustificueshme në Evropë.....	118
4. Sfidat kryesore për zbatimin e sistemit <i>in rem</i> të konfiskimit në Republikën e Kosovës....	120

PJESA III

KAPITULLI IX PRAKTIKA GJYQËSORE KUNDËR KORRUPSIONIT GJATË VITEVE 2019-2022

1. Praktika gjyqësore kundër korrupsionit gjatë vitit 2019.....	124
2. Praktika gjyqësore kundër korrupsionit gjatë vitit 2020.....	131
3. Praktika gjyqësore kundër korrupsionit gjatë vitit 2021.....	138

KAPITULLI X ASPEKTE KRAHASUESE

1. Lufta kundër veprave penale të korrupsionit në Republikën Federale të Gjermanisë.....	145
2. Lufta kundër veprave penale të korrupsionit në Republikën e Austrisë.....	152
3. Mbrojtja juridike civile e viktimave të korrupsionit në Republikën e Francës.....	157
4. Mbrojtja juridike civile e viktimave të korrupsionit në Mbretërinë e Bashkuar.....	163

PËRFUNDIMI

Konstatime dhe rekomandime.....	169
---------------------------------	-----

BIBLIOGRAFIA.....	174
--------------------------	------------

PARATHËNIE

Korrupsioni si tematikë e hulumtimit shkencor është më i gjerë se çdo punim i doktoratës. Pra nuk mjafton një punim shkencor si i vetëm për të thënë të gjitha ato që mund të thuhet për korrupsionin. Për këtë arsye, ky punim ka shkoqitur vetëm ato segmente të korrupsionit të cilat janë aktuale dhe të domosdoshme për t'u hulumtuar. Në këtë drejtim, pashmangshëm është trajtuar edhe korrupsioni në sektorin publik. Megjithatë fokusi i punimit është orientuar mbi korrupsionin në sektorin privat. Më tutje, vëmendja është përqendruar në format e

korupsionit përmes kriptovalutave dhe teknologjisë 'Blockchain'. Një shtyllë tjetër e këtij punimi është mbrojtja e viktimave të korupsionit përmes mjeteve juridike efektive duke përfshirë edhe kompensimin e dëmit të pësuar nga korupsioni. Po ashtu, në fokus është edhe konfiskimi civil i pasurisë së pajustificueshme si një front tjetër me rëndësi për luftimin me sukses të korupsionit.

Ky punim i doktoratës është manifestim i një hulumtimi krahasues ndërmjet instrumenteve juridike të Këshillit të Evropës dhe të Republikës së Kosovës në fushën e luftimit të korupsionit. Prandaj trajtimi i segmenteve të korupsionit si më sipër është bërë pikërisht në këtë kontekst të studimit krahasues. Për nevojat e këtij punimi, standardet e Këshillit të Evropës janë përfaqësuar kryesisht nga Konventa Penale kundër Korupsionit dhe nga Konventa Civile kundër Korupsionit. Kuptohet se për tema të caktuara, analiza krahasuese ka përfshirë edhe instrumente të tjera të Këshillit të Evropës por edhe të OKB dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare. Sidoqoftë, ky hulumtim shkencor ka nxjerr në dritë një diskrepancë të konsiderueshme ndërmjet standardeve të Këshillit të Evropës dhe të Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e korupsionit.

Sa i përket korupsionit në sektorin publik, është konfirmuar se Republika e Kosovës ka bërë një progres të konsiderueshëm. Mirëpo njëkohësisht është konstatuar edhe nevoja për të zvogëluar më tutje ndikimin e politikës në sistemin e drejtësisë si dhe për të rishikuar politikën kriminale të institucioneve kompetente në luftën e shtetit të Kosovës kundër korupsionit.

Lidhur me korupsionin në sektorin privat, shteti i Kosovës në vitin 2019 ka arritur që të inkriminoj ryshfetin në sektorin privat, në përputhje me Konventën Penale kundër Korupsionit. Megjithatë, është e domosdoshme që edhe përvojat e shtetit të Kosovës për këtë formë të korupsionit të konsolidohen në përputhje me praktikatat e mira të Këshillit të Evropës.

Korupsioni është fenomen dinamik i cili ndryshon varësisht nga koha dhe vendi. Një nga format më aktuale të korupsionit manifestohet përmes kriptovalutave dhe teknologjisë 'Blockchain'. Kjo për arsye se karakteristikat e kriptovalutave që konsistojnë në mungesën e rregullimit ligjor, luhatjeve të vlerës së tregut si dhe vështirësitë në gjurmimin e tyre, i bëjnë kriptovalutat shumë

tërheqëse si mjete për kryerjen e veprave penale të korrupsionit. Rrjedhimisht është e domosdoshme që Republika e Kosovës të miratoj masat përkatëse ligjore përmes të cilave do të bëhet rregullimi penal juridik dhe civil juridik i përdorimit të teknologjive 'Blockchain'.

Sa i përket mbrojtjes së viktimave të korrupsionit përmes mjeteve efektive juridike duke përfshirë edhe kompensimin e dëmit të korrupsionit, ekziston një diskrepancë e konsiderueshme ndërmjet përcaktimeve në Konventën Civile kundër Korrupsionit dhe rregullimit ligjor të këtyre çështjeve në Republikën e Kosovës. Në parim, legjislacioni në Kosovë e mundëson kompensimin e viktimave të krimit në përgjithësi. Megjithatë Konventa Civile kundër Korrupsionit promovon të drejtën në mjete efektive juridike përtej kompensimit të viktimave të korrupsionit. Për më tepër, kjo konventë ka veçuar viktimat e korrupsionit nga viktimat tjera të krimit për shkak të karakteristikave unike të kësaj kategorie të personave. Në këtë kontekst, legjislacioni në Kosovë nuk është në përputhje të plotë me frymën e Konventës Civile kundër Korrupsionit.

Askush nuk duhet të përfitoj prej korrupsionit apo veprave të tjera penale. Prandaj konfiskimi i pasurisë së kundërligjshme ka rëndësi të posaçme për luftimin efikas të korrupsionit. Një numër i madh i shteteve anëtare në Këshillin e Evropës, tanimë kanë përvetësuar sistemin civil të konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme. Një trend të tillë është duke tentuar për të ndjekur edhe Republika e Kosovës. Megjithatë ky proces ka shpërfaqur mjaft sfida të cilat duhet të tejkalohen në mënyrë që një sistem i tillë i konfiskimit të jetësohet edhe në shtetin e Kosovës.

Republika e Kosovës nuk është ende anëtare e Këshillit të Evropës. Pavarësisht kësaj, ballafaqimi me korrupsionin mund të ketë sukses vetëm duke respektuar standardet ndërkombëtare për këtë fushë. Në këtë kontekst, ky punim ka evidentuar dallimet ndërmjet Këshillit të Evropës dhe Republikës së Kosovës që duhet të harmonizohen me qëllim që lufta kundër korrupsionit të bëhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të Këshillit të Evropës.

ABSTRACT

Corruption as a scientific research topic is broader than any doctoral thesis. Therefore, a single dissertation is definitely not enough to include everything that can be said about corruption. Thus, this dissertation has highlighted only some segments of corruption that are currently trending and necessary to be researched. This way, corruption in the public sector has been treated unavoidably. However, the focus of the research is on the corruption in the private sector. Further, on, the attention is on the corruption forms through cryptocurrencies and the blockchain technologies. Another pillar of this work is the protection of the victims of corruption by ensuring effective remedies including the right for compensation for the damage incurred from corruption. In addition, the focus is also on the civil confiscation of unjustified property as another important front in the successful fight against corruption.

This doctoral thesis is a comparative research between the legal frameworks of the Council of Europe and the Republic of Kosova on the fight against corruption. Thus, the research of the corruption segments as above was conducted in a comparative approach. For the needs of this dissertation, the standards of the Council of Europe have been mainly represented from the Criminal Law Convention on Corruption and the Civil Law Convention on Corruption. Of course, for certain topics the comparative research has also included other legal instruments of the Council of Europe, of the United Nations and other international organizations as well. This paper has brought to light a significant discrepancy between the standards of the Council of Europe and the Republic of Kosovo for the prevention and fight against corruption.

As far as it is concerned corruption in the public sector, it is confirmed that the Republic of Kosova has marked a considerable progress. Nevertheless, at the same time remains the need to reduce further the influence of politics on the justice system as well as to review the punitive policies of the courts for corruption cases and to reform the public procurement procedures.

Concerning corruption in the private sector, in 2019 the Republic of Kosova managed to criminalize bribery in the private sector, in accordance with the Criminal Law Convention on Corruption. However, it is imperative for Kosova to consolidate its experience in accordance with the good practices of the Council of Europe when dealing with this form of corruption.

Corruption is a dynamic phenomenon that changes depending on time and place. One of the most current forms of corruption is manifested through cryptocurrencies and blockchain technology. This is because the main features of cryptocurrency consisting of the lack of legal regulation, fluctuations in market value, as well as the difficulties in tracking them, make cryptocurrencies very attractive tools for committing criminal acts of corruption. Consequently, it is necessary for Kosova to adopt the Law on Cryptocurrencies in order to provide the regulation on the use of blockchain technologies from the civil and criminal law point of view.

Regarding the protection of the victims of corruption through effective legal remedies, including compensation for corruption damage, there is a significant discrepancy between the provisions in the Civil Law Convention on Corruption and the legal regulation of these issues in Kosova.

The legal framework in Kosova allows compensation for the victims of crime in general. However, the Civil Law Convention on Corruption promotes the right to effective legal remedies including the right to compensation for the victims of corruption. Moreover, this convention has distinguished the victims of corruption from other victims of crime due to the unique characteristics of this category of victims. From this point of view, the legislation in Kosova is not yet in full compliance with the approach of the Civil Law Convention on Corruption.

No one shall benefit from corruption or other criminal activities. Therefore, confiscation of illegal wealth is specifically important in the fight against corruption. Many member states in the Council of Europe have already adopted the civil confiscation system of unjustified property. The Republic of Kosova is trying to follow such a trend by issuing the Project-law on civil confiscation. However, this initiative has enlightened also some challenges that need to be overcome in order to successfully implement the civil confiscation system.

The Republic of Kosova is not yet a member state of the Council of Europe. However, dealing with corruption can be successful only through implementing the international standards in this field. This dissertation has highlighted some important differences between the Council of

Europe and the Republic of Kosova that must be harmonized in order to be in accordance with the international standards and move forward in the fight against corruption.

LISTA E AKRONIMEVE

- BE** - Bashkimi Evropian
- DASH** - Departamenti Amerikan i Shtetit
- GRECO** - Grupi i Shteteve Kundër Korrupsionit
- GJEDNJ** - Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- KCKK** - Konventa Civile Kundër Korrupsionit
- KE** - Këshilli i Evropës
- KPKK** - Konventa Penale Kundër Korrupsionit
- KPPRK** - Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës
- KPRK** - Kodi Penal i Republikës së Kosovës
- LAPSK** - Ligji për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar
- LDP** - Ligji për Deklarimin, Origjinën dhe Kontrollin e Pronës së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Origjinën dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë
- LKVK** - Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit
- LKZKP** - Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë
- LMD** - Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve
- LPKI** - Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit
- OECD** - Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
- OJQ** - Organizatë Jo Qeveritare
- OKB** - Organizata e Kombeve të Bashkuara
- RKS** - Republika e Kosovës

LISTA E TABELAVE

- Tabela nr. 1 -** Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit për Ballkanin Perëndimor 2012-2021
- Tabela nr. 2 -** Numri i aplikimeve për viza në Zonën Schengen nga Kosova
- Tabela nr. 3 -** Aspekte krahasuese lidhur me veprat penale të marrjes së ryshfetit dhe dhënies së ryshfetit
- Tabela nr. 4 -** Veprat penale të korrupsionit nga zyrtarët policor në Republikën e Kosovës
- Tabela nr. 5 -** Instrumentet ndërkombëtare të tjera nga KPKK dhe KCKK që rregullojnë mbrojtjen civile nga korrupsioni
- Tabela nr. 6 -** Veprat penale të korrupsionit zyrtar në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë vitit 2019
- Tabela nr. 7 -** Epilogu i rasteve të korrupsionit në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë vitit 2019
- Tabela nr. 8 -** Veprat penale të korrupsionit zyrtar në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë vitit 2020
- Tabela nr. 9 -** Epilogu i rasteve të korrupsionit në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë vitit 2020
- Tabela nr. 10 -** Veprat penale të korrupsionit zyrtar në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë vitit 2021
- Tabela nr. 11 -** Epilogu i rasteve të korrupsionit në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë vitit 2021
- Tabela nr. 12 -** Veprat penale të korrupsionit në Austri gjatë vitit 2020
- Tabela nr. 13 -** Veprat penale të korrupsionit në Austri gjatë vitit 2019

LISTA E FIGURAVE

- Figura nr. 1 -** Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit në Republikën e Kosovës 2012-2021
- Figura nr. 2 -** Numri i leje qëndrimeve në BE për shtetasit e Kosovës
- Figura nr. 3 -** Aprovimet preliminare të kërkesave për punësim të kosovarëve në Gjermani
- Figura nr. 4 -** Epilogu i rasteve të korrupsionit zyrtar gjatë vitit 2019
- Figura nr. 5 -** Numri i personave të gjykuar për korrupsion zyrtar gjatë vitit 2019
- Figura nr. 6 -** Llojet e dënimeve për shkak të korrupsionit zyrtar gjatë vitit 2019
- Figura nr. 7 -** Llojet e dënimeve për korrupsion zyrtar gjatë vitit 2019
- Figura nr. 8 -** Epilogu i rasteve të korrupsionit zyrtar gjatë vitit 2020
- Figura nr. 9 -** Numri i personave të gjykuar për korrupsion zyrtar gjatë vitit 2020
- Figura nr. 10 -** Llojet e dënimeve për shkak të korrupsionit zyrtar gjatë vitit 2020
- Figura nr. 11 -** Llojet e dënimeve për korrupsion zyrtar gjatë vitit 2020
- Figura nr. 12 -** Epilogu i rasteve të korrupsionit zyrtar gjatë vitit 2021
- Figura nr. 13 -** Numri i personave të gjykuar për korrupsion zyrtar gjatë vitit 2021
- Figura nr. 14 -** Llojet e dënimeve për shkak të korrupsionit zyrtar gjatë vitit 2021
- Figura nr. 15 -** Llojet e dënimeve për korrupsion zyrtar gjatë vitit 2021
- Figura nr. 16 -** Veprat penale dhe të dyshuarit për korrupsion në Gjermani në vitet 2016-2020
- Figura nr. 17 -** Vlera e dëmeve nga korrupsioni në Gjermani gjatë viteve 2016-2020
- Figura nr. 18 -** Trendi i korrupsionit në Austri gjatë viteve 2018-2020

HYRJE

1. Objekti, qëllimet dhe metodologjia e hulumtimit

Korrupsioni po vazhdon të mbetet një kërcënim për drejtësinë, demokracinë, sigurinë, ligjin dhe mirëqenien e qytetarëve kudo në botë. Natyrisht që as Republika e Kosovës nuk gëzon imunitet ndaj korrupsionit. Në fakt perceptimi për korrupsionin në shtetin e Kosovës vazhdon të mbetet mjaft i lartë duke e renditur këtë dukuri në fillim të listës së shqetësimeve për qytetarët e Kosovës. Ky konstatim konfirmohet edhe nga Transparency International ashtu që në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2021, Republika e Kosovës renditet nr. 87 nga 180 shtetet e anketuara duke shënuar kështu gjithsej 39 pikë nga 100 pikët totale (Transparency International, 2022).

Padyshim që luftimi i suksesshëm i korrupsionit në Republikën e Kosovës mund të bëhet vetëm kur ekziston përputhja e plotë me standardet e fundit ndërkombëtare kundër korrupsionit. Ky punim i doktoratës është manifestim i një hulumtimi të thuktë krahasues ndërmjet kornizës ligjore të Republikës së Kosovës dhe instrumenteve juridike të Këshillit të Evropës kundër korrupsionit.

Vëmendja më e veçantë në kontekst të studimit krahasues në këtë punim do të jetë mbi Konventën Penale kundër Korrupsionit si dhe mbi Konventën Civile kundër Korrupsionit, si dy nga instrumentet kryesore juridike të Këshillit të Evropës për luftimin e korrupsionit. Korrupsioni në sektorin privat dhe mbrojtja e viktimave të korrupsionit janë vetëm dy nga çështjet që promovohen fuqishëm prej këtyre dy konventave. Në anën tjetër pikërisht këto tematika, janë të parregulluara mjaftueshëm në infrastrukturën juridike të Republikës së Kosovës.

Tutje, jeta e qytetarëve po digjitalizohet çdo ditë më shumë. Ky aspekt i globalizimit po manifestohet edhe me forma të reja dhe më të avancuara të kriminalitetit siç është korrupsioni digjital përkatësisht korrupsioni që mund të kryhet përmes kriptovalutave. Përkundër këtij fakti, legjislacioni pozitiv mund të përballlet me vështirësi gjatë tentimit për të mbuluar këto zhvillime në jetën e qytetarëve. Për këtë arsye ky punim i ka kushtuar vëmendje edhe situatave kur kriptovalutat mund të shërbejnë si mjete për kryerjen e veprave penale të korrupsionit.

Korrupsioni është kompleks sepse është dinamik dhe shumë dimensional. Koncepti klasik i korrupsionit vazhdon të manifestohet në sektorin publik përmes formave të ndryshme të keqpërdorimit të pushtetit publik për interesa private të personave zyrtarë. Mirëpo sot jemi dëshmitarë se si subjektet e caktuara ekonomike në tregun botëror kanë kapacitet miliardësh dhe rrjedhimisht mund të kenë më shumë pushtet faktik sesa një apo më shumë shtete të caktuara së bashku. Me fjalë të tjera sektori privat sikurse edhe shoqëria civile, mediat, federatat sportive, forumet religjioze dhe partitë politike janë vetëm disa nga sektorët që mund të jenë të përfshirë nga korrupsioni përtej sektorit publik. Shto këtu faktin se sot korrupsioni po merr çdo herë më shumë karakter transnacional për shkak se mund të manifestohet edhe në më shumë shtete njëkohësisht. Kriptovalutat janë vetëm një nga mjetet që mund të shfrytëzohen për këto forma të korrupsionit transnacional. Për shtetin e Kosovës është e domosdoshme që të jetë në hap me standardet e fundit evropiane për luftimin e korrupsionit. Kjo ndër të tjera nënkupton se Republika e Kosovës duhet të shtoj vëmendjen për dimensionet tjera të korrupsionit siç janë korrupsioni në sektorin privat, korrupsioni përmes kriptovalutave, mbrojtja e viktimave të korrupsionit si dhe konfiskimi i pasurisë së fituar përmes korrupsionit. Rrjedhimisht ky punim i doktoratës trajton një tematikë mjaft aktuale, të arsyeshme por edhe mjaft të nevojshme për shtetin e Kosovës.

Punimi është i strukturuar në tri (3) pjesë që përbëhen nga gjithsej dhjetë (10) kapituj. Pjesa e parë (I) e punimit përbëhet nga kapitulli i parë (I) deri te kapitulli i tretë (III). Pjesa e dytë (II) përbëhet nga kapitulli katërt (IV) deri te kapitulli i tetë (VIII). Ndërsa pjesa e tretë (III) përbëhet nga kapitulli i nëntë (IX) dhe kapitulli i dhjetë (X).

Kapitulli i parë (I) ka të bëj me nocionet themelore lidhur me kuptimin e korrupsionit dhe disa momente të rëndësishme të zhvillimit historik të korrupsionit. Në këtë kapitull ekziston vëmendje e shtuar lidhur me korrupsionin në përgjithësi dhe pasojat e tij në Republikën e Kosovës.

Kapitulli i dytë (II) e trajton aspektin juridik të përcaktimit të korrupsionit. Me këtë rast fillimisht trajtohet aspekti juridik i përcaktimit në nivel të Republikës së Kosovës dhe pastaj në

nivel ndërkombëtar respektivisht në nivel të Këshillit të Evropës si dhe në nivel të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Kapitulli i tretë (III) ka shqyrtuar çështjen e zbatimit të instrumenteve juridike të Këshillit të Evropës në Republikën e Kosovës. Me këtë rast janë analizuar detyrimet e Republikës së Kosovës për zbatimin e instrumenteve juridike të Këshillit të Evropës në fushën e luftimit të korrupsionit. Njëkohësisht është vënë në pah edhe rëndësia e anëtarësimit të shtetit të Kosovës në Këshillin e Evropës jo vetëm për luftimin me sukses të korrupsionit por edhe për garantimin e plotë të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, për çdo shtetas pa dallim në Kosovë.

Kapitulli i katërt (IV) ka të bëjë me luftimin e korrupsionit në sektorin publik në kontekst krahasues ndërmjet kornizës ligjore në Republikën e Kosovës si dhe instrumenteve juridike të Këshillit të Evropës për luftimin e korrupsionit në sektorin publik. Në këtë drejtim, vëmendja është më e shtuar te aspekti i përcaktimit juridik të formave të ndryshme të korrupsionit në sektorin publik sipas KPKK, inkriminimeve në RKS, sfidat aktuale për parandalimin dhe luftimin efikas të tyre si dhe specifikat e rasteve të korrupsionit ku mund të përfshihen zyrtarët policor.

Kapitulli i pestë (V) ka trajtuar çështjen e ballafaqimit me korrupsionin në sektorin privat në kontekst krahasues ndërmjet legjislacionit në Republikën e Kosovës dhe instrumenteve juridike të Këshillit të Evropës për këtë fushë. Natyrisht se në fokus të studimit krahasues është aspekti i përcaktimit juridik të korrupsionit në sektorin privat, pasojat dhe format e posaçme të korrupsionit në sektorin privat. Korniza ligjore në fuqi dhe sfidat për luftimin e këtyre formave të korrupsionit janë po ashtu në qendër të vëmendjes së këtij kapitulli.

Kapitulli i gjashtë (VI) ka shqyrtuar aspektet lidhur me luftimin e korrupsionit përmes kriptovalutave të njohur edhe si “korrupsioni digjital”. Me këtë rast fokusi është vendosur te aspekti i përcaktimit juridik të kësaj forme të korrupsionit, karakteristikave kryesore të saj, pasojave që manifestohen, shkaqet si dhe sfidat me rastin ballafaqimit me këtë fenomen.

Kapitulli i shtatë (VII) ka të bëjë me mbrojtjen e viktimave të korrupsionit respektivisht me aspektet e përcaktimit juridik të këtij dimensionit për luftimin e korrupsionit. Njëkohësisht fokusi

është te rëndësia e shqyrtimit të këtij aspekti si dhe sfidat aktuale që mund të përfshijnë por nuk kufizohen me identifikimin e viktimave të korrupsionit, kualifikimin apo kuantifikimin e dëmeve të korrupsionit si dhe mbrojtjen e viktimave të korrupsionit transnacional.

Kapitulli i tetë (VIII) ka të bëjë me konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme duke vënë në pah rëndësinë edhe të këtij aspekti me rëndësi për luftimin e korrupsionit. Njëkohësisht janë trajtuar sfidat aktuale lidhur me këtë temë të cilat përfshijnë por nuk kufizohen me efektet që mund të ketë parimi i prezumimit të pafajësisë, fuqia prapavepruese e ligjit si dhe përcaktimi ligjor i ndikimit të remitencave nga diaspora për shtetin e Kosovës në raport ligjin përkatës.

Kapitulli i nëntë (IX) ka shqyrtuar praktikën gjyqësore kundër korrupsionit në Republikën e Kosovës respektivisht në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë periudhës 2019-2021.

Kapitulli i dhjetë (X) përmban shqyrtime krahasuese me Gjermaninë, Austrinë, Francën, dhe Britaninë e Madhe duke përfshirë kështu jo vetëm krahasimet me shtetet përfaqësuese të sistemit kontinental por edhe me shtetet përfaqësuese të sistemit anglo-sakson.

Duhet cekur se shqyrtimi krahasues me Gjermaninë dhe Austrinë kryesisht fokusohet në luftën kundër korrupsionit në kuptim penalo juridik respektivisht nga këndvështrimi i Konventës Penale kundër Korrupsionit. Ndërsa shqyrtimi krahasues me Francën dhe Britaninë e Madhe fokusohet në luftën kundër korrupsionit në kuptimin civil juridik respektivisht nga këndvështrimi i Konventës Civile kundër Korrupsionit.

Natyrisht se ky punim i doktoratës përfundon me konstatime dhe rekomandime konkrete të bazuara në të gjeturat e këtij hulumtimi shkencor.

Qëllimet e punimit konsistojnë në trajtimin krahasues të çështjeve si në vijim:

- **Ballafaqimi me korrupsionin në sektorin publik:** Të studiohet qasja e Këshillit të Evropës për luftimin e korrupsionit në sektorin publik dhe të bëhet krahasimi me kornizën ligjore në Republikën e Kosovës me qëllim të evidentimit të dallimeve kryesore mes tyre.

- **Ballafaqimi me korrupsionin në sektorin privat:** Të analizohet modeli i Konventës Penale kundër Korrupsionit për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në sektorin privat. Tutje, të krahasohet ky model i Këshillit të Evropës me përcaktimet e Kodit Penal të Republikës së Kosovës për luftimin e korrupsionit në sektorin privat.
- **Luftimi i korrupsionit përmes kriptovalutave:** Të sqarohet kuptimi i korrupsionit digjital respektivisht korrupsionit përmes kriptovalutave. Tutje, të studiohet qasja e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit digjital. Të evidentohet qasja e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit digjital si dhe të krahasohet me qasjen e Këshillit të Evropës lidhur me këtë çështje. Të sqarohen format dhe mënyrat e shfaqjes së korrupsionit digjital duke përfshirë këtu rastet kur korrupsioni digjital shfaqet në simbiozë me shpëlarjen e parave. Të konstatohen rreziqet që kanosen nga korrupsioni digjital si dhe të arrihet deri te rekomandimet e sakta për luftimin efikas dhe efektiv të këtyre fenomeneve.
- **Mbrojtja e viktimave të korrupsionit:** Të sqarohet kuptimi dhe rëndësia e mbrojtjes së viktimave të korrupsionit. Tutje, të evidentohen sfidat dhe vështirësitë kryesore ligjore dhe praktike për mbrojtjen e viktimave të korrupsionit. Të krahasohet modeli i mbrojtjes së viktimave të korrupsionit sipas Konventës Civile kundër Korrupsionit si dhe kornizës ligjore që është në fuqi në Republikën e Kosovës lidhur me këto çështje.
- **Konfiskimi i pasurisë së pajustificueshme (të fituar përmes korrupsionit):** Të krahasohen mekanizmat për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme në Republikën e Kosovës dhe Këshillin e Evropës duke u fokusuar në prezumimin e pafajësisë dhe efektet e këtij parimi.

Ky punim i doktoratës është i ndërtuar mbi bazën e tri (3) hipotezave të elaboruara si në vijim:

H1: *“Republika e Kosovës ka nevojë për rritjen e kapaciteteve për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin në sektorin privat sipas standardeve të përcaktuara me instrumentet juridike të Këshillit të Evropës kundër korrupsionit”.*

H2: *“Në Republikën e Kosovës mungon një kornizë ligjore që është në harmoni me standardet ndërkombëtare për parandalimin dhe luftimin e formave të korrupsionit përmes kriptovalutave”.*

H3: *“Legjislacioni në Republikën e Kosovës nuk është në përputhje të plotë me përcaktimet e Konventës Civile kundër Korrupsionit për të ofruar mjete efektive juridike për mbrojtjen e viktimave të korrupsionit duke përfshirë edhe kompensimin e dëmit të pësuar nga korrupsioni”.*

Hipoteza e parë është përcaktuar sepse deri në vitin 2019 në Republikën e Kosovës nuk kanë qenë fare të inkriminuara veprat penale të korrupsionit në sektorin privat. Në prill të vitit 2019 ka hyrë në fuqi Kodi Penal i Kosovës nr. 06/L-074 përmes të cilit janë inkriminuar dy vepra penale të korrupsionit në sektorin privat të cilat janë “dhënia e ryshfetit në sektorin privat” përmes nenit 310 të Kodit Penal si dhe “pranimi i ryshfetit në sektorin privat” përmes nenit 309 të Kodit Penal.

Inkriminimi i këtyre dy veprave penale mund të konsiderohet si suksesi i parë i Kosovës në luftën kundër korrupsionit në sektorin privat. Megjithatë institucionet kompetente në Kosovë duhet të bashkëpunojnë ngushtë edhe me shtetet tjera të cilat kanë përvojë më të gjatë se Kosova në luftën kundër korrupsionit në sektorin privat. Në këtë mes nuk përjashtohen as shtetet e rajonit pasi që korrupsioni në sektorin privat mund të manifestohet edhe në dimensionin transnacional. Në veçanti duhet merren parasysh edhe përvojat e atyre shteteve që janë anëtare të Konventës Penale kundër Korrupsionit e cila i kushton vëmendje të shtuar luftimit të kësaj forme të korrupsionit. Në këtë mënyrë përmes bashkëpunimit penal ndërkombëtar, shteti i Kosovës mund të jetë më efikas në realizimin e qëllimeve të kodit penal të Kosovës bazuar në inkriminimet përkatëse të korrupsionit në sektorin privat.

Hipoteza e dytë është përcaktuar pasi që kriptovalutat sot përdoren në shumicën e shteteve të botës duke përfshirë këtu edhe Republikën e Kosovës. Mirëpo përkundër faktit se në shumë prej këtyre shteteve është rregulluar me ligj të veçantë përdorimi i kriptovalutave, në Republikën e Kosovës nuk është ndërmarrë ende një iniciativë e tillë. Rrjedhimisht investimi, përfitimi, transferimi, cedimi dhe format tjera të përdorimit të këtyre valutave elektronike në

Republikën e Kosovës nuk është i rregulluar ende me ligj. Pikërisht ky fakt mund të përbëjë një mundësi të shtuar edhe për kryerjen e veprave penale të korrupsionit duke shfrytëzuar sistemet elektronike zinxhirore të kriptovalutave në Republikën e Kosovës.

Hipoteza e tretë është përcaktuar sepse legjislacioni në fuqi në Republikën e Kosovës nuk e rregullon në mënyrë specifike të drejtën e kompensimit të viktimave të korrupsionit dhe aq më pak procedurën ligjore që duhet ndjekur për të realizuar këtë të drejtë. Rrjedhimisht shumë viktima të korrupsionit mund të mos realizojnë asnjëherë satisfaksionin e merituar për shkak të dëmit që ata kanë pësuar nga veprat penale të korrupsionit.

Metodologjia e hulumtimit lidhur me këtë punim të doktoratës konsiston kryesisht në metodat shkencore të cilat janë aplikuar sipas elaborimeve në vijim:

- Përmes **metodës historike** është analizuar zhvillimi i korrupsionit në etapa të ndryshme historike të shoqërisë. Natyrisht se kjo metodë ka mundësuar evidentimin e disa rrethanave faktike me rëndësi edhe për kontekstin e luftimit të korrupsionit në Republikën e Kosovës.
- Përmes **metodës krahasuese** është bërë evidentimi i dallimeve dhe pjesëve të përbashkëta ndërmjet kornizës ligjore të Republikës së Kosovës dhe instrumenteve juridike të Këshillit të Evropës për luftimin e korrupsionit. Përmes kësaj metode është bërë edhe krahasimi i kornizës ligjore të Republikës së Kosovës me shtetet tjera përfshirë këtu Gjermaninë, Austrinë, Francën dhe Britaninë e Madhe. Rrjedhimisht është bërë e mundur që të evidentohen dallimet kryesore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Evropës lidhur me masat dhe veprimet juridike penale me qëllim të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit në sektorin publik, sektorin privat, korrupsionit digjital, konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme si dhe mbrojtjes së viktimave të korrupsionit.
- Përmes **metodës statistikore**, hulumtimi ka përfshirë po ashtu analizimin e statistikave relevante për korrupsionin në Republikën e Kosovës duke përfshirë këtu statistikën mbi aktgjykimet e Gjykatës Themelore të Prishtinës lidhur me rastet e korrupsionit gjatë viteve 2019-2021. Përmes kësaj metode është përcaktuar trendi, vëllimi dhe dinamika e luftimit të korrupsionit në Republikën e Kosovës.

- Përmes **metodës empirike** është shfrytëzuar përvoja profesionale e kandidatit si hetues në Inspektoratin Policor të Kosovës ku ka marrë pjesë në hetimin penal të veprave të korrupsionit që janë kryer nga zyrtarët policor në Policinë e Kosovës. Në këtë mënyrë janë arritur të evidentohen disa nga sfidat dhe vështirësitë gjatë ballafaqimit me korrupsionin në sektorin publik dhe veçanërisht kur të dyshuar mund të jenë zyrtarët policor të Kosovës.
- Përmes **studimit të rasteve gjyqësore** është realizuar pjesa e hulumtimit etiologjik. Në këtë mënyrë janë evidentuar edhe disa nga konstatimet me rëndësi të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me sistemet moderne për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme.

Në fushën e luftimit të korrupsionit janë bërë hulumtime të shumta në Republikën e Kosovës. Njëkohësisht, nuk është ndonjë zbulim i ri nëse sot themi se “korrupsioni është fenomen i dëmshëm” ose që “Kosova duhet të punoj më shumë për të luftuar korrupsionin”. Sidoqoftë, ky punim i doktoratës ka tejkaluar objektivat e këtyre hulumtimeve të zakonshme. Kjo për arsye se ky punim i trajton disa nga format tjera të korrupsionit që për Republikën e Kosovës janë shumë pak të njohura deri tani. Si shembull korrupsioni digjital që nënkupton korrupsionin përmes valutave digjitale është një fenomen që nuk është trajtuar ende mjaftueshëm përkundër faktit se po jetojmë në një kohë kur valutat digjitale janë duke u bërë gjithnjë më shumë prezente dhe konsistojnë në vlera miliardëshe mirëpo ende të parregulluara juridikisht në shtetin e Kosovës.

Korrupsioni në sektorin privat është po ashtu një temë që nuk është trajtuar mjaftueshëm në Republikën e Kosovës. Ndoshta arsyet për këtë konsistojnë në faktin se në Ballkanin Perëndimor duke përfshirë këtu edhe shtetin e Kosovës, sektori privat nuk ka arritur ende fuqinë që mund të ketë në të ardhmen. Me fjalë të tjera, përderisa në Republikën e Kosovës do të mbetet administrata shtetërore si një nga punëdhënësit kryesor, korrupsioni në sektorin privat do të jetë nën hijen e korrupsionit në sektorin publik (korrupsioni politik, gjyqësor, shëndetësor, etj). Mirëpo nëse nisemi nga prezumimi që edhe Republika e Kosovës të arrij

zhvillimin ekonomik mesatar për shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, atëherë padyshim që edhe korrupsioni në sektorin privat do të mund të vjen në shprehje më shumë se tani.

Një aspekt tjetër me rëndësi që evidenton ky punim është aspekti viktimologjik i korrupsionit i cili po ashtu nuk është trajtuar mjaftueshëm deri sot në Republikën e Kosovës. Asnjëherë nuk do të mund të luftohet korrupsioni me sukses nëse e gjithë vëmendja i kushtohet kryesve të veprave penale ndërsa nuk dëgjohet edhe zëri i viktimave të korrupsionit. Nuk ka dilemë se Konventa Civile kundër Korrupsionit është modeli që duhet të ndjekë Kosova lidhur me këtë temë.

Mbi bazën e të thënave më sipër, kandidati konfirmon bindjen e tij se ky punim është aktual, i nevojshëm dhe i rëndësishëm për tematikën që trajton. Në fakt, ky punim dhe të gjitha shkrimet tjera akademike me vizione të këtilla shkencore janë të domosdoshme për Republikën e Kosovës dhe luftën e saj efikase kundër të gjitha formave të korrupsionit.

PJESA I

KAPITULLI I - KUPTIMI I KORRUPSIONIT DHE ZHVILLIMI HISTORIK I TIJ

1. Kuptimi i korrupsionit

Korrupsioni është fenomen mjaft dinamik, i cili ndryshon vazhdimisht në varësi të vendit dhe kohës. Rrjedhimisht është mjaft e vështirë të përcaktohet një përkufizim i korrupsionit i cili do të jetë i pranueshëm në mënyrë universale (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999). Megjithatë, në forume të ndryshme ndërkombëtare janë diskutuar definicione të mundshme të korrupsionit.

Sipas **Bankës Botërore** korrupsioni paraqet *“përdorimin e autorizimeve publike apo të korporatës për përfitime personale”* (Bhargava, 2005). Tutje, **Fondi Monetar Ndërkombëtar** e përkufizon korrupsionin si *“abuzimi i autoritetit publik për qëllime të përfitimeve personale”* (Fondi Monetar Ndërkombëtar, 2005).

Interpoli e përkufizon korrupsionin si *“pranim apo miratim, direkt apo indirekt, nga zyrtari policor apo nga ndonjë i punësuar në ndonjë forcë apo shërbim policor, të parave, artikujve me*

vlërë, dhuratave, favoreve, premtimeve, shpërblimeve apo përparësive, për vete, personin tjetër, grupin apo etnitetin tjetër në këmbim të ndonjë veprimi apo mosveprimi që është kryer apo do të kryhet në të ardhmen lidhur me ndonjë performancë apo funksion të caktuar policor” (Interpol, 2002).

Konventa Civile kundër Korrupsionit korrupsionin e definon si *“kërkim, ofrim, marrje ose dhënie direkte ose indirekte të një ryshfeti apo avantazhi tjetër të padrejtë ose ndonjë përparësi, që shtrembëron kryerjen siç duhet të detyrës ose sjelljes përkatëse nga marrësi i mitos*” (Civil Law Convention on Corruption, 1999).

Konventa Penale kundër Korrupsionit nuk ka arritur të përcaktojë një definicion uniform mbi korrupsionin (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 5).

Korrupsioni mbi bazën e kësaj që u tha deri më tani, mund të kuptohet si një fenomen kompleks i cili mund të paraqitet në forma dhe mënyra të ndryshme. Në këtë fenomen janë të përfshirë faktorë të ndryshëm të natyrës politike, sociale, administrative, institucionale dhe ekonomike, qofshin të përmasave vendore apo ndërkombëtare (Alina Rocha Menocal & Nils Taxell, 2015).

Një përkufizim mjaft i njohur për korrupsionin është nga **Transparency International** sipas së cilit korrupsioni paraqet *“abuzimin e autorizimeve të besuara për interesa private”* (Transparency International, n.d.). Në varësi të sektorit ku shfaqet korrupsioni si dhe kryesit të tij, Transparency International e klasifikon korrupsionin në tri (3) grupe kryesore:

- 1) **Korrupsioni i lartë**: korrupsioni i nivelit të lartë qeveritar përmes të cilit interferohet drejtpërdrejtë në funksionimin e shtetit duke keqpërdorur të mirat publike të shoqërisë për qëllime private të liderëve të caktuar institucional.
- 2) **Korrupsioni i ulët**: korrupsioni i personave zyrtarë të nivelit të ulët dhe të mesëm, të cilët në kontakte ditore me qytetarët e zakonshëm, në institucionet shkollore, shëndetësore apo në institucione tjera, kryejnë vepra penale të korrupsionit.
- 3) **Korrupsioni politik**: manipulimi i politikave, institucioneve dhe rregullave procedurale me rastin e ndarjes së resurseve të caktuara apo financimit të personave vendimmarrës në

politikë, të cilët abuzojnë me pozitën e tyre për të arritur pushtetin, statusin apo mirëqenien.

Padyshim që korrupsioni duhet të kuptohet edhe si një sulm i rrezikshëm kundër demokracisë dhe shtetit ligjor (Dr. Halili, 2016, p. 2021). Në fakt korrupsioni paraqet edhe sulm kundër nivelit kulturor dhe edukativ të një shoqërie (Dr. Halili, 2016, p. 2021). Prandaj korrupsioni ndërlidhet ngushtë edhe me integritetin e personave që autorizimet e caktuara i keqpërdorin për interesa të caktuara personale. Ndërlidhjen homogjene ndërmjet integritetit të personave zyrtar dhe korrupsionit e konfirmon edhe Konventa e OKB kundër Korrupsionit që në disa raste e thekson rëndësinë e promovimit dhe mbrojtjes së integritetit të personave me rastin e luftimit të korrupsionit (UNCAC, 2003, pp. art. 5 par. 1, art. 8, art. 11 par. 1). Integriteti mund të perceptohet si një karakteristikë e brendshme e një personi që determinon nëse ai person vepron në përputhje me parimet dhe vlerat specifike. Me fjalë tjera integriteti do të thotë kryerja e detyrave të punës në mënyrë të ndershme, me mirëbesim, korrektësi dhe me zell, në përputhje me normat juridike në fuqi (Danilet, 2009). Nëse integriteti analizohet në korrelacion me termin korrupsion, mund të konstatojmë se ***çdo person me integritet është i pa korruptuar dhe anasjelltas, çdo person i korruptuar është pa integritet***. Kështu që edhe përkushtimi për rritjen e nivelit kulturor dhe edukativ të një shoqërie, është gjithashtu i domosdoshëm në luftën kundër korrupsionit.

2. Zhvillimet historike me rëndësi

Autorët vlerësojnë se korrupsioni si fenomen ekziston që nga antikiteti, i manifestuar në forma dhe mënyra të ndryshme. Mirëpo inkriminimi juridiko penal ka ndodhur vetëm në shek. XIX kur edhe ka filluar përpunimi i rëndësishëm teorik i korrupsionit (Ismet Salihu, 2014, p. 1203). Kodi Francez i Napoleonit i vitit 1810 konsiderohet si pikë referimi ku për herë të parë në Evropë është inkriminuar korrupsioni në jetën publike (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 1).

Termi ***korrupsion*** mendohet që rrjedh nga fjala latine “***corrumpere***” që në gjuhën shqipe mund të përkthehet si “***shkatërrim***”, “***prishje***” apo “***dëmtim***” (Lexico - Oxford). Në të vërtetë emërtimi i ‘korrupsionit’ ka ndryshuar disa herë përgjatë shekujve. Andaj në burime të ndryshme mund

të hasen të dhëna sipas të cilave termi korrupsion ka origjinën edhe nga fjalët latine tjera siç janë **corrumpo**, **corrupti** dhe **corruptus**. Këto në fakt janë vetëm emërtime të modifikuara gjatë kohës, të cilat si të tilla i kanë paraprirë termit që ne sot e njohim si **“korrupsion”** (Latdict, 1982).

Format dhe trajtat në të cilat është paraqitur korrupsioni, janë të ndryshme gjatë periudhave të ndryshme të zhvillimit shoqëror. Autori *Wiley Blackwell* shpjegon se si në shekullin XVIII p.e.s, Hamurabi - mbreti i gjashtë i Babilonisë, në Kodin e tij të famshëm kishte përcaktuar se *“gjyqtari duhet të shkarkohet nga posti nëse ai ka ndryshuar një vendim të përfunduar për një çështje të mbyllur”* (Blackwell, 2013, p. 23). Megjithatë nuk është evidentuar ndonjë provë mbi bazën e të cilës do të mund të interpretonim këtë dispozitë ashtu që (*ratio legis*) qëllimi i Hamurabit të ketë qenë të parandalojë korrupsionin e gjyqtarëve (Blackwell, 2013, p. 23). Mirëpo nuk ka dilemë që kjo dispozitë të jetë zbatuar edhe ndaj atyre gjyqtarëve që në shkëmbim të një dhurate kanë ndryshuar vendimet *res judicata* (Blackwell, 2013, p. 23). Rrjedhimisht mund të thuhet se korrupsioni është inkriminuar pjesërisht përmes Kodit të Hamurabit edhe në kohën e Babilonisë.

Në Romën antike, filozofi i madh romak Ciceroni ka vënë në dukje shkallëzimin e përhapjes së korrupsionit. Ai natyrën e korrupsionit e ka ndërlidhur me qenien dhe vetëdijen e njeriut si dhe ekzistimin e veseve njerëzore, d.m.th. i jep një shpjegim psikologjik. Në të drejtën romake për herë të parë ndeshim një ligj të përpiluar posaçërisht për korrupsionin ku edhe evidentohet përdorimi i drejtpërdrejtë i termit **“korrupsion”** (Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 2014, p. 9).

Autorja australiane Lisa Hill argumenton se në kohën e Romës dhe Greqisë antike kanë dominuar dy forma themelore të korrupsionit:

- **Forma e parë** apo korrupsioni politik për të cilën autorja Hill shprehet se ka qenë një fenomen i përhapur veçanërisht në skenën politike dhe në ushtri. Korrupsioni ishte shkaku dhe efekti i karakterit agresiv të perandorive të atëhershme, të hedonizmit (sidomos kënaqësisë përmes luksit), pabarazisë materiale dhe sociale të qytetarëve (Hill, 2013, pp. 1-2).

- **Forma e dytë** e korrupsionit që sipas Hill ka qenë prezentë në kohën antike është korrupsioni përmes abuzimit të pushtetit publik me qëllim të realizimit të interesave private. Në fakt kjo formë e korrupsionit është mjaft e njohur edhe sot (Hill, 2013, p. 2).

Në mesjetë Nikola Makiaveli korrupsionin e përcaktonte si një të keqe shoqërore, në bazë të së cilës qëndron shfrytëzimi i mundësive publike për interesa private. Ky përcaktim edhe sot përbën thelbin e shumicës së përkufizimeve për korrupsionin (Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 2014, p. 9).

Kosova është një shtet i ri i sapo dalë nga lufta. Prandaj edhe luftimi i korrupsionit në Republikën e Kosovës është mjaft i hershëm (Ibrahimi B. G., 2020, p. 235). Fillimisht korrupsioni ishte inkriminuar në vitin 2004 përmes Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, 2004). Njëkohësisht kanë hyrë në fuqi edhe disa nga ligjet tjera relevante për luftimin e korrupsionit siç është ligji për prokurimin publik (Ligji për prokurimin publik, 2004) dhe ligji kundër korrupsionit përmes të cilit ishte themeluar edhe Agjencia e Kosovës kundër Korrupsionit (Ligji kundër korrupsionit, 2004, neni 8 par. 1, neni 23). Një fenomen që ka karakterizuar zhvillimin historik të luftës kundër korrupsionit në Kosovë gjatë periudhës kohore nga viti 2004 deri në vitin 2013 është themelimi i shumë trupave ligjore për luftimin e korrupsionit (Ibrahimi B. G., 2020, p. 235). Këto trupa kanë mundur të jenë të ndryshme në përbërje apo organizim mirëpo shumica prej tyre kanë pasur misionin ligjor pothuajse të njëjtë, duke krijuar në këtë mënyrë edhe kolizion të fushëveprimeve që kanë pasur këto trupa ekzekutive (Ibrahimi B. G., 2020, p. 235). Disa prej këtyre trupave përveç Agjencisë kundër Korrupsionit janë edhe Këshilli Kombëtar kundër Korrupsionit (Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit, 2012), Koordinatori Kombëtar për Luftën Kundër Korrupsionit (Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, 2012), Task Forca Speciale Anti Korrupsion (Qeveria e Republikës së Kosovës, 2012), etj.


3. Korrupsioni në Republikën e Kosovës

Korrupsioni është një nga sfidat kryesore me të cilat është ballafaquar shteti i Kosovës në dekadën e fundit. Nga 100 pikët maksimale, Transparency International e ka vlerësuar shtetin e

Kosovës në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit me 34 pikë në vitin 2012 ndërsa me 33 pikë gjatë viteve 2013 deri 2015 (Transparency International, 2012-2021).

Në vitin 2016, 2019 dhe 2020 Republika e Kosovës është vlerësuar me 36 pikë (Transparency International, 2012-2021). Në vitin 2018 është vlerësuar me 38 pikë ndërsa në vitin 2017 dhe 2021 Republika e Kosovës është vlerësuar me 39 pikë që njëkohësisht është performanca më e mirë e shtetit të Kosovës në këtë indeks (Transparency International, 2022).

Fig. 1. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit në Republikën e Kosovës 2012-2021



Burimi: (Transparency International, 2012-2021).

Bazuar në Fig.1. si më sipër mund të konstatohet se Republika e Kosovës ka shënuar një trend rritës në kuadër të Indeksit të Perceptimit për Korrupsionin. Kjo për arsye se nga 33 pikë në indeksin e vitit 2016, Republika e Kosovës është vlerësuar me 39 pikë në vitin 2021

(Transparency International, 2012-2021). Rrjedhimisht mund të thuhet shteti i Kosovës në përgjithësi është duke manifestuar progres në luftën kundër korrupsionit respektivisht në kuadër të Indeksit për Perceptimin e Korrupsionit (Transparency International, 2022).

Tab. 1. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit për Ballkanin Perëndimor 2012-2021

	Mali i Zi	Kosova	Maqedonia e Veriut	Serbia	Shqipëria	Bosnja dhe Hercegovina
2012	41	34	43	39	33	42
2013	44	33	44	42	31	42
2014	42	33	45	41	33	39
2015	44	33	42	40	36	38
2016	45	36	37	42	39	39
2017	46	39	35	41	38	38
2018	45	37	37	39	36	38
2019	45	36	35	39	35	36
2020	45	36	35	38	36	35
2021	46	39	39	38	35	35

Burimi: (Transparency International, 2022).

Në krahasim me shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor për vitin 2021, Mali i Zi me 46 pikë ka indeksin më të mirë lidhur me perceptimin e korrupsionit sipas Transparency International (Transparency International, 2022).

Në vendin e dytë (II) janë Republika e Kosovës dhe Maqedonia e Veriut me nga 39 pikë (Transparency International, 2022). Në vendin e tretë (III) renditet Serbia me 38 pikë ndërsa në vendin e fundit ndodhen Republika e Shqipërisë dhe Bosnja & Hercegovina me nga 35 pikë (Transparency International, 2022).

Bazuar në Tab.1. si më sipër mund të konstatohet po ashtu se gjatë viteve 2012-2021, Mali i Zi dhe Kosova kanë shënuar një trend pozitiv në luftën kundër korrupsionit. Maqedonia e Veriut

dhe Bosnja & Hercegovina kanë një trend negativ ndërsa Serbia dhe Shqipëria e kanë ruajtur një *status quo* në këtë aspekt.

Sidoqoftë, trendi pozitiv i shtetit të Kosovës në fushën e luftimit kundër korrupsionit është evidentuar edhe në Raportet e Progresit për Kosovën nga Komisioni Evropian ku është konstatuar se Kosova ka shënuar një nivel të caktuar të përgatitjes për luftimin e korrupsionit. Mirëpo përkundër trendit pozitiv gjatë periudhës raportuese, Kosova është ende në një stad të hershëm për luftën kundër korrupsionit, sipas vlerësimeve nga raportet e progresit.

- **Raporti i Progresit për Kosovën në vitin 2021** ka konstatuar se në fushën e luftimit të korrupsionit, *“Kosova ka shënuar progres të limituar sidomos në sektorin e korrupsionit të nivelit të lartë. Në mungesë të hetimeve pro aktive dhe vullnetit të qëndrueshëm politik, korrupsioni në Kosovë mbetet mjaft i shpërndarë dhe një shqetësim serioz për vendin”* (European Commission, 2021).
- **Raporti i Progresit për Kosovën në vitin 2020** ka konstatuar se në fushën e luftimit të korrupsionit, *“Kosova ka shënuar progres të limituar sidomos në sektorin e korrupsionit të nivelit të lartë si dhe konfiskimin e aseteve. Në mungesë të hetimeve pro aktive dhe vullnetit të qëndrueshëm politik, korrupsioni në Kosovë mbetet mjaft i shpërndarë dhe një shqetësim serioz për vendin. Projekt-Kodi i Procedurës Penale si dhe Projekt-Ligji për financimin e partive politike janë vonuar për miratim”* (European Commission, 2020).
- **Raporti i Progresit për Kosovën në vitin 2019** ka konstatuar se në fushën e luftimit të korrupsionit, *“Kosova ka shënuar progres për shkak të reformës legislative në fushën e sundimit të ligjit dhe hetimin e rasteve të profilit të lartë. Progres është shënuar edhe në sekuestrimin preliminar të aseteve mirëpo konfiskimi përfundimtar i tyre mbetet ende shumë i ulët. Në përgjithësi, korrupsioni në Kosovë mbetet mjaft i shpërndarë dhe një shqetësim serioz për vendin”* (European Commission, 2019).

Padyshim se një nga pasojat që mund të manifestoj korrupsioni ka të bëj me shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Prandaj korrupsioni ka qenë subjekt i trajtimit edhe nga

raportet vjetore të Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH) për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në Republikën e Kosovës.

Në përgjithësi mund të thuhet se Raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit kanë konfirmuar progresin e Republikës së Kosovës në luftën kundër korrupsionit, por duke konstatuar njëkohësisht se ky progres mbetet i pamjaftueshëm për të arritur nivelin e dëshirueshëm të luftimit të korrupsionit në shtetin e Kosovës.

- **Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për Kosovën në vitin 2021** ka theksuar se *“janë bërë disa hapa në drejtim të hetimit dhe ndëshkimit të korrupsionit në Kosovë megjithatë këto veprime anti korrupsion nuk kanë manifestuar konsistencë të vazhdueshme duke nxjerrë në pah edhe akterë të caktuar me indemnitet”* (U.S. Department of State, 2021).
- **Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për Kosovën në vitin 2020** ka theksuar se *“janë bërë disa hapa në drejtim të hetimit dhe ndëshkimit të korrupsionit megjithatë këto veprime nuk kanë manifestuar konsistencë të vazhdueshme duke nxjerrë në pah edhe akterë të caktuar me indemnitet. Në disa raste janë suspenduar ose larguar nga puna të dyshuarit për korrupsion të cilët në disa raste edhe janë dënuar nga gjykata. Mirëpo në shumë raste të tjera, zyrtarët publik të dyshuar për korrupsion kanë vazhduar të punojnë në sektorin publik”* (U.S. Department of State, 2020).
- **Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për Kosovën në vitin 2019** ka theksuar se *“janë bërë disa hapa në drejtim të hetimit dhe ndëshkimit të korrupsionit megjithatë këto veprime nuk kanë manifestuar konsistencë të vazhdueshme duke nxjerrë në pah edhe akterë të caktuar me indemnitet. Inspektorati Policor i Kosovës ka ndërmarrë disa veprime hetimore për shkak se edhe zyrtarët policor kanë qenë të dyshuar për vepra penale të korrupsionit”* (U.S. Department of State, 2019).

Korrupsioni përbën cenim të drejtpërdrejtë për lirinë dhe demokracinë për çdo vend duke manifestuar shkeljen e të drejtave dhe lirive politike dhe civile për qytetarët e atij vendi. Për

këtë arsye, korrupsioni është evidentuar edhe në raportet e Freedom House për shtetin e Kosovës.

Bazuar në këto raportet e Freedom House për Republikën e Kosovës për vitet 2021 dhe 2022 është konstatuar se shteti i Kosovës ka shënuar progres të caktuar në luftën kundër korrupsionit përmes disa reformave në këtë fushë, megjithatë korrupsioni vazhdon të mbetet mjaft prezent në shtetin e Kosovës (Freedom House, 2022).

- **Raporti i Freedom House për Kosovën në vitin 2022** ka theksuar se *“Qeveria e Kosovës ka iniciuar disa reforma në luftën korrupsionit. Megjithatë korrupsioni në përgjithësi mbetet mjaft prezent në Kosovë”* (Freedom House, 2022).
- **Raporti i Freedom House për Kosovën në vitin 2021** ka theksuar po ashtu se *“Qeveria e Kosovës ka iniciuar disa reforma në luftën korrupsionit. Megjithatë korrupsioni në përgjithësi mbetet mjaft prezent në Kosovë”* (Freedom House, 2021).

Përndryshe raportet e Freedom House për shtetin e Kosovës gjatë viteve 2021 dhe 2022 kanë potencuar edhe individ të caktuar me emra të përveçëm që dyshohet të jenë të përfshirë në afëra të korrupsionit si në nivelin lokal ashtu edhe në dikastere të ndryshme në nivelin qendror të qeverisjes në Republikën e Kosovës (Freedom House, 2021).

Njëkohësisht raportet e Freedom House për Kosovën nxjerrin në dritë edhe ushtrimin e vazhdueshëm të ndikimit nga shteti i Serbisë mbi një parti politike të caktuar në shtetin e Kosovës e cila emërtohet si *“Lista Serbe”* (Freedom House, 2021). Me këtë rast duhet shtuar se shteti i Serbisë në vazhdimësi është duke e shfrytëzuar këtë subjekt politik për arritjen e qëllimeve të saj propagandistike në kuadër të luftës së saj hibride kundër Republikës së Kosovës (Freedom House, 2021). Vlen të potencohet po ashtu se Freedom House përmes raporteve të saj vjetore, në përgjithësi ka vlerësuar se shumica e shteteve në Ballkanin Perëndimor duke përfshirë edhe Republikën e Kosovës në këtë mes, janë pjesërisht të lira në kuptim të respektimit të drejtave civile dhe politike të qytetarëve.

3.1. Korrupsioni si faktor shtytës për *“ikjen e trurit”* nga Kosova

Përveç raporteve të ndryshme ndërkombëtare, korrupsioni është konstatuar si sfidë serioze për Kosovën edhe nga raportet e ndryshme të shoqërisë civile brenda Republikës së Kosovës. Si shembull, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka konstatuar se *“Korrupsioni në Kosovë është endemik. Kosova vuan nga mungesa e vullnetit për të luftuar korrupsionin në praktikë në të gjitha hallkat e pushtetit. Luftimi i korrupsionit të nivelit të lartë mbetet retorikë, përderisa rezultatet konkrete mungojnë”* (Instituti i Kosovës për Drejtësi, 2022). Ngjashëm kanë raportuar edhe disa portale vendore (Kallxo.com, 2022).

Ajo që mbetet shqetësuese lidhur me temën e korrupsionit në shtetin e Kosovës janë pasojat e korrupsionit për shoqërinë kosovare. Nuk është kontestuese që pasojat e korrupsionit shpërfaqen në administratën publike, sistemin gjyqësor, sistemin shëndetësor, sistemin arsimor, ambientin mjedisor dhe pothuajse në të gjitha poret e tjera të shoqërisë. Prandaj në mesin e shumë sferave dhe dimensioneve që mund të preken nga pasojat e korrupsionit, mund të thuhet se korrupsioni është po ashtu një nga shkaktarët kryesorë të ‘ikjes së trurit’ respektivisht migrimit të rinisë dhe fuqisë punëtore të kualifikuar nga shteti i Kosovës në drejtim të vendeve perëndimore. Në vijim mund të konfirmohet se një konstatim i ngjashëm është mbështetur edhe nga disa raporte kredibile të organizatave të ndryshme të shoqërisë civile që merren me monitorimin dhe hulumtimin e korrupsionit në Republikën e Kosovës.

Kur flasim për ‘ikjen e trurit’ dhe migrimin në përgjithësi, duhet cekur se njerëzit në parim janë çdo herë në lëvizje nga një vend në vendin tjetër sepse ata shtyhen apo tërhiqen prej faktorëve të ndryshëm shoqëror. Në këtë kontekst, migrimi është një cikël i cili nuk përfundon asnjëherë mirëpo shfaqet në intensitete të ndryshme në vende dhe në kohë të ndryshme.

Migrimi i popullsisë nuk është gjithmonë një zgjidhje e dyanshme përfituese për të dy shtetet e përfshira. Në fakt, kur fuqia punëtore profesionale apo e kualifikuar largohet nga një shtet, ky fenomen për atë shtet njihet si *“ikje e trurit”* (European Commission, 2021). Në anën tjetër, për shtetin e destinacionit të asaj fuqie punëtore profesionale apo të kualifikuar, fenomeni i njëjtë njihet si *“përfitim i trurit”* (European Commission, 2021).

Bazuar në një hulumtim të European Policy Institute of Kosova (EPIK), gjatë periudhës kohore

2008-2018 mbi 344,660 persona janë larguar nga Republika e Kosovës në drejtim të Bashkimit Evropian në kërkim të mirëqenies më të mirë (European Policy Institute of Kosovo, 2019, p. 2). Në mesin e tyre, rreth 141,330 shtetas të Republikës së Kosovës janë gjetur duke qëndruar ilegalisht në vendet e ndryshme të Bashkimit Evropian. Njëkohësisht rreth 203,330 shtetasit e tjerë të Republikës së Kosovës kanë parashtruar kërkesë për azil në shtetet e ndryshme të Bashkimit Evropian (European Policy Institute of Kosovo, 2019, p. 2).

Bazuar në matjet e fundit në Republikën e Kosovës nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, numri i banorëve rezidentë në shtetin e Kosovës është rreth 1,782,115 banorë (Kosovo Agency of Statistics, 2020, p. 12). Rrjedhimisht, nëse marrim si të mirëqena statistikat e mësipërme që ka shpërfaqur hulumtimi i European Policy Institute of Kosova, mund të thuhet se vetëm brenda dhjetë (10) viteve (2008-2018), përafërsisht 1/5 ose 19.5% e popullsisë kosovare kanë ikur nga Republika e Kosovës në drejtim të vendeve të ndryshme të Bashkimit Evropian.

Duhet shtuar se gjatë viteve 2012-2015, Republika e Kosovës është ballafaquar edhe me kriza serioze të migrimit jo të rregullt. Gjatë kësaj periudhe kohore mendohet se mbi 135.000 shtetas të Republikës së Kosovës kanë migruar në mënyrë jo të rregullt nga shteti i Kosovës në drejtim të vendeve të ndryshme në Bashkimin Evropian për të parashtruar më pas kërkesë për azil në këto shtete të Bashkimit Evropian (Halili Xhevdet, 2017, pp. 90, 91). Në mesin e këtyre azilkërkuesve kosovar, konsiderohet se mbi 75% të tyre kanë qenë të moshës 0-34 vjet e cila grup-moshë përfaqëson shumicën mesatare të popullsisë dhe të fuqisë punëtore në Kosovë (Halili Xhevdet, 2017, pp. 90, 91). Në anën tjetër, mesatarja e nivelit të tyre të shkollimit mendohet të ketë qenë më e lartë se mesatarja e përgjithshme e nivelit të shkollimit të banorëve rezident në Republikën e Kosovës (World Bank Group, 2018, p. 21). Prandaj kur analizohet mosha mesatare dhe niveli mesatar i shkollimit të këtyre azilkërkuesve, si dhe kur këta dy faktorë i krahasojmë me moshën mesatare dhe nivelin mesatar të shkollimit me banorët rezident në Republikën e Kosovës, atëherë mund të konstatojmë se gjatë kësaj periudhe kohore (2012-2015), në simbiozë me krizën e migrimit jo të rregullt mund të jetë manifestuar edhe një krizë e *“ikjes masive të trurit”* nga Republika e Kosovës (World Bank Group, 2018, p. 21).

Gjatë periudhës kohore nga viti 2014 deri në vitin 2019, mesatarisht 87,059 shtetas të Kosovës brenda vitit kanë aplikuar për vizë në zonën schengen (Schengen Visa Info, 2014-2020). Bazuar në matjet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për numrin e përgjithshëm të banorëve në Republikën e Kosovës, kjo nënkupton se përafërsisht 4.9% e popullsisë çdo vit gjatë periudhës kohore nga viti 2014 deri në vitin 2019 kanë aplikuar për vizë për në zonën schengen. Ky fakt mund të mos ndërlidhet drejtpërdrejtë me migrimin dhe aq më pak me korrupsionin si faktor shtytës për migrim nga Republika e Kosovës. Mirëpo këto të dhëna statistikore padyshim mund të konfirmojnë se qytetarët e Kosovës për arsye të ndryshme vazhdimisht kërkojnë që të udhëtojnë për në zonën schengen.

Duhet shtuar se mungesa e liberalizimit të vizave të zonës schengen për shtetasit e Republikës së Kosovës, natyrshëm i pengon ata që të lëvizin lirshëm nga shteti i Kosovës për në Bashkimin Evropian dhe anasjelltas. Nga ky këndvështrim, mund të thuhet edhe se shtetasve të Republikës së Kosovës është duke ju mohuar jo vetëm një liri themelore e njeriut siç është liria e lëvizjes së lirë, por edhe një nga vlerat evropiane më bazike të proklamuar si shtyllë të vet Bashkimit Evropian. Në anën tjetër duhet shtuar se pikërisht arsyetimi i Bashkimit Evropian për mungesën e liberalizimit të vizave për shtetasit e Republikës së Kosovës ndërlidhet jo rrallë me “mungesën e progresit kundër korrupsionit” në shtetin e Kosovës, pa çka se ky proces është më shumë politik sesa gjithçka tjetër (Prishtina Insight, 2021). Sidoqoftë për nevojat e këtij punimi duhet të potencohet edhe ky narracion në mënyrë që të shpërfaqet ose jo korrupsioni si faktor shtytës i migrimit në formë të ‘ikjes së trurit’ nga Republika e Kosovës në drejtim të Bashkimit Evropian.

Tab. 2. Numri i aplikimeve për viza në Zonën Schengen nga Kosova


Viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
#Nr.	74,286	80,175	77,800	90,478	90,840	108,774	26,036
%Prq.	4.2	4.5	4.4	5.1	5.1	6.1	1.5

Burimi: (Schengen Visa Info, 2014-2020).

Vlen të theksohet se numri i aplikacioneve për viza schengen është rritur vazhdimisht që nga viti 2014 deri në vitin 2019 kur është arritur zeniti me 108.774 aplikacione apo 6.1% e popullsisë në Kosovë (Schengen Visa Info, 2014-2020).

Në fund të vitit 2018 afërsisht 854,198 kosovarë kanë qenë duke jetuar jashtë Kosovës, shumica në Gjermani dhe në Zvicër (Balkans Policy Research Group, 2020, p. 13). Nga 2011 deri në 2018, numri i lejeve për qëndrim të përkohshëm për shtetasit e Kosovës është rritur çdo vit. Shumica e tyre kanë qenë për punë ose për bashkim familjar (Balkans Policy Research Group, 2020, p. 19).


Fig. 2. Numri i leje qëndrimeve në BE për shtetasit e Kosovës



Burimi: (Balkans Policy Research Group, 2020, p. 19).

Gjermania mbetet destinacioni më i preferuar për migrantët nga Kosova. Supozohet se në vitin 2017 mbi 433.000 kosovarë kanë qenë duke jetuar në Gjermani dhe prej tyre mbi 66% kanë qenë edhe duke punuar atje (GAP Institute, 2020, pp. 23-24). Vetëm gjatë viteve 2016-2018, mbi 67.272 persona apo 3.78% e popullsisë në Kosovë kanë aplikuar për një vend të punës në Gjermani (GAP Institute, 2020, p. 15). Prej tyre, 67.272 ose 96% e aplikacioneve janë miratuar në parim nga Agjencia Federale e Gjermanisë për Punësim (GAP Institute, 2020, p. 23).

Fig. 3 Aprovimet preliminare të kërkesave për punësim të kosovarëve në Gjermani



Burimi: (GAP Institute, 2020, p. 23).

Kosova ka popullsinë më të re në rajon me rreth 25% të popullsisë nën moshën 15 vjet (Eurostat, 2019). Me një strukturë kaq të re të popullsisë, natyrshëm se të rinjtë në Kosovë janë jo vetëm më të prekurit nga korrupsioni por janë edhe në qendër të vëmendjes kur flitet për ikjen e trurit përmes migrimit nga Kosova. Organizata Gallup Research Migration Center ka publikuar rezultatet e anketës së zhvilluar lidhur me Indeksin e Potencialit Neto për Migrim (Potential Net Migration Index - PNMI) ku Kosova është vlerësuar me -48% humbje neto të rinisë dhe -43% ikje të trurit për shkak të migrimit gjatë viteve 2015-2017. Kosova është

vlerësuar me -42% PNMI që është njëkohësisht rezultati më negativ në rajon lidhur me ikjen neto të popullsisë në rajon (Gallup Research Migration Center, 2018). Nëse këto rezultate të indeksit të migrimit (PNMI) nga Gallupi i lexojmë njëkohësisht me Indeksën e Perceptimit të Korrupsionit (CPI) nga Transparency International gjatë kësaj periudhe, mund të konstatohet se ikja e trurit nga Kosova mund të jetë e lidhur ngushtë edhe me nivelin e korrupsionit në vend.

Grupi për Hulumtim të Politikave në Ballkan në vitin 2020 kishte konstatuar se korrupsioni, nepotizmi, papunësia, sistemi i dobët shëndetësor dhe arsimor janë ndër faktorët kryesor shtytës për migrim nga Kosova (Balkans Policy Research Group, 2020, pp. 14, 19). Mirëpo nuk ka dilemë se sistemi shëndetësor është përfundimisht sistemi më i dëmtuar në Kosovë për shkak të ikjes së trurit nga Kosova (Ahmetxhekaj, Shkumbin, 2019).

Situata politike, juridike dhe ekonomike në vend konsiderohet se përbëjnë shkaktarët kryesor për migrimin e kosovarëve (European Policy Institute of Kosovo, 2019, p. 10). Bazuar në një matje të bërë më herët nga shoqëria civile në Republikën e Kosovës, rreth 43% e të rinjve besojnë se korrupsioni dhe nepotizmi janë sfidat kryesore për të jetuar në Kosovë (European Policy Institute of Kosovo, 2019, p. 10). Për më tepër, rreth 58% e të rinjve kanë vendosur ose kanë filluar të marrin në konsideratë migrimin e tyre nga Republika e Kosovës (European Policy Institute of Kosovo, 2019, p. 10).

Sektorët më të dëmtuar prej ikjes së trurit nga shteti i Kosovës mendohet të jenë sektori i shëndetësisë, teknologjisë, ndërtimit, hotelarisë dhe turizmit (Balkans Policy Research Group, 2020, p. 21). Përfituesi më i madh në anën tjetër rezulton të jetë shteti Gjerman për shkak se rezulton të jetë vendi më i preferuar i destinacionit për migrantët kosovarë.

KAPITULLI II – ASPEKTI JURIDIK I PËRCAKTIMIT TË KORRUPSIONIT

1. Korniza juridike për luftimin e korrupsionit në Republikën e Kosovës

Në Republikën e Kosovës konsiderohet se ekziston një strukturë juridike dhe institucionale mjaft e konsoliduar në luftën kundër korrupsionit. Kjo nënkupton që ekzistojnë ligjet dhe institucionet funksionale përmes të cilave mund të manifestohet lufta e shtetit të Kosovës

kundër korrupsionit. Në fakt, sipas vlerësimeve të ekspertëve vendor dhe ndërkombëtar mund të thuhet që legjislacioni i Republikës së Kosovës në fushën e luftimit të korrupsionit, në përgjithësi është i harmonizuar me standardet e fundit ndërkombëtare (Këshilli i Evropës & Unioni Evropian, 2013, p. 14).

Një numër i konsiderueshëm i kritikave drejtuar shtetit të Kosovës për luftimin e korrupsionit, parimisht nuk i referohen mungesës së ligjeve apo institucioneve kompetente për këtë fushë. Në vend të kësaj, shqyrtimet kritike mund të fokusohen më tepër në efikasitetin dhe efektivitetin e kësaj kornize ligjore dhe institucionale për luftimin e korrupsionit në Republikën e Kosovës.

Disa nga aktet juridike kryesore të cilat përbëjnë bazën juridike në fuqi kundër korrupsionit në shtetin e Kosovës janë:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës (KRK, 2008);
- Kodi nr. 06/L-074 Penal i Kosovës (KPRK, 2019);
- Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale së Kosovës (KPPRK, 2013);
- Ligji nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar edhe Konfiskuar (LAPSK, 2016);
- Ligji nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (LPKI, 2018);
- Ligji nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit (LAKK, 2010);
- Ligji nr. 04/L-050 për Deklarimin, Origjinën dhe Kontrollin e Pronës së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Origjinën dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë (LDP, 2011);
- Ligji nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë (LKZKP, 2018).

Duhet potencuar faktin se Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar edhe Strategjinë Shtetërore kundër Korrupsionit si dhe Planin e Veprimit për vitin 2018-2022 (Agjencia Kundër Korrupsionit, 2017, p. 12). Synim i kësaj strategjie konsiderohet të jetë luftimi efikas i

korupsionit përmes rritjes së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet të gjithë akterëve relevant në këtë fushë (Agjencia Kundër Korupsionit, 2017, p. 12).

Sidoqoftë, është i padiskutueshëm fakti se korupsioni si fenomen kriminal është mjaft dinamik sikurse në kuptim të formës ashtu edhe në kuptim të mënyrës së paraqitjes. Prandaj është e domosdoshme që edhe korniza juridike në fuqi të jetë në hap me trendet eventuale të zhvillimit të korupsionit në vendin dhe kohën e caktuar.

Në kapitujt në vijim të këtij punimi, do të mund të konfirmohet se aktualisht në qendër të vëmendjes mendohet të jetë korupsioni që zhvillohet përmes sistemeve elektronike të kriptovalutave. Njëkohësisht fokusi mbetet te korupsioni në sektorin privat si dhe te mbrojtja e viktimave të korupsionit përmes mjeteve juridike civile. Prandaj mund të thuhet se Republika e Kosovës do të duhet të ndërmarrë masat dhe veprimet e nevojshme për të siguruar që korniza ligjore në fuqi do të reflektoj me format moderne në të cilat manifestohet korupsionit.

Aktualisht mund të thuhet se Republika e Kosovës nuk ka miratuar ende aktet ligjore të nevojshme përmes të cilave me mjete juridiko civile apo penale do të mund të parandalohen dhe luftohen format e ndryshme të korupsionit përmes kriptovalutave. Po ashtu mungon edhe korniza përkatëse ligjore përmes të cilës do të mund të adresohet dhe rregullohet plotësisht çështja e mbrojtjes së viktimave të korupsionit përmes mjeteve efektive juridike civile duke përfshirë këtu edhe kompensimin e dëmit që mund të jetë shkaktuar nga korupsioni. Në anën tjetër, që nga viti 2019 në Republikën e Kosovës janë inkriminuar si vepra penale marrja e ryshfetit në sektorin privat si dhe dhënia e ryshfetit në sektorin privat. Megjithëse mund të jetë parashtruar ndonjë aktakuzë për shkak të këtyre veprave penale, ky hulumtim ka gjetur se deri sot nuk mund të evidentohet ndonjë aktgjykim penal fajësues dhe i formës së prerë për këto vepra penale të korupsionit në sektorin privat. Ky fakt mund të nënkupton që shteti i Kosovës ende mbetet në një fazë të hershme edhe sa i përket luftës efikase kundër korupsionit në sektorin privat përmes figurave ligjore të inkriminimeve që janë në fuqi prej vitit 2019.

2. Korniza juridike ndërkombëtare për luftimin e korupsionit

Mobilizimi i organizatave kompetente ndërkombëtare në fushën kundër korrupsionit është një pasqyrim tjetër i rrezikshmërisë dhe pasojave të rënda që sjell me vete fenomeni i korrupsionit për të gjitha shtetet dhe shoqëritë pa përjashtim.

Mendohet se një numër i konsiderueshëm i instrumenteve juridike ndërkombëtare kundër korrupsionit janë miratuar veçanërisht prej viteve të nëntëdhjeta të shekullit njëzet dhe më tutje deri më tani (Jónasson, 2005, p. 24). Sot mund të thuhet se është konsoliduar një infrastrukturë juridike ndërkombëtare e konsiderueshme kundër korrupsionit.

Ky kapitull ka për qëllim që të pasqyroj vetëm në mënyrë të përgjithshme instrumentet dhe mekanizmat kryesor ndërkombëtar për luftimin e korrupsionit. Rrjedhimisht aspekti juridik ndërkombëtar i përcaktimit të korrupsionit në këtë kapitull është trajtuar përmes dy (2) dimensioneve kryesore si në vijim:

- a) Dimensioni global respektivisht universal apo instrumentet juridike të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për luftimin e korrupsionit;*
- b) Dimensioni regjional respektivisht evropian apo instrumentet juridike të Këshillit të Evropës për luftimin e korrupsionit.*

2.1. Instrumentet juridike të Kombeve të Bashkuara për luftimin e korrupsionit

Në fund të shekullit XX dhe fillim të shekullit XXI, OKB ka miratuar disa instrumente të ndryshme me qëllim të luftimit të korrupsionit (Jónasson, 2005, p. 25). Në mesin e tyre, kryesoret janë:

- **Kodi për sjelljen e zyrtarëve publik** (UNCC, 1979);
- **Deklarata kundër korrupsionit në transaksionet komerciale ndërkombëtare** (UNDC, 1997);
- **Konventa kundër Krimit të Organizuar Transnacional** (UNCTOC, 2000);
- **Konventa kundër Korrupsionit** (UNCAC, 2003).

Kodi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Sjelljen e Zyrtarëve Publik i vitit 1979 është një instrument ndërkombëtar përmes të cilit Organizata e Kombeve të Bashkuara ka arritur të përcaktoj nocionet e përgjithshme për sjelljen e zyrtarëve publik (UNCC, 1979, p. neni 7). Kombet e Bashkuara përmes këtij kodi kanë vënë në dukje detyrimin e zyrtarëve publik për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të tyre me përkushtim dhe profesionalizëm me qëllim të rritjes së integritetit në administratën shtetërore (UNCC, 1979, p. neni 7).

Neni 7 i Kodit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Sjelljen e Zyrtarëve Publik përcakton se *“Zyrtarët e zbatimit të ligjit nuk duhet të përfshihen në kryerjen e veprave të korrupsionit. Ata duhet në mënyrë rigoroze të kundërshtojnë dhe luftojnë veprat e tilla”* (UNCC, 1979, p. neni 7). Termi korrupsion për nevojat e Kodit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Sjelljen e Zyrtarëve Publik nënkupton *“veprimet apo mosveprimet lidhur me detyrën zyrtare që përfshijnë një dhuratë, premtim apo iniciativë të pranuar ose kërkuar kundërligjshëm para ose pas veprimit apo mosveprimit të caktuar”* (UNCC, 1979, p. neni 7).

Deklarata e Organizatës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit në transaksionet komerciale ndërkombëtare e vitit 1997 është një deklaratë përmes të cilës Organizata e Kombeve të Bashkuara bën thirrje për miratimin dhe zbatimin e ligjeve me të cilat luftohet korrupsioni në të gjitha nivelet duke përfshirë këtu edhe transaksionet ekonomike ndërkombëtare (UNDC, 1997, p. 4). Përmes kësaj deklarate është arritur të nxirret në pah nevoja që jo vetëm shtetet por edhe ndërmarrjet ekonomike si dhe organizatat ndërkombëtare duhet të bashkëpunojnë ngushtë në luftën kundër korrupsionit (UNDC, 1997, p. 4).

Deklarata kundër korrupsionit në transaksionet komerciale ndërkombëtare si e tillë mund të ngjasoj më tepër me një tentativë të asaj kohe për të trasuar rrugën e mobilizimit ndërkombëtar kundër korrupsionit (UNDC, 1997, p. 4). Megjithatë kjo deklaratë ka arritur të përcaktoj elementet kryesore *inter alia* të cilat mund të përbëjnë figurën ligjore të korrupsionit në kontekst të kësaj deklarate siç janë ofrimi, pranimi, kërkesa, dhënia ose marrja e kundërligjshme, direkte ose indirekte, e dhuratës, pagesës apo përfitimit tjetër nga korporatat publike apo subjektet tjera private apo edhe nga vet individët e shtetit tjetër në këmbim të një

veprimi apo mosveprimi në kuadër të një transaksioni komercial ndërkombëtar (UNDC, 1997, p. 4).

Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional e vitit 2000 ka për qëllim të promovoj bashkëpunimin në funksion të parandalimit dhe luftimit më efikas të krimit të organizuar transnacional (UNCTOC, 2000, p. neni 1).

Mund të thuhet se Konventa kundër Krimit të Organizuar Transnacional i ka kushtuar vëmendje të posaçme inkriminimit të korrupsionit me element të huaj. Përndryshe neni 8 i Konventës kundër Krimit të Organizuar Transnacional kërkon nga shtetet anëtare të saj që të miratojnë masa ligjore dhe masa tjera të nevojshme për të përcaktuar korrupsionin si vepër penale që kryhet me dashje (UNCTOC, 2000, p. neni 8). Për nevojat e kësaj dispozite, korrupsioni nënkupton premtimin, ofrimin apo dhënien direkte ose indirekte, të një avantazhi të kundërligjshëm, një zyrtari publik për veten e tij apo një personi apo një etniteti tjetër, në mënyrë që të realizohet një veprim apo mosveprim i ndërlidhur me detyrën zyrtare (UNCTOC, 2000, p. neni 8).

Tutje, neni 9 i Konventës kundër Krimit të Organizuar Transnacional i referohet masave që duhet të ndërmarrin shtetet anëtare për luftimin e korrupsionit. Në këtë pjesë të kësaj konvente synohet që të përcaktohen detyrimet ndërkombëtare për secilin shtet anëtar për të miratuar masat ligjore, masat administrative si dhe masat tjera juridike efektive përmes të cilave duhet të promovohet integriteti me qëllimin që të parandalohet, zbulohet dhe të dënohen zyrtarët publik për veprat e tyre të korrupsionit (UNCTOC, 2000, p. neni 9).

Neni 9 i Konventës kundër Krimit të Organizuar Transnacional kërkon gjithashtu nga shtetet anëtare që të themelojnë autoritetet e brendshme kompetente për luftimin e korrupsionit si dhe të sigurojnë që këto autoritete kompetente të jenë plotësisht të pavarura dhe profesionale në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësiive ligjore për luftimin e formave të ndryshme të korrupsionit (UNCTOC, 2000, p. neni 9).

Duhet shtuar po ashtu se Konventa kundër Krimit të Organizuar Transnacional i ka kushtuar vëmendje edhe çështjes së sekuestrimit dhe konfiskimit ashtu që përmes nenit 12 dhe 13 ka

përcaktuar se shtetet anëtare duhet të fuqizojnë sistemet e tyre për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së kundërligjshme si dhe të bashkëpunojnë në nivel ndërkombëtar me qëllim të rritjes së efikasitetit të konfiskimit (UNCTOC, 2000, pp. neni 12, 13).

Konventa kundër Korrupsionit është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 31 tetor 2003 dhe ka hyrë në fuqi më 14 dhjetor 2005 (UNODC Web, 2022).

Deri më 18 nëntor 2021, mund të evidentohen 189 shtete anëtare në Konventën kundër Korrupsionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNODC Web, 2022). Kuptohet se ky numër i madh i ratifikimeve të Konventës kundër Korrupsionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara mund të interpretohet edhe si reflektim i përgjithshëm i konsensusit dhe mobilitetit të gjerë ndërkombëtar për luftimin efikas dhe efektiv të formave të ndryshme të korrupsionit (Cloots, 2012, p. 14).

Bazuar në nenin 1, mund të thuhet se qëllimi i Konventës kundër Korrupsionit është që të promovoj dhe fuqizoj masat për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në mënyrë më efikase dhe efektive (UNCAC, 2003, p. neni 1).

Njëkohësisht mund të thuhet se Konventa kundër Korrupsionit ka për qëllim edhe që të promovoj dhe përkrahë bashkëpunimin ndërkombëtar si dhe asistencën teknike për luftimin e korrupsionit duke përfshirë këtu edhe marrjen respektivisht sekuestrimin edhe konfiskimin e aseteve të kundërligjshme të cilat janë përfituar nga korrupsioni apo janë përdorur për kryerjen e veprat e ndryshme penale të korrupsionit (UNCAC, 2003, p. neni 1).

Konventa kundër Korrupsionit e Organizatës së Kombeve të Bashkuara përmes nenit 1 të saj i kushton një vëmendje të posaçme edhe promovimin e integritetit, llogaridhënies dhe menaxhimit adekuat të pronës publike (UNCAC, 2003, p. neni 1). Në këtë kontekst mund të konstatohet se Organizata e Kombeve të Bashkuara e proklamon fuqizimin e integritetit të zyrtarëve publik si një nga mekanizmat më themelor për luftimin efikas dhe efektiv të korrupsionit në të gjitha format e saj. Paralelisht me mbrojtjen dhe fuqizimin e integritetit të zyrtarëve publik edhe rritja e nivelit të llogaridhënies së tyre së bashku me menaxhimin efikas

dhe efektiv të resurseve publike përmes nenit 1 të kësaj konvente vendosen në qendër të vëmendjes për luftimin e suksesshëm të gjitha formave të korrupsionit jo vetëm në dimensionin e brendshëm por edhe në dimensionin transnacional.

2.2. Instrumentet juridike të Këshillit të Evropës për luftimin e korrupsionit

Këshilli i Evropës është një organizatë regjionale e krijuar në vitin 1949 e cila sot numëron gjithsej dyzet e gjashtë (46) shtete anëtare (Council of Europe Web Site, 2022).

Të drejtat dhe liritë e njeriut, demokracia dhe sundimi i ligjit promovohen si vlerat më fundamentale mbi të cilat është krijuar dhe mbi të cilat vazhdon të funksionon Këshilli i Evropës (Council of Europe Web Site, 2022). Me qëllimin për të ruajtur dhe garantuar këto vlera themelore të cilat manifestojnë shtyllat kryesore identifikuese të saj, Këshilli i Evropës ka arritur të konsolidoj një ndërthurje komplekse mirëpo mjaft të qëndrueshme të instrumenteve juridike ndërkombëtare që janë juridikisht të obligueshme për shtetet anëtare të saj. Njëkohësisht është arritur të etablohet edhe sistemi po aq kredibil i mekanizmave përkatës për mbikëqyrjen e zbatimit efikas edhe efektiv të këtyre instrumenteve juridike ndërkombëtare.

Në frymën e misionit të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, promovimit të demokracisë si dhe sundimit të ligjit, padyshim që korrupsioni ndodhet në krye të listës së preokupimeve të shteteve anëtare në Këshillin e Evropës. Në këtë kontekst, luftimi i korrupsionit është vendosur në qendër të fushëveprimit të kësaj organizate evropiane.

Duke filluar nga fundi i viteve të tetëdhjeta të shekullit të kaluar deri më sot, Këshilli i Evropës ka arritur të konsolidoj një infrastrukturë të instrumenteve juridike ndërkombëtare si dhe mekanizmave përkatës për parandalimin dhe luftimin e formave të ndryshme të korrupsionit. Në kuadër të kësaj game të gjerë të instrumenteve juridike ndërkombëtare për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, ekzistojnë dy (2) konventa të Këshillit të Evropës të cilat kanë rëndësi të veçantë për fushën kundër korrupsionit e rrjedhimisht edhe për objektivat e këtij punimi:

- **Konventa Penale kundër Korrupsionit** (Criminal Law Convention on Corruption, 1999);

- **Konventa Civile kundër Korrupsionit** (Civil Law Convention on Corruption, 1999).

Në përputhje me hipotezat dhe qëllimet e këtij hulumtimi, kapituajt në vijim të këtij punimi do të përqendrohen në shqyrtimin e thuktë të dispozitave relevante të këtyre dy konventave në krahasim me kornizën ligjore kundër korrupsionit në Republikën e Kosovës.

2.2.1. Konventa Penale kundër Korrupsionit

Ministrat e Drejtësisë në Këshillin e Evropës në vitin 1994 kanë mbajtur një konferencë ku ishte konstatuar se korrupsioni përbën cenim të drejtpërdrejtë për vlerat më themelore në çdo shoqëri demokratike ku respektohen të drejtat e njeriut, rendi dhe ligji (Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, 1994, p. 2). Konstatim tjetër në këtë konferencë ka qenë po ashtu se korrupsioni nuk është vetëm shqetësim multidimensional por edhe kërcënim transnacional (Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, 1994, p. 4). Për pasojë, lufta kundër korrupsionit nuk mund të bëhet individualisht por duhet të bazohet në bashkëpunimin e ngushtë ndërshtetëror (Ibrahimi B. G., 2020, p. 230).

Në këtë mënyrë gjatë viteve të nëntëdhjeta të shekullit njëzet, mund të thuhet se luftimi i korrupsionit ishte vendosur në qendër të vëmendjes së Këshillit të Evropës (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 2).

Në vitin 1994 ishte themeluar Grupi Multidisiplinar kundër Korrupsionit me qëllim të hulumtimit masave dhe veprimeve ligjore kundër korrupsionit si dhe krijimit të një plani të veprimit me përmasa ndërkombëtare dhe gjithëpërfshirëse (Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, 1994, p. 20).

Grupi Multidisiplinar kundër Korrupsionit si trup i themeluar në kuadër të Këshillit të Evropës kishte përgatitur Planin e Veprimit kundër Korrupsionit të cilin si të tillë Këshilli i Evropës e kishte miratuar në vitin 1996 (Multidisciplinary Group on Corruption - GMC, 1996). Ky dokument në fakt ka qenë hapi i parë konkret i Këshillit të Evropës për aprovimin e Konventës Penale kundër Korrupsionit (Ibrahimi B. G., 2020, p. 230).

Një moment tjetër i rëndësishëm në luftimin e korrupsionit nga Këshilli i Evropës ka ndodhur edhe në vitin 1997 kur janë miratuar “Njëzet Parimet Udhëheqëse për Luftën Kundër Korrupsionit” (Ibrahimi B. G., 2020, p. 230). Ky dokument kishte për qëllim të unifikoj sa më shumë që është e mundur kornizat legislative të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës në luftimin e korrupsionit (CoE Resolution (97)24, 1997).

Në vazhden e këtyre zhvillimeve, Këshilli i Evropës në vitin 1998 kishte miratuar një rezolutë për themelimin e një trupi tjetër të quajtur “Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit” (CoE Resolution (98)7, 1998). Qëllimi i këtij trupi ishte monitorimi i zbatimit të Parimeve Udhëheqëse kundër Korrupsionit si dhe Planin e Veprimit kundër Korrupsionit (Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, 1999, p. 9).

Konventa Penale kundër Korrupsionit është miratuar në vitin 1998 për të hyrë në fuqi më pas në vitin 2002 (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 5). Deri sot kjo konventë është ratifikuar nga gjithsej 46 shtete anëtare (ETS No. 173 - Treaty Office, 2022).

Raporti shpjegues i Konventës Penale kundër Korrupsionit ka evidentuar një numër të konsiderueshëm të sfidave dhe pengesave me të cilat ballafaqohet luftimi i korrupsionit sot në nivel ndërkombëtar (Ibrahimi B. G., 2020, p. 231). Dy (2) prej këtyre sfidave kryesore sipas këtij raporti shpjegues të Këshillit të Evropës janë:

- I. Përcaktimi i një definicioni sa më gjithëpërfshirës dhe të pranueshëm përtej divergjencave që mund të shpërfaqen nga legjislacionet e brendshme të shteteve anëtare të Konventës Penale kundër Korrupsionit (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 5).
- II. Rritja e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në drejtim të tejkalimit me sukses të pengesave eventuale të natyrës politike apo burokratike që mund të shpërfaqen, duke pasur në qendër të vëmendjes qëllimin e përbashkët për luftimin e korrupsionit transnacional (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 5).

Fushëveprimi i Konventës Penale kundër Korrupsionit përfshinë një diapazon të gjerë për shkak të relativizimit të diskrepancave relativisht të mëdha që mund të manifestohen në mes të

shteteve anëtare në fushën kundër korrupsionit (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 6). Prandaj mund të konstatohet se një nga qëllimet themelore të Konventës Penale kundër Korrupsionit është po ashtu përcaktimi i parimeve kryesore për luftimin e korrupsionit. Kështu synohet edhe harmonizimi i botëkuptimeve të ndryshme të shteteve mbi korrupsionin si dhe rritjes së bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në këtë drejtim (Ibrahimi B. G., 2020, p. 231).

Në kapitullin e dytë të Konventës Penale kundër Korrupsionit janë përcaktuar masat që shtetet anëtare duhet të ndërmarrin në nivel të brendshëm. Për të gjitha masat e përcaktuara, Konventa Penale kundër Korrupsionit ka fokusuar së paku dy (2) elemente kryesore në kuadër të secilës prej dispozitave të saj:

- a) Miratimin e masave legislative apo masave tjera të nevojshme për të miratuar inkriminimin përkatës;*
- b) Figurën ligjore të inkriminimit përkatës.*

Përmes Konventës Penale kundër Korrupsionit janë inkriminuar format kryesore në të cilat mund të manifestohet korrupsioni siç janë korrupsioni aktiv dhe korrupsioni pasiv në sektorin publik, pastaj korrupsioni aktiv dhe korrupsioni pasiv në sektorin privat, ushtrimi i ndikimit, etj (Criminal Law Convention on Corruption, 1999, pp. art. 2-13).

Përmes nenit 18 të Konventës Penale kundër Korrupsionit parashihen tri (3) forma të korrupsionit për të cilat edhe personat juridik duhet të mbahen përgjegjës sipas legjislacioneve të brendshme të shteteve anëtare (Criminal Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 18):

- 1. Korrupsioni aktiv,*
- 2. Ushtrimi i ndikimit dhe*
- 3. Pastrimi i parave.*

Për këto tri (3) forma të korrupsionit si më sipër, bazuar në nenin 18 të Konventës Penale kundër Korrupsionit nuk kërkohet nga shtetet që të përcaktojnë patjetër sanksione penale (Criminal Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 18). Mjafton të përcaktohen masa

monetare (dënime me gjobë) por të cilat duhet të jenë efektive, proporcionale dhe shtrënguese (Criminal Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 18).

Ndërsa nenet 20 deri 23 të Konventës Penale kundër Korrupsionit kryesisht u referohen masave që shtetet duhet të ndërmarrin jo për inkriminimin e formave të caktuara të korrupsionit, por edhe për ndjekjen penale të këtyre veprave penale të korrupsionit.

Duhet shtuar po ashtu se përmes nenit 20 të Konventës Penale kundër Korrupsionit përcaktohet edhe detyrimi i shteteve anëtare për krijimin e autoriteteve të specializuara për luftimin e korrupsionit (Criminal Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 20). Përtej krijimit të këtyre autoriteteve të specializuara si të tilla, shtetet duhet të ndërmarrin edhe masat e nevojshme për të garantuar se ato do të jenë profesionale, të pavarura dhe do të funksionojnë në përputhje me parimet e përcaktuara me Konventën Penale kundër Korrupsionit (Criminal Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 20).

2.2.2. Konventa Civile kundër Korrupsionit

Në kuadër të historisë juridike të luftës kundër korrupsionit ndodhet i gdhendur një moment shumë i rëndësishëm kur për të parë nga Këshilli i Evropës promovohet përdorimi i mjeteve juridike civile për të luftuar një fenomen në thelb penalo juridik siç është korrupsioni.

Në vitin 1999 Këshilli i Evropës miratoi Konventën Civile Kundër Korrupsionit (KCKK) e cila hyri në fuqi në vitin 2003 (ETS no. 174 - Treaty Office, 2022). Deri më sot, konventën e kanë nënshkruar 42 shtete prej të cilave e kanë ratifikuar 35 shtete anëtare të konventës (ETS no. 174 - Treaty Office, 2022).

Pikërisht përmes Konventës Civile kundër Korrupsionit, Këshilli i Evropës për të parë kishte krijuar një front të ri të panjohur më parë për luftimin e korrupsionit. Në këtë mënyrë në arsenalin e mjeteve kundër korrupsionit, ishin shtuar edhe mjetet juridike nga e drejta civile.

Bazuar në nenin 1 të Konventës Civile kundër Korrupsionit, qëllimi i konventës është që përmes ligjeve të brendshme të shteteve anëtare të sigurohen mjete juridike efektive për **personat** që janë dëmtuar nga veprat penale të korrupsionit si dhe të mundësohet që të mbrohen të drejtat dhe interesat e tyre duke përfshirë edhe kompensimin e dëmit të pësuar (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. neni 1).

Termi “*personat*” që përdoret në nenin 1 të Konventës Civile kundër Korrupsionit, mund të nënkupton personat fizik, personat juridik si dhe subjektet tjera të së drejtës që mund të ekzistojnë në sisteme të caktuara juridike (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 4).

Përmes nenit 5 të Konventës Civile kundër Korrupsionit përcaktohet që “*secili shtet anëtar duhet që përmes ligjeve të brendshme të siguroj **procedura të përshtatshme** për personat e dëmtuar nga korrupsioni përmes të cilave do të mundësohet kompensimi i dëmit të tyre nga **shteti apo autoriteti kompetent***” (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. neni 5).

Për qëllimet e nenit 5 të Konventës Civile kundër Korrupsionit të cituar më sipër, termi “*procedurë e përshtatshme*” mund të nënkupton procedura efektive të cilat realizohen brenda një kohe të arsyeshme nga shteti respektivisht nga autoriteti kompetent (Explanatory Report - EUS no. 174, 1999, p. 7). Ndërsa çështja e kompensimit të dëmit nga shteti apo autoriteti kompetent nuk do duhej të pamundëson që shteti apo autoriteti përkatës të kërkoj regresin nga zyrtari publik i dënuar për korrupsion ashtu që të kërkoj rimbursimin e buxhetit të shfrytëzuar për kompensimin e dëmit të korrupsionit (Explanatory Report - EUS no. 174, 1999, p. 7). Në fakt, shumica e shteteve që janë anëtare të Konventës Civile kundër Korrupsionit e kanë të rregulluar përmes ligjeve të brendshme edhe të drejtën e regresit krahas përcaktimeve në nenin 5 të konventës (Explanatory Report - EUS no. 174, 1999, p. 7).

Duhet shtuar se Konventa Civile kundër Korrupsionit i ka kushtuar vëmendje edhe bashkëpunimit ndërkombëtar në mbrojtjen juridiko civile të viktimave të korrupsionit. Konkretisht përmes nenit 13 të Konventës Civile kundër Korrupsionit është përcaktuar se shtetet anëtare duhet të bashkëpunojnë në mënyrë efikase lidhur me çështjet e procedurave civile të korrupsionit dhe sidomos në rastet e ofrimit të shërbimeve, dokumenteve, provave,

njohjes dhe zbatimit të aktgjykimeve dhe shpenzimeve të procedurës gjyqësore, në përputhje me dispozitat e instrumenteve ndërkombëtare në fuqi por edhe ligjeve të tyre të brendshme (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. neni 13).

Mbikëqyrja e zbatimit të Konventës Civile kundër Korrupsionit bëhet po ashtu nga GRECO - Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. neni 14).

KAPITULLI III – ZBATIMI I INSTRUMENTEVE TË KËSHILLIT TË EVROPËS NË SHETETIN E KOSOVËS

1. Obligimet për zbatimin e instrumenteve juridike të Këshillit të Evropës

Republika e Kosovës ende nuk është anëtare e Këshillit të Evropës dhe rrjedhimisht nuk është as nënshkruese e Konventës Penale kundër Korrupsionit apo Konventës Civile kundër Korrupsionit (ETS No. 173 - Treaty Office, 2022). Në kuptimin e ngushtë formal, mund të thuhet se Kosova nuk bart mbi vete detyrimin për zbatimin e përcaktimeve të këtyre dy konventave apo të instrumenteve tjera juridike të Këshillit të Evropës për luftimin e korrupsionit apo për fusha të tjera respektive (Ibrahimi B. G., 2020, p. 239). Megjithatë, orientimi kushtetues i shtetit të Kosovës i mishëruar përmes nenit 16 paragrafit 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se *“Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare”* (KRK, 2008, p. neni 16 par. 3). Në këtë drejtim përmes nenit 17 paragrafit 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcaktohet po ashtu se *“Republika e Kosovës të merr pjesë në bashkëpunim ndërkombëtar për promovimin dhe mbrojtjen e paqes, sigurisë dhe të drejtave të njeriut”* (KRK, 2008, p. neni 17 par. 2). Njëkohësisht edhe në vet preambulën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcaktohet *“synimi që shteti i Kosovës të përfshihet në proceset integruuese Euro-Atlantike”* (KRK, 2008).

Padyshim se nocionet juridike si *“bashkëpunimi ndërkombëtar”* apo *“respektimi i të drejtës ndërkombëtare”* ngërthejnë brenda vetes një diapazon të gjerë të mundësisë së interpretimit (Ibrahimi B. G., 2020, p. 239). Megjithatë Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka epërsi juridike ndaj të gjitha akteve tjera juridike në shtetin e Kosovës (KRK, 2008, p. neni 16 par. 1). Prandaj kur flitet për luftën kundër korrupsionit, të gjitha interpretimet logjike dhe qëllimore të këtyre orientimeve kushtetuese duhet të kenë në epiqendër faktin se legjislacioni penal dhe civil si dhe

masat tjera juridike kundër korrupsionit në Republikën e Kosovës duhet të jenë në përputhje me frymën që përcaktojnë instrumentet juridike ndërkombëtare kundër korrupsionit (Ibrahimi B. G., 2020, p. 240). Megjithatë kundërthëniet ndërmjet Konventës Penale kundër Korrupsionit apo Konventës Civile kundër Korrupsionit me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, nuk duhet patjetër që të cilësohen si shkelje kushtetuese (Ibrahimi B. G., 2020, p. 240). Aq më pak këto kundërthënie mund të shërbejnë si *causa criminalis* pasi që kjo do të mund të përbënte edhe shkelje të parimit të ligjshmërisë në procedurë penale (Ibrahimi B. G., 2020, p. 240).

Kuptohet se një situatë juridike plotësisht ndryshe do të krijohet nëse Republika e Kosovës do të nënshkruante dhe do të ratifikonte Konventën Penale kundër Korrupsionit dhe Konventën Civile kundër Korrupsionit. Në këtë rast do të kishim të bënim me parimin *pacta sunt servanta* i cili është i garantuar përmes nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ku përcaktohet se “*marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti i Kosovës zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kanë epërsi ndaj ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës*” (KRK, 2008, p. neni 19 par. 1 dhe 2).

Sidoqoftë, përderisa Republika e Kosovës të mos jetë anëtare e Këshillit të Evropës ajo eventualisht nuk do të jetë as nënshkruese e Konventës Penale kundër Korrupsionit dhe Konventës Civile kundër Korrupsionit apo instrumenteve tjera juridike të Këshillit të Evropës. Rrjedhimisht kolizionet eventuale në mes të akteve juridike përkatëse në fuqi në kuadër të kornizës ligjore në Republikën e Kosovës në raportet me ndonjë dispozitë të Konventës Penale kundër Korrupsionit apo të Konventës Civile kundër Korrupsionit, nuk do të duhej që të jenë të sanksionuara as në aspektin e të drejtës kushtetuese apo të drejtës penale dhe aq më pak në aspektin e të drejtës ndërkombëtare. Përkundër kësaj, fryma e Kushtetutës së Republikës së Kosovës e determinon që legjislacioni i brendshëm në shtetin e Kosovës duhet të jetë në harmoni të plotë me konventat e Këshillit të Evropës duke përfshirë këtu edhe Konventën Penale kundër Korrupsionit si dhe Konventën Civile kundër Korrupsionit. Prandaj ky orientim kushtetues si i tillë jo vetëm që duhet të ruhet por edhe të promovohet me vendosmëri nga legjislacioni përkatës në fuqi në Republikën e Kosovës.

Duhet theksuar po ashtu se ekzistojnë tetë (8) instrumente juridike ndërkombëtare të Këshillit të Evropës dhe të Organizatës së Kombeve të Bashkuara të cilat nuk janë të nënshkruara dhe rrjedhimisht nuk janë as të ratifikuara nga Republika e Kosovës. Megjithatë, përmes nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës këto tetë (8) instrumente juridike ndërkombëtare zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës. Për më tepër ato kanë prioritet, në rast të konfliktit ndaj dispozitave e ligjeve apo akteve të tjera të institucioneve publike (KRR, 2008, p. neni 22). Në këtë mënyrë cilado dispozitë e cilësdo nga këto instrumente juridike ndërkombëtare mëveshët me fuqinë e barasvlershme të dispozitave në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Këto tetë (8) instrumente juridike ndërkombëtare të cilat zbatohet drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës janë (KRR, 2008, p. neni 22):

1. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut publike;
2. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
3. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
4. Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
5. Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
6. Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
7. Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
8. Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

Ajo që ka rëndësi të potencohet në këtë kapitull është fakti në mesin e këtyre instrumenteve juridike ndërkombëtare nuk janë të listuar as Konventa Penale kundër Korrupsionit dhe as Konventa Civile kundër Korrupsionit. Prandaj edhe dispozitat e këtyre dy konventave nuk kanë karakter *ius cogens* për legjislacionin e Republikës së Kosovës. Megjithatë zbatimi i tyre duhet të bëhet në kuptim të orientimit kushtetues dhe strategjik të shtetit të Kosovës për të kontribuar në zbatimin e të drejtës ndërkombëtare dhe në bashkëpunimin ndërkombëtar si dhe për të avancuar drejt anëtarësimit të plotë Euro-Atlantik të Republikës së Kosovës.

Në këtë drejtim ka rëndësi të kuptohet edhe relacioni që aktualisht ekziston ndërmjet Kodit Penal të Republikës së Kosovës si dhe Konventës Penale kundër Korrupsionit në njërën anë si dhe ligjeve civile të Republikës së Kosovës me Konventën Civile kundër Korrupsionit në anën tjetër. Prandaj këto relacione janë trajtuar në mënyrë mjaft të thuktë përmes kapitujve në vijim të këtij punimi. Lidhur me pikat dalluese dhe të përbashkëta ndërmjet Kodit Penal të Republikës së Kosovës me Konventën Penale kundër Korrupsionit, në vija të përgjithshme mund të thuhet se pjesa më e madhe e dispozitave në Kodin Penal në fuqi në Republikën e Kosovës duken *prima facie* që të jenë në përputhje me parimet që promovon Konventa Penale kundër Korrupsionit.

Megjithatë Kodi Penal në fuqi në Republikën e Kosovës është mjaft i ri pasi që është miratuar rishtazi në vitin 2019. Prandaj mund të jetë e rëndësishme që të shqyrtohet në aspektin krahasues edhe raporti ndërmjet Konventës Penale kundër Korrupsionit me Kodin Penal të vjetër i cili ka qenë në fuqi në Republikën e Kosovës nga viti 2013 deri në vitin 2019.

Kodi i vjetër penal në Republikën e Kosovës nuk e kishte inkriminuar fare veprën penale të marrjes së ryshfetit në sektorin privat dhe as veprën penale të dhënies së ryshfetit në sektorin privat, sikurse përcaktohet me nenin 7 dhe 8 të Konventës Penale kundër Korrupsionit. Për më tepër, kodi i vjetër penal nuk e kishte inkriminuar as veprën penale të marrjes së ryshfetit nga personat zyrtar të huaj. Në këtë mënyrë mund të thuhet se deri në vitin 2019 ka ekzistuar një diskrepancë e konsiderueshme ndërmjet Konventës Penale kundër Korrupsionit dhe Kodit të vjetër Penal në Republikën e Kosovës.

Sidoqoftë, përmes tabelës në vijim mund të konfirmohet po ashtu se këtë diskrepancë tanimë ka arritur të përmbushë në mënyrë të kënaqshme Kodi Penal në fuqi në Republikën e Kosovës.

Tab. 3. Aspekte krahasuese lidhur me veprat penale të marrjes dhe dhënies së ryshfetit

VEPRA PENALE	KODI I VJETËR		KODI PENAL		KONVENTA	
Marrja e ryshfetit	Neni 428	✓	Neni 421	✓	Neni 3	✓
Dhënia e ryshfetit	Neni 429	✓	Neni 422	✓	Neni 2	✓

Marrja e ryshfetit nga zyrtari i huaj	-	-	Neni 421	✓	Neni 5	✓
Dhënia e ryshfetit zyrtarit të huaj	Neni 430	✓	Neni 423	✓	Neni 5	✓
Marrja e ryshfetit në sektorin privat	-	-	Neni 309	✓	Neni 8	✓
Dhënia e ryshfetit në sektorin privat	-	-	Neni 310	✓	Neni 7	✓
Ushtrimi i ndikimit	Neni 431	✓	Neni 424	✓	Neni 12	✓

Burimet: (Criminal Law Convention on Corruption, 1999) (KPRK, 2019) (KPRK, 2013).

2. Rëndësia e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Këshillin e Evropës

Anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës mund të ndikoj në fuqizimin e mbrojtjes juridike të qytetarëve në shtetin e Kosovës prej rreziqeve potenciale nga brenda apo jashtë vendit (GAP, 2022, p. 4). Gjithashtu, shtetasit e Kosovës do të mund t'i drejtohen Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nëse konsiderojnë se u janë shkelur të drejtat dhe liritë e tyre themelore nga shteti i Kosovës, apo cilido shtet tjetër anëtar në Këshillin e Evropës (GAP, 2022, p. 4).

Padyshim se anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës do të hapte rrugën drejt rezultateve më të mira në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kjo nënkupton edhe luftimin më efikas dhe më efektiv të korrupsionit në vend. Natyrisht se Kosova më tutje do të mund të bëhej anëtare edhe e Konventës Penale dhe Konventës Civile kundër korrupsionit si dhe instrumenteve të tjera juridike të Këshillit të Evropës në këtë fushë.

Duke marrë parasysh konstalacionin gjeopolitik në rajon si dhe situatën e ballafaqimit me korrupsionin në Kosovë, përfaqësuesit politik në vend janë duke intensifikuar debatet lidhur me mundësinë e anëtarësimit të shtetit të Kosovës në Këshillin e Evropës (TRT, 2022). Në këtë mënyrë qeveria e Kosovës gjatë vitit 2022 ka dorëzuar edhe aplikimin e saj për anëtarësim në Këshillin e Evropës (Qeveria e Kosovës - Mbledhja nr. 77, 2022).

Vlen të shtohet se të gjitha shtetet që e rrethojnë Republikën e Kosovës tanimë janë anëtarë në Këshillin e Evropës (Council of Europe Web Site, 2022). Kjo nënkupton që Kosova është shteti i

vetëm në rajon që nuk është anëtarë në Këshillin e Evropës. Nëse lexohet ky fakt në kontekst të luftimit të korrupsionit, bazuar në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit nga Transparency International për vitin 2021 (Transparency International, 2022), Republika e Kosovës pas Malit të Zi ka shënuar progresin më të madh në rajon në luftën kundër korrupsionit duke lënë pas vetes Shqipërinë, Serbinë dhe Bosnje & Hercegovinën. Kuptohet që rëndësia e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës konsiston në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim mes tyre. Mirëpo në kontekst të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, anëtarësimi i Kosovës në KE do të nënkuptonte rritjen më tutje të efikasitetit dhe efektivitetit me rastin e ballafaqimit me korrupsionin, në përputhje të plotë me standardet e KE.

PJESA II

KAPITULLI IV – KORRUPSIONI NË SEKTORIN PUBLIK

1. Korrupsioni në sektorin publik sipas Konventës Penale kundër Korrupsionit

Konventa Penale kundër Korrupsionit në pjesën më të madhe të saj fokusohet te korrupsioni në sektorin publik. Megjithatë bazamenti për inkriminimin e korrupsionit në sektorin publik është përcaktuar përmes nenit 2 dhe 3 të Konventës Penale kundër Korrupsionit.

Përmes nenit 2 të Konventës Penale kundër Korrupsionit është përcaktuar korrupsioni aktiv i zyrtarëve publik sipas figurës ligjore e cila konsiston në *“premtimin, ofrimin ose dhënien, direkt ose indirekt të një avantazhi që nuk i takon zyrtarit publik për veten e tij ose për personin tjetër, në mënyrë që të veproj apo mos veproj në përputhje me funksionet e zyrtarit publik”* (Criminal Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 2).

Neni 2 i Konventës Penale kundër Korrupsionit sikurse është cituar më sipër, ka arritur që të përcaktoj elementet themelore të figurës ligjore për veprën penale të dhënies së rryshfetit respektivisht të korrupsionit aktiv të zyrtarëve publik. Nga interpretimi telologjik i kësaj dispozite, rezulton se qëllimi i nenit 2 është të siguroj që administrata publike të funksionoj në mënyrën e duhur duke respektuar parimet e përgjithshme për transparencë, barazi, pavarësi,

objektivitet dhe funksionimit për interesin publik (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, pp. 7-8).

Parimisht mund të thuhet që forma e fajësisë si të korrupsioni aktiv ashtu edhe të korrupsioni pasiv është dashja e drejtpërdrejtë së bashku me qëllimin e kryesit që duhet të konsistojë në mënyrën e veprimit të përcaktuar me dispozitat respektive në nenin 2 dhe 3 të Konventës Penale kundër Korrupsionit (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, pp. 7-8). Qëllimi si element i figurës ligjore të korrupsioni aktiv apo të korrupsioni pasiv, duhet të jetë i ndërlidhur me një veprim në të ardhmen ashtu që zyrtari publik të veproj apo të mos veproj në përputhje me funksionin e tij ligjor (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, pp. 7-8). Megjithatë është e parëndësishme nëse është realizuar me sukses ose jo qëllimi i kryesit. Për kryerjen e veprës penale mjafton vetëm që të konfirmohet se qëllimi ka ekzistuar krahas elementeve të tjera të figurës ligjore (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, pp. 7-8).

Dhënia e ryshfetit apo korrupsioni aktiv mund të kryhet nga kushdo përderisa në anën tjetër është një zyrtar publik në cilësi të marrësit të ryshfetit (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 8). Nëse dhënësi i ryshfetit do të vepron në emër të një personi juridik atëherë do të aplikohen dispozitat përkatëse ligjore siç përcaktohen me Konventën Penale kundër Korrupsionit lidhur me përgjegjësinë penale të personave juridik, ashtu që në këtë rast nuk do të përjashtohet as përgjegjësia penale personit fizik përkatës (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 8).

Komponentët materiale të figurës ligjore të korrupsionit aktiv përkatësisht të veprës penale të dhënies së ryshfetit sipas nenit 2 të Konventës Penale kundër Korrupsionit konsistojnë në ***“premtimin”, “ofrimin” ose “dhënien”*** e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një ***“avantazhi që nuk i takon zyrtarit publik”*** (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, pp. 7-8).

Nocionet ***“Premtimi dhe ofrimi”*** të përdorura në kuptim të nenit 2 të Konventës Penale kundër Korrupsionit mund të nënkuptojnë të gjitha situatat kur kryesi do të bëjë të ditur gatishmërinë e tij për të dhënë një avantazh që nuk i takon zyrtarit publik (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, pp. 7-8). Ndërsa ***dhënia*** e ryshfetit sipas kësaj dispozite mund të përfshijë të gjitha rastet

e transferimit të ryshfetit të zyrtari publik (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, pp. 7-8). Nuk ka rëndësi nëse zyrtari publik ka marrë ryshfetin drejtpërdrejtë apo përmes një personi tjetër të ndërmjetëm (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, pp. 7-8). Në fakt dhënia e ryshfetit konsiderohet e kryer edhe nëse zyrtari publik nuk e merr fare ryshfetin përderisa ka qenë në dijeni dhe është pajtuar me faktin se ryshfeti po merret në emër të tij qoftë edhe nga një person tjetër (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, pp. 7-8).

Sa i përket pjesës së ***“avantazhit që nuk i takon zyrtarit publik”*** në kuptim nenit 2 të Konventës Penale kundër Korrupsionit duhet cekur se është jo relevante nëse avantazhi ka natyrë materiale apo jo materiale (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, pp. 7-8). Me rëndësi është fakti që avantazhi të mos i takoj zyrtarit publik sipas normave juridike në fuqi derisa ky avantazh e ka vënë zyrtarin publik në një pozitë më të mirë se para se të marrë ryshfetin (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, pp. 7-8). Avantazhet mund të nënkuptojnë të holla, pushime, hua, ushqim, përshpejtimi i trajtimit të një rasti në një procedurë juridike të caktuar, etj (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, pp. 7-8).

Përmes nenit 3 të Konventës Penale kundër Korrupsionit është përcaktuar korrupsioni pasiv apo marrja e ryshfetit sipas figurës ligjore e cila konsiston në *“pranimin e ofertës apo premtimit, kërkimin ose marrjen, direkt ose indirekt të një avantazhi që nuk i takon zyrtarit publik për vete ose për personin tjetër, në mënyrë që të veprojnë apo të mos veprojnë në përputhje me funksionet e zyrtarit publik”* (Criminal Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 3).

Neni 3 i Konventës Penale kundër Korrupsionit sikurse është cituar më lartë, ka arritur që të përcaktoj elementet e figurës ligjore të marrjes së ryshfetit respektivisht të korrupsionit pasiv të zyrtarëve publik (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 9). Kjo vepër penale është *delicta propria* pasi që kryes mund të jenë vetëm zyrtarët publik. Definicionin për zyrtarët publik, Konventa Penale kundër Korrupsionit e ka përcaktuar në formë të dispozitës referuese përmes nenit 1, ashtu që këtë përkufizim e ka referuar te cilindo përkufizim i ligjeve të brendshme të shteteve anëtare lidhur me termin ***“zyrtar”, “oficer publik”, “kryetar i komunës”, “ministër” “gjyqtar”*** ose status publik tjetër të ngjashëm (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 6).

Komponentët materiale të figurës ligjore për marrjen e ryshfetit sipas nenit 3 të Konventës Penale kundër Korrupsionit konsistojnë në ***“pranimin e ofertës apo premtimit, kërkesën apo pranimin”*** e një avantazhi që nuk i takon zyrtarit publik (Criminal Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 3).

Termi ***“kërkim”*** sikurse termet ***“pranim i ofertës apo premtimit”*** mund të konsistojnë në një akt të njëanshëm përmes të cilit zyrtari publik e vë në dijeni personin tjetër, në mënyrë eksplicite apo implicite, se ky person tjetër duhet të paguaj në një formë të caktuar ashtu që zyrtari publik të kryej apo mos kryej një veprim të caktuar (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 9). Pra është jo relevante nëse është realizuar pagesa apo nëse është vepruar sipas kërkesës për të cilën është dhënë ose jo ryshfeti. Vlen të thuhet se marrja e ryshfetit në formë të ***“kërkimit”*** mund të nënkuptoj që kërkesa e zyrtarit publik për marrjen e ryshfetit duhet të jetë bërë para se të jetë ndërmarrë veprimi apo mosveprimi i caktuar në kundërshtim me kompetencat e tij ligjore (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 9). Në të kundërtën nëse kërkesa është bërë pas kryerjes së veprimit apo mosveprimit përkatës, kjo eventualisht mund të mos korrespondoj me këtë figurë ligjore të korrupsionit pasiv (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 9).

Ndërsa termi ***“pranim”*** sipas nenit 3 të Konventës Penale kundër Korrupsionit mund të nënkuptoj veprimin konkret të marrjes së përfitimit të caktuar pavarësisht nëse kjo bëhet personalisht nga zyrtari publik apo një person tjetër në emër të tij (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 9).

Duhet cekur se komuniteti ndërkombëtar për një kohë të gjatë ka shqyrtuar mundësinë e inkriminimit të posaçëm për zyrtarët e huaj publik (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 10). Duke u nisur nga interesi i përbashkët i shteteve që të luftojnë korrupsionin në të gjitha format e saj, Bashkimi Evropian ka qenë organizata e parë ndërkombëtare e cila me 26 maj 1997 kishte trajtuar këtë çështje përmes **Konventës për luftimin e korrupsionit ku përfshihen zyrtarët e komuniteteve evropiane apo zyrtarët e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian** (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 10).

Tutje në nëntor të vitit 1997 edhe OECD (Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik) kishte inkriminuar korrupsionin e zyrtarëve publik të huaj sipas shembullit të dhënë nga Bashkimi Evropian më 26 maj të po atij viti. Në vazhden e kësaj, natyrshëm edhe Konventa Penale kundër Korrupsionit i ka kushtuar vëmendje të veçantë korrupsionit transnacional në sektorin publik me elemente të huaja (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 10). Konkretisht përmes Konventës Penale kundër Korrupsionit janë inkriminuar disa figura ligjore përmes të cilave është përcaktuar *“korrupsioni i zyrtarëve publik të huaj”*, pastaj *“korrupsioni i anëtarëve të asambleve publike të huaja”*, *“korrupsioni i zyrtarëve të organizatave ndërkombëtare”*, *“korrupsioni i anëtarëve të asambleve parlamentare ndërkombëtare”* si dhe *“korrupsioni i gjyqtarëve dhe zyrtarëve të gjykatave ndërkombëtare”* (Criminal Law Convention on Corruption, 1999, pp. art. 5, 6, 9, 10, 11).

Duhet të potencohet se Konventa Penale kundër Korrupsionit ka arritur që të përcaktoj edhe forma të tjera të korrupsionit në sektorin publik siç janë ushtrimi i ndikimit dhe pastrimi i parave që janë produkt i korrupsionit si dhe të ashtuquajturat veprat e llogarive. Njëkohësisht Konventa Penale kundër Korrupsionit ka përcaktuar edhe institutet juridike përkatëse në formë të detyrimit për shtetet anëtare për inkriminimin dhe mbikëqyrjen e përcaktimeve duke filluar me dhënien e ndihmës ose përkrahjen e veprave penale të korrupsionit, pastaj imunitetin penalo juridik, përgjegjësinë e personave juridik, autoritetet e specializuara, etj (Criminal Law Convention on Corruption, 1999, pp. art. 16, 17, 18, 19, et. al.).

2. Korrupsioni në sektorin publik sipas legjislacionit në Republikën e Kosovës

Një nga karakteristikat themelore për veprat penale kundër korrupsionit në sektorin publik mund të konsiderohet pikërisht objekti i mbrojtur me këto vepra penale i cili parimisht konsiston në cenimin e detyrës apo autoritetit zyrtar (Dr. Halili, 2016, p. 2021). Në fakt objekti i mbrojtur përmes veprave penale korruptive të sektorit publik në kuptimin formal konsiderohet *“ushtrimi i ligjshëm i autorizimeve zyrtare dhe personave përgjegjës”* (Ismet Salihu, 2014, p. 1205). Ndërsa në kuptimin material objekti i mbrojtur mund të përkufizohet si *“interes i përgjithshëm i shoqërisë për një funksionim të ndershëm dhe të ligjshëm të organeve shtetërore si dhe shërbimeve të tjera me interes publik”* (Ismet Salihu, 2014, p. 1205).

Numri më i madh i veprave penale kundër korrupsionit në sektorin publik në Republikën e Kosovës janë të inkriminuara përmes kapitullit XXXIII të Kodit Penal të Republikës së Kosovës me titull “*Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare*”. Disa prej veprave penale të cilat konsiderohen më përfaqësuese të kapitullit XXXIII të Kodit Penal të Kosovës janë:

- *Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar* (KPRK, 2019, p. neni 414);
- *Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik* (KPRK, 2019, p. neni 415);
- *Keqpërdorimi i informatës zyrtare* (KPRK, 2019, p. neni 416);
- *Konflikti i interesit* (KPRK, 2019, p. neni 417);
- *Përvetësimi në detyrë* (KPRK, 2019, p. neni 418);
- *Mashtrimi në detyrë* (KPRK, 2019, p. neni 419);
- *Përdorimi i paautorizuar i pasurisë* (KPRK, 2019, p. neni 420);
- *Marrja e ryshfetit* (KPRK, 2019, p. neni 421);
- *Dhënia e ryshfetit* (KPRK, 2019, p. neni 422);
- *Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj apo personit të huaj zyrtar* (KPRK, 2019, p. neni 423);
- *Ushtrimi i ndikimit* (KPRK, 2019, p. neni 424);
- *Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore* (KPRK, 2019, p. neni 425);
- *Zbulimi i fshehtësisë zyrtare* (KPRK, 2019, p. neni 426);
- *Falsifikimi i dokumentit zyrtar* (KPRK, 2019, p. neni 427); etj.

Natyrisht se të gjitha veprat penale kundër korrupsionit në sektorin publik nuk janë të koncentruara vetëm në kuadër të kapitullit XXXIII të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Varësisht nga figura ligjore apo objekti i mbrojtur specifik, veprat e caktuara penale kundër korrupsionit janë të sistemuara edhe në kapitujt tjerë në Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Për të ilustruar këtë fakt mund të merren shembujt në vijim:

- Vepra penale “*Dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin*” përmes nenit 212 është sistemuar në kuadër të kapitullit XVIII me titull “*Veprat penale kundër të drejtave të votimit*” (KPRK, 2019, p. neni 212);

- Vepra penale *“Pengimi i të provuarit apo procedurës zyrtare”* përmes nenit 386 është sistemuar në kuadër të kapitullit XXXI me titull *“Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike”* (KPRK, 2019, p. neni 386), etj.

Një nga veçoritë themelore për veprat penale kundër korrupsionit në sektorin publik është fakti që si kryes i këtyre veprave penale parimisht konsiderohet të jetë personi zyrtar apo personi tjetër i cili qoftë edhe përkohësisht ushtron funksionin e caktuar publik siç bën për shembull komisionari apo vëzhguesi gjatë procesit të votimit, etj (Ismet Salihu, 2014, p. 1206).

Dashja si formë e fajësisë manifeston një karakteristikë tjetër themelore për veprat penale kundër korrupsionit zyrtar përkatësisht sektorit publik në Republikën e Kosovës. Kjo për arsye se figurat ligjore të veprave penale të korrupsionit në sektorin publik rëndom konsistojnë në veprimin apo mosveprimin e kryer me vullnet të plotë dhe në kundërshtim me rregullat e ndërgjegjes dhe integritetit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare. Përfundim kështu mund të përbëjë zbulimi i sekretit zyrtar si vepër penale për të cilën është përcaktuar përgjegjësia penale edhe për shkak të pakujdesisë (Ismet Salihu, 2014, p. 1208).

Veçoria tjetër themelore e korrupsionit në sektorin publik ka të bëjë me faktin se veprimi i kryerjes të këto vepra penale zakonisht manifestohet përmes keqpërdorimit, abuzimit apo shpërdorimit të autoritetit apo pozitës zyrtare nga ana e personit zyrtar apo personi tjetër me autorizime publike, duke vepruar kështu në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fuqi (Ismet Salihu, 2014, p. 1208).

Tutje, qëllimi i kryerjes së veprave penale të korrupsionit në sektorin publik zakonisht ka të bëjë me arritjen e një përfitimi të caktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, qoftë për veten e tij apo për një person tjetër (Ismet Salihu, 2014, p. 1208). Si shembull për këtë mund të merret *“Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”* e cila vepër penale kryhet nëse përmbushet figura ligjore si në vijim *“Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t’i shkel të drejtat e personit tjetër”* (KPRK, 2019, p. neni 414).

Duhet cekur se Kodi Penal që është në fuqi në Republikën e Kosovës ka arritur që përmes nenit 415 të përcaktoj edhe një vepër të re penale të korrupsionit me titull *“Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik”* e cila vepër penale asnjëherë nuk ka qenë e inkriminuar në të kaluarën (KPRK, 2019, p. neni 415).

Bazuar në përkufizimin që ofrohet sipas nenit 415 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, vepra penale *“Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik”* mund të realizohet nga *“kushdo që me vetëdije shkel rregullat e prokurimit publik gjatë një oferte për dhënien e kontratës së prokurimit publik, duke paraqitur dokumentacion të rremë, marrëveshje të fshehtë kundërligjore apo ndërmerr ndonjë veprim tjetër të paligjshëm me qëllim të mashtrimit në procedurat e prokurimit publik dhe me qëllim të ndikimit në vendimin e një autoriteti kontraktues në procedurën e prokurimit publik”* (KPRK, 2019, p. neni 415).

Nga interpretimi gjuhësor i dispozitivit të përcaktuar sipas nenit 415 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës mund të konfirmohet se forma e fajësisë përmes të cilës mund të kryhet vepra penale *“Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik”* është dashja e drejtpërdrejtë si element i figurës ligjore të kësaj vepre penale (KPRK, 2019, p. neni 415). Përndryshe, në kontekst të ndërthurjes së figurës ligjore që është përcaktuar përmes nenit 415 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, mund të arrihet deri te përfundimi se qëllimi i ligjvënësit me rastin e inkriminimit të veprës penale *“Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik”* është ekskluzivisht që të mbrohen procedurat publike të prokurimit në përputhje me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës (KPRK, 2019, p. neni 415).

3. Ballafaqimi i Republikës së Kosovës me korrupsionin në sektorin publik

Bazuar në raportet vjetore të Komisionit Evropian, Republika e Kosovës ende ndodhet në një stad të hershëm të përgatitjeve për luftën kundër korrupsionit ndërsa ekziston një progres i limituar në këtë fushë sidomos në trajtimin e rasteve të profilit të lartë të korrupsionit (European Commission, 2021, pp. 4, 5).

Konkretisht sipas raportit të Komisionit Evropian të vitit 2021 në Republikën e Kosovës, *“nevojiten përpjekje më të qëndrueshme të cilat përfshijnë edhe aktgjykime të formës së prerë*

nga gjykata si dhe vendime finale për konfiskimin e asetëve” (European Commission, 2021, pp. 4, 5).

Tutje raporti i vitit 2021 nga Komisioni Evropian për Republikën e Kosovës ka theksuar edhe faktin se *“legjislacioni në fuqi lidhur me konfiskimin e asetëve nuk është duke u zbatuar mjaftueshëm duke lënë pas vlerë të vogël të asetëve të konfiskuara me vendim të gjykatës”* (European Commission, 2021, pp. 4, 5). Në anën tjetër, Projekt-Kodi i Procedurës Penale si dhe ligjet tjera kundër korrupsionit ende nuk po procedohen për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës përkatësisht nuk kanë hyrë ende në fuqi (European Commission, 2021, pp. 4, 5).

Në përgjithësi mund të thuhet se korrupsioni vazhdon të mbetet shqetësim serioz për Republikën e Kosovës. Prandaj sipas raporteve të Komisionit Evropian për Republikën e Kosovës *“për luftimin e suksesshëm të korrupsionit është e domosdoshme që të ekzistoj një vullnet politik konsistent si dhe një sistem gjyqësor i konsoliduar i cili mund të përgjigjet edhe kundër korrupsionit të profilit të lartë”* (European Commission, 2021, pp. 4, 5).

Lufta kundër korrupsionit në Republikën e Kosovës është subjekt i mbikëqyrjes së vazhdueshme edhe nga Transparency International. Me këtë rast Transparency International e përdor një metodologji të sofistikuar shkencore të bazuar kryesisht në të dhënat nga organizata ndërkombëtare kredibile si “Freedom House”, “World Bank”, “Bertelsmann Foundation”, “World Justice Project ROLI”, “Global Insight” dhe “Varieties of Democracy Project” (Instituti Demokratik i Kosovës, 2021).

Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit nga Transparency International e shfrytëzon sistemin e vlerësimit prej 100 shkallëve ku vlerësimi me sa më shumë pikë nënkupton që perceptimi për nivelin e korrupsionit është më i vogël dhe anasjelltas, vlerësimi me sa më pak pikë nënkupton që perceptimi për nivelin e korrupsionit është më i madh.

Mesatarja globale e Indeksit për Perceptimin e Korrupsionit nga Transparency International aktualisht vlerësohet që të jetë rreth 43 pikë. Ndërsa mesatarja e Indeksit për Perceptimin e Korrupsionit në Evropë vlerësohet që të jetë rreth 66 pikë (Instituti Demokratik i Kosovës, 2021).

Për vitin 2021 Republika e Kosovës është vlerësuar me 39 pikë në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit nga Transparency International. Mund të thuhet se një indeksim i tillë është mjaft afër mesatares globale të Indeksit për Perceptimin e Korrupsionit prej 43 pikëve (Transparency International, 2022). Në anën tjetër kjo performancë e Republikës së Kosovës është dukshëm larg mesatares në Evropë ku edhe synon të integrohet shteti i Kosovës në përputhje me orientimet e saj strategjike dhe kushtetuese. Në këtë drejtim, sipas vlerësimeve shoqërisë civile në vend, Republika e Kosovës ka nevojë që të përqendrohet në mënyrë më intensive në disa fusha specifike duke përfshirë këtu por pa u kufizuar në fushën e prokurimit publik si dhe në pavarësinë e sistemit të drejtësisë në përgjithësi (Instituti Demokratik i Kosovës, 2021).

3.1. Sfidat dhe vështirësitë për luftimin e korrupsionit në sektorin publik

Sikurse është argumentuar edhe më sipër në këtë punim, Republika e Kosovës vazhdon të ballafaqohet me sfida dhe vështirësi të ndryshme gjatë ballafaqimit me korrupsionin në sektorin publik (European Commission, 2021, pp. 4, 5).

Mund të thuhet se interferimet politike në sistemin gjyqësor dhe mungesa e vullnetit politik për luftimin e korrupsionit janë disa prej sfidave kryesore me të cilat është ballafaquar deri sot Republika e Kosovës (U.S. Department of State, 2021, p. 18). Për pasojë, mungesa e efikasitetit të mjaftueshëm të sistemit prokurorial dhe gjyqësor është manifestuar si një nga vështirësitë kryesore në këtë fushë (U.S. Department of State, 2021, p. 18).

Përmes raportit të vitit 2021 nga Departamenti Amerikan i Shtetit për të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës është konstatuar se *“në Republikën e Kosovës vazhdon politika e mos-ndëshkimit apo ndëshkimit joadekuat të rasteve të korrupsionit”* përderisa *“rastet e korrupsionit shpesh i janë nënshtruar apelimit të përsëritur ndërsa sistemi gjyqësor jo rrallë ka lejuar edhe parashkrimin e rasteve të korrupsionit pa i gjykuar ato”* (U.S. Department of State, 2021, p. 18).

Tutje, sipas raportit të vitit 2021 nga Departamenti Amerikan i Shtetit për të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës është konstatuar po ashtu se *“në shumë pak raste janë ngritur aktakuza kundër zyrtarëve të lartë shtetëror, të cilat aktakuza edhe ashtu kanë qenë me mjaft gabime ose pasaktësi. Përndryshe edhe ato raste që kanë përfunduar me dënime gjyqësore, gjykata ka shqiptuar dënime mjaft të buta pasi që shumica e dënimeve për korrupsion kanë qenë dënime me kusht ose me gjoba ndërsa vetëm 4-5% e tyre kanë qenë dënime me burgim”* (U.S. Department of State, 2021, p. 18).

Vlen të theksohet se në kuadër të këtij raporti të Departamentit Amerikan të Shtetit lidhur me konstatimet që janë potencuar në të, janë evidentuar në formë të argumenteve edhe disa shembuj lidhur me disa raste të ndjeshme të korrupsionit në Republikën e Kosovës (U.S. Department of State, 2021, pp. 18, 19). Fjala është për rastin kur është arritur parashkrimi i procedurës penale kundër një ish-kryetari të Komunës së Lipjanit (Sh.B) si i pandehur për vepra të caktuara të korrupsionit pranë gjykatës kompetente në Republikën e Kosovës (U.S. Department of State, 2021, pp. 18, 19). Më tutje është potencuar edhe rasti i zvarritjes së procedurës penale kundër një ish-ministri të Bujqësisë (N.R) së bashku edhe me shtatë (7) zyrtarë të tjerë po ashtu si të pandehur për shkak të disa veprave penale të korrupsionit gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare (U.S. Department of State, 2021, pp. 18, 19).

Ngjashëm sikurse raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit të vitit 2021 për të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës, edhe Raporti i Freedom House për Republikën e Kosovës në vitin 2022 ka konstatuar raste kur përmes korrupsionit dhe klientelizmit është ushtruar presion mbi votuesit gjatë zgjedhjeve në Kosovë duke potencuar edhe situata kur biznesmenë të fuqishëm mund të ndikojnë në preferencat politike të punonjësve të tyre (Freedom House, 2022).

Tutje, ky raport i Freedom House për Republikën e Kosovës në vitin 2022 ka potencuar edhe ushtrimin e ndikimit që ka shteti Serb në partinë politike *“Lista Serbe”* por edhe në preferencat politike të shtetasve të Kosovës me etni serbe (Freedom House, 2022). Freedom House ka potencuar edhe raste kur figura të fuqishme politike në vend kanë lidhje me krimin e organizuar

dhe nivelin e lartë të korrupsionit, duke ushtruar ndikimin edhe në instalimin e personave të caktuar në pozita të rëndësishme shtetërore në vend (Freedom House, 2022).

Sipas Freedom House korniza institucionale në fuqi në Republikën e Kosovës nuk është duke arritur që të luftoj me sukses kapjen e shtetit dhe korrupsionin veçanërisht atë në profilin e lartë përderisa numri i dënimeve gjyqësore mbetet po ashtu relativisht i ulët (Freedom House, 2022). Përndryshe interferimet politike në sistemin gjyqësor vazhdojnë të paraqesin problem duke stimuluar korrupsionin në përgjithësi (Freedom House, 2022).

3.1.1. Specifikat e rasteve të korrupsionit kur persona të dyshuar janë zyrtarët policor

Korrupsioni si fenomen nuk kursen asnjë segment të shoqërisë. Prandaj jo rrallë herë mund të evidentohen afera korruptive edhe në agjencitë për zbatimin e ligjit siç është Policia e Kosovës.

Inspektorati Policor i Kosovës është një agjenci ekzekutiv kompetent i cili sipas udhëzimeve të prokurorisë së shtetit mund të zhvilloj hetime për veprat penale që dyshohet se janë kryer nga zyrtarët policor të Kosovës (Ligji për IPK, 2010, p. neni 2).

Bazuar në raportin vjetor të Inspektoratit Policor të Kosovës gjatë vitit 2021 thuhet se janë trajtuar 33 raste të korrupsionit nga zyrtarët e Policisë së Kosovës gjatë vitit 2021 (IPK, 2022, p. 22). Në vitin 2020 janë evidentuar 32 raste të tilla ndërsa në vitin 2019 janë trajtuar 36 raste të korrupsionit nga zyrtarët e Policisë së Kosovës (IPK, 2022, p. 22).

Gjithsej gjatë tri (3) viteve 2019-2021, Inspektorati Policor i Kosovës ka trajtuar 71 raste të korrupsionit nga zyrtarët policor në Republikën e Kosovës (IPK, 2022, p. 22). Vepra penale për të cilën janë hetuar më shpesh zyrtarët policor është “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” sipas nenit 414 të Kodit Penal të Kosovës (IPK, 2022, p. 22).

Tab. 4. Veprat penale të korrupsionit nga zyrtarët policor në Republikën e Kosovës

Vepra penale	Neni	2019	2020	2021
---------------------	-------------	-------------	-------------	-------------

Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	414	26	28	27
Marrja e ryshfetit	421	04	03	01
Ushtrimi ndikimit	424	01	01	02
Falsifikim i dokumentit zyrtar	427	01	00	01
Zbulimi fshehtësisë zyrtare	426	01	00	02
Përvetësimi në detyrë	418	01	00	00
Konflikti interesit	417	01	00	00
Keqpërdorimi informatës zyrtare	416	01	00	00
Gjithsej		36	32	33

Burimi: (IPK, 2022, p. 22).

Hetimi i veprave penale që kryhen nga zyrtarët policor është proces mjaft i ndërlikuar, aq më shumë kur hetimi bëhet për shkak të veprave penale të korrupsionit (Ibrahimi, 2020, p. 14). Kjo për arsye të përgatitjes profesionale dhe kompetencave ligjore të zyrtarëve policor (Ibrahimi, 2020, p. 14). Ata janë njohës të mirë të ligjit prandaj mund të lënë sa më pak gjurmë në rastet kur ata vet janë përfshirë në vepra penale të korrupsionit (Ibrahimi, 2020, p. 14). Rrjedhimisht procesi hetimor bëhet më kompleks se zakonisht.

Nga këndvështrimi tjetër, zyrtarët policor janë të thirrur që të luftojnë kriminalitetin dhe jo të përfshihen në të (Ibrahimi, 2020, p. 14). Një zyrtar policor mund të heton penalisht me dhjetëra raste brenda vitit (Ibrahimi, 2020, p. 14). Prandaj është shumë me rëndësi secili zyrtar policor të mos jetë person i korruptuar si dhe të ketë integritet të lartë moral dhe profesional (Ibrahimi, 2020, p. 14).

Nuk mund të pritet që një zyrtar policor i korruptuar të hetoj në mënyrë profesionale cilindo rast penal (Ibrahimi, 2020, p. 14). Në anën tjetër, jo të gjitha rastet e korrupsionit mund të zbulohen në flagrancë, aq më pak kur i dyshuari kryesor është zyrtar policor (Ibrahimi, 2020, p.

14). Fillimisht duhet cekur se procedura penale kundër zyrtarit policor të korruptuar, kërkon një kohë të konsiderueshme gjatë të cilës është e domosdoshme një qasje më specifike se në rastet tjera hetimore penale ashtu që të manifestohen në mënyrë efikase dhe efektive një konglomerat i masave operative taktike dhe veprimeve hetimore në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi (Ibrahimi, 2020, p. 14). Në fakt, vetëm për të arritur deri te dyshimi se zyrtari policor është i përfshirë në ndonjë vepër penale të korrupsionit nevojitet një kohë relativisht e gjatë për të realizuar me sukses një tërësi të masave dhe veprimeve komplekse hetimore penale (Ibrahimi, 2020, p. 14).

Duhet merret parasysh fakti se për zyrtarin policor sikurse për çdo person tjetër të dyshuar për vepër penale është i garantuar prezumimi i pafajësisë (Ibrahimi, 2020, p. 14). Rrjedhimisht dilema që mund të shtrohet ka të bëjë pikërisht me dëmet që ka mundur të shkaktoj ky zyrtar policor përmes aferës së korrupsionit ku ai eventualisht është përfshirë deri në momentin kur do të vërtetohet ose jo fajësia e tij për veprën penale të korrupsionit (Ibrahimi, 2020, p. 14).

Personi i dyshuar për vepër penale të korrupsionit gjatë kohës sa ka vepruar në cilësi të zyrtarit policor ka mundur të ketë qasje te provat penale në kuadër të procedurave të ndryshme penale si dhe ka ushtruar në mënyrë të vazhdueshme kompetencat e veta hetimore penale (Ibrahimi, 2020, p. 14). Njëkohësisht personi në fjalë në cilësi të zyrtarit policor ka mundur të ushtroj autorizimet e tij ligjore për të parashtruar ose jo të kallëzime penale pranë prokurorisë kompetente (Ibrahimi, 2020, p. 14).

Dihet mirëfilli se në sistemin tonë miks të procedurës penale me nuanca të sistemit penal akuzator, roli i hetuesit policor është i shpërfaqur në mënyrë të theksuar gjatë fazës së procedurës parapenale (Ibrahimi, 2020, p. 14). Njëkohësisht është i padiskutueshëm fakti se pikërisht rezultatet e evidentuara në kuadër të procedurës parapenale do të afektojnë në mënyrë thelbësore edhe procedurën penale në fazat e mëvonshme të saj duke mos e përjashtuar këtu as vendimin meritator përkatësisht përfundimtar të gjykatës kompetente (Ibrahimi, 2020, p. 14).

Nga ky kënd i vështrimit, është e domosdoshme që pa mëdyshje të kuptohet projeksioni ligjor lidhur me statusin e rasteve penale që kanë mundur të hetohen nga zyrtarët policor për të cilët është konfirmuar se vet ata janë të përfshirë në raste të korrupsionit dhe njëkohësisht vërtetohet se pikërisht ato raste që ata kanë hetuar paraprakisht kanë mundur të jenë të ndërlidhura në cilëndo formë me veprën penale të korrupsionit për të cilën janë dënuar zyrtarët përkatës policor (Ibrahimi, 2020, p. 14).

Për të sqaruar këtë tematikë, në këtë kapitull mund të përdoret një situatë hipotetike sipas të cilës një zyrtar policor është duke zhvilluar hetimet penale për rastin e evidentuar si rasti “A” (Ibrahimi, 2020, p. 14). Në ndërkohë Inspektorati Policor i Kosovës paraqet kallëzim penal për shkak të dyshimit se ky zyrtar policor e ka keqpërdorur detyrën zyrtare pikërisht përmes veprimeve të tij hetimore të kundërligjshme lidhur me rastin “A” (Ibrahimi, 2020, p. 14).

Tutje, prokuroria kompetente sipas kallëzimit penal nga Inspektorati Policor i Kosovës do të zhvilloj hetimet penale dhe eventualisht do të parashtroj aktakuzë pranë gjykatës kompetente kundër këtij zyrtari policor (Ibrahimi A. , 2020, p. 15). Në këtë mënyrë gjykata do të mbaj shqyrtimin gjyqësor dhe në fund me aktgjykim përfundimtar do të shpall fajtor zyrtarin policor për shkak të veprës penale të korrupsionit zyrtar (Ibrahimi A. , 2020, p. 15). Ky aktgjykim përfundimtar i gjykatës si i tillë eventualisht do të merr edhe formën e prerë në procedurën sipas mjeteve juridike (Ibrahimi A. , 2020, p. 15).

Njëkohësisht me këto zhvillime procedurale penale, prokuroria e shtetit hipotetikisht ka mundur të parashtroj një aktakuzë edhe për rastin “A” duke u bazuar plotësisht në veprimet hetimore që kishte për të zhvilluar pikërisht ky zyrtar policor, tanimë i dënuar për vepër penale të korrupsionit (Ibrahimi A. , 2020, p. 15).

Dilema që mund të shtrohet në këtë rast ka të bëjë me çështjen nëse personat që mund të kenë qenë subjekte në rastin “A”, kanë të drejtë ose jo që mbi bazën e kësaj gjendje faktike të kontestojnë legjitimitetin dhe ligjshmërinë e epilogut të këtij rasti penal (Ibrahimi A. , 2020, p. 15). Nëse po, cilat mund të jenë ato mjete juridike efektive që eventualisht mund të përdoren për të realizuar këtë të drejtë (Ibrahimi A. , 2020, p. 15).

Në vazhden e trajtimit të kësaj tematike përmes këtij shembulli hipotetik, ka shumë rëndësi se deri në cilin stad ka arritur procedura penale lidhur me rastin “A” në momentin kur zyrtari policor është dënuar me aktgjykim të formës së prerë për shkak të veprës penale të korrupsionit (Ibrahimi, 2020, p. 15).

Padyshim që në stad sa më të vonshëm që mund të arrij procedura penale për rastin “A”, aq më të mëdha mund të jenë pasojat për viktimat e veprës penale të korrupsionit dhe *vice versa* (Ibrahimi, 2020, p. 15). Prandaj në varësi të stadi të procedurës penale lidhur me rastin “A”, për nevojat e këtij kapitulli mund të shkoqiten tri (3) mënyra kryesore juridike përmes të cilave mund të kontestohen pasojat juridike që mund të jenë krijuar nga aktgjykimi lidhur me rastin “A” për shkak të veprës penale të korrupsionit nga zyrtari policor.

Mënyra e parë është nëse për rastin “A” nuk është shpallur ende aktgjykim përfundimtar, atëherë fakti që hetuesi i këtij rasti (zyrtari policor) është dënuar për vepër penale të korrupsionit lidhur me rastin “A”, mund të propozohet si provë e re para gjykatës (Ibrahimi, 2020, p. 15).

Mënyra e dytë është nëse lidhur me rastin “A” gjykata ka shqiptuar aktgjykim përfundimtar, atëherë personat e autorizuar mund të parashtrojnë ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike duke u bazuar në nenin 383 paragrafi 1 nën paragrafi 3 lidhur me nenin 386 paragrafi 3 dhe nenin 392 paragrafin 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK, 2013, pp. neni 386 par. 1 pika 3 dhe par. 3, neni 392 par. 1 dhe 2).

Kuptohet që përmes ankesës do duhej të prezantohet si provë fakti i sapokrijuar për shkak të dënimit të zyrtarit policor (Ibrahimi, 2020, p. 15). Në këtë situatë Gjykata e Apelit sipas nenit 398 paragrafit 1 nën paragrafit 4 do të ketë mundësinë që të ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës Themelore nga aktgjykim i dënues në aktgjykim lirues (KPPRK, 2013, p. neni 398 par. 1 pika 4), duke marrë parasysh edhe efektet shtesë të ankesës të cilat janë *Reformatio in Peius* (KPPRK, 2013, p. neni 395), *Beneficium Cohesionis* (KPPRK, 2013, p. neni 397) si dhe efektet tjera shtesë (KPPRK, 2013, p. neni 396).

Mënyra e tretë ka të bëj me situatën kur lidhur me rastin “A” gjykata ka shpallur aktgjykimin e formës së prerë, me ç’rast pasojat për viktimat e korrupsionit të zyrtarit policor do të jenë më vështirë të riparueshme sesa në mënyrën e parë dhe të dytë (Ibrahimi, 2020, p. 15). Sidoqoftë, vlen të theksohet që edhe në këto situata mund të parashtrohet kërkesë për rishikimin e procedurës penale në përputhje me nenin 423 paragrafi 1 nën paragrafi 2 të KPPRK (KPPRK, 2013, p. neni 423 par. 1 pika 2). Me rastin e shfrytëzimit të këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik, pala duhet të paraqes prova sipas të cilave aktgjykimi dënues për të dënuarin në rastin “A” është rezultat i një veprë penale të korrupsionit që e ka kryer hetuesi policor i këtij rasti (Ibrahimi, 2020, p. 15). Në këtë mënyrë gjykata do të mund të merr vendim në favor të palës siç do të mund të ishte vendimi për refuzimin e aktakuzës apo për lirin nga akuzat (Ibrahimi, 2020, p. 15).

Cilado nga mënyrat më sipër apo mënyrave tjera juridike që do të mund të shfrytëzonte viktimat e korrupsionit për të vendosur drejtësi në rastin “A”, duhet pasur parasysh se për realizimin e të drejtave të tij do të mund të kalojnë vite të tëra në sallat gjyqësore të Kosovës qoftë për shkak të numrit të madh të rasteve, numrit të pamjaftueshëm të stafit apo arsyeve tjera për të cilat do të mund të zvarritej procedura gjyqësore (Ibrahimi, 2020, p. 15).

Padyshim që ato vite i dëmtuari nuk do të mund t’i kompensoj asnjëherë, as atëherë kur ndoshta gjykata do të vendos në favorin e tij. Nga ky këndvështrim duhet theksuar se përtej aspektit të ligjshmërisë, është i kontestueshëm edhe legjitimiteti i atyre rasteve penale në kuadër të cilave hetuesit policor janë përfshirë në afera të korrupsionit (Ibrahimi, 2020, p. 15).

Nga sa u tha më sipër, do të ishte e preferueshme që në rastet kur parashtrohen aktakuza për korrupsion kundër zyrtarëve policor, procedura penale lidhur me këto aktakuza të konsiderohen si çështje paraprake (**res prejudice**) për procedurat penale lidhur me rastet që ka trajtuar ai zyrtar policor dhe që janë objekt i shqyrtimit edhe në aferën e korrupsionit të zyrtarit policor për të cilën është ngritur aktakuza (Ibrahimi, 2020, p. 15). Përndryshe, shteti duhet të ndërmerr të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme që të parandalohen rastet e korrupsionit

dhe veçanërisht ato raste ku janë të përfshirë zyrtarët e zbatimit të ligjit siç janë zyrtarët policor. Për këtë arsye, integriteti i personit në fjalë duhet të jetë kriteri themelor për të veshur uniformën policore.

KAPITULLI V - KORRUPSIONI NË SEKTORIN PRIVAT

1. Përcaktimi i korrupsionit në sektorin privat sipas Konventës Penale kundër Korrupsionit

Konventa Penale kundër Korrupsionit ka arritur të përcaktoj një dimension të ri dhe shumë të rëndësishëm të luftës kundër korrupsionit përmes inkriminimit të veprave penale të korrupsionit në sektorin privat (Criminal Law Convention on Corruption, 1999, pp. art. 7, 8).

Përmes nenit 7 të Konventës Penale kundër Korrupsionit është përcaktuar korrupsioni aktiv në sektorin privat respektivisht dhënia e ryshfetit në sektorin privat (Criminal Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 7). Ndërsa përmes nenit 8 është përcaktuar korrupsioni pasiv në sektorin privat respektivisht marrja e ryshfetit në sektorin privat (Criminal Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 8).

- Lidhur me korrupsionin aktiv në sektorin privat, neni 7 i konventës ka përcaktuar që *“Secila palë do të miratoj masa të tilla legjislative dhe masa të tjera që janë të nevojshme për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të brendshëm, kur kryhen me qëllim që gjatë veprimtarisë së biznesit të premtoj, ofroj apo të jap, direkt ose indirekt, çfarëdolloj avantazhi që nuk i takon, cilitdo personi që drejton ose punon, në çfarëdo cilësie, në entitete të sektorit privat, për vete apo për tjetrin që të veprojnë ose të mos veprojnë, në kundërshtim me detyrat e caktuara”* (Criminal Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 7).
- Lidhur me korrupsionin pasiv në sektorin privat, konventa përmes nenit 8 ka përcaktuar që *“Secila palë do të miratoj masa të tilla legjislative dhe masa të tjera që janë të nevojshme për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të brendshëm, kur kryhen me qëllim që gjatë veprimtarisë së biznesit, të kërkojnë ose të marrin, direkt ose indirekt, nga cilitdo person që drejton ose punon, në çfarëdolloj cilësie, në entitete të*

sektorit privat, çfarëdoj avantazhi që nuk i takon ose premtimi për vete apo për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte apo premtimi i një avantazhi të tillë, për të vepruar ose mos vepruar në kundërshtim me detyrat e tyre” (Criminal Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 8).

Korrupsioni në sektorin privat gjatë shekullit të kaluar është trajtuar nga ligjet civile dhe ligjet e punës (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 11). Inkriminimi i tij penalo juridik mendohet se është manifestuar si përpjekje ndërkombëtare në fund të shekullit të kaluar ndërsa u manifestua nga Këshilli i Evropës përmes Konventës Penale kundër Korrupsionit në vitin 1999 (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 11). Megjithatë në vitin 2004 edhe Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit ka inkriminuar korrupsionin në sektorin privat (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 11).

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit përmes nenit 12 përcakton korrupsionin në sektorin privat si në vijim:

- *“Secila palë do të miratoj masa në përputhje me parimet themelore të legjislacionit të brendshëm, për të parandaluar korrupsionin në sektorin privat dhe të promovoj standardet e kontabilitetit dhe auditimit në sektorin privat si dhe aty ku është e përshtatshme të miratoj sanksione efektive dhe proporcionale të natyrës juridike civile, administrative dhe penale në rastet kur nuk respektohen këto masa” (UNCAC, 2004, p. neni 12 par. 1).*

Korrupsioni në kontekst të sektorit të biznesit afekton të gjitha llojet e ndërmarrjeve private (UNODC, 2019). Megjithatë disa sektorë apo industri të caktuara janë më të ndjeshme ndaj korrupsionit sesa të tjerat (UNODC, 2019).

Si shembull, mbrojtja ushtarake konsiderohet si një nga industritë më të ekspozuara ndaj korrupsionit për shkak të vlerave të mëdha monetare dhe natyrës së punës në këtë industri (UNODC, 2019). Ngjashëm edhe industria e gazit, naftës, ndërtimtarisë, teknologjisë dhe infrastrukturës janë po ashtu të ekspozuara ndaj korrupsionit (UNODC, 2019). Në përgjithësi

mendohet se sektorët e biznesit që janë të bazuar në marrëdhënie kontraktuese janë mjaft të ekspozuar ndaj korrupsionit (UNODC, 2019).

Motivet si elemente të figurës ligjore të veprave penale të korrupsionit në sektorin privat, parimisht konsistojnë në krijimin e avantazheve të caktuara në kuadër të konkurrencës për atë industri të caktuar (UNODC, 2019).

Padyshim se korrupsioni si fenomen shpërfaqet si armik i konkurrencës së lirë të tregut që për pasojë ka dëmtimin e konsumatorit për shkak të rritjes së çmimit dhe uljes së kualitetit të produkteve dhe shërbimeve (UNODC, 2019).

Arsyet për vendosjen e sanksioneve penale për korrupsionin në sferën private janë të shumta. Para së gjithave korrupsioni në sferën private dëmton vlerat si besueshmëria që është e nevojshme për ruajtjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve sociale dhe ekonomike (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 11). Përtej dëmit specifik material për viktimën, korrupsioni privat i shkakton dëm edhe shoqërisë në tërësi (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 11).

Sa i përket figurës ligjore të korrupsionit në sektorin privat, mund të thuhet se ajo është mjaft e ngjashme me figurën ligjore të korrupsionit në sektorin publik (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 11). Megjithatë, ekzistojnë disa dallime të rëndësishme ndërmjet dispozitave për ryshfetin e sektorit publik dhe atij privat të cilat do të përmbliidhen në vijim të këtij kapitulli.

Në rastin e zyrtarëve publik vepra penale e korrupsionit mund të realizohet edhe nëse nuk manifestohet qëllimi i kryesit përmes shkeljes së detyrës zyrtare (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 12). Ky inkriminim është si i tillë për shkak të pritshmërisë së përgjithshme për transparencë, paanshmëri dhe llogaridhënie nga zyrtarët publik (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 12).

Për dallim nga veprat penale të korrupsionit në sektorin publik, manifestimi i veprave penale të korrupsionit në sektorin privat domosdo duhet të konsistojë në shkeljen e detyrave apo përgjegjësi nga personat përkatës në emër të pasojës së veprës penale (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 12).

Shprehja "*në shkelje të detyrave të tyre*" të cilës i referohet neni 7 në Konventën Penale të Korrupsionit, parimisht nuk synon që të siguroj ekskluzivisht vetëm respektimin e detyrimeve specifike kontraktuese, por më tepër që të garantoj se nuk do të ketë shkelje të detyrës së përgjithshme të besnikërisë në lidhje me punët ose biznesin e porositësit (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 12).

Punonjësi, ortak, drejtori menaxhues apo personi tjetër që pranon ryshfet për të vepruar ose mos vepruar në një mënyrë që është në kundërshtim me interesin e punëdhënësit, do të tradhtoj besimin e vendosur ndaj tij (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 12). Kjo justifikon mjaftueshëm vet inkriminimin e korrupsionit në sektorin privat si vepër penale. Konventa Penale kundër Korrupsionit e promovon këtë filozofi dhe prandaj e kërkon elementin shtesë të "*shkeljes së detyrës*" në kuadër të këtij inkriminimi (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 12).

Neni 7 i Konventës Penale kundër Korrupsionit e përcakton sferën e korrupsionit privat në fushën e "*veprimtarisë së biznesit*", duke përjashtuar kështu qëllimisht çdo aktivitet jofitimprurës si p.sh nga OJQ apo shoqatat e ndryshme (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 11). Megjithatë "*veprimtaria e biznesit*" mund të interpretohet në kuptim të gjerë duke përfshirë çdo lloj të aktivitetit tregtar (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 11).

Termet "*Subjektet e sektorit privat*" të përdorura në kuptim të nenit 7 të Konventës Penale kundër Korrupsionit, mund t'i referohen shoqërive, ndërmarrjeve, trusteve dhe subjekteve të tjera të cilat janë tërësisht ose në një masë përcaktuese në pronësi të personave privat (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 12). Kjo sigurisht mbulon një gamë të tërë subjektesh. Ato mund të jenë korporata por edhe subjekte pa personalitet juridik (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 12).

Për qëllimin e nenit 7 të Konventës Penale kundër Korrupsionit, fjala "*entitet*" duhet të nënkuptoj qoftë edhe një individ të caktuar të përfshirë në sektorin privat (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 12). Natyrisht që entet publike bien jashtë fushëveprimit të kësaj dispozite (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 12). Tutje, si kryes të mundshëm të

korupsionit në sektorin privat konventa përcakton “*çdo person që drejton ose punon në çfarëdo cilësie për subjektin e sektorit privat*” (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 11). Përsëri edhe ky nocion gjithëpërfshirës do të mund të interpretohet në mënyrë ekstensive pasi që mbulon jo vetëm punëdhënësit, por edhe marrëdhëniet tjera juridike në kuadër të ndërmarrjes siç janë partnerët, avokatët, klientët, konsulentët, agentët komercial si dhe subjektet tjera të ndërlidhura në cilëndo formë me ndërmarrjen përkatëse (Explanatory Report - EUS No. 173, 1999, p. 11).

2. Ballafaqimi i Republikës së Kosovës me korupsionin në sektorin privat

Kodi Penal i Republikës së Kosovës përmes neni 309 ka inkriminuar veprën penale ***“pranimi i ryshfetit në sektorin privat”***. Bazuar në figurën ligjore sipas nenit 309 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës është përcaktuar se kjo vepër penale mund të kryhet si në vijim:

- *“kushdo që drejton ose punon në cilësinë e një subjekti të sektorit privat ose që punon si person i vetëpunësuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë kërkon ose merr ndonjë dhuratë të pamerituar ose keqpërdor pozitën ose premtimin nga dikush ose pranon një ofertë ose premtim për një dhuratë apo shpërblim të tillë, për vete ose për një person tjetër, me qëllim që të veprojë ose të mos veprojë në shkelje të detyrës ose të funksionit të tij gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, financiare ose tregtare”* (KPRK, 2019, p. neni 309 par. 1).

Tutje përmes nenit 310 të Kodit Penal të Kosovës është inkriminuar po ashtu vepra penale ***“dhënia e ryshfetit në sektorin privat”***. Bazuar në figurën ligjore sipas nenit 310 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës është përcaktuar se kjo vepër penale mund të kryhet si në vijim:

- *“kushdo që jep, ofron ose premtim në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë çdo shpërblim ose përfitim të panevojshëm për një person që drejton ose punon, në cilindo kapacitet, nga një entitet i sektorit privat ose që punon si person i vetëpunësuar për vete ose për një person tjetër në mënyrë që të veprojë ose të mos veprojë duke shkelur detyrën ose funksionin e tij/saj gjatë aktiviteteve ekonomike, financiare ose tregtare”* (KPRK, 2019, p. neni 310 par. 1).

Në kuptim të inkriminimeve të cituara si më sipër, mund të konstatohet se veprat penale “dhënia e ryshfetit në sektorin privat” dhe vepra penale “pranimi i ryshfetit në sektorin privat” kanë për objekt të mbrojtur marrëdhëniet ekonomike në shtetin e Kosovës respektivisht të drejtat dhe vlerat përkatëse që derivojnë nga këto marrëdhënie ekonomike (Ibrahimi B. G., 2020, p. 241). Si të tilla këto vepra penale janë të sistemuara në kuadër të kapitullit XXV të Kodit Penal të Republikës së Kosovës me titull “Veprat penale kundër ekonomisë”.

Mund të thuhet se vepra penale “pranimi i ryshfetit në sektorin privat” sipas nenit 309 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës është parimisht në përputhje me përcaktimet në nenin 8 të Konventës Penale kundër Korrupsionit përmes të cilës inkriminohet korrupsioni pasiv në sektorin privat (Ibrahimi B. G., 2020, p. 241). Kjo vlen edhe për veprën penale “dhënia e ryshfetit në sektorin privat” nga neni 310 i Kodit Penal të Kosovës për të cilën po ashtu mund të konstatohet se parimisht është në përputhje me nenin 7 të Konventës Penale kundër Korrupsionit përmes të cilës inkriminohet korrupsioni aktiv në sektorin privat (Ibrahimi B. G., 2020, p. 241).

Për qëllimet e këtij punimi, përmes shqyrtimit krahasues mund të thuhet që përmes dispozitave të cituara më sipër nga Kodi Penal i Republikës së Kosovës është arritur që të konsolidohet një përcaktim mjaft i detajuar i figurave ligjore në kuptimin penal material për veprat penale përkatëse, edhe kur ato i vejmë përballë vetë dispozitave të Konventës Penale kundër Korrupsionit.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës përmes nenit 309 dhe 310 ka specifikuar fushëveprimin e korrupsionit në sektorin privat duke përdorur nocionet “*gjatë aktiviteteve ekonomike, financiare ose tregtare*” (KPRK, 2019, pp. neni 309 par. 1, neni 310 par. 1). Në anën tjetër neni 7 dhe 8 i Konventës Penale kundër Korrupsionit për qëllimin e njëjtë ka përdorur nocionet “*veprimtari e biznesit*” (Criminal Law Convention on Corruption, 1999, pp. art. 7, 8).

Padyshim që të dy terminologjitë e përdorura e kanë kontekstin e njëjtë dhe në kuptim të interpretimit të normës ato duhet lexohen në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse për shkak të qëllimit unik inkriminues. Megjithatë mund të thuhet se termi “*veprimtari e biznesit*” mund të

mos ishte mjaftueshëm i përshtatshëm për figurat ligjore të dhënies së ryshfetit në sektorin privat dhe të marrjes së ryshfetit në sektorin privat siç përcaktohen me Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Kjo për arsye Kodi Penal i Republikës së Kosovës nuk ka arritur që njëkohësisht të përkufizoj në mënyrë specifike edhe kuptimin e nocionit *“organizatë e biznesit”* (KPRK, 2019, p. neni 113 par. 7). Në vend të kësaj, përmes një dispozite referuese në emër të këtij përkufizimi e ka pranuar përkufizimin e bërë nga ligji në fuqi për shoqëritë tregtare (KPRK, 2019, p. neni 113 par. 7).

Konkretisht, Kodi Penal i Republikës së Kosovës përmes nenit 113 paragrafit 7 lidhur me termin *“organizatë biznesi”* ka përkufizuar si në vijim:

- *“person fizik apo juridik ose grup personash që merren me veprimtari ekonomike, siç përcaktohet dhe rregullohet me Ligjin për Shoqëritë Tregtare”* (KPRK, 2019, p. neni 113 par. 7).

Përkundër faktit se kjo dispozitë i referohet Ligjit për Shoqëritë Tregtare, paradoksi që shpërfaqet konsiston në faktin se as Ligji për Shoqëritë Tregtare në fuqi nuk ka arritur që të përcakton një përkufizim se çka nënkuptojmë me termin *“organizatë biznesi”* (LSHT, 2018, p. neni 3). Duke marrë parasysh këtë fakt, mund të thuhet se formulimi i fushëveprimit të korrupsionit në sektorin privat përmes nenit 309 dhe 310 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës mund të jetë më i përshtatshëm se formulimi në nenin 7 dhe 8 në Konventën Penale kundër Korrupsionit për inkriminimet e veprave penale përkatëse.

Përndryshe në kuptim të përgjithshëm të figurave të tyre ligjore mund të arrihet konstatimi se të dy inkriminimet lidhur me këto vepra penale parimisht janë kompatible ndërmjet dispozitave përkatëse të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe të Konventës Penale kundër Korrupsionit. Në fakt të gjitha elementet e posaçme të figurave ligjore për të dy veprat penale konsistojnë që të janë të njëjta duke përfshirë këtu kryesin e veprës penale, mënyrën e kryerjes, formën e fajësisë, fushëveprimin e inkriminimit si dhe elementet tjera respektive.

Përtej përcaktimeve juridiko materiale të veprave penale të pranimi të ryshfetit në sektorin privat dhe të dhënies së ryshfetit në sektorin privat në Kodin Penal të Republikës së Kosovës,

duhet cekur se këto inkriminime janë mjaft të reja për shtetin e Kosovës. Kjo për arsye se deri në vitin 2019 këto vepra penale nuk kanë ekzistuar fare pasi që nuk kanë qenë të inkriminuara me Kodin Penal të vjetër që deri atëherë ka qenë në fuqi në Republikën e Kosovës. Rrjedhimisht këto vepra penale ekzistojnë si të tilla në shtetin e Kosovës vetëm prej muajit prill të vitit 2019.

Duhet cekur se Kodi Penal i vjetër kishte përcaktuar veprën penale *“Pranimi i paarsyeshëm i dhuratave”* e cila *prima facie* rezulton të ketë qenë mjaft e ngjashme me veprën penale të pranimi të ryshfetit në sektorin privat sipas nenit 309 të Kodit Penal në fuqi në shtetin e Kosovës.

Përmes nenit 319 të Kodit Penal të vjetër para vitit 2019 ka qenë e përcaktuar se vepra penale *“Pranimi i paarsyeshëm i dhuratave”* mund të realizohet nëse:

- *“Kushdo që gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike kërkon apo pranon shpërblim, dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër jo proporcional me qëllim të lënies anash të interesave të organizatës së tij të biznesit apo të personit juridik ose për t’i shkaktuar dëm organizatës së tillë të biznesit apo personit juridik me rastin e lidhjes së kontratës ose pajtimit për kryerjen e ndonjë shërbimi”* (KPRK, 2013, p. neni 319 par. 1).

Në shikim të parë dispozitivi i përcaktuar për këtë vepër penale që ka qenë e inkriminuar para vitit 2019 në Republikën e Kosovës mund të jetë mjaft e ngjashme me veprën penale të marrjes së ryshfetit në sektorin privat siç përcaktohet me nenin 8 të Konventës Penale kundër Korrupsionit respektivisht me nenin 309 të Kodit Penal që aktualisht është në fuqi në Republikën e Kosovës. Megjithatë një analizë më e thuktë mund të nxjerr në pah konstatimin se figurat ligjore të këtyre dy inkriminimeve në fakt nuk janë aspak të njëjta me njëra tjetrën. Përveç emërtimeve të tyre, dallimet kryesore janë evidente për sa i përket kryesit të veprës penale, veprimit të kryerjes si dhe qëllimit të kryesit të veprës penale.

- **Kryesi** te vepra penale e pranimi të ryshfetit në sektorin privat bazuar në nenin 8 të Konventës Penale kundër Korrupsionit por edhe bazuar në nenin 309 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës mund të jetë *cilido person që drejton ose punon në çfarëdo cilësie në entitete të sektorit privat* (KPRK, 2019, p. neni 113 par. 7). Ndërsa te vepra penale e dhënies

së paarsyeshme të dhuratave, kryes mund të jetë vetëm *kushdo* që ushtron veprimtari ekonomike (KPRK, 2013, p. neni 319 par. 1). Rrjedhimisht vepra penale e pranimi të ryshfetit në sektorin privat përbën një *delicta propria* pasi që rrethi i kryesve të mundshëm të kësaj vepra penale është mjaft i gjerë por megjithatë është i kufizuar pasi që përjashtohen personat zyrtar dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile. Një situatë e tillë nuk ka vlejtur shprehimisht edhe për veprën penale “*Pranimi i paarsyeshëm i dhuratave*” pasi që kryes ka mundur që të jetë kushdo që ka mundur të ushtroj veprimtari ekonomike përtej statusit të tij apo lidhjes që ka mundur të ketë me subjektin e caktuar në sektorin privat (KPRK, 2013, p. neni 319 par. 1).

- **Veprimi i kryerjes** te vepra penale e pranimi të ryshfetit në sektorin privat mund të përfshijë “*kërkimin, marrjen apo pranimin, direkt ose indirekt të çfarëdo premtimi, oferte apo avantazhi që nuk i takon për vete apo tjetrin*” (KPRK, 2019, p. neni 113 par. 7). Ndërsa te pranimi i paarsyeshëm i dhuratave veprimi i kryerjes konsistonte në “*kërkon apo pranon shpërblim, dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër jo proporcional*” (KPRK, 2013, p. neni 319 par. 1). Dallimi është se te pranimi i paarsyeshëm i dhuratave mungon inkriminimi i elementeve të veprimit siç është veprimi “*direkt ose indirekt*”, apo pjesa e veprimit përmes “*pranimi të premtimit apo ofertës*” si dhe elementit “*për vete apo tjetrin*” (KPRK, 2013, p. neni 319 par. 1). Në këtë mënyrë mund arrihet përfundimi logjik se diapazoni inkriminues te vepra penale e pranimi të paarsyeshëm të dhuratave ka qenë shumë më i ngushtë sesa diapazoni inkriminues te vepra penale e pranimi të ryshfetit në sektorin privat.
- **Qëllimi i kryesit** te pranimi i paarsyeshëm i dhuratave konsiston në *lënien anash të interesave të organizatës* ndërsa përfitimi i avantazhit të caktuar mund të shërbejë si motiv për kryerjen e veprës penale (KPRK, 2013, p. neni 319 par. 1). Te pranimi i ryshfetit në sektorin privat qëllimi është ekskluzivisht *përfitimi i ndonjë avantazhi për vete apo për tjetrin* ashtu që për realizimin e këtij qëllimi kryesi vepron në pajtim apo vepron në kundërshtim me detyrën e tij (KPRK, 2019, p. neni 113 par. 7).

Nuk janë mbushur ende katër (4) vite prej kur ligjvënësi në Republikën e Kosovës ka përcaktuar si vepra penale “marrjen e ryshfetit në sektorin privat” dhe veprën penale “dhënia e ryshfetit në sektorin privat”. Së këndejmi mund të supozohet se institucionet kompetente në shtetin e Kosovës ende mund të mos kenë konsoliduar përvojën e mjaftueshme për të arritur qëllimet e përcaktuara me rastin e ballafaqimit me format e ndryshme të korrupsionit në sektorin privat. Në vazhden e kësaj si argument plotësues mund të referohet fakti që ende nuk ekziston asnjë aktgjykim i formës së prerë lidhur me cilëndo nga veprat penale të korrupsionit në sektorin privat sipas nenit 309 dhe 310 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022), pa çka se mund të jenë parashtruar një numër mjaft i limituar i aktakuzave për shkak të këtyre dy veprave penale.

Sidoqoftë, mungesa eventuale e aktgjyqimeve të formës së prerë për shkak veprave penale të korrupsionit në sektorin privat në ndërlidhje edhe me përvojën jo të gjatë të ballafaqimit me këtë fushë, nuk duhet të nënkuptoj patjetër që korrupsioni në sektorin privat nuk është i pranishëm në shtetin e Kosovës.

Sipas një studimi të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë lidhur me perceptimin e korrupsionit në vend në vitin 2020 kishte rezultuar se rreth 70% e të anketuarve janë të bindur se korrupsioni është i pranishëm edhe në sektorin privat në Republikën e Kosovës (Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, 2020). Përndryshe një konstatim të tillë e kanë konfirmuar edhe hulumtues të tjerë të kësaj fushe nga shoqëria civile dhe mediat në Republikën e Kosovës (Koha Islame, 2021).

Korrupsioni në sektorin publik padyshim që është i ndërlidhur me administratën publike në kontekst të objektit të mbrojtur përmes këtyre veprave penale. Duke u nisur nga kjo logjikë e mendimit, veprat penale të korrupsionit në sektorin privat natyrshëm janë të ndërlidhura me ekonominë e vendit të caktuar. Sipas kësaj premise në kuptimin etiologjik të analizës, niveli i zhvillimit ekonomik mund të përfaqësoj një nga faktorët e jashtëm kriminogjen të korrupsionit në sektorin privat. Me fjalë të tjera, sa më i vogël që të jetë tregu ekonomik aq më të vogla janë mundësitë e korrupsionit në sektorin privat dhe anasjelltas. Sipas të dhëna nga Banka Botërore, zhvillimi ekonomik në Republikën e Kosovës nga viti 2009 është në trend rritës (World Bank,

2022). Për më tepër në vitin 2021 rritja ekonomike konsiderohet të jetë 9.1% që njëkohësisht është rritja më e madhe prej vitit 2008 kur edhe është shpallur pavarësia e Republikës së Kosovës (World Bank, 2022).

Përderisa administrata publike të jetë një nga punëdhënësit kryesor në shtetin e Kosovës, natyrshëm edhe vëmendja do të përqendrohet te ballafaqimi me korrupsionin në sektorin publik. Mirëpo paralelisht me trendin rritës të zhvillimit ekonomik në vend, do të ishte më se e logjikshme që edhe fokusi për ballafaqimin me korrupsionit të zhvendoset proporcionalisht edhe në sektorin privat. Ndoshta nuk do të arrihet që shteti të jetë një hap përpara kryesve të veprave penale të korrupsionit. Mirëpo të paktën në këtë mënyrë do të krijohet mundësia që shteti të ndjek trendin e zhvillimit të korrupsionit si një fenomen mjaft dinamik dhe kompleks.

2.1. Korrupsioni në media në Republikën e Kosovës

Tregu medial është i kufizuar në aspektin financiar, por mjaft i larmishëm për një vend të vogël si Republika e Kosovës (Konrad Adenauer Stiftung, 2020). Ai dominohet nga një transmetues publik, ndërsa sektori privat përbëhet nga radio-televizionet, gazetatat ditore dhe portalet e lajmeve në internet (Konrad Adenauer Stiftung, 2020). Afërsisht 88.8% e popullsisë kosovare janë përdorues të internetit ndërsa 'Facebook' mbetet rrjeti social më i preferuar në Republikën e Kosovës (Internet World Stats, 2021).

Duhet cekur se shteti i Kosovës renditet nr. 78/180 në Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit (WPFI) për vitin 2021, që është një performancë shumë më e mirë se të gjitha vendet fqinje në Ballkanin Perëndimor (Reporters Without Borders, 2021). Megjithatë, gazetarët dhe mediat në Republikën e Kosovës vazhdojnë të ekspozohen ndaj një mjedisi jo miqësor për shkak të mungesës së transparencës lidhur me pronësinë e mediave (Reporters Without Borders, 2021). Në ndërkohë që mediat e brishta financiarisht vazhdojnë që të jenë relativisht të ndjeshme edhe ndaj ndikimit politik (Reporters Without Borders, 2021).

Një konstatim i ngjashëm është konfirmuar edhe nga organizata ndërkombëtare IREX ashtu që sipas Indeksit të Qëndrueshmërisë së Mediave (MSI) për vitin 2019 Republika e Kosovës ende mbetet në klasifikimin **“afër qëndrueshmërisë”** me një rezultat të përgjithshëm prej 2.53 MSI

apo Media Sustainability Index (IREX, 2019, p. 3). Me këtë rast janë vlerësuar pesë (5) kriteret të vlerësuar për vitin 2019 si në vijim:

- **Liria e fjalës** - që është vlerësuar me 2.52 MSI (IREX, 2019, p. 2);
- **Gazetaria profesionale** - që është vlerësuar me 2.41 MSI (IREX, 2019, p. 2);
- **Pluralizmi i burimeve të gazetarisë** - që është vlerësuar me 2.72 MSI (IREX, 2019, p. 2);
- **Menaxhimi i biznesit** - që është vlerësuar me 1.96 MSI (IREX, 2019, p. 2);
- **Mbështetja e institucioneve** - që është vlerësuar me 3.02 MSI (IREX, 2019, p. 2).

Pra përtej mesatares prej 2.53 MSI në vitin 2019, IREX më së shumti ka vlerësuar kriterin e mbështetjes së institucioneve me 3.02 MSI dhe më së paku pjesën e menaxhimit të biznesit me 1.96 MSI (IREX, 2019, p. 2).

Për më tepër, Raporti nga organizata ndërkombëtare IREX i cituar më sipër, ka përmbledhur gjithashtu se gazetarët dhe profesionistët e tjerë të mediave në Republikën e Kosovës janë të ekspozuar edhe ndaj korrupsionit, kryesisht për shkak të ardhurave financiare të pamjaftueshme nga profesionet e tyre (IREX, 2019, p. 6).

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2020 ka sqaruar se:

“Transmetuesi publik mbetet i pambrojtur ndaj presionit dhe ndikimit politik. Mungesa e vetë qëndrueshmërisë financiare ka lënë edhe transmetuesit privatë të pambrojtur ndaj interesave politike dhe të biznesit. Kjo përforcohet më tej nga mungesa e informacionit dhe e të dhënave për përfituesin përfundimtar të pronësisë së medias, ndërkohë që për këtë çështje ende nuk ekzistojnë dispozita ligjore në fuqi” (European Commission, 2020, p. 31).

Mediat në Kosovë janë të cenueshme edhe nga dezinformatat dhe lajmet e rreme (NDI Kosovo, 2021). Kjo për shkak se mediat në Kosovë i nënshtrohen presionit të politikanëve dhe biznesmenëve (BIRN, 2017, pp. 2, 6). Nga ky këndvështrim, përveç transmetuesit publik edhe mediat private në Kosovë mund të jenë mjaft të ekspozuara ndaj korrupsionit (Risk&Compliance, GAN, 2020). Veçanërisht mediat private që veprojnë përmes portaleve

online janë të varura nga interesi politik dhe ekonomik i pronarëve të tyre pasi që atyre u mungon financimi i qëndrueshëm (Risk&Compliance, GAN, 2020).

Mungesa e rezultateve të dëshirueshme nga ballafaqimi i Republikës së Kosovës me korrupsionin, vitet e fundit mund të ketë krijuar një “terren mjaft pjellor” edhe për dezinformim dhe lajme të rreme (European Parliament, 2021, p. 13).

Me fjalë të tjera, korrupsioni në media jo vetëm që ka shkaktuar mosbesim të thellë në publik, por eventualisht edhe ka stimuluar dezinformimin si dhe fushatat e konsiderueshme për lajme të rreme në Republikën e Kosovës (European Parliament, 2021, p. 13). Rrjedhimisht, Freedom House ka konstatuar se mjedisi i lirisë në Kosovë gjatë vitit 2020 duhet vlerësuar vetëm si pjesërisht i lirë me 54 pikë nga 100 pikët e mundshme në indeksin e përdorur për vlerësim (Freedom House, 2021).

KAPITULLI VI – KORRUPSIONI PËRMES KRIPTOVALUTAVE

1. Kuptimi i korrupsionit përmes kriptovalutave

Kriptomonedha është bërë e pranishme kudo dhe po evoluon vazhdimisht. Pyetja është nëse korniza ligjore po arrin të përcjellë zhvillimet me kriptovaluta. Prandaj, ky kapitull analizon argumentet mbi legjitimitetin dhe ligjshmërinë e kriptomonedhës në mënyrë që të theksohet ndërlidhja midis korrupsionit dhe kriptomonedhës. Në këtë drejtim ekzistojnë disa argumente që e potencojnë relacionin ndërmjet korrupsionit dhe kriptovalutave. Këto argumente në thelb i referohen disa prej karakteristikave unike të kriptomonedhës siç janë luhatjet e shpejta të vlerës, vështirësitë për gjurmimin e tyre si dhe mungesa e rregullimit ligjor të kësaj fushe.

Karakteristikat unike mund ta bëjnë tregun e kriptomonedhave si një mjedis mjaft tërheqës për aktivitetet e korrupsionit. Në fakt bota tashmë është përballur me disa afere korruptive përmes kriptovalutave të cilat kanë shkaktuar dëme në vlerë prej qindra milionë dollarë. Prandaj, qëllimi i këtij kapitulli është të evidentojë mundësinë e kryerjes së aktiviteteve korruptive përmes kriptovalutave si një formë e korrupsionit e panjohur më parë.

Në vitin 2009, Bitcoin u bë kriptovaluta e parë e lëshuar ndonjëherë. Sot numërohen më shumë se 12,000 blloqe të ndryshme të kriptomonedhave (Lyle Daly, 2022) me mbi 300 milionë përdorues në mbarë botën (TripleA, 2022).

Njerëzit po i besojnë kriptomonedhës si një mjet këmbimi pasi që mbi 18,000 biznese në botë tanimë pranojnë pagesa me kriptomonedhë (TripleA, 2022). Ndoshta ky besim i njerëzve në kriptomonedha është për shkak të karakteristikave unike të saj. Transaksionet bëhen më lehtë, më shpejtë, drejtpërdrejtë dhe pa tarifa që mund të shpijnë në shpenzime të dyfishta si dhe zakonisht nuk kërkohen as informacionet personale të palëve të transaksionit. Kjo mundësohet sepse kriptovalutat nuk kanë nevojë për një palë të tretë mbikëqyrëse si autoritet qendror të kontrollit. Të gjitha transaksionet kryhen brenda një rrjeti të decentralizuar *peer-to-peer* përmes algoritmeve dhe teknikave kriptografike që mbrojnë transaksionet financiare që realizohen përmes kriptovalutave (Conotoxia, 2022).

Zhvillimet e tilla në rrjedhën e jetës sonë financiare duhet jo vetëm të njihen, por edhe të inkuadrohen në kuadrin ligjor në fuqi. Duhet dhënë përgjigje edhe në pyetjet lidhur me nivelin e sigurisë si dhe aktivitetet e mundshme kriminale siç është korrupsioni dhe pastrimi i parave. Bashkimi Evropian tashmë ka filluar të trajtoj disa nga këto çështje, duke synuar edhe miratimin e legjislacionit të duhur për kriptomonedhat (European Commission, 2022).

Aktualisht, kriptomonedha është shumë e vështirë për t'u gjurmuar. Kjo nënkupton se shpeshherë nuk dihet nga kush dhe për kë është bërë një transaksion i caktuar. Në fakt lehtësisht mund të bëhen transaksione të shumta dhe të shpejta pa u vënë re sepse zakonisht nuk kërkohen të dhëna personale dhe nuk ekziston asnjë autoritet mbikëqyrës si qendër e kontrollit (PYMNTS.com, 2022). Për më tepër, legjislacioni në fuqi është relativisht i varfër lidhur me këtë fushë. Njerëzit ende nuk kanë arritur të kuptojnë nëse kriptomonedha është një monedhë e vërtetë apo është send apo diçka tjetër (Kane Russell, 2021). Pra, si mund të ndalojmë aktet e korrupsionit në një mjedis të tillë me kaq shumë pikëpyetje? Më e rëndësishmja, si mund t'i identifikojmë, hetojmë dhe gjykojmë aktet e tilla të korrupsionit përmes kriptomonedhave pa legjislacionin e duhur në fuqi? Padyshim që dilemat e tilla të

ngritura po na çojnë drejt një forme të re të korrupsionit me një *modus operandi* të ri dhe të panjohur më parë.

1.1. Legjitimiteti i kriptovalutave

Kriptomonedhat janë një formë e re e aseteve dixhitale të bazuara në një rrjet elektronik që shpërndahet në një numër të madh kompjuterësh. Sistemet e kriptomonedhave lejojnë pagesa të sigurta në internet të cilat si të tilla mundësohen nga tokenët virtual (Frankenfield, 2022). Fjala kriptomonedhë derivon për shkak të teknikave të kriptimit që përdoren për të siguruar rrjetin elektronik. Termi "kripto" i referohet algoritmeve të ndryshme të kriptimit dhe teknikave kriptografike që mundësojnë qasjen e sigurtë në këto sisteme elektronike, të tilla si kriptimi i korbës eliptike, çiftet e çelësave publik-privat dhe funksionet numerike. Termi "Blockchains" apo blloqet zinxhirore janë një komponentë tjetër thelbësore e kriptovalutave dhe nënkuptojnë metodat organizative për të siguruar integritetin e të dhënave të transaksioneve (Frankenfield, 2022).

Kriptomonedha e parë e bazuar në blockchain ishte Bitcoin, e cila vazhdon të ketë vlerën më të madhe në treg përkundër faktit që sot ka mijëra kriptomonedha alternative me funksione dhe specifika të ndryshme. Në vitin 2008 u publikua një punim me titullin "*Bitcoin: një sistem elektronik Peer-to-Peer i parave të gatshme*" (Satoshi Nakamoto, 2008, p. 1). Autorësia e këtij punimi i takon pseudonimit Satoshi Nakamoto, që njëkohësisht konsiderohet edhe pionieri kriptografik i monedhave dixhitale (Satoshi Nakamoto, 2008, p. 1).

Tutje në vitin 2009, blloku i parë i gjenezës u krijua dhe transaksionet përmes Bitcoin u realizuan për herë të parë në historinë e kriptovalutave (Decentralized Dog, 2021). Ka shumë për të mësuar rreth Satoshi Nakamotos pasi që nuk dihet nëse kemi të bëjmë me një individ apo një grup të personave (Decentralized Dog, 2021).

Sidoqoftë, demaskimi i autorit dhe krijuesit të Bitcoin dhe kriptomonedhave në përgjithësi nuk është në fokus të këtij punimi. Me rëndësi është fakti se Satoshi Nakamoto ka konstatuar që

“ne kemi nevojë për një sistem elektronik të pagesave të bazuar në prova kriptografike në vend të besimit në paratë e gatshme, duke mundësuar që dy palë të realizojnë transaksione drejtpërdrejt me njëra tjetrën pa ndërmjetësues të tretë si autoritet i mbikëqyrjes financiare” (Satoshi Nakamoto, 2008, p. 1). Nakamoto konstaton po ashtu se transaksionet përmes kriptovalutave do të mbrojnë shitësit nga mashtrimi ndërsa mekanizmat rutinë të ruajtjes mund të zbatoheshin lehtësisht për të mbrojtur edhe blerësit (Satoshi Nakamoto, 2008, p. 2).

Kriptovalutat nuk kanë autoritet qendror të mbikëqyrjes, që do të thotë se mbijetesa e kriptomonedhës mbahet në kontroll nga vet komuniteti i përdoruesve. Në këtë rrjet “peer-to-peer”, çdo përdorues është një “host” dhe një nyje për softuerin. Prandaj, kriptovalutat shpesh përkufizohen edhe si “token dixhital të përdorur për të transferuar para në mënyrë anonime në çast midis individëve në një rrjet të decentralizuar peer-to-peer me tarifa minimale për transaksionin” (UKEssays, 2020). Një përkufizim i tillë ka ngritur pyetje në lidhje me vlefshmërinë e tyre juridike në tregun aktual financiar dhe nëse ato me të vërtetë mund të shërbejnë për lehtësimin e transaksioneve (UKEssays, 2020).

Për të kuptuar më tej argumentin e legjitimitetit të kriptomonedhës, është e rëndësishme të theksohet se aktualisht ka mbi 84 milionë kuleta (blockchain-përdorues) të kriptomonedhave në botë dhe ky numër po rritet vazhdimisht (Blockchain.com, 2022). Në anën tjetër rezulton se kapitali i përgjithshëm i tregut mbi të cilin ndërveprojnë llojet e ndryshme të kriptomonedhave ka arritur rreth një (1) triliardë dollarë (CoinMarketCap, 2022).

- Kapitali i tregut të Bitcoin është mbi 408 miliardë dollarë (CoinMarketCap, 2022).
- Kapitali i tregut të Ethereum është mbi 145 miliardë dollarë (CoinMarketCap, 2022).
- Kapitali i Tether është mbi 66 miliardë dollarë (CoinMarketCap, 2022).
- Tutje, kapitali i tregut të USD Coin është 56 miliardë dollarë (CoinMarketCap, 2022).
- Kapitali i tregut për BNB është 39 miliardë dollarë (CoinMarketCap, 2022).
- Kapitali i tregut për Binance USD është 18 miliardë dollarë (CoinMarketCap, 2022).
- Kapitali i tregut për XRP dhe për Cardano (ADA) është nga 16 miliardë dollarë (CoinMarketCap, 2022).

- Më shumë se tridhjetë kriptovaluta të tjera kanë kapital të tregut mbi 1 miliardë dollarë secila prej tyre (CoinMarketCap, 2022).
- Mbi tetëdhjetë kriptovaluta të tjera kanë një kapitalizim tregu prej mbi një milion dollarë secila (CoinMarketCap, 2022).
- Më shumë se njëqind kriptovaluta të tjera kanë kapital tregu me qindra mijëra dollarë secila (CoinMarketCap, 2022).

Në vende të ndryshme kriptovalutat njihen me terma të ndryshëm si në vijim (Global Legal Research Center, 2019, p. 1):

- “Valuta Dixhitale” në Argjentinë, Tajlandë dhe Australi;
- “Mall virtual” në Kanada, Kinë dhe Tajvan;
- “Crypto-Token” në Gjermani apo “Payment Token” në Zvicër;
- “Cyber Monedha” në Itali dhe Liban;
- “Asete Virtuale” në Meksikë dhe Honduras;
- “Monedha Elektronike” në Kolumbi.

Përtej termave të ndryshëm që përdoren në shtete të ndryshme, kriptovalutat janë bërë shumë premtuese për të ndryshuar në thelb sistemin aktual financiar në botë. Prandaj është e rëndësishme të sqarohet edhe përcaktimi i tyre juridik në përgjithësi dhe në relacion me korrupsionin në veçanti.

2. Përcaktimi juridik i korrupsionit përmes kriptovalutave

Mungesa e infrastrukturës juridike për kriptovalutat nënkupton pasiguri jo vetëm për përdoruesit por edhe për qeveritë në mbarë botën (Mandjee, 2015, p. 25). Komisioni Evropian ka konstatuar po ashtu domosdoshmërinë për siguri juridike lidhur me fushat e aplikacioneve elektronike të bazuara në sistemin blockchain (European Commission, 2022).

Në fakt mund të thuhet se Bashkimi Evropian mbështet fuqishëm krijimin e një kornize pan-evropiane dhe shpreson të shmangë fragmentimin ligjor dhe rregullator (European Commission, 2022). Prandaj Bashkimi Evropian ka miratuar një pako gjithëpërfshirëse të propozimeve legislative për rregullimin e krypto-aseteve, përditësimin e rregullave të tregut financiar për krypto-asetet duke përfshirë edhe përdorimin e blockchains për tregti, postë dhe letrat me vlerë (European Commission, 2022).

Në kuadër të kësaj iniciative ligjore të Bashkimit Evropian është miratuar edhe propozimi nr. 2020/0265 (COD)-COM (2020) 593 në Bruksel më 24.09.2020 (Document 52020PC0593, 2020). Duke iu referuar këtij propozimi, termi "kripto-aset" nënkupton:

- *"një përfaqësim dixhital i vlerës ose i të drejtave që mund të ruhen dhe transferohen në mënyrë elektronike, duke përdorur teknologjinë ledger (të protokollit) ose teknologji të ngjashme"* (Document 52020PC0593, 2020, p. 35).

Më tej duke iu referuar këtij propozimi *"shtetet anëtare do të caktojnë autoritetet kompetente përgjegjëse për kryerjen e funksioneve dhe detyrave të parashikuara në këtë propozim"* (Document 52020PC0593, 2020, p. 84).

Termi *"Autoritet kompetent"* i parashikuar në propozimin si më sipër të Bashkimit Evropian është po aq vendimtar sa përkufizimi i propozuar për "kripto-asetet". Kjo për shkak se veçoria e tyre përshkruhet saktësisht si një rrjet i decentralizuar *peer-to-peer* pa kontroll qendror të mbikëqyrjes. Neni 83 i propozimit parashikon një numër të madh kompetencash të këtyre autoriteteve si p.sh. *"të ndalojnë ofrimin e shërbimeve të krypto-aseteve kur konstatojnë se kjo rregullore është shkelur"* ose *"të pezullojnë ofrimin e shërbimit me kriptovaluta"* (Document 52020PC0593, 2020, p. art. 83).

Një rregullim i tillë tingëllon vështirë i zbatueshëm për sa kohë që synohet të krijohet një autoritet i kontrollit qendror për një rrjet të decentralizuar (Global Legal Research Center, 2019, p. 154). Sidoqoftë, kjo iniciativë e Bashkimit Evropian është e mirëseardhur pasi që nënkupton marrjen e drejtimit për rregullimin ligjor të aplikacioneve elektronike të bazuara në sistemin blockchain. Nga ky këndvështrim, korniza juridike e Bashkimit Evropian është shumë e

rëndësishme në këtë fushë pasi që përmes saj ndikohen edhe rregullimet juridike të vendeve të tjera evropiane.

Kriptomonedha nuk duhet të jetë vetëm një objekt i ligjit civil dhe financiar, por edhe i ligjit penal (Eveshnie Reddy, 2018, p. 86). Kjo sepse kriptovalutat mund të jenë shumë tërheqëse për aktivitete kriminale si korrupsioni dhe pastrimi i parave (Anna Irrera, 2020). Fatkeqësisht, shumë vende nuk kanë ende legjislacion për kriptovalutat. Shumica e vendeve që kanë miratuar ligje për kriptovalutat synojnë vetëm të rrisin ndërgjegjësimin e njerëzve për rrezikun dhe kërcënimet që lidhen me kriptomonedhën. Në anën tjetër, vendet si Algjeria, Bolivia, Maroku, Nepali, Pakistani dhe Vietnami kanë ndaluar çdo aktivitet që përfshijnë kriptovalutat (Global Legal Research Center, 2019, p. 2).

Vende të tjera si Bangladeshi, Irani, Tajlanda, Lituania, Kina dhe Kolumbia, nuk e kanë ndaluar investimin në kriptovaluta, por kanë vendosur kufizime indirekte duke i ndaluar institucionet financiare brenda kufijve të tyre që të lehtësojnë transaksionet që përfshijnë kriptovalutat (Global Legal Research Center, 2019, p. 2). Vetëm disa vende si Australia, Zvicra, Japonia, Danimarka dhe Kanadaja kanë miratuar ligje për t'i sjellë transaksionet dhe institucionet e kriptomonedhave që i lehtësojnë ato nën kuadrin e ligjeve të pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit (Global Legal Research Center, 2019, p. 5).

2.1. Kriptovalutat si mjete të kryerjes së korrupsionit

Kryesit e veprave penale janë zakonisht ndër adoptuesit e parë të çdo teknologjie të re që funksionon në shoqëri. Blockchains mund të bëhen vetëm një shembull tjetër e teknologjive të reja që përdoren për të kryer vepra penale (Weinstein, 2019).

Qysh nga krijimi i kriptomonedhës janë shkaktuar mjaft skandale të mëdha të mashtrimit të cilat janë manifestuar më pas si afera të korrupsionit apo aktiviteteve tjera kriminale. Disa prej këtyre skandaleve më përfaqësuese mund të jenë:

- **“Silk Road”**: Në vitin 2013 FBI ka arrestuar Ross Ulbricht ish-operatorin e rrjetit të errët “Silk Road” i njohur edhe me pseudonim si “Dread Pirate Roberts”. Ulbricht është akuzuar për

përfshirje në një komplot për pastrim parash dhe trafik narkotikësh si dhe për hakerim kompjuterik. Sipas aktakuzës faqja kishte gjeneruar mbi 9.5 milionë dollar në të ardhura nga shitjet dhe mbi 600,000 dollar në komisione për pronarin e saj (Hume, 2013).

- **“BitConnect”**: Në vitin 2018 policia indiane arrestoi Divyesh Darji - pronarin e BitConnect, i cili është akuzuar për grumbullimin e 12.6 miliardë dollarëve (880 miliardë rupi indiane) nga investorët në Indi përmes një "Skeme Ponzi" (Osborne, 2018).
- **“Crypto Queen”**: Në qershor 2016 një biznesmene 36-vjeçare e quajtur Dr. Ruja Ignatova doli në skenë në Wembley Arena (Londër) përpara mijëra tifozëve të futbollit (BBC News, 2019). Ajo i tha turmës brohoritëse se "OneCoin" ishte në rrugën e duhur për t'u bërë kriptomonedha më e madhe në botë "që të gjithë të bëjnë pagesa kudo" (BBC News, 2019).

Në të gjithë botën, njerëzit kishin filluar të investonin kursimet e tyre në 'OneCoin', duke shpresuar të ishin pjesë e këtij "revolucionit të ri" (BBC News, 2019). Midis gushtit 2014 dhe marsit 2017 më shumë se 4 miliardë euro janë investuar në dhjetëra vende (BBC News, 2019). Në vitin 2017 Dr. Ruja Ignatova fitoi pseudonimin "kripto mbretëresha" pasi që u zhduk bashkë me të gjitha këto investime. Deri sot ajo ndodhet në kërkim nga autoritetet kompetente mirëpo nuk është zbuluar asnjëherë vendndodhja e saj (BBC News, 2019).

- **“Bitclub network”**: Në vitin 2019 Prokurori i shtetit në SHBA Craig Carpenito (Distrikti i Nju Xhersit, SHBA) njoftoi opinionin publik se tre (3) burra u arrestuan në lidhje me një skemë të minierave të kriptomonedhave që mashtroi investorët në vlerë prej 722 milionë dollarësh (United States vs. Matthew Brent Goettsche et.al., 19-CR-877-CCC, 31).

Të pandehurit Goettsche, Balaci dhe Weeks janë akuzuar për konspiracion për t'u përfshirë në mashtrime në lidhje me rolet e tyre në "BitClub Network" (United States vs. Matthew Brent Goettsche et.al., 19-CR-877-CCC, 31).

Nga prilli 2014 deri në dhjetor 2019, "Rrjeti BitClub" ishte një skemë mashtruese që kërkonte para nga investorët në këmbim të aksioneve të grupeve të supozuara të

minierave të kriptomonedhave dhe shpërblente investitorët për rekrutimin e investitorëve të rinj në skemë (United States vs. Matthew Brent Goettsche et.al., 19-CR-877-CCC, 31).

Duke njohur interesin e përbashkët për të luftuar aferat korruptive përmes kriptovalutave, organizatat ndërkombëtare tanimë kanë filluar të manifestojnë një mobilitet më të gjerë në këtë temë (Blockchain Alliance, 2020). Në këtë mënyrë është formuar "Aleanca Blockchain" si një forum publik-privat për të ndihmuar në luftimin e aktivitetit kriminal përmes teknologjisë blockchain (Blockchain Alliance, 2020).

Njëkohësisht edhe Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin ka nisur disa programe trajnimi për të trajtuar aktivitetet kriminale që lidhen me kriptomonedhën (UNODC, 2017). Rrjedhimisht mund të konstatohet se lufta kundër korrupsionit përmes kriptomonedhave po merr çdo herë më shumë vëmendje në të gjithë botën (Weinstein, 2019, p. 7).

Ekzistojnë të paktën tre (3) karakteristika të kriptomonedhave që i bëjnë ato mjaft tërheqëse për aktivitete kriminale në përgjithësi dhe të korrupsionit në veçanti:

- 1) Janë vështirë të gjurmueshme** (Conotoxia, 2022),
- 2) Vlera e tyre nuk është qëndrueshme** (Conotoxia, 2022) dhe
- 3) Mungesa e legjislacionit** (European Commission, 2022).

Parimisht dy karakteristikat e para (pagjurmueshmëria dhe luhatja e vlerës) në masën më të madhe derivojnë për shkak se kriptovalutat janë rrjete të decentralizuara peer-to-peer ndërsa mungesa e legjislacionit mund të rrjedhë sepse kriptomonedha është një industri e re ende në rritje dhe e panjohur më herët.

Nëse ekziston një aset digjital i ngjashëm me paranë e vërtetë por i cili është vështirë i gjurmueshëm me një vlerë që luhatet shpejt dhe pa legjislacionin e duhur, çfarë aktivitetesth kriminale mund të kryhen duke përfshirë ato asete digjitale? Padyshim që një ambient i tillë është shumë i përshtatshëm jo vetëm për kryerjen e veprave të korrupsionit por edhe për pastrimin e parave, evazionin fiskal dhe financimin e terrorizmit (William Buchanan, 2018).

Gjithashtu e rëndësishme është të adresohen disa nga sfidat dhe pengesat kryesore për inkriminimin e korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera kriminale që përfshijnë kriptovalutat. Për shembull vendet në Ballkanin Perëndimor ende nuk kanë legjislacion për teknologjitë e kriptomonedhave. Bazuar në këtë fakt, shtrohet pyetja se si mund të ndiqen penalisht kryesit e marrjes së ryshfetit në formë të bitcoin, nëse bitcoin është shumë vështirë për t'u gjurmuar dhe ka mungesë të legjislacionit për këtë fushë.

Për më tepër, kriptomonedha mund të transferohet edhe të konvertohet lehtësisht në çdo kriptomonedhë tjetër dhe vlera e saj mund të luhatet në mënyrë drastike brenda pak kohe. Transaksionet mund të bëhen gjithashtu lehtësisht dhe të gjitha ato veprime nuk regjistrohen nga asnjë autoritet qendror i kontrollit sepse një autoritet i tillë nuk ekziston. Sidoqoftë, më shqetësues është fakti se për të gjitha këto veprime ende nuk ka legjislacion të duhur jo vetëm në shtetin e Kosovës por në shumicën e shteteve evropiane.

Për shkak të karakteristikave të kriptovalutave ato mund të konsiderohen si ambient i përshtatshëm për kryerjen e akteve të korrupsionit. Për të luftuar me sukses këtë fenomen, nevojitet jo vetëm ndërgjegjësim i përdoruesve të kriptovalutave por edhe një mobilizim i gjerë nga vendet dhe organizatat ndërkombëtare me qëllim të miratimit të legjislacionit të duhur jo vetëm në fushën e të drejtës penale por edhe të drejtën penale ndërkombëtare (CMI U4, 2022).

3. Lufta kundër korrupsionit përmes kriptovalutave

Kriptomonedha ka potencialin të ndryshojë sistemin financiar në botë sepse kapitalizimi i saj i tregut po rritet vazhdimisht që nga krijimi i tyre në vitin 2009. Kriptovalutat janë unike prandaj dallojnë shumë në krahasim me monedhat e zakonshme. Monedhat e rregullta janë kryesisht në letër fizike dhe kontrollohen nga një autoritet qendror i besuar për çdo transaksion. Nga ana tjetër, kriptomonedhat janë një rrjet elektronik i decentralizuar *peer to peer* të cilat nuk kontrollohen nga asnjë autoritet qendror, por vetëm nga përdoruesit e softuerit të caktuar blockchain. Karakteristikat e tilla dërgojnë në përfundimin se kriptomonedha mund të jetë jo vetëm revolucion nga pikëpamja financiare, por edhe mjaft e cenueshme nga pikëpamja ligjore.

Korrupsioni përmes kriptomonedhave është mjaft kompleks sepse është i ri dhe i pa hulumtuar mjaftueshëm. Kriptoalutat janë të vështira për t'u gjurmuar, prandaj është shumë e vështirë të zbulohet se kush e ka dhënë apo kush e ka marrë rryshfetin. Duhet të merret parasysh fakti që kriptomonedhat mund të transferohen dhe konvertohen lehtësisht në çdo kriptomonedhë tjetër si dhe vlera e tyre mund të luhetet në mënyrë drastike brenda pak kohe. Këto veçori të kriptomonedhave u mundësojnë kryesve të veprave penale të përfshihen në korrupsion dhe pastrimin e parave pasi që transaksionet mund të kryhen shumë lehtë dhe të gjitha ato veprime nuk regjistrohen nga asnjë autoritet qendror sepse një autoritet i tillë nuk ekziston. Në mungesë të legjislacionit të duhur nuk ekziston alternativë tjetër përveçse të studiohen më tutje dhe të kuptohen mënyrat për luftimin e korrupsionit dhe aktiviteteve tjera kriminale ku përdoret teknologjia “blockchain” si mjet të kryerjes së veprave penale. Sa i përket Republikës së Kosovës, hapi i parë që duhet të ndërmerret është miratimi i ligjit për kriptoalutat përmes të cilit duhet të përcaktohet statusi juridik i kriptoalutave në shtetin e Kosovës si dhe të rregullohen mënyrat e përdorimit dhe veprimet juridike përmes kriptoalutave. Sidoqoftë për të tejkaluar sfidat dhe pengesat në luftimin e korrupsionit përmes kriptoalutave, objekt i legjislacionit lidhur me teknologjinë blockchain duhet të jetë edhe inkriminimi juridiko material i veprave penale të korrupsionit të cilat si mjet të kryerjes në figurën e tyre ligjore e kanë teknologjinë blockchain të kriptoalutave. Njëkohësisht në aspektin procedural penal duhet përcaktuar autoriteti kompetent për luftimin e këtyre formave korruptive si dhe masat dhe veprimet hetimore penale që mund të ndërmerren për këto qëllime.

KAPITULLI VII – MBROJTJA E VIKTIMAVE TË KORRUPSIONIT

1. Mbrojtja e viktimave të korrupsionit

Vënia e drejtësisë në vend nuk nënkupton vetëm ndëshkimin e kryesve të veprave penale por edhe arritjen e satisfaksionit moral dhe material për viktimat e atyre veprave penale (Dr. Halili, Viktimologjia, 2011). Kur flasim për korrupsionin duhet theksuar se edhe korrupsioni është një fenomen kriminal prej të cilit mbesin pas shumë viktimat (Dr. Halili, Viktimologjia, 2011). Prandaj synim i këtij kapitulli është që të sqaroj se mbrojtja juridiko civile e të drejtave të viktimave të korrupsionit është një nga betejat më vendimtare në luftën kundër korrupsionit.

Korrupsioni edhe ashtu është një shqetësim që vazhdon të jetë aktual në Republikën e Kosovës. Megjithatë duket se situata me pandeminë Covid-19 vetëm sa e ka bërë më të brishtë sistemin e drejtësisë në vend. Për rrjedhojë është krijuar një ambient ende më i favorshëm për kryerjen e akteve të korrupsionit. Për luftimin efikas të korrupsionit, ka shumë rëndësi që të sigurohen mjete juridike efektive për të gjithë personat që kanë pësuar dëme nga aktet e korrupsionit, duke përfshirë këtu edhe të drejtën e tyre për kompensimin e dëmeve që kanë pësuar.

Sipas Organizatës së Kombeve të Bashkuara, mbi 1 trilion dollarë amerikanë paguhën në formë të ryshfetit çdo vit, ndërsa rreth 2.6 trilion dollarë paguhën çdo vit përmes formave të tjera të korrupsionit. Kjo shumë është përafërsisht ekuivalente me më shumë se 5% të GDP-së globale (United Nations, 2019).

Megjithatë, korrupsioni sot nuk ka të bëj vetëm me paratë. Korrupsioni duhet të kuptohet si një kërcënim i vazhdueshëm për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Pasojat e tij manifestohen veçanërisht në vendet e varfra apo në vendet në zhvillim.

Për shembull, Transparency International ka raportuar se *“Korrupsioni mund të kushtoj me jetë në përgjigjen e Amerikës Latine ndaj Coronavirusit”* (Transparency International, 2020). Vetëm reduktimi i korrupsionit gjatë ballafaqimit me Covid-19 mund të jetë i mjaftueshëm për të siguruar mobilitetin e duhur të institucioneve kompetente atje (Transparency International, 2020). Në të kundërtën (*vice versa*) pasojat mund të jenë shumë më të mëdha për vendin atje (Transparency International, 2020). Në këto rrethana, çmimet e korrupsionit mund të duhet që të paguhën edhe me jetë të njerëzve të pafajshmëve, të cilët për shkak të korrupsionit nuk kishin mbrojtjen e duhur nga shteti i tyre (Transparency International, 2020). Nga ky këndvështrim, nuk përjashtohet mundësia që korrupsioni mund të kushtoj me jetë të njerëzve edhe në Ballkanin Perëndimor, sidomos gjatë luftës kundër pandemisë Covid-19.

Kudo që ka korrupsion do të ketë edhe varfëri, papunësi, nepotizëm, sistem të dobët shëndetësor, sistem të dobët arsimor, mungesë të sundimit të ligjit dhe mbi të gjitha njerëzit mund të paguajnë edhe me jetën e tyre sepse dikush në sistemin shëndetësor apo gjetkë mund të jetë korruptuar.

Vlen të thuhet që Republika e Kosovës nuk është anëtare e Konventës Civile për Korrupsion pasi që nuk është as anëtare e Këshillit të Evropës. Megjithatë për shkak të rëndësisë që ka mbrojtja e viktimave të korrupsionit, pikërisht kjo konventë duhet të jetë udhërrëfyese për krijimin e mundësive të tilla ligjore edhe në Republikën e Kosovës. Në anën tjetër ekzistojnë edhe praktika të mira juridike me të cilat mund të shërbehet shteti i Kosovës në këtë rrugë, siç është rasti me Francën dhe Britaninë e Madhe.

Ky kapitull është fokusuar pikërisht në mbrojtjen e të drejtave të viktimave të korrupsionit në Republikën e Kosovës me qëllim të evidentimit dhe evitimit të dallimeve ndërmjet kornizës ligjore në fuqi të Republikës së Kosovës si dhe Konventës Civile kundër Korrupsionit dhe standardet e Këshillit të Evropës në përgjithësi për mbrojtjen e viktimave të korrupsionit.

1.1. Përcaktimi juridik i mbrojtjes së viktimave të korrupsionit

Luftimi i korrupsionit përmes masave të së drejtës civile është një karakteristikë ekskluzive e Këshillit të Evropës (Explanatory Report - EUS no. 174, 1999, Strasbourg, p. 2). Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës më 6 nëntor 1997 miratoi Rezolutën (97) 24 me titull *"20 Parimet Udhëzuese për luftën kundër Korrupsionit"*. Parimi 17 tregon në mënyrë specifike se shtetet anëtare duhet *"të sigurojnë që ligji civil të marrë parasysh nevojën për të luftuar korrupsionin dhe në veçanti të parashikoj mjete juridike efektive për ata, të drejtat dhe interesat e të cilëve preken nga korrupsioni"* (20 Guiding Principles for the fight against Corruption, 1997, p. par. 17).

Korrupsioni nuk është vetëm objekt i shqyrtimit nga legjislacioni penal por edhe nga legjislacioni civil. Nëse veprat e korrupsionit janë të inkriminuara përmes ligjit penal, atëherë kërkesat që pasojnë për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga korrupsioni janë objekt i shqyrtimit nga legjislacioni civil. Në fakt, viktimat e korrupsionit në disa raste mund ta kenë shumë më të lehtë të mbrojnë interesat e tyre përmes ligjit civil sesa përmes ligjit penal (Explanatory Report - EUS no. 174, 1999, Strasbourg).

Më 1 nëntor 2003 hyri në fuqi Konventa Civile kundër Korrupsionit për të manifestuar përpjekjen e parë që të përcaktohen rregullat e përbashkëta ndërkombëtare në fushën e së drejtës civile dhe korrupsionit (Details of Treaty no. 174, 2022).

Qëllimi i Konventës Civile kundër korrupsionit është që shtetet anëtare "*të parashikojnë në legjislacionin e tyre të brendshëm mjete juridike efektive për personat që kanë pësuar dëme si rezultat i akteve të korrupsionit, për t'u mundësuar atyre që të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre, duke përfshirë mundësinë e marrjes së kompensimit për dëmin e pësuar nga korrupsioni*" (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 1).

Theksi i Konventës Civile kundër Korrupsionit është në përgjegjësinë që ka çdo shtet anëtar për të parashikuar në legjislacionin e vet të brendshëm procedurat e duhura për të kërkuar dëmshpërblim nga shteti për personat që kanë pësuar dëme si rezultat i një veprë penale të korrupsionit nga zyrtarët publik në atë shtet gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 5).

Bazuar në nenin 4 paragrafin 1 të Konventës Civile kundër Korrupsionit, për të kompensuar viktimat e korrupsionit për dëmin që ata kanë pësuar duhet të plotësohen tri (3) kritere në mënyrë kumulative si në vijim (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 4 par. 1):

- a) I padituri (i pandehuri) ka kryer ose ka autorizuar kryerjen e veprës së korrupsionit ose nuk ka ndërmarrë veprimet e arsyeshme dhe të nevojshme për të parandaluar kryerjen e veprës së korrupsionit;**
- b) Paditësi (viktima) është dëmtuar nga vepra e korrupsionit; dhe**
- c) Lidhja kauzale në mes të veprës së korrupsionit të pandehurit dhe dëmit të paditësit.**

Në rastet kur vepra e korrupsionit është kryer nga disa persona, ata do të jenë përgjegjës për të kompensuar dëmin e shkaktuar në mënyrë solidarë (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 4 par. 2).

Natyrisht se Konventa Civile kundër Korrupsionit nuk i jep të drejtën për kompensim çdo personi që vetëm pretendon se ndonjë veprë penale e korrupsionit e ka dëmtuar atë në një mënyrë ose në një tjetër, të drejtat ose interesat e tij qoftë edhe për të ardhmen e tij.

Për fituar dëmshpërblimin, paditësi (viktima) duhet të provojë dëmin që ka pësuar nga i padituri, pastaj duhet të provojë fajësinë e të paditurit (të pandehurit) respektivisht nëse ka vepruar me dashje apo nga pakujdesia si dhe duhet të provojë lidhjen kauzale në mes të veprës së korrupsionit dhe dëmit që ai ka pësuar.

Me fjalë të tjera kërkesa për shpërblimin e dëmit të korrupsionit duhet që në mënyrë bindëse të argumentoj elementet si në vijim (Explanatory Report - EUS no. 174, 1999, Strasbourg, p. 6):

- a) Veprimin e paligjshëm (korrupsionin) të kryer me fajin e të pandehurit,**
- b) Dëmin e viktimës dhe**
- c) Lidhjen kauzale.**

Nëse plotësohen këto parakushte të kërkesës për dëmshpërblim, një kompensim i tillë mund të kërkohej dhe të realizohet për këto lloje të dëmit (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 3 par. 2):

- a) Dëmin material (*damnum emergens*);**
- b) Dëmin jo material (*dëmi moral*);**
- c) Fitimin e humbur (*lucrum cessans*).**

Vlen të përmendet se Konventa Civile kundër Korrupsionit përmes dispozitave të saj ka përcaktuar masa konkrete qoftë të aspektit juridiko material ashtu edhe të aspektit procedural, që shtetet anëtare duhet të ndërmarrin në nivelin e tyre kombëtar. Disa prej këtyre masave specifike janë:

- **Neglizhenca kontribuese** që nënkupton rregullimin ligjor të situatave kur paditësi me fajin e vet ka kontribuar në dëmin e pësuar. Prandaj dëmshpërblimi i tij do të zvogëlohet në përputhje me neglizhencën kontribuese të paditësit (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 6);
- **Afati i parashkrimit** për të kërkuar shpërblimin e dëmit nga korrupsioni që duhet të jetë jo më pak se tri (3) vite nga momenti kur viktima ka kuptuar apo është dashur në mënyrë të arsyeshme që të kuptonte për dëmin që ka pësuar (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 7);

- **Mbrojtja e sinjalizuesve** që nënkupton përcaktimin e masave ligjore përmes të cilave do të mbrohen punonjësit kundër të gjitha sanksioneve të pajustificueshme për shkak të sinjalizimit të tyre lidhur me dyshimet e arsyeshme për vepra penale të korrupsionit (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 9);
- **Auditimi dhe kontrollimi** i ndërmarrjeve që nënkupton kryerjen e së paku një auditimi dhe kontrolli të ndërmarrjeve ekonomike me qëllim që të sigurohet menaxhimi i drejtë dhe i ndershëm i financave të asaj kompanie (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 10);
- **Marrja e provave** në procedurën civile që zhvillohet për shkak të një veprë të korrupsionit parashihet me nenin 11 të konventës (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 11);
- **Masat e përkohshme** që nënkupton përcaktimin përmes ligjit të urdhrave gjyqësor të atillë që janë të nevojshëm për të ruajtur nga rreziku i humbjes së të drejtave dhe dëmtimit të pariparueshëm të interesave që kanë palët e caktuara në procedurë civile për aq sa mund të zgjatë procedura gjyqësore (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 12).

Konventa Civile kundër Korrupsionit ka qenë e hapur për nënshkrim nga data 4 nëntor 1999 për të hyrë në fuqi më 1 nëntor 2003. Janë tridhjetë e pesë (35) ratifikime dhe shtatë (7) shtete të tjera që e kanë nënshkruar por nuk e kanë ratifikuar ende konventën. Përndryshe të gjitha shtetet fqinje të Kosovës janë shtete ratifikuese të konventës (Details of Treaty no. 174, 2022).

Republika e Kosovës nuk është shtet anëtarë i konventës mirëpo as Kuvendi i Kosovës deri sot nuk ka miratuar ndonjë ligj i cili do të ishte në përputhje të plotë me të gjitha përcaktimet e Konventës Civile kundër Korrupsionit.

1.2. Raporti i Konventës Civile kundër Korrupsionit me instrumentet tjera ndërkombëtare

Neni 19 në Konventën Civile kundër Korrupsionit ka rregulluar raportet e kësaj konvente të Këshillit të Evropës me instrumentet apo marrëveshjet tjera ndërkombëtare që mund të rregullojnë të njëjtat çështje.

Duhet theksuar se Konventa Civile kundër Korrupsionit nuk afekton detyrimet që derivojnë nga instrumentet ndërkombëtare shumëpalëshe përderisa ato përcaktime specifike nuk janë në kundërshtim me përcaktimet e Konventës Civile kundër Korrupsionit (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 12). Kjo nënkupton që shtetet anëtare të konventës nuk mund të jenë subjekt edhe i marrëveshjeve apo instrumenteve tjera që kanë kolizion me konventën.

Megjithatë, shtetet palë mund të jenë subjekt i këtyre instrumenteve ndërkombëtare por vetëm nëse dispozitat e këtyre instrumenteve janë në shërbim të zbatimit më efikas të dispozitave të Konventës Civile kundër Korrupsionit (Explanatory Report - EUS no. 174, 1999, Strasbourg, p. 13).

Referuar tabelës nr. 5 si vijim, ekzistojnë disa instrumente të rëndësishme ligjore ndërkombëtare që trajtojnë çështjet lidhur me mbrojtjen e viktimave të korrupsionit. Disa prej këtyre instrumenteve përcaktojnë dispozita të ngjashme me ato të Konventës Civile kundër Korrupsionit.

Megjithatë, të gjitha këto instrumente ndërkombëtare sipas tabelës në vijim kanë konfirmuar të drejtën e viktimave për mjete efektive juridike duke përfshirë edhe kompensimin për dëmet e shkaktuara nga veprat penale në përgjithësi, por pa specifikuar edhe dëmet që mund të rezultojnë prej korrupsionit në veçanti. Përfshihet këtu vetëm Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit e cila po ashtu e njeh luftën kundër korrupsionit edhe nga pikëpamja e të drejtës civile (UNCAC, 2004). Konkretisht Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit përmes nenit 35 ka përcaktuar se:

- *“çdo shtet palë do të sigurojë që subjektet ose personat që kanë pësuar dëme si rezultat i një vepre të korrupsionit, të kenë të drejtën që të iniciojnë procedurat ligjore kundër personave përgjegjës për të kompensuar dëmin që kanë pësuar nga korrupsioni”* (UNCAC, 2004).

Tab. 5. Instrumentet tjera ndërkombëtare që rregullojnë mbrojtjen civile nga korrupsioni

Titulli	Neni	Referenca	Depozitues	Në fuqi	Ratifikime
Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit	35 53 (b) 57 (3c)	Res. 58/4	OKB	14/12/2005	187

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut	8	Res. 217 A	OKB	10/12/1948	-
Deklarata mbi Parimet Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Keqpërdorimit të Pushtetit	par. 19	Res. 40/34	OKB	29/11/1985	-
Karta e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore	47	2012/C 326/02	BE	26/10/2012	-
Korniza e Këshillit për Vendimet lidhur me Statusin e Viktimave në Procedurën Penale	9 par. 1 & 2	2001/220/JHA	BE	22/03/2001	-
Direktiva e Këshillit lidhur me Kompensimin e Viktimave të Krimit	1, 2, 3, et. al.	2004/80/EC	BE	29/04/2004	-
Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje	30	CETS No. 210	KE	01/08/2014	34
Konventa Evropiane për Kompensimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme	1, 2, 3, et. al.	ETS No. 116	KE	24/11/1983	26
Rezoluta mbi Njëzet Parimet Udhëheqëse në Luftën kundër Korrupsionit	par. 17	Res. (97) 24	KE	06/11/1997	-
Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut	13	ETS No. 005	KE	03/09/1953	47

Burimi: instrumentet juridike të përmendura në tabelë.

Konventa Civile kundër Korrupsionit është në përputhje me të gjitha instrumentet tjera ndërkombëtare të evidentuara në tabelën më sipër dhe veçanërisht me Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit.

E drejta për mjete efektive juridike si e drejtë themelore e njeriut është përcaktuar që nga viti 1948 përmes nenit 8 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut ku thuhet se:

- *“çdokush ka të drejtën e një mjete juridik efektiv nga gjykatat kombëtare kompetente për aktet që cenojnë të drejtat themelore të garantuara me kushtetutë ose me ligj” (UDHR, 1948, p. art. 8).*

E drejta për mjete juridike efektive është konfirmuar si e drejtë themelore e njeriut edhe në vitin 1950 përmes nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ku përcaktohet se:

- *“kujtdo që i shkelen të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duhet të ketë të drejtën për një mjet juridik efektiv përpara një autoriteti kombëtar, pavarësisht nëse shkelja është kryer ose jo nga persona që veprojnë në cilësinë zyrtare” (ECHR, 1950, Rome).*

Megjithatë, korrupsioni sot është një shqetësim mjaft specifik dhe kompleks me përmasa globale. Prandaj edhe trajtimi i viktimave të korrupsionit është po aq specifik dhe kompleks në kuptim të sfidave që duhen kapërcyer fillimisht për identifikimin e këtyre viktimave si të tillë pastaj edhe kriterëve që duhet konfirmuar për të mundësuar shpërblimin e dëmit të korrupsionit. Për të luftuar me sukses korrupsionin është e domosdoshme që të garantohet edhe mbrojtja e viktimave të korrupsionit përmes procedurës civile kontestimore. Në kontekst të së drejtës ndërkombëtare, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit si dhe Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut manifestojnë një inkurajim për mobilitet të shtuar ndërkombëtar lidhur me këtë çështje. Megjithatë, Konventa Civile kundër Korrupsionit mbetet instrumenti kryesor juridik ndërkombëtar që fokusohet veçanërisht në garantimin e mjeteve juridike efektive përmes të cilave në procedurë civile do të sigurohet kompensimi i viktimave për dëmin që kanë pësuar nga veprat penale të korrupsionit.

2. Mbrojtja e viktimave të korrupsionit në Republikën e Kosovës

Korrupsioni në Republikën e Kosovës inkriminohet përmes Kodit Penal nr. 06/L-074 të Republikës së Kosovës (neni 414, 415, et. al). Ndërsa të gjitha dispozitat e natyrës formale penale në Kosovë janë të kodifikuara përmes Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale të Republikës Kosovës.

Neni 62 paragrafi 4 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës ka përcaktuar se:

- *“i dëmtuari ka të drejtë në kompensimin e arsyeshëm të urdhëruar nga gjykata prej të pandehurit që ka pranuar ose është shpallur fajtor për dëmin material, fizik dhe emocional të shkaktuar nga kryerja e veprës penale për të cilën i pandehuri është shpallur fajtorë”* (KPPRK, 2013, p. neni 62 par. 4).

E drejta e të dëmtuarit për kompensimin e dëmit të veprës penale mund të kërkohet përmes kërkesës pasurore juridike deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor pranë gjykatës në shkallë të parë (KPPRK, 2013, p. neni 460 par. 2).

Kërkesa pasurore juridike në Republikën e Kosovës sipas Kodit të Procedurës Penale në fuqi mund të përfshijë kompensimin e dëmit, kthimin e sendit ose anulimin e një veprimi të caktuar juridik (KPPRK, 2013, p. neni 458 par. 1).

Kërkesa e tillë pasurore juridike do të zgjidhet në kuadër të procedurës penale e cila njihet më pas si procedurë e *adhezionit* (procedurë e bashkangjitur) pa pasur nevojë që të iniciohet një procedurë tjetër civile, me kusht që zgjidhja e kërkesës pasurore juridike nuk do të zvarritë tej mase procedurën penale. Në të kundërtën, pala do të udhëzohet për fillimin e kontestit civil (KPPRK, 2013, p. neni 458 par. 2).

Kompensimi për viktimat e korrupsionit nuk është i rregulluar në mënyrë eksplicite nga Kodi i Procedurës Penale. Kjo për arsye se Kodi i Procedurës Penale përmes dispozitave të cituara më sipër, ka rregulluar këtë çështje vetëm në mënyrë të përgjithshme pa veçuar viktimat e dëmtuara nga veprat penale të korrupsionit.

Duhet cekur se në Republikën e Kosovës është në fuqi edhe Ligji nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit i cili ka për qëllim që të rregulloj procedurën dhe kushtet për të realizuar kompensimin e viktimave të veprave penale në përgjithësi (LKVK, 2015, p. neni 2). Mirëpo duhet theksuar se as ky ligj nuk e rregullon në mënyrë specifike procedurën apo kushtet që duhet të plotësohen lidhur me kompensimin e viktimave të korrupsionit (LKVK, 2015, p. neni 2).

Në fakt, ky ligj as që e përmend termin korrupsion në asnjërën prej dispozitave në fuqi (LKVK, 2015, p. neni 2).

Si konstatim mund të thuhet se dispozitat në fuqi të Kodit të Procedurës Penale dhe të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit nuk e ndalojnë kompensimin e viktimave të korrupsionit. Megjithatë këto dispozita në asnjë mënyrë nuk e inkurajojnë këtë të drejtë të viktimave sikurse e bën Konventa Civile kundër Korrupsionit.

Kompensimi për viktimat e korrupsionit është një çështje shumë specifike dhe kërkon një trajtim ligjor specifik. Pikërisht për këtë arsye, Këshilli i Evropës kishte miratuar Konventën Civile kundër Korrupsionit me ç ‘rast ka garantuar një trajtim të posaçëm për të gjithë personat që dëmtohen nga veprat penale të korrupsionit dhe njëkohësisht e ka veçuar këtë kategori të viktimave nga viktimat tjera të krimit në përgjithësi.

Në këtë kontekst, dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës dhe ato të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, nuk konsistojnë që të jenë në harmoni me frymën e Konventës Civile kundër Korrupsionit apo dispozitave përkatëse të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit.

Kompensimi i dëmit si institut juridik mbetet lëndë e trajtimit të së drejtës civile konkretisht e së drejtë detyrimore. Kjo ndodh edhe në rastet kur kompensimi mund të manifestohet përmes urdhrave të gjykatës në kuadër të procedurës penale të *adhezionit* për shkak të kërkesës pasurore juridike nga palët e dëmtuara në atë procedurë (LMD, 2012, p. neni 359). Në këtë mënyrë edhe normat materiale për shpërblimin dëmit të viktimave të korrupsionit janë të natyrës civile detyrimore përderisa normat formale vazhdojnë që të jenë natyrës juridike kontestimore (LMD, 2012, p. neni 359).

Sidoqoftë, Ligji nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve në Republikën e Kosovës e ka rregulluar vetëm pjesërisht çështjen e kompensimit të viktimave të korrupsionit. Në fakt, kjo çështje trajtohet nga një dispozitë e vetme në nenin 359 ku thuhet se:

- *“në rast se dëmi është shkaktuar nga akti në të cilin ofrimi, dhënia, pranimi ose kërkesa e ryshfetit ose ndonjë përfitimi tjetër ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, ose nga mosveprimi apo veprimi që do të kishte parandaluar aktin e korrupsionit, ose nga ndonjë akt tjetër që sipas ligjit ose traktatit ndërkombëtar paraqet korrupsion, kërkesa parashkruhet pesë (5) vite pasi pala e dëmtuar të ketë mësuar për dëmin dhe personin që e ka shkaktuar atë, në cilindo rast ajo parashkruhet pesëmbëdhjetë (15) vite pas kryerjes së aktit” (LMD, 2012, p. neni 359).*

Përkundër faktit se kjo dispozitë e sapo cituar titullohet “Kompensimi i kërkesave për arsye të korrupsionit”, në fakt ajo rregullon vetëm afatin e parashkrimit të kërkesës për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga korrupsioni (LMD, 2012, p. neni 359). Me këtë rast afati subjektiv i parashkrimit është përcaktuar pesë (5) vite ndërsa afati objektiv i parashkrimit është përcaktuar pesëmbëdhjetë (15) vite (LMD, 2012, p. neni 359).

Duhet cekur se si e tillë dispozita e LMD e cituar më sipër është në përputhje me nenin 7 të Konventës Civile kundër Korrupsionit ku kërkohet që afati i parashkrimit të jetë së paku tri (3) vite (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 7).

Sidoqoftë, rregullimi i parashkrimit të së drejtës për të kërkuar kompensimin për dëmin e veprave penale të korrupsionit nuk është i mjaftueshëm për të siguruar mbrojtjen e viktimave të korrupsionit. Në këtë kontekst, nëse krahasojmë dispozitën përkatëse të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve me dispozitat e Konventës Civile kundër Korrupsionit, mund të thuhet se në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve ekziston një trajtim shumë i mangët lidhur me çështjen e kompensimit të viktimave të korrupsionit. Kjo për arsye se ky ligj përkundër faktit që ka përcaktuar afatin e parashkrimit për kompensim të dëmit të korrupsionit, nuk ka arritur që të rregullojë edhe një mori të çështjeve tjera të rëndësishme sikurse që janë të përcaktuara me Konventën Civile kundër Korrupsionit.

Disa prej instituteve juridike dhe masave tjera që përcaktohen nga Konventa Civile kundër Korrupsionit por që nuk reflektohen mjaftueshëm nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Republikës së Kosovës janë:

- **E drejta për kompensim** që nënkupton përcaktimin e kategorive të personave që kanë të drejtë për të kërkuar kompensim për shkak të dëmit nga veprat penale të korrupsionit (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 3 par. 1);
- **Format e kompensimit** që nënkupton kompensimin e dëmit material, jo material si dhe fitimin e humbur për shkak të korrupsionit (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 3 par. 2);
- **Kushtet e kompensimit** që nënkupton përcaktimin e kushteve që duhet të provohen përmes kërkesës së paditësit për kompensimin e dëmit të korrupsionit (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 4).

Këto kushte duhet të konfirmojnë se i padituri ka kryer veprën penale të korrupsionit ashtu që paditësi ka pësuar një dëm të caktuar për shkak të lidhjes kauzale që ka vepra përkatëse e korrupsionit dhe dëmi i pësuar (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 4).

Nëse dëmi është shkaktuar për shkak të korrupsionit të kryer nga disa persona, ata duhet të përgjigjen për dëmin në mënyrë solidare (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 4);

- **Përgjegjësia e shtetit** që nënkupton përcaktimin e përgjegjësisë që kanë institucionet kompetente për të kompensuar dëmin që kanë shkaktuar zyrtarët publik për shkak të përfshirjes së tyre në vepra penale të korrupsionit (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 5);
- **Neglizhenca kontribuese** që nënkupton situatat kur paditësi me fajin e vet ka kontribuar në dëmin e pësuar ashtu që dëmshpërblimi i tij do të zvogëlohet në proporcion me neglizhencën kontribuese të paditësit (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 6);
- **Mbrojtja e sinjalizuesve** që nënkupton mbrojtjen e punonjësve kundër të gjitha sanksioneve të pajustificueshme për shkak të sinjalizimit të tyre lidhur me dyshimet e arsyeshme për vepra penale të korrupsionit (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 9);
- **Auditimi dhe kontrollimi** i ndërmarrjeve që nënkupton kryerjen e së paku një auditimi dhe kontrolli të ndërmarrjeve ekonomike me qëllim që të sigurohet menaxhimi i drejtë dhe i ndershëm i financave të asaj kompanie (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 10);

- **Masat e përkohshme** që nënkupton përcaktimin e urdhrave gjyqësor të nevojshëm për të ruajtur të drejtat dhe interesat e palëve nga rreziku i humbjes apo dëmtimit të tyre të pariparueshëm (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 12);
- **Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar** që nënkupton përcaktimin e formave të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile lidhur me kompensimin e viktimave për shkak të dëmit nga veprat penale të korrupsionit (Civil Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 13).

Nga sa u tha më sipër, korniza ligjore në fuqi në Republikën e Kosovës nuk rezulton që të jetë plotësisht kompatible me përcaktimet e Konventës Civile kundër Korrupsionit në kuptim të sigurimit të mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e viktimave të korrupsionit duke përfshirë edhe të drejtën e tyre për kompensimin e dëmit të pësuar nga korrupsioni.

Neni 359 në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve është padyshim i mangët për të përmbushur standardet e Këshillit të Evropës të mishëruara në Konventën Civile kundër Korrupsionit. Në fakt rezulton që të jetë mjaft i vështirë zbatimi i këtij neni si të vetëm pa rregulluar aspektet tjera të cekura më sipër. Në anën tjetër, as Kodi i Procedurës Penale dhe Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit nuk kanë arritur të plotësojnë këtë vakum ligjor pasi që përmes tyre vetëm rregullohet kompensimi i viktimave të krimit në përgjithësi por nuk merren parasysh edhe specifikat e viktimave të korrupsionit sikurse që janë nxjerrë në pah nga Këshilli i Evropës përmes Konventës Civile kundër Korrupsionit.

2.1. Mbrojtja e viktimave të korrupsionit në Kosovë gjatë pandemisë Covid-19

Situata me pandeminë Covid-19 ka manifestuar ndryshime radikale në jetën tonë. Kjo pandemi nuk ka të bëjë vetëm sistemin tonë shëndetësor. Bëhet fjalë gjithashtu për ekonominë dhe mirëqenien tonë, sistemin tonë të drejtësisë, sistemin arsimor dhe në përgjithësi stilin tonë të jetesës që është afektuar për shkak të pandemisë Covid-19.

Padyshim që Covid-19 do të përfundojë një ditë me shpresën që do të ketë sa më pak viktima për shkak të tij. Mirëpo kur flitet për viktimat, dilema që shtrohet është e lidhur me dallimet në mes të

viktimave që kanë humbur jetën për shkak të Covid-19 pavarësisht trajtimit të tyre mjekësor dhe viktimave të tjera që kanë vdekur pasi që nuk kanë arritur fare të marrin trajtim mjekësor për faj të një afere të korrupsionit në sistemin shëndetësor gjatë pandemisë. Në fund të ditës, që të dy viktimat kanë humbur jetën. Të dy këto viktima duhet të njihen. Të dy këto viktima duhet të mbrohen.

Padyshim që korrupsioni inkurajon pabarazinë sociale dhe ky fakt përbën shqetësim të shtuar sidomos gjatë pandemisë Covid-19. Në anën tjetër nuk ekziston një njësi matëse për korrupsionin, por vetëm perceptim dhe askush nuk mund të evidentoj saktë as numrin e errët të korrupsionit sot. Pavarësisht kësaj, ky kapitull synon të ndërgjegjësojë se askush nuk duhet të përfitojë përmes korrupsionit sepse kostot për viktimat janë thjesht të padrejta dhe jonjerëzore, veçanërisht gjatë pandemisë Covid-19.

Duhet theksuar se sistemi i prokurimit në Republikën e Kosovës gëzon vëmendje të shtuar kur bëhet fjalë për mundësinë e aferave të korrupsionit. Kjo vëmendje vetëm sa është shtuar për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19. Mirëpo edhe para Covid-19, procedurat e prokurimit në Kosovë kanë qenë në llupë për afera eventuale korruptive. Në këtë drejtim, Këshilli i Evropës kishte prioritzuar pesë (5) rekomandime për Republikën e Kosovës me qëllim të luftimit të korrupsionit në sektorin e prokurimit publik (Fazekas, 2017, p. 5). Këto rekomandime janë:

1. Rritja e konkurrencës së drejtë në tenderët e prokurimit publik duke rritur mundësinë e qasjes për më shumë operatorë ekonomik duke zvogëluar mundësinë e ndikimit politik dhe pseudo suksesit në procedurat e prokurimit publik;
2. Investimi në profesionalizimin dhe motivimin e zyrtarëve të prokurimit publik duke siguruar njëkohësisht edhe pavarësinë e tyre nga ndikimet politike;
3. Fuqizimi i monitorimit të procesit të tenderimit nga agjencitë qeveritare dhe shoqëria civile duke mundësuar edhe intervenime efektive nëse paraqiten flamuj të kuq gjatë procesit;
4. Rritja e konsistencës së sistemit të mjeteve juridike në prokurimin publik duke rritur profesionalizmin dhe duke zvogëluar ndikimet politike në trupat e rishikimit të prokurimit;
5. Zgjerimi i përdoruesve të prokurimit publik qendror për standardizimin e mallrave dhe mbështetjen e kornizës së marrëveshjeve të niveleve përkatëse sektoriale sipas nevojës.

Nga data 24 mars 2020 kur janë konfirmuar rastet e para të Covid-19 në Kosovë, procedurat e prokurimit të Ministrisë së Shëndetësisë janë zhvilluar kryesisht përmes procedurave të përshpejtuara të negocimit. Kjo do të thotë se nuk janë publikuar thirrjet për oferta përderisa operatorët ekonomik që janë përzgjedhur nuk kanë pasur konkurrencë reale. Prandaj jo rrallëherë edhe mediat në Kosovë kanë raportuar dyshimet për afera të korrupsionit gjatë pandemisë Covid-19 sidomos në Ministrinë e Shëndetësisë së Kosovës (Insajderi, 2020). Rekomandimet më sipër nga Këshilli i Evropës duhet të jenë prioritet për shtetin e Kosovës veçanërisht gjatë pandemisë Covid-19. Kjo sepse një gjë e përbashkët që ekziston në mes korrupsionit dhe Covid-19 është se të dyja këto fenomene “nuk diskriminojnë”. Korrupsioni sikurse Covid-19 nuk përzgjedhin viktimë por edhe nuk falin asnjë viktimë (Ministry of Health of the Republic of Kosovo, 2020).

3. Kompensimi i viktimave të korrupsionit

Korrupsioni është një formë e abuzimit të pushtetit publik për përfitime private (Transparency International, What is corruption?, n.d.). Duke iu referuar Transparency International, kostot e korrupsionit mund të ndahen në katër kategori kryesore: politike, ekonomike, sociale dhe mjedisore.

Në frontin politik, korrupsioni është një pengesë kryesore për demokracinë dhe sundimin e ligjit. Ekonomikisht, korrupsioni shteron pasuritë publike të shtetit dhe shoqërisë. Ai cenon po ashtu aspektin social pasi që e zvogëlon besimin e shoqërisë në sistemin shtetëror. Në fund por jo më pak e rëndësishme, degradimi i mjedisit është një tjetër pasojë e korrupsionit pasi që kompanitë në mbarë globin vazhdojnë të paguajnë ryshfet në dëm të ambientit për shkak të interesave të tyre ekonomike (Transparency International, What is corruption?, n.d.).

Të identifikohen pasojat e korrupsionit apo dhe të klasifikohen ato në kategori të caktuara është mjaft e rëndësishme. Megjithatë sfida kryesore mbetet për viktimat që vuajnë nga këto pasoja. Fatkeqësisht, këto viktimë më së shpeshti i gjejmë te shtresat e varfra të shoqërisë, të cilët zakonisht janë të harruar nga “dora e qeverisë” dhe të injoruar nga “çekani i drejtësisë”.

"Korrupsioni nuk është një krim pa viktimë" - ky slogan përdoret mjaft shpesh nga Organizatat Ndërkombëtare dhe Organizatat Joqeveritare të cilat janë të fokusuara në luftën kundër korrupsionit (Hawley, 2016).

Në anën tjetër korrupsioni ka një histori të gjatë 'sa vet njerëzimi' prandaj është utopike të mendohet zhdukja e plotë e korrupsionit. Përkundrazi lufta e suksesshme kundër korrupsionit është një proces i komplikuar hap pas hapi, veçanërisht për vendet në zhvillim e sipër siç është Kosova dhe shtetet tjera në Ballkanin Perëndimor (Hawley, 2016).

Sigurimi i mjeteve juridike efektive duke përfshirë edhe të drejtën për kompensimin e viktimave të korrupsionit manifeston avantazhe të shumta në luftën kundër korrupsionit (State Parties to the UNCAC, 2017, p. 6). Disa prej këtyre avantazheve mund të jenë:

1. Ulja e numrit të errët të korrupsionit për shkak të rritjes së gatishmërisë së viktimave për të raportuar korrupsionin;
2. Vendosja e sanksioneve pasurore në përpjesëtim të saktë me dëmet e korrupsionit;
3. Shmangia e mundësisë së përdorimit të përfitimeve të korrupsionit nga kryesit; si dhe
4. Rritja e përgjegjësisë së shtetit për çështjet e korrupsionit.

Ende nuk ekziston një përkufizim i pranuar globalisht as për korrupsionin dhe as për viktimat e korrupsionit. Kjo për arsye se të dy përkufizimet referojnë në dukuri mjaft komplekse dhe dinamike si në kuptim të kohës dhe territorit ashtu edhe në kuptim të përcaktimit juridik. Rrjedhimisht për kompensimin e viktimave të korrupsionit përmes mjeteve efektive juridike kërkohet përcaktimi i qasjes së duhur ligjore në përputhje me dimensionet e ndryshme të këtij procesi (State Parties to the UNCAC, 2017, p. 6).

Disa nga sfidat kryesore që paraqiten për kompensimin e viktimave të korrupsionit përmes mjeteve efektive juridike është përcaktimi i kriterëve për identifikimin e viktimave të korrupsionit, pastaj përcaktimi i kushteve që duhet të konfirmohen për shpërblimin e dëmit, si dhe përcaktimi i parametrave për vlerësimin e dëmit të pësuar (State Parties to the UNCAC, 2017, p. 6).

Shtetet anëtare të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit kanë arritur që të zhvillojnë disa praktika të mira në identifikimin e viktimave të korrupsionit si dhe përcaktimin e parametrave për vlerësimin e dëmit me rastin e kompensimit (State Parties to the UNCAC, 2017, p. 6). Bazuar në këto praktika janë kategorizuar viktimat e korrupsionit si në vijim (State Parties to the UNCAC, 2017, p. 6):

1. Kompanitë si viktimat e korrupsionit;
2. Aksionarët dhe bashkëpronarët si viktimat e korrupsionit;
3. Ofertuesit e pasuksesshëm në procedura të prokurimit si viktimat e korrupsionit;
4. Shtetet tjera si viktimat e korrupsionit;
5. Shoqëria si viktimë e korrupsionit.

Korrupsioni mund të afektoj në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë viktimat e saj, të cilat në raste të caktuara mund të jenë edhe një shoqëri e tërë. Disa kategori të personave mund të mos konsiderohen viktimat e korrupsionit në shikim të parë dhe kjo pozitë e tyre juridike mund të mohohet kur nuk konfirmohet interesi i tyre juridik respektivisht dëmi i drejtpërdrejtë dhe konkret. Në këtë kontekst duhet theksuar koncepti i “dëmit social nga korrupsioni” (State Parties to the UNCAC, 2017, p. 5).

Koncepti i “dëmit social nga korrupsioni” është përcaktuar si institut juridik në shumë juridiksione dhe përmes tij mundësohet kompensimi i dëmeve të korrupsionit në interes të përgjithshëm të publikut (State Parties to the UNCAC, 2017, p. 5).

Dëmi social nga korrupsioni mund të përfshijë dëmtimin e mjedisit, dëmtimin e besueshmërisë në institucione ose dëmtimi i të drejtave tjera kolektive siç janë shëndeti, siguria, paqja, arsimi ose qeverisja e mirë (State Parties to the UNCAC, 2017, p. 5).

Çdo viktimë e korrupsionit është e rëndësishme dhe ka një histori të veçantë për të treguar. Mund të jetë një person fizik apo person juridik, një kompani, një shtet i caktuar apo edhe një shoqëri e tërë. E rëndësishme është njohja e të gjithëve si viktimat e korrupsionit nëse ata kanë pësuar dëme nga një vepër penale e korrupsionit dhe nëse vërtetohet lidhja kauzale në mes të korrupsionit dhe dëmit të pësuar.

Qëllimi kryesor me rastin e kompensimit të viktimave të korrupsionit duhet të konsistojë në rivendosjen e viktimës në pozitën më të afërt të mundshme me pozitën që do të kishte nëse nuk do të shkaktohej dëmi nga vepra penale e korrupsionit (State Parties to the UNCAC, 2017, p. 10). Me këtë rast, identifikimi i viktimave të korrupsionit, parametrat e vlerësimit të dëmit dhe kriteret e kompensimit janë procese mjaft sfiduese.

Për të tejkaluar këto sfida me sukses, duhet që paraprakisht të evidentohen shkaqet dhe format e manifestimit të korrupsionit në vendin dhe kohën e caktuar. Tutje duhet të konsolidohen rrugët ligjore të cilat garantojnë mjetet efektive juridike për mbrojtjen e viktimave të korrupsionit. Konventa Civile kundër Korrupsionit është udhërrëfyese më adekuat për arritjen e këtyre qëllimeve përderisa praktikrat e mira të shteteve anëtare në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit mund të shërbejnë si përgjigje ndaj sfidave të ndryshme që mund të shfaqen në këtë proces.

KAPITULLI VIII - KONFISKIMI I PASURISË SË PAJUSTIFIKUESHME

1. Kuptimi i pasurisë së pajustificueshme

Fillimisht duhet cekur se çështja e pasurisë së pajustificueshme mund të adresohet përmes termave në ndryshëm në vende të ndryshme siç janë termet “pasuri e pashpjegueshme” apo “pasuri kriminale”, pastaj “pasuri e paligjshme”, “pasuri e paarsyeshme”, “pasurim pa bazë”, etj.

Për nevojat e këtij punimi përtej terminologjisë së përdorur, pasuria e pajustificueshme duhet të kuptohet si çdo formë e pasurisë që mund të fitohet përmes kryerjes së veprave penale të korrupsionit apo aktiviteteve tjera të kundërligjshme (Vettori, 2006).

Nëse i referohemi maksimave latine “*nemo locupletari potest aliena iactura*” dhe “*nemo locupletari debet cum aliena iactura*”, mund të konstatojmë se që nga koha e Romës antike ka

mbizotëruar mendimi se *"askush nuk duhet të përfitoj në kurriz të tjetrit"* (Horwitz, 2011, p. 194).

Në kontekst të së drejtës penale ndërkombëtare, çështja e pasurisë së paligjshme është trajtuar qysh në vitin 1990 nga Këshilli i Evropës përmes Konventës për Pastrimin e Parave, Zbulimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin (CLSSCPC, 1990). Rrjedhimisht neni 1 paragrafi a) i kësaj konvente ka definuar nocionin e produkteve të krimin si *"çdo avantazh ekonomik që krijohet përmes veprave penale"* (CLSSCPC, 1990, p. neni 1 par. a). Natyrisht se konventa përmes paragrafit c) të nenit 1 ka dalluar produktet e krimin nga instrumentet e krimin duke definuar këto të fundit si *"çdo send që përdoret ose ka për qëllim që të përdoret, në çdo formë, plotësisht apo pjesërisht, për të kryer një ose më shumë vepra penale"* (CLSSCPC, 1990, p. neni 1 par. a). Ka mjaft rëndësi që të kuptohet dallimi juridik ndërmjet produkteve të krimin dhe instrumenteve të krimin pasi që të dy këto pasuri duhet të konfiskohen si të kundërligjshme. Mirëpo objekt i trajtimit në këtë kapitull janë vetëm produktet e krimin respektivisht pasuria që fitohet nga korrupsioni por jo edhe mjetet që përdoren për të kryer korrupsionin pasi që kjo përbën një tematikë tjetër të mëvetësishme nga ky punim.

Vlen të theksohet se Këshilli i Evropës në vitin 2005 ka miratuar edhe Konventën e Këshillit të Evropës për Pastrimin e Parave, Zbulimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin dhe Financimin e Terrorizmit (CLSSCPCFT, 2005). Kjo konventë në fakt është derivat i plotësuar i konventës së vitit 1990 për Pastrimin e Parave, Zbulimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin. Prandaj të gjithë anëtarët e njërës konventë konsiderohen edhe si anëtarë edhe të konventës tjetër (CLSSCPCFT, 2005, p. neni 49 par. 6). Dallimet kryesore në mes të konventës së vitit 1990 dhe asaj të vitit 2005 janë se kjo e fundit fokusohet përtej tjerave edhe në luftimin e financimit të terrorizmit. Në fakt, ekziston edhe një dallim në mënyrën se si definojnë produktet e përfituara nga veprat penale. Për dallim nga konventa e vitit 1990, konventa e vitit 2005 përmes nenit 1 paragrafit a) përcakton definicionin e produkteve të krimin si *"çdo avantazh ekonomik, që derivohet apo përfitohet, në mënyrë direkte apo indirekte, përmes veprave penale"* (CLSSCPCFT, 2005, p. neni 1 par. a). Në fakt dallimet në mes të këtyre dy konventave lidhur me definicionet e produkteve të krimin konsistojnë vetëm

në qëllimin e konventës së vitit 2005 për zgjerimin e diapazonit të inkriminimit por jo edhe të ndryshimit të kontekstit të përkufizimit që ekziston në konventën e vitit 1990 (Explanatory Report - EUS no. 198, 2005, p. 7).

Tutje, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit në vitin 2004 ka trajtuar po ashtu çështjen e pasurisë së paligjshme ashtu që përmes nenit 20 ka përcaktuar se pasurimi i paligjshëm duhet të kuptohet si "*një rritje e madhe në pasuritë e një zyrtari publik që ai ose ajo nuk mund ta justifikojë në raport me të ardhurat e tij ose të saj të ligjshme*" (UNCAC, 2004, p. neni 20). Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit ka përcaktuar gjithashtu nevojën për rregullimin juridik të këtij fenomeni nga të gjitha shtetet anëtare të konventës përmes ligjeve të tyre të brendshme (UNCAC, 2004, p. neni 20). Rrjedhimisht mund të thuhet se edhe Organizata e Kombeve të Bashkuara përmes Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit ka arritur të konfirmoj se rregullimi i duhur ligjor i konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme përbën një mekanizëm shumë të rëndësishëm për luftimin me sukses jo vetëm kundër korrupsionit por edhe kundër veprave tjera penale (UNCAC, 2004, p. neni 20).

Një përcaktim i ngjashëm sikurse në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit lidhur me kuptimin e pasurisë së paligjshme ekziston edhe në Konventën Ndër-Amerikane kundër Korrupsionit. Përmes nenit 9 të Konventës Ndër-Amerikane kundër Korrupsionit është përcaktuar që pasuria e pajustificueshme duhet të kuptohet si "*rritje e konsiderueshme e asetëve të zyrtarit publik që nuk mund të shpjegohet në asnjë mënyrë të arsyeshme pasi që kjo rritje është në shpërputhje me të ardhurat e tij të ligjshme nga ushtrimi i funksioneve të tij publike*" (Organization of American States, 1996, p. neni 9).

Përtej mënyrës së formulimit të definicioneve lidhur me pasurinë e pajustificueshme, mund të konstatohet se çdo lloj i përfitimit pasuror që mund të arrihet në çdo formë përmes korrupsionit, veprave penale apo aktiviteteve tjera të kundërligjshme, paraqet pasuri e kundërligjshme. Prandaj, një përcaktim i përbashkët për të gjitha konventat e cituara dhe elaboruara më sipër është domosdoshmëria për konfiskimin e çdo pasurie të kundërligjshme. Rrjedhimisht edhe Konventa për Pastrimin e Parave, Zbulimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin dhe Financimin e Terrorizmit përmes nenit 3 paragrafit 1 ka përcaktuar se

“Shtetet anëtare duhet të miratojnë masa legislative apo masa tjera të nevojshme për të mundësuar konfiskimin e produkteve dhe instrumenteve të krimit apo pasurinë tjetër që korrespondon me vlerën e pasurisë së kundërligjshme” (CLSSCPCFT, 2005, p. neni 3 par. 1).

2. Sistemet për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme

Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) ka klasifikuar sistemet për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme në tri (3) sisteme kryesore të konfiskimit të cilat janë (Vitaly Kasko, Dmytro Kotlyar, 2018, pp. 50, 51):

- **Sistemi i konfiskimit penal** (sistemi tradicional) i cili manifestohet në formë të procedurës penale mirëpo në kuadër të saj ekzistojnë kompetenca të zgjeruara të autoriteteve kompetente për konfiskimin e pasurisë së kundërligjshme;
- **Sistemi i konfiskimit civil** (sistemi modern) i cili manifestohet në formë të procedurës kontestimore përballë gjykatës kompetente për procedurë civile ndërmjet paditësi i cili është autoriteti kompetent për të përfaqësuar shtetin dhe të paditurit i cili është pronari respektivisht poseduesi i pasurisë që kontestohet;
- **Sistemi i konfiskimit administrativ** (sistemi modern) si cili manifestohet në formë të procedurës administrative përballë organit kompetent administrativ apo gjykatës administrative nëse procedura administrative kalon në fazën e konfliktit administrativ.

Sistemi tradicional i konfiskimit është i përvetësuar edhe në Republikën e Kosovës me ç ‘rast pasuria e kundërligjshme mund të konfiskohet në procedurë penale ku ekzistojnë kompetenca të zgjeruara të organeve kompetente. Fillimisht duhet të provohet se i pandehuri është fajtor për korrupsion apo vepër tjetër penale me aktgjykim të formës së prerë (LAPSK, 2016, p. neni 2). Në këtë rast, gjykata së bashku me aktgjykimin fajësues e shqipton edhe urdhrin për konfiskimin e pasurisë së fituar me korrupsion apo vepra tjera penale (KPPRK, 2013, p. neni 284 par. 1). Më tutje, prokurori i shtetit brenda afatit prej pesë (5) viteve pas aktgjykimit të formës së prerë, mund të kërkoj verifikimin e pasurisë së pandehurit të dënuar për vepra penale të korrupsionit apo vepra penale tjera siç përcaktohet me nenin 2 paragrafin 1 të Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë (LKZKP, 2018, p. neni 4 par. 1). Natyrisht se

barra e provës në këtë procedurë është te prokurori i shtetit i cili ka parashtuar kërkesën për verifikimin e pasurisë (LKZKP, 2018, p. neni 6 par. 1). Duhet theksuar se që nga viti 2018 kur ka hyrë në fuqi e ky ligj janë parashtuar shumë pak kërkesa për verifikimin e pasurisë nga prokuroria e shtetit lidhur me afera të mëdha të korrupsionit në Republikën e Kosovës.

Në shtetet si Kroacia, Polonia, Rumania, Lituania, Moldavia dhe Estonia, është përvetësuar po ashtu sistemi penal me kompetenca të zgjeruara për konfiskim. Mirëpo në këto sisteme është arritur që në procedurat e konfiskimit (*in rem*) të zhvendoset barra e provës nga prokuroria te mbrojtja, por vetëm nëse plotësohet disa kushte paraprakisht lidhur me procedurën penale (*in personam*) të cilat kanë të bëjnë natyrën e veprës penale, llojin e aktgjykimit të shqiptuar, si dhe kohëzgjatjen e procedurës penale (Vitaly Kasko, Dmytro Kotlyar, 2018, pp. 67-74).

Sistemet moderne të konfiskimit përfaqësohen nga sistemi civil dhe sistemi administrativ i konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme. Sistemi administrativ zbatohet nga Zvicra ku procedura për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme manifestohet përmes procedurës administrative (Lindy Muzila, Criminalizing Illicit Enrichment to Fight Corruption, 2012, p. 37). Përndryshe praktikat më të mira të luftës moderne kundër korrupsionit përmes konfiskimit të pasurisë së kundërligjshme, aktualisht i gjejmë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britani të Madhe, Kanada, Australi, Itali dhe Irlandë ku zbatohet procedura *in rem* në kuadër të sistemit civil të konfiskimit të pasurisë së fituar me korrupsion. Në këto procedura të konfiskimit, barra e provës i takon të dyshuarit për korrupsion i cili duhet të provoj se pasuria e tij ka prejardhje të ligjshme, në të kundërtën ajo pasuri do të konfiskohet (CoE Impact study on civil forfeiture, 2013, pp. 8, 9, 12). Këshilli i Evropës përmes një studimi në vitin 2013 ka konstatuar po ashtu se sistemi civil për konfiskimin e pasurisë së kundërligjshme është një nga mënyrat më efikase për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar (CoE Impact study on civil forfeiture, 2013, p. 19).

2.1. Barra e provës në procedurën për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme

Prezumimi i pafajësisë si parim në drejtësi ka një histori të gjatë juridike. Mendohet se mendimet e para lidhur me këtë temë kanë ekzistuar që nga periudha antike në Angli, Romë dhe Greqi (Dale, 2015). Nëse kërkohet origjina e prezumimit të pafajësisë, do të hasim në maksima të njohura në drejtësi siç janë "*më mirë është të lirohen mijëra njerëz që janë fajtorë sesa të lejohet një person i pafajshëm që të vdesë*" (Thayer, 1897, p. 187) ose "*ku ka tym ka edhe zjarr*" (Dale, 2015). Natyrisht se këto fraza nuk duhet që të kuptohen bukalisht. Mirëpo përmes tyre mund të konfirmohet se mendimet origjinere lidhur me prezumimin e pafajësisë janë mjaft të lashta.

E rëndësishme për të theksuar është gjithashtu se është i njohur rasti kur ky parim është zbatuar për herë të parë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Mbi 127 vite më parë respektivisht në vitin 1895 Gjykata e Lartë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka vendosur lidhur mjetet juridike në shkallë të dytë për çështjen "*Coffin et.al. kundër SHBA*" (Pennington, 2003, p. 108). Gjykata më e ulët që ka gjykuar në shkallë të parë në këtë çështje kishte refuzuar që të udhëzonte jurinë se "*personat e akuzuar për vepra penale duhet të prezumohen si të pafajshëm derisa të provohet fajësia e tyre sipas ligjit*" (Pennington, 2003, p. 108). Në vend të kësaj, gjykata e shkallës së parë kishte udhëzuar se "*fajësia e të pandehurit do të shpallet nga gjykata nëse ajo arrihet të provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm para gjykatës*" (Pennington, 2003, p. 108). Gjykata e Lartë me rastin e gjykimit sipas mjeteve juridike, kishte konstatuar se gjykata më e ulët nuk kishte arritur të bëjë dallimin ndërmjet gjykimit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe prezumimit të pafajësisë, pasi që në thelb këto dy institute nuk janë të njëjta (Coffin v. U.S., 1895). Në këtë mënyrë gjykata më e ulët ka shkelur të drejtat e të pandehurve sepse nuk ka arritur që të udhëzoj jurinë lidhur me mbrojtjen prezumimit të pafajësisë (Coffin v. U.S., 1895).

Prezumimi i pafajësisë si parim në të drejtën penale shprehet gjerësisht përmes maksimës së njohur "*i pafajshëm derisa të provohet fajësia*" (Pennington, 2003, p. 106). Kombet e Bashkuara kanë përcaktuar prezumimin e pafajësisë në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut në vitin 1948 përmes nenit 11 paragrafi 1 ku thuhet se "*çdokush i akuzuar për vepër penale ka të*

drejtën që të prezumohet si i pafajshëm deri sa të provohet fajësia e tij sipas ligjit në një proces gjyqësor publik ku ai gëzon të gjitha të drejtat e garantuara për mbrojtjen e tij” (UDHR, 1948).

Ngjashëm, maksima e prezumimit të pafajësisë është përcaktuar edhe përmes Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1966 ku përmes nenit 14 paragrafit 2 është përcaktuar se *“Çdokush i akuzuar për vepër penale duhet të ketë të drejtën që të prezumohet si i pafajshëm deri sa të provohet si i fajshëm sipas ligjit”* (ICCPR, 1966).

Natyrisht se prezumimi i pafajësisë ka gjetur një vend edhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në 1950, ku përmes nenit 6 paragrafi 2 është përcaktuar se *“Çdo person i akuzuar për vepër penale duhet të prezumohet i pafajshëm deri sa të provohet fajësia e tij sipas ligjit”* (ECHR, 1950).

Prezumimi i pafajësisë si parim në të drejtën penale është garantuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës përmes nenit 31 paragrafi 5 ku përcaktohet se *“Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin”* (KRK, 2008, p. neni 31 par. 5). Rrjedhimisht ky parim është mishëruar edhe në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës përmes nenit 3 paragrafi 1 ku përcaktohet se *“Çdo person i dyshuar ose që akuzohet për vepër penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës”* (KPPRK, 2012, p. neni 3 par. 1).

Vlen të theksohet se standardet ndërkombëtare të Këshillit të Evropës dhe të Kombeve të Bashkuara të manifestuara përmes konventave të cituara më sipër janë të zbatueshme drejtpërdrejt përmes nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ku përcaktohet se

- *“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike* (KRK, 2008, p. neni 22):

(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;

(2) *Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;*

(3) *Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj”.*

Për objektivat e këtij kapitulli duhet të potencohet roli dhe rëndësia e parimit të prezumimit të pafajësisë në procedurën penale në përgjithësi dhe në procedurën për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme në veçanti. Në këtë kontekst duhet theksuar dy efektet thelbësore të prezumimit të pafajësisë:

1. *Onus probandi* (barra e provës) dhe
2. *In dubio pro reo* (dyshimet interpretohen në dobi të pandehurit).

Efekti *Onus Probandi* nënkupton që barra e të provuarit të fajësisë së të pandehurit i takon prokurorit të shtetit respektivisht autoritetit që ka akuzuar të pandehurin për veprë penale.

Në anën tjetër, efekti *In Dubio Pro Reo* nënkupton se prokurori jo vetëm që duhet të provojë fajësinë e të pandehurit për veprën penale që e ka akuzuar, por të provuarit e fajësisë duhet të bëhet përtej çdo dyshimi të bazuar. Në të kundërtën nëse prokurori nuk arrin që të provoj se i pandehuri është fajtor përtej çdo dyshimi të bazuar, atëherë i pandehuri duhet të lirohet nga akuza dhe çdo dyshim tjetër lidhur me fajësinë e tij gjatë procedurës penale do të interpretohet në dobi të palës së pandehur. Për shembull nëse një person akuzohet për marrje të ryshfetit apo vepra tjera të korrupsionit, në përputhje me prezumimin e pafajësisë, prokurori i shtetit ka barrën që të provoj para gjykatës se i pandehuri është fajtor përtej çdo dyshimi të bazuar për shkak të marrjes së ryshfetit sipas aktakuzës. Në të kundërtën, gjykata nuk do të ketë mundësi që të shqiptoj dënimin penal për të pandehurin për korrupsion dhe as të urdhëroj konfiskimin e pasurisë që i pandehuri e ka përfituar përmes ryshfetit apo aferave tjera të korrupsionit.

Në disa vende të botës *onus probandi* si efekt i prezumimit të pafajësisë nuk ka karakter absolut sikurse në shtetet evropiane. Për shembull, në Australi ekzistojnë disa dispozita përjashtuese në Kodin Penal përmes të cilave është përcaktuar se *onus probandi* respektivisht barra e të provuarit nuk është mbi prokurorinë por mbi të pandehurin nëse akuzat janë për shkak të veprave penale të terrorizmit, të narkotikëve, abuzimeve seksuale të fëmijëve si dhe veprat

penale që lidhen me eksplozivët plastikë të pashënuar (Australian Law Reform Commission, 2015). Korrupsioni nuk bën pjesë në këtë kategori. Përndryshe këto dispozita të Kodit Penal në Australi janë të njohura si *“reverse onus provisions”* apo barra e kundërt e provës dhe si të tilla ato paraqesin kufizime të prezumimit të pafajësisë në procedurën penale (Attorney-General's Departament).

Në Evropë dhe në shumicën e vendeve të botës, prezumimi i pafajësisë ka karakter absolut dhe konsiderohet i shkelur në cilindo rast kur barra e provës zhvendoset nga prokuroria te pala e akuzuar (European Court of Human Rights, 2020, p. 69). Në vitin 2001 në çështjen *Telfner kundër Austrisë* (paragrafi 15 i aktgjykimit) Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka vendosur se *“neni 6 paragrafi 2 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kërkon, ndër të tjera, që gjatë zbatimit të detyrave të tyre, anëtarët e një gjykate nuk duhet të fillojnë procedurën gjyqësore me idenë e paragjyqese se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar”* (Telfner v. Austria, 2001, p. par. 15).

Ngjashëm, në vitin 1988 në çështjen *Barbera et.al. kundër Spanjës* (paragrafi 77 i aktgjykimit) Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka vendosur se *“barra e provës është mbi prokurorinë dhe nga çdo dyshim duhet të përfitojë i akuzuari”* (Barberà et. al. v. Spain, 1988). Nga ky këndvështrim, në çështjen *John Murray kundër Britanisë së Madhe* në vitin 1996, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (paragrafi 54 i aktgjykimit) ka arritur në përfundimin se *“zhvendosja e barrës së provës nga prokuroria te mbrojtja e cenon parimin e prezumimit të pafajësisë”* (John Murray v. UK, 1996).

Në kontekstin e këtij punimi, duhet theksuar se konfiskimi i të gjitha përfitimeve pasurore që rezultojnë prej korrupsionit është i domosdoshëm për të luftuar me sukses korrupsionin në Republikën e Kosovës. Për shkak të efekteve të prezumimit të pafajësisë, në procedurën penale barra e provës është mbi prokurorinë e shtetit. Rrjedhimisht nëse konfiskimi i të ardhurave nga korrupsioni duhet të realizohet vetëm përmes procedurës penale, atëherë prokurori do të ketë barrën e provës jo vetëm për të provuar fajësinë e të pandehurit për korrupsion por edhe për të provuar se pasuria e caktuar ka rezultuar nga korrupsioni dhe si e tillë duhet të konfiskohet. Natyrisht se për prokurorinë do të ishte shumë më e favorshme që vet të akuzuarit të

justifikojnë prejardhjen e pasurisë së tyre duke dëshmuar se pasuria e tyre ka prejardhje të ligjshme dhe nuk është përfituar përmes korrupsionit apo veprave tjera penale. Prandaj mund të shtrohet dilema nëse barra e provës sipas prezumimit të pafajësisë e afekton efikasitetin e luftimit të korrupsionit. Sigurisht që prezumimi i pafajësisë me të gjitha efektet e saj i shërben tendencës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në procedurën penale. Në anën tjetër, procedura penale nuk do të kishte kuptim edhe pa tendencën për efikasitet të procedurës penale. Në fund të ditës, mbrojtja e të drejtave të njeriut duhet të jetë po aq e rëndësishme sa edhe efikasiteti në luftimin e korrupsionit. Përndryshe, rrezikojmë të përfundojmë duke mohuar drejtësinë për viktimat e korrupsionit dhe duke u përpjekur që të mbrojmë të drejtat e kryesve të korrupsionit në procedurën penale. Për këto arsye tendenca për të drejtat e njeriut dhe tendenca për efikasitet në procedurën penale duhet të jenë në ekuilibër me njëra tjetrën. Ndërsa për të arritur këtë ekuilibër në rastet e korrupsionit, përveç gjyqimit dhe dënimit të kryesve të veprave penale të korrupsionit në procedurë penale duhet të rritet edhe efikasiteti për konfiskimin e pasurisë të fituar përmes këtyre veprave të korrupsionit.

Zhvendosja e barrë së provës nga prokurori te pala e akuzuar në procedurë penale qoftë edhe vetëm për aspektin e konfiskimit të pasurisë së fituar me korrupsion, do të përbënte shkelje të prezumimit të pafajësisë bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Mirëpo nëse konfiskimi i pasurisë së fituar me korrupsion do të realizohej në procedurë civile, barra e provës do të ketë efekte plotësisht të ndryshme për dallim nga procedura penale. Rrjedhimisht nëse barra për të provuar prejardhjen e pasurisë së paligjshme në procedurë civile do të zhvendoset te pala e paditur (i akuzuari), kjo nuk do të përbëj shkelje të prezumimit të pafajësisë sepse nuk bëhet fjalë për procedurë penale.

Koncepti për zhvendosjen e këtillë të barrës së provës (*reverse onus probandi*) për konfiskimin e të ardhurave nga korrupsioni rekomandohet fuqishëm nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik. Në vitin 2018 ajo ka rekomanduar se “*duhet të ekzistojë prezumimi i origjinës kriminale të pasurisë dhe njëkohësisht duhet të zhvendoset barra e provës te personi i dënuar dhe/ose palët e treta të informuara*” (Vitaly Kasko, Dmytro Kotlyar, 2018, p. 99).

Shtetet anëtare të Rrjetit Kundër Korrupsionit për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore po ashtu janë duke proklamuar fuqishëm konceptin “*reverse onus probandi*” në procedurat për konfiskimin e pasurisë së pajustificuar duke përfshirë edhe pasurinë e fituar përmes veprave penale të korrupsionit (Vitaly Kasko, Dmytro Kotlyar, 2018, pp. 50, 51).

Për të kuptuar konceptin “*reverse onus probandi*”, ka shumë rëndësi që të bëhet dallimi ndërmjet procedurës *in rem* (kundër sendit) të konfiskimit si dhe procedurës *in personam* (kundër personave):

Procedura *in personam* në disa vende është procedurë civile por zakonisht është procedura penale kundër të pandehurit (personit) dhe ku patjetër kërkohet që barra e provës të mbetet te prokurori për të vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar fajësinë e të pandehurit lidhur me veprën penale të korrupsionit që akuzohet (CoE Impact study on civil forfeiture, 2013, p. 12). Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e ka etabluar në këtë formë barrën e provës dhe çdo formë tjetër përbën shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë (CoE Impact study on civil forfeiture, 2013, p. 12).

- Procedura *in rem* ka për objekt pasurinë e caktuar dhe nuk trajton fare personat. Me fjalë të tjera, procedura *in rem* ka për qëllim të shqyrtoj ligjshmërinë e prejardhjes së pasurisë së caktuar dhe nuk trajton fare fajësinë apo pafajësinë e personit që posedon këtë pasuri respektivisht që është pronar i pasurisë përkatëse pasi që ky aspekt shqyrtohet ekskluzivisht në procedurën *in personam* (CoE Impact study on civil forfeiture, 2013, p. 19). Në këtë procedurë civile, shkalla e të provuarit nuk kërkohet të jetë “përtej çdo dyshimi të bazuar” por bëhet me ballafaqim të provave sipas maksimës “*da mihi factum dabu tibi ius*” apo “*më jep faktet, të jap të drejtën*” që nënkupton se cilado palë që e bën më të besueshme kërkesën e vet, e fiton të drejtën për aq sa ka arritur që të provoj atë para gjykatës (CoE Impact study on civil forfeiture, 2013, p. 19).

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut deri sot nuk ka gjetur asnjëherë që dispozitat ligjore për zhvendosjen e barrës së provës “*reversal onus probandi clauses*” për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme në procedurën *in rem*, përbën shkelje të

Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përderisa barra e provës vazhdon të mbetet te prokurori për procedurën penale *in personam* (Levi, 2000, p. 4).

Në vitin 2001 në çështjen *Phillips kundër Britanisë së Madhe*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (paragrafi 28 i aktgjykimit) ka konstatuar se “*nëse urdhri për konfiskim shqiptohet si një penalti për veprat penale të narkotikëve kundër të pandehurve që janë gjykuar dhe janë gjetur fajtorë përderisa pasuria që konfiskohet nuk rezulton nga vepra penale të tjera, nuk aplikohet neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*” (Phillips v. UK, 2001). **Summa Summarum**, mund të konstatohet se në procedurën *in rem* për konfiskim të pasurisë së paligjshme, në të cilën respektohen të gjitha garancitë për një proces të drejtë gjyqësor, nuk manifeston shkelje të drejtave të njeriut në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Vitaly Kasko, Dmytro Kotlyar, 2018, p. 21).

Në vitin 1949 shkrimtari i njohur George Orwell në esenë e tij “Reflektime mbi Gandin” kishte shkruar se “*Të shenjtët gjithmonë duhet të gjykohen si fajtorë, derisa të provohet pafajësia e tyre*” (Orwell, 1949). Kjo thënie mund të ketë kuptim në kontekstin e përdorur nga Orwell pasi që tematika e esesë së tij ka qenë për paqen si mjet politik të pacifistit të njohur Mahatma Gandit. Përndryshe në kontekstin juridik, konstatimi i Orwell paraqitet në asimetri të plotë me parimin e prezumimit të pafajësisë në procedurën penale. Megjithatë, synim i një sistemi juridik duhet të jetë ekuilibri në mes të drejtave të njeriut dhe zbatimit efikas të normave juridike në fuqi. Nga ky këndvështrim, thënia e Orwell vlen të diskutohet kur bëhet fjalë për luftën kundër korrupsionit.

Konfiskimi i pasurisë së fituar përmes korrupsionit është një nga mjetet më të rëndësishme për të luftuar me sukses korrupsionin. Prandaj Republika e Kosovës duhet të merr në konsideratë përvetësimin e sistemit *in rem* të konfiskimit të pasurisë së fituar nga korrupsioni. Me këtë rast, shteti i Kosovës mund të shërbehet me përvojën dhe praktikën e mira në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britaninë e Madhe, Itali, Irlandë dhe shtetet tjera me traditë të konsoliduar juridike.

Prezumimi i pafajësisë nuk mund të konsiderohet si i cenuar nëse barra e provës zhvendoset nga prokurori te i pandehuri respektivisht i padituri, përderisa procedura *in rem* për konfiskimin e pasurisë së fituar me korrupsion është e veçuar nga procedura penale *in personam* ku barra e

provës vazhdon të mbetet mbi prokurorin. Me fjalë të tjera, prezumimi i pafajësisë nuk duhet të trajtohet si udhëkryq por si urë lidhëse ndërmjet të drejtave të njeriut dhe luftimit efikas të korrupsionit përmes konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme që është fituar nga korrupsioni.

3. Zbatimi i konfiskimit *in rem* të pasurisë së pajustificueshme në Evropë

Sistemi i konfiskimit *in rem* është përhapur në pjesën më të madhe të vendeve evropiane, me qëllimin që të luftohen me sukses veprat penale të korrupsionit dhe veprimet tjera të kundërligjshme. Italia përfaqëson një nga modelet më të njohura dhe më të suksesshme të sistemit *in rem* të konfiskimit në Evropë. Në vitin 1996 në Itali është miratuar ligji nr. 109/1996 për destinimin dhe menaxhimin e pasurisë së konfiskuar (Sergi, 2015, p. 7). Dihet se hyrja në fuqi e këtij ligji ishte manifestuar me mjaft rezistencë nga nivelet e ndryshme të administratës së shtetit Italian ku ishin të infiltuara grupet e organizuara të krimit. Sidoqoftë në vitin 2011, Italia kishte miratuar ligjin antimafia për të amandamentuar atë në vitin 2017 me qëllim që të shtohen kompetencat e zgjeruara të konfiskimit të pasurisë së paligjshme (Sergi, 2015, p. 7).

Bazuar në legjislacionin antimafia në Itali, kur një person fizik ose juridik konsiderohet se ka fituar pasurinë në mënyrë të paligjshme, prokurori duhet të provojë se pasuria e një individi është në shpërputhje me të ardhurat e tij të ligjshme (Sergi, 2015, p. 7). Nëse arrihet kjo nga prokuroria, fillon procedura gjyqësore civile duke prezumuar se pasuria në fjalë është e paligjshme (Sergi, 2015, p. 7). Me këtë rast, barra e provës zhvendoset te i padituri që është posedues respektivisht pronar i pasurisë (Sergi, 2015, p. 7). Nëse i padituri nuk mund të provojë se pasuria e tij ka prejardhje të ligjshme, ajo do të konfiskohet pavarësisht nëse i pandehuri është dënuar ose jo për korrupsion apo vepër tjetër penale (Sergi, 2015, p. 7).

Duhet cekur se një numër i konsiderueshëm i shteteve evropiane siç janë Franca, Luksemburgu, Belgjika, Portugalia, Malta dhe Suedia, vazhdojnë të preferojnë që të zbatojnë sistemin tradicional të konfiskimit të pasurisë së paligjshme, ku është i domosdoshëm një vendim përfundimtar nga gjykata penale që vërteton fajësinë e të pandehurit, në mënyrë që të mundësohet edhe konfiskimi i pasurisë së fituar me veprën penale përkatëse. Mirëpo mjaft

shtete tjera evropiane siç janë Britania e Madhe, Kroacia, Polonia, Sllovenia, Letonia dhe të tjera po promovojnë fuqishëm sistemet moderne të konfiskimit sipas të cilave procedura për konfiskimin e pasurisë së fituar me veprë penale është e ndarë dhe e pavarur nga procedura penale për vërtetimin e fajësisë së të pandehurit për veprën penale në fjalë.

Irlanda është një shembull tjetër i suksesit të modelit *in rem* të konfiskimit të pasurisë së paligjshme. Irlanda që në vitin 1996 ka miratuar ligjin për të ardhurat nga krimi përmes të cilit është mundësuar konfiskimi civil i pasurisë së pajustificueshme pavarësisht nga vendimi i gjykatës penale (King, 2016, p. 3). Përmes ligjit për të ardhurat nga krimi, në Irlandë është themeluar Byroja e Pasurive Kriminale e cila përfaqëson një task forcë në mes të prokurorisë policisë, administratës tatimore dhe organeve tjera kompetente. Byroja si e tillë ka kompetencë për të parashtruar në gjykatën kompetente kërkesë për konfiskimin e pasurisë që dyshohet se është fituar përmes veprave penale në mënyrë të kundërligjshme dhe vlera e pasurisë në fjalë tejkalon 5.000 sterling apo rreth 6.000 euro (King, 2016, p. 3). Me rastin e paraqitjes së kërkesës për konfiskim, është kompetencë e gjykatës nëse do të sekuestrojë ose jo pasurinë e caktuar përkohësisht deri në përfundim të procedurës gjyqësore (King, 2016, p. 3).

Sidoqoftë, barra për të provuar se pasuria e kontestuar ka prejardhje të ligjshme në Irlandë mbetet te i padituri që është poseduesi respektivisht pronari i pasurisë. Në të kundërtën, me urdhër të gjykatës do të konfiskohet pasuria pavarësisht epilogut të procedurës penale lidhur me veprat penale përmes të cilave është fituar pasuria që konfiskohet (King, 2016, p. 3).

Në Mbretërinë e Bashkuar ekziston po ashtu një legjislacion shumë i ngjashëm me atë në Irlandë ku konfiskimi i pasurisë së paligjshme mundësohet përmes procedurës civile në të cilën gjykata vendos bazuar në ***preponderance of evidence*** (balancën e provave) dhe jo në standardin ‘përtej çdo dyshimi të bazuar’. Nëse i padituri nuk arrin që të provoj ligjshmërinë e pasurisë, gjykata urdhëron konfiskimin e saj.

4. Sfidat kryesore për zbatimin e sistemit *in rem* të konfiskimit në Republikën e Kosovës

Me datë 14 korrik 2022, Kuvendi i Republikës së Kosovës kishte miratuar në parim Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Qëllimi i këtij projektligji konsiston në

- *“rregullimin e procedurave të verifikimit dhe konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme si dhe themelimin e Byrosë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme”* (PL-BShVKPP, 2022, p. neni 1).

Ky projektligj synon që të zbatohet ndaj *“pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme nga personat zyrtarë, anëtarët e familjes, personat e ekspozuar politikisht dhe palët e treta”* (PL-BShVKPP, 2022, p. neni 2 par. 1). Si i tillë, ky projektligj zbatohet ndaj *“pasurisë së pajustificueshme të fituar përgjatë periudhës së ushtrimit të funksionit nga subjektet përkatëse nga data 17 shkurt 2008 si dhe brenda dhjetë (10) viteve pas momentit kur këto subjekte pushojnë së ushtruari funksionin e tyre”* (PL-BShVKPP, 2022, p. neni 2 par. 2). Nëse nga të dhënat e mbledhura nga procedura e verifikimit, konstatohet se ka shpërputhje në mes të hyrave dhe pasurisë mbi vlerën 25.000 euro, Byroja do të parashtroj në gjykatë propozimin për konfiskimin e asaj pasurie (PL-BShVKPP, 2022, p. neni 20 par. 8).

Pas paraqitjes së propozimit në Gjykatë, pala ndërgjyqëse në seancën e shqyrtimit, duhet të provojë se pasuria që është objekt i propozimit ka prejardhje të justifikueshme. Me fjalë të tjera *“Çdo pasuri e personit në procedurë supozohet se është fituar në mënyrë të pajustificueshme derisa personi të vërtetojë të kundërtën”* (PL-BShVKPP, 2022, p. neni 31). Ky dokument mund të konsiderohet si hapi kryesor i Republikës së Kosovës me qëllim të përvetësimit të sistemit *in rem* të konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme. Mirëpo kjo iniciativë ligjore në shtetin e Kosovës është ende në fazën e projektligjit. Kjo nënkupton që deri te miratimi dhe hyrja në fuqi, mund të bëhen edhe ndryshime të caktuara në këtë projektligj. Sidoqoftë, në rast të hyrjes në fuqi të këtyre dispozitave si të tilla mund të shpërfaqen disa sfida me rastin e zbatimit të tyre në praktikë.

Dihet se në Republikën e Kosovës aktualisht zbatohet sistemi tradicional i konfiskimit të pasurisë i cili është elaboruar më sipër në këtë kapitull. Prandaj fillimisht duhet theksuar se në

dispozitat kalimtare dhe përfundimtare të projektligjit në fjalë nuk është përcaktuar që do të shfuqizohen dispozitat juridike në fuqi sipas të cilave aktualisht funksionon sistemi tradicional i konfiskimit në Republikën e Kosovës. Në këtë mënyrë implementimi i sistemit *in rem* të konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme sipas këtij projektligji, mund të dërgoj deri të krijimi i një dualizmi të sistemeve të konfiskimit në Republikën e Kosovës. Natyrisht se në një situatë të tillë ku mbetet në fuqi edhe sistemi tradicional edhe sistemi modern i konfiskimit, mund të shkaktohen kolizione të normave juridike që mund të pengojnë efikasitetin e qëllimit të përbashkët të dy sistemeve.

Një përcaktim tjetër i cili po ashtu mund të cilësohet si kontravers në projektligj është neni 2 përmes të cilit synohet që të rregullohet kompetenca e gjykatës për shqyrtimin e kërkesave për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme (PL-BShVKPP, 2022, p. neni 2 par. 1.3 & 1.4). Bazuar në nenin 2 paragrafin 1 nën paragrafët 1.3. dhe 1.4. të projektligjit përcaktohet se kompetente për të shqyrtuar në shkallë të parë kërkesat për konfiskim të pasurisë së pajustificueshme është Departamenti Special në Gjykatën Themelore në Prishtinë ndërsa për gjykimin në shkallë të dytë është Departamenti Special në Gjykatën e Apelit (PL-BShVKPP, 2022, p. neni 2 par. 1.3 & 1.4). Nëse i referohemi ligjit për Gjykatat në Republikën e Kosovës, atëherë Departamenti Special si kompetencë funksionale ka shqyrtimin e lëndëve që janë në kompetencën lëndore të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (LGJ, 2018, p. neni 18 & 24).

Në këtë mënyrë, mund të konstatohet se neni 2 paragrafi 1 nën paragrafët 1.3. dhe 1.4. të projektligjit në fjalë nuk janë në përputhje me nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit për Gjykatat. Për më tepër, kompetencat funksionale të Departamentit Special i referohen ekskluzivisht procedurës penale.

Prima facie mund të thuhet se është e pakuptimtë që të synohet zbatimi me sukses i sistemit civil të konfiskimit të pasurisë përmes procedurës penale pranë departamentit special të gjykatës penale në shkallë të parë dhe të dytë. Kjo për arsye të pamundësisë së zhvendosjes së barrës së provës nga prokurori te pala e pandehur në procedurë penale, për shkak të kufizimeve të prezumimit të pafajësisë siç është sqaruar më sipër në këtë punim. Një zhvendosje e tillë e barrës së provës është e mundur vetëm përmes procedurës civile dhe

pikërisht për këtë arsye ekziston edhe emërtimi i sistemit civil të konfiskimit. Prandaj do të ishte më e përshtatshme që kompetenca për shqyrtimin e kërkesave për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme të mbetet te Departamenti i Përgjithshëm dhe jo te Departamenti Special i Gjykatës Themelore dhe të Apelit në Republikën e Kosovës.

Çështja tjetër përkatësisht sfida tjetër që duhet pasur parasysh ndërlidhet me fuqinë retroaktive të projektligjit. Përmes nenit 2 paragrafit 2 të tij përcaktohet veprimi retroaktiv ashtu që dispozitat e projektligjit do të jenë të vlefshme nga data 17 shkurt 2008, që në mënyrë simbolike konsiston edhe me datën e shpalljes së pavarësisë të Republikës së Kosovës.

Në parim, fuqia retroaktive e një ligji të kësaj natyre nuk do të duhej që të përbënte një problem juridik në vetvete. Megjithatë konstalacioni aktual i shoqërisë në shtetin e Kosovës mund të konsiderohet si argument se ekziston një vijë shumë e hollë në mes të veprimit retroaktiv të këtij projektligji dhe të shkeljes së të drejtave të njeriut. Për të mbështetur këtë konstatim mund të referohen së paku dy (2) argumente të rëndësishme të cilat janë (1) niveli i ekonomisë joformale në Kosovë si dhe (2) ndikimi i remitencave të diasporës në shoqërinë kosovare. Në një raport të Komisionit Evropian në vitin 2020 është konstatuar se ekonomia joformale në Republikën e Kosovës mesatarisht është rreth 31.7% të Bruto Produktit Vendor apo rreth 1.845 miliardë euro në vit (CEU, 2020, p. 15).

Në kontekst të projekt ligjit në fjalë, kjo nënkupton se rreth 1.845 miliardë euro në vit mund të jenë objekt i shqyrtimit nga byroja. Mirëpo nëse kalkulohet vlera e ekonomisë jo formale për 14 vitet e fundit respektivisht nga data 17 shkurt 2008 deri më 17 shkurt 2022, atëherë mund të supozohet se rreth 26 miliardë euro mund të bëhen objekt i shqyrtimit nga byroja shtetërore që në fillim të themelimit të saj. Kur mendohet se buxheti i shtetit të Kosovës nuk është as 3 miliardë euro, atëherë verifikimi i vlerës prej 26 miliardë euro është ngarkesë mjaft e madhe.

Tutje, duhet cekur se remitencat nga diaspora për shtetin e Kosovës përbëjnë një nga burimet kryesore të ardhurave për familjet kosovare. Rrjedhimisht remitencat kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mbajtjen dhe zhvillimin e shumë familjeve në Kosovë. Mendohet se rreth 14

miliardë euro janë të hyrat prej remitencave nga viti 2008 apo mesatarisht rreth një (1) miliardë euro në vit (Monitor.al, 2022).

Kuptohet se remitencat në vetvete nuk janë të kundërligjshme, përkundrazi janë shumë të mirëseardhura për shtetin e Kosovës. Problemi konsiston në faktin që remitencat në shumicën e rasteve përfitohen nga dora në dorë dhe jo përmes transaksioneve bankare. Prandaj nuk është e lehtë që të vërtetohet prejardhja e tyre e ligjshme.

Për shkak të fuqisë retroaktive që mund të manifestohet përmes dispozitave aktuale të projektligjit, byroja shtetërore mund të vjen në një situatë ku mbi 14 miliardë euro të remitencave që nga viti 2008 mund të bëhen objekt i verifikimit dhe konfiskimit si pasuri e pajustificueshme. Nëse i shtojmë edhe 26 miliardë eurot e supozuara nga ekonomia joformale për këtë periudhë, atëherë bëhet fjalë për një vlerë mbi 40 miliardë euro që në mënyrë retroaktive synohen të bëhen objekt i trajtimit nga byroja shtetërore. Padyshim që kjo është një vlerë e konsiderueshme e pasurisë përkatëse që mund të bëhet objekt potencial i verifikimit nga byroja shtetërore sipas projektligjit në fjalë. Duhet pasur parasysh që nuk bëhet fjalë në mënyrë të drejtpërdrejtë për korrupsionin apo për krimin e organizuar por për remitencat e diasporës dhe për nivelin e ekonomisë joformale në Republikën e Kosovës. Prandaj veprimi retroaktiv i projektligjit në fjalë nëse eventualisht miratohet për të hyrë në fuqi si i tillë, mund të rezultojë si është vështirë i zbatueshëm dhe lehtësisht mund të konsistojë në shkeljen e të drejtave apo lirive themelore të njeriut.

KAPITULLI IX - PRAKTIKA GJYQËSORE KUNDËR KORRUPSIONIT GJATË VITEVE 2019-2022

1. Praktika gjyqësore kundër korrupsionit gjatë vitit 2019

Gjatë vitit 2019 në Gjykatën Themelore në Prishtinë janë trajtuar gjithsej 219 lëndë ku kanë qenë të përfshirë 600 persona të akuzuar lidhur me veprat penale nga kapitulli XXXIII “Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare” në Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Mirëpo nga këto 219 raste penale, janë zgjidhur vetëm 66 raste gjatë vitit 2019 apo 30.13%. Ndërsa prej 600 personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit, vetëm 214 prej tyre apo 35.66% janë gjykuar me vendim përfundimtar. Në këtë mënyrë 153 rastet tjera apo

69.87% që kanë mbetur të pazgjidhura me gjithsej 386 persona të akuzuar, janë bartur në vitin 2020 për gjykim (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020).

Tab. 6. Veprat penale të korrupsionit zyrtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë gjatë 2019

Vepra Penale	Raste në shqyrtim	Të akuzuar	Raste të zgjidhura	Të akuzuarit e gjykuar	Raste pazgjidhur	Të akuzuar pagjykuar
Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	129	463	40	175	89	288
Keqpërdorimi i informatës zyrtare	0	0	0	0	0	0
Konflikti i interesit	3	3	2	2	1	1
Përvetësimi në detyrë	46	75	8	14	38	61
Mashtrimi në detyrë	1	1	0	0	1	1
Përdorimi i paautorizuar i pasurisë	0	0	0	0	0	0
Marrja e ryshfetit	18	29	4	7	14	22
Dhënia e ryshfetit	12	12	7	7	5	5
Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj	2	2	0	0	2	2
Ushtrimi i ndikimit	2	6	1	3	1	3
Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore	1	1	1	1	0	0
Zbulimi i fshehtësisë zyrtare	1	2	0	0	1	2
Falsifikimi i dokumentit zyrtar	3	5	3	5	0	0
Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme	0	0	0	0	0	0
Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor	1	1	0	0	1	1
Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, të ardhurave, dhuratave, dobisë tjetër ose detyrimeve financiare	0	0	0	0	0	0
Gjithsej	219	600	66	214	153	386

Burimi: (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020).

Më shumë se gjysma e rasteve të korrupsionit zyrtar që janë gjykuar në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë vitit 2019 kanë qenë për shkak të veprës penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Me fjalë të tjera, nga 219 raste lidhur me veprat penale të korrupsionit zyrtar, 129 prej tyre apo 58.9% e tyre kanë qenë për shkak të veprës penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Ndërsa nga gjithsej 600 personat e akuzuar për korrupsion zyrtar gjatë këtij viti, 463 raste apo 77.16% e tyre kanë qenë të akuzuar pikërisht për këtë vepër penale. Sidoqoftë, gjatë vitit 2019 Gjykata Themelore në Prishtinë ka arritur të zgjidh vetëm 40 nga 129 rastet për shkak të veprës penale

“Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Kjo nënkupton që efikasiteti i gjykatës në zgjidhjen e këtyre rasteve gjatë vitit 2019 ka qenë vetëm rreth 31%. Rrjedhimisht 69% e rasteve tjera respektivisht 89 raste lidhur me këtë vepër penale të korrupsionit zyrtar janë bartur për gjykim në vitin pasues. Nga 463 personat e akuzuar për këtë vepër penale, për vetëm 175 prej tyre apo rreth 37.79% e akuzave kanë marrë një epilog dhe rastet e tyre janë gjykuar me vendim përfundimtar. Ndërsa 488 të akuzuarit e tjerë apo 62.21% e tyre kanë vazhduar të presin epilogun e akuzave kundër tyre edhe në vitin pasues 2020 (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020).

Lidhur me veprën penale “Përvetësimi në detyrë” nga neni 418 i Kodit Penal, gjatë vitit 2019 janë pranuar 46 raste me gjithsej 75 të akuzuar. Prej tyre janë zgjidhur 8 raste apo 17.4% me gjithsej 14 të akuzuar apo 18.66%. Ndërsa 38 rastet tjera apo 82.6% me 61 të akuzuar apo 81,34% janë bartur për gjykim në vitin pasues 2020 (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020).

Lidhur me veprën penale “Marrja e ryshfetit” nga neni 421 i Kodit Penal, janë pranuar 18 raste me gjithsej 29 të akuzuar gjatë vitit 2019 në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Prej tyre janë zgjidhur 4 raste apo 22.22% me 7 të akuzuar apo 24.13%. Rastet tjera të marrjes së ryshfetit janë bartur në vitin 2020. Lidhur me veprën penale “Dhënia e ryshfetit” nga neni 422 i Kodit Penal, janë pranuar 12 raste me gjithsej 12 të akuzuar gjatë vitit 2019 në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Prej tyre janë zgjidhur 7 raste apo 58.33% e rasteve me 7 të akuzuar apo 58.33% e të akuzuarve. Rastet tjera të dhënies së ryshfetit janë bartur në vitin 2020 (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020).

Tab. 7. Epilogu i rasteve të korrupsionit në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë vitit 2019


Vepra Penale	Me aktgjykim fajësues								Aktgjykim lirues	Të liruar me aktgjykim lirues	Aktgjykim refuzues	Të liruar me aktgjykim refuzues	Përfundime tjera	Persona sipas përfundimeve tjera	Asete të konfiskuara
	Dënim me burgim	Të dënuar me burgim	Dënim me gjobë	Të dënuar me gjobë	Dënim me kusht	Të dënuar me kusht	Dënime tjera	Persona me dënime tjera							
Keqpërdorimi i pozitës apo	7	71	4	7	3	9	2	26	12	24	5	18	7	20	0

autoritetit zyrtar															
Keqpërdorimi i informatës zyrtare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Konflikti i interesit	0	0	2	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përvetësimi në detyrë	1	1	4	8	1	1	0	0	1	3	0	0	1	1	0
Mashtrimi në detyrë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përdorimi i paautorizuar i pasurisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Marrja e ryshfetit	1	1	2	5	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Dhënia e ryshfetit	0	0	5	5	2	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Ushtrimi i ndikimit	1	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0	0	0
Zbulimi i fshehtësisë zyrtare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Falsifikimi i dokumentit zyrtar	0	0	2	3	1	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, të ardhurave, dhuratave, dobisë tjetër ose detyrimeve financiare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsej	10	76	19	30	8	15	2	26	13	27	6	19	8	21	0

Burimi: (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020).

Nga 66 rastet e zgjidhura të korrupsionit zyrtar gjatë vitit 2019 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, 39 raste apo 59.1% kanë përfunduar me aktgjykim fajësues, 13 raste apo 19.7% kanë përfunduar me aktgjykim lirues, 6 raste apo 9.1 % kanë përfunduar me aktgjykim refuzues ndërsa 8 raste apo 12.1% kanë përfunduar në mënyra tjera respektivisht në procedura penale alternative (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020).

Fig. 4. Epilogu i rasteve të korrupsionit zyrtar gjatë vitit 2019



Burimi: (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020).


Përmes 39 rasteve që kanë përfunduar me aktgjykim fajësues janë dënuar gjithsej 147 persona për shkak të veprave penale të korrupsionit zyrtar (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020).

Nëse kemi parasysh se gjatë vitit 2019 janë gjykuar 214 persona për korrupsion zyrtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kjo nënkupton se 68.7% e tyre janë gjykuar me aktgjykim fajësues (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020). Në anën tjetër, përmes 13 rasteve që kanë

përfunduar me aktgjykim lirues, janë liruar nga akuzat për korrupsion zyrtar gjithsej 27 persona apo 12.6% (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020).

Tutje, përmes 6 rasteve që kanë përfunduar me aktgjykim refuzues janë refuzuar akuzat për korrupsion zyrtar për 19 persona apo 8.9%. Ndërsa përmes 8 rasteve që janë zgjidhur në mënyra tjera, janë gjykuar për korrupsion zyrtar 21 persona apo 9.8% (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020).

Fig. 5. Numri i personave të gjykuar për korrupsion zyrtar gjatë vitit 2019




Burimi: (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020).

Nga 39 rastet e korrupsionit zyrtar që kanë përfunduar me aktgjykim fajësues gjatë vitit 2019, në vetëm 10 raste apo 25.65% është shqiptuar dënim me burgim (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020). Në 19 raste apo 48.7% është shqiptuar dënim me gjobë (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020).

Duhet theksuar se në 8 raste apo 20.5% është shqiptuar dënim me kusht për shkak të veprave penale të korrupsionit zyrtar (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020). Ndërsa në 2 rastet tjera apo në 5.1% janë shqiptuar sanksione tjera penale (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020).

Fig. 6. Llojet e dënimeve për shkak të korrupsionit zyrtar gjatë vitit 2019




Burimi: (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020).

Përmes 10 aktgjyimeve fajësuese ku është shqiptuar dënim me burgim, gjithsej 76 persona janë dënuar me burgim për shkak të korrupsionit zyrtar gjatë vitit 2019 në Gjykatën Themelore në Prishtinë (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020). Nëse marrim parasysh se gjithsej 147 persona janë dënuar me aktgjykim fajësues për korrupsion zyrtar gjatë vitit 2019, kjo

nënkupton se rreth gjysma e tyre apo 51.7% janë dënuar me burgim (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020). Përmes 19 aktgjykimeve fajësuese tjera ku është shqiptuar dënim me gjobë, janë dënuar gjithsej 30 persona apo 20.4% (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020). Të dënuar me kusht përmes 8 aktgjykimeve fajësuese janë 15 persona apo 10.2% (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020). Për 26 persona të tjerë apo 17.7% janë shqiptuar dënime tjera alternative apo masa të trajtimit të detyrueshëm (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020).

Fig. 7. Llojet e dënimeve për korrupsion zyrtar gjatë vitit 2019



Burimi: (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020).

Vlen të potencohet se nga 39 rastet që kanë përfunduar me aktgjykim fajësues ku janë dënuar 147 persona për korrupsion zyrtar gjatë vitit 2019 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, nuk është konfiskuar asnjë aset si i kundërligjshëm nga personat e dënuar (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020). Rrjedhimisht vlera e aseteve të konfiskuara nga veprat penale të korrupsionit zyrtar gjatë vitit 2019 në Gjykatën Themelore të Prishtinës është zero (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020). Njëkohësisht duhet cekur se gjatë këtij viti nuk është parashtruar asnjë aktakuzë për shkak të korrupsionit në sektorin privat (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2020). Andaj nuk ekziston asnjë aktgjykim për shkak të veprave penale të marrjes apo dhënies së ryshfetit në sektorin privat.

2. Praktika gjyqësore kundër korrupsionit gjatë vitit 2020

Gjatë vitit 2020 në Gjykatën Themelore në Prishtinë janë trajtuar gjithsej 199 lëndë ku kanë qenë të përfshirë 473 persona të akuzuar lidhur me veprat penale nga kapitulli XXXIII “Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare” në Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Mirëpo nga këto 199 raste penale, janë zgjidhur vetëm 42 apo 21.1% gjatë vitit 2020. Ndërsa prej 473 personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit, vetëm 68 prej tyre apo 14.37% janë gjykuar me vendim përfundimtar (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021). Në këtë mënyrë 157 rastet tjera që kanë mbetur të pazgjidhura me gjithsej 405 persona të akuzuar, janë bartur në vitin pasues 2021 për gjykim (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021).

Tab. 8. Veprat penale të korrupsionit zyrtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë gjatë 2020

Vepra Penale	Raste në shqyrtim	Të akuzuar	Raste të zgjidhura	Të akuzuarit e gjykuar	Raste pazgjidhur	Të akuzuar pagjykuar
Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	124	357	26	46	98	311
Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik	0	0	0	0	0	0
Keqpërdorimi i informatës zyrtare	0	0	0	0	0	0
Konflikti i interesit	1	1	0	0	1	1
Përvetësimi në detyrë	39	62	7	10	32	52
Mashtrimi në detyrë	2	5	0	0	2	5
Përdorimi i paautorizuar i pasurisë	0	0	0	0	0	0
Marrja e ryshfetit	20	31	4	7	16	24
Dhënia e ryshfetit	5	5	3	3	2	2
Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj	2	2	0	0	2	2
Ushtrimi i ndikimit	1	3	0	0	1	3
Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore	0	0	0	0	0	0
Zbulimi i fshehtësisë zyrtare	1	2	0	0	1	2
Falsifikimi i dokumentit zyrtar	2	2	2	2	0	0
Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme	0	0	0	0	0	0
Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor	2	3	0	0	2	3
Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, të ardhurave, dhuratave, dobisë tjetër ose detyrimeve financiare	0	0	0	0	0	0
Gjithsej	199	473	42	68	157	405

Burimi: (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021).

Shumica e rasteve të korrupsionit zyrtar që janë gjykuar në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë vitit 2020 kanë qenë për shkak të veprës penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Me fjalë të tjera, nga 199 raste lidhur me veprat penale të korrupsionit zyrtar, 124 prej tyre apo 62.31% e tyre kanë qenë për shkak të veprës penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Ndërsa nga gjithsej 473 personat e akuzuar për korrupsion zyrtar gjatë këtij viti, 357 raste apo 75.47% e tyre kanë qenë të akuzuar pikërisht për këtë vepër penale. Sidoqoftë, gjatë vitit 2020 Gjykata Themelore në Prishtinë ka arritur të zgjidh vetëm 26 nga 124 rastet për shkak të veprës penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Kjo nënkupton që efikasiteti i gjykatës në zgjidhjen e këtyre rasteve gjatë vitit 2019 ka qenë vetëm rreth 20.96%. Rrjedhimisht 79.04% e rasteve tjera respektivisht 98 raste lidhur me këtë vepër penale të korrupsionit zyrtar janë bartur për gjykim në vitin pasues. Nga 357 personat e akuzuar për këtë vepër penale, për vetëm 46 prej tyre apo rreth 12.88% akuzat kanë marrë një epilog dhe rastet e tyre janë gjykuar me vendim përfundimtar. Ndërsa 311 të akuzuarit e tjerë apo 87.12% e tyre kanë vazhduar të presin epilogun e akuzave kundër tyre edhe në vitin pasues 2021 (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021).

Lidhur me veprën penale “Përvetësimi në detyrë” nga neni 418 i Kodit Penal, gjatë vitit 2020 janë pranuar 39 raste me gjithsej 62 të akuzuar. Prej tyre janë zgjidhur 7 raste apo 17.94% me gjithsej 10 të akuzuar apo 16.12%. Ndërsa 32 rastet tjera apo 82.06% me 52 të akuzuar apo 83.88% janë bartur për gjykim në vitin pasues 2021 (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021).

Lidhur me veprën penale “Marrja e ryshfetit” nga neni 421 i Kodit Penal, janë pranuar 20 raste me gjithsej 31 të akuzuar gjatë vitit 2020 në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Prej tyre janë zgjidhur 4 raste apo 20% me 7 të akuzuar apo 22.58%. Rastet tjera të marrjes së ryshfetit janë bartur në vitin 2021.

Sa i përket veprës penale “Dhënia e ryshfetit” nga neni 422 i Kodit Penal, janë pranuar 5 raste me gjithsej 5 të akuzuar gjatë vitit 2020 në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Prej tyre janë zgjidhur 3 raste apo 60% e rasteve me 3 të akuzuar apo 60% e të akuzuarve. Rastet tjera të dhënies së ryshfetit janë bartur në vitin 2021 (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021).


Tab. 9. Epilogu i rasteve të korrupsionit në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë vitit 2020

Vepra Penale	Me aktgjykim fajësues								Aktgjykim lirues	Të liruar me aktgjykim lirues	Aktgjykim refuzues	Të liruar me aktgjykim refuzues	Përfundime tjera	Persona sipas përfundimeve tjera	Asete të konfiskuara
	Dënim me burgim	Të dënuar me burgim	Dënim me gjobë	Të dënuar me gjobë	Dënim me kusht	Të dënuar me kusht	Dënime tjera	Persona me dënime tjera							
Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	3	6	5	10	3	3	0	0	11	17	3	9	1	1	0
Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Keqpërdorimi i informatës zyrtare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Konflikti i interesit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përvetësimi në detyrë	0	0	0	0	2	2	0	0	3	5	1	2	1	1	0
Mashtrimi në detyrë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përdorimi i paautorizuar i pasurisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Marrja e ryshfetit	0	0	1	1	1	1	0	0	2	5	0	0	0	0	0
Dhënia e ryshfetit	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	2	2	0
Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Ushtrimi i ndikimit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Zbulimi i fshehtësisë zyrtare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Falsifikimi i dokumentit zyrtar	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0
Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, të ardhurave, dhuratave, dobisë tjetër ose detyrimeve financiare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsej	3	6	8	13	6	6	0	0	16	27	4	11	5	5	0

Burimi: (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021).

Nga 42 rastet e zgjidhura të korrupsionit zyrtar gjatë vitit 2020 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, 17 raste apo 40.47% kanë përfunduar me aktgjykim fajësues, 16 raste apo 38.10% kanë përfunduar me aktgjykim lirues, 4 raste apo 9.53% kanë përfunduar me aktgjykim refuzues ndërsa 5 raste apo 11.90% kanë përfunduar në mënyra tjera respektivisht në procedura penale alternative (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021).

Fig. 8. Epilogu i rasteve të korrupsionit zyrtar gjatë vitit 2020




Burimi: (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021).

Përmes 17 rasteve që kanë përfunduar me aktgjykim fajësues janë dënuar gjithsej 25 persona për shkak të veprave penale të korrupsionit zyrtar (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021). Nëse kemi parasysh se gjatë vitit 2020 janë gjykuar 68 persona për korrupsion zyrtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kjo nënkupton se 36.76% e tyre janë gjykuar me aktgjykim fajësues (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021). Në anën tjetër, përmes 16 rasteve që kanë përfunduar me aktgjykim lirues, janë liruar nga akuzat për korrupsion zyrtar gjithsej 27 persona apo 39.7% (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021).

Tutje, përmes 4 rasteve që kanë përfunduar me aktgjykim refuzues janë refuzuar akuzat për korrupsion zyrtar për 11 persona apo 16.17% (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021). Ndërsa përmes 5 rasteve që janë zgjidhur në mënyra tjera, janë gjykuar për korrupsion zyrtar 5 persona apo 7.35% (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021).


Fig. 9. Numri i personave të gjykuar për korrupsion zyrtar gjatë vitit 2020



Burimi: (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021).

Nga 17 rastet e korrupsionit zyrtar që kanë përfunduar me aktgjykim fajësues gjatë vitit 2020, në vetëm 3 raste apo 17.65% është shqiptuar dënim me burgim. Në 8 raste apo 47.05% është shqiptuar dënim me gjobë. Ndërsa në 6 rastet tjera apo 35.3% është shqiptuar dënim me kusht për shkak të veprave penale të korrupsionit zyrtar (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021).


Fig. 10. Llojet e dënimeve për shkak të korrupsionit zyrtar gjatë vitit 2020



Burimi: (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021).

Përmes 3 aktgjykimeve fajësuese ku është shqiptuar dënim me burgim, gjithsej 6 persona janë dënuar me burgim për shkak të korrupsionit zyrtar gjatë vitit 2020 në Gjykatën Themelore në Prishtinë (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021). Nëse marrim parasysh se gjithsej 25 persona janë dënuar me aktgjykim fajësues për korrupsion zyrtar gjatë vitit 2020, kjo nënkupton se 24% janë dënuar me burgim (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021). Përmes 8 aktgjykimeve fajësuese tjera ku është shqiptuar dënim me gjobë, janë dënuar gjithsej 13 persona apo 52% (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021). Të dënuar me kusht përmes 6 aktgjykimeve fajësuese janë 6 persona apo 24% (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021).

Fig. 11. Llojet e dënimeve për korrupsion zyrtar gjatë vitit 2020



Burimi: (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021).

Vlen të potencohet se nga 17 rastet që kanë përfunduar me aktgjykim fajësues ku janë dënuar 25 persona për korrupsion zyrtar gjatë vitit 2020 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, nuk është konfiskuar asnjë aset si i kundërligjshëm nga personat e dënuar (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021). Rrjedhimisht vlera e aseteve të konfiskuara nga veprat penale të korrupsionit zyrtar gjatë vitit 2020 në Gjykatën Themelore të Prishtinës është zero (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021). Njëkohësisht duhet cekur se gjatë këtij viti nuk është parashtuar asnjë aktakuzë për shkak të korrupsionit në sektorin privat (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021). Prandaj nuk ekziston asnjë aktgjykim për shkak të veprave penale të marrjes apo dhënies së ryshfetit në sektorin privat (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2021).

3. Praktika gjyqësore kundër korrupsionit gjatë vitit 2021

Gjatë vitit 2021 në Gjykatën Themelore në Prishtinë janë trajtuar gjithsej 197 lëndë ku kanë qenë të përfshirë 498 persona të akuzuar lidhur me veprat penale nga kapitulli XXXIII “Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare” në Kodin Penal të Republikës së Kosovës (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022). Mirëpo nga këto 197 raste penale, janë zgjidhur vetëm 34 raste apo 17.25% gjatë vitit 2021. Ndërsa prej 498 personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit, vetëm 59 prej tyre janë gjykuar me vendim përfundimtar (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022). Në këtë mënyrë 163 rastet tjera që kanë mbetur të pazgjidhura me gjithsej 439 të akuzuar, janë bartur në vitin pasues 2022 për gjykim (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022).

Tab. 10. Veprat penale të korrupsionit zyrtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë gjatë 2021

Vepra Penale	Raste në shqyrtim	Të akuzuar	Raste të zgjidhura	Të akuzuarit e gjykuar	Raste pazgjidhur	Të akuzuar pagjykuar
Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	122	382	26	50	96	332
Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik	3	4	0	0	3	4
Keqpërdorimi i informatës zyrtare	0	0	0	0	0	0
Konflikti i interesit	1	1	0	0	1	1
Përvetësimi në detyrë	32	52	3	3	29	49
Mashtrimi në detyrë	3	6	0	0	3	6
Përdorimi i paautorizuar i pasurisë	0	0	0	0	0	0
Marrja e ryshfetit	20	30	3	4	17	26
Dhënia e ryshfetit	3	3	2	2	1	1
Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj	2	2	0	0	2	2
Ushtrimi i ndikimit	2	4	0	0	2	4
Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore	0	0	0	0	0	0
Zbulimi i fshehtësisë zyrtare	1	2	0	0	1	2
Falsifikimi i dokumentit zyrtar	6	9	0	0	6	9
Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme	0	0	0	0	0	0
Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor	2	3	0	0	2	3
Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, të ardhurave, dhuratave, dobisë tjetër ose detyrimeve financiare	0	0	0	0	0	0
Gjithsej	197	498	34	59	163	439

Burimi: (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022).

Shumica e rasteve të korrupsionit zyrtar që janë gjykuar në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë vitit 2021 kanë qenë për shkak të veprës penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Me fjalë të tjera, nga 197 raste lidhur me veprat penale të korrupsionit zyrtar, 122 prej tyre apo 61.92% e tyre kanë qenë për shkak të veprës penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Ndërsa nga gjithsej 498 personat e akuzuar për korrupsion zyrtar gjatë këtij viti, 382 raste apo 76.7% e tyre kanë qenë të akuzuar pikërisht për këtë vepër penale.

Sidoqoftë, gjatë vitit 2021 Gjykata Themelore në Prishtinë ka arritur të zgjidh vetëm 26 nga 122 rastet për shkak të veprës penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Kjo nënkupton që efikasiteti i gjykatës në zgjidhjen e këtyre rasteve gjatë vitit 2021 ka qenë vetëm rreth 21.31%. Rrjedhimisht 78.69% e rasteve tjera respektivisht 96 raste lidhur me këtë vepër penale të korrupsionit zyrtar janë bartur për gjykim në vitin pasues. Nga 382 personat e akuzuar për këtë vepër penale, për vetëm 50 prej tyre apo rreth 13.09% akuzat kanë marrë një epilog dhe rastet e tyre janë gjykuar me vendim përfundimtar. Ndërsa 332 të akuzuarit e tjerë apo 86.91% e tyre kanë vazhduar të presin epilogun e akuzave kundër tyre në vitin pasues 2022 (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022).

Lidhur me veprën penale “Përvetësimi në detyrë” nga neni 418 i Kodit Penal, gjatë vitit 2021 janë pranuar 32 raste me gjithsej 52 të akuzuar. Prej tyre janë zgjidhur 3 raste apo 9.37% me gjithsej 3 të akuzuar apo 5.76%. Ndërsa 29 rastet tjera apo 90.63% me 49 të akuzuar apo 94.24% janë bartur për gjykim në vitin pasues 2022 (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022).

Sa i përket veprës penale “Marrja e ryshfetit” nga neni 421 i Kodit Penal, janë pranuar 20 raste me gjithsej 30 të akuzuar gjatë vitit 2021 në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Prej tyre janë zgjidhur 3 raste 15% me 4 të akuzuar apo 13.33%. Rastet tjera të marrjes së ryshfetit janë bartur në vitin 2022.

Lidhur me veprën penale “Dhënia e ryshfetit” nga neni 422 i Kodit Penal, janë pranuar 3 raste me gjithsej 3 të akuzuar gjatë vitit 2021 në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Prej tyre janë

zgjdhur 2 raste apo 66.66% e rasteve me 2 të akuzuar apo 66.66% e të akuzuarve. Rastet tjera të dhënies së ryshfetit janë bartur në vitin 2022 (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022).

Tab. 11. Epilogu i rasteve të korrupsionit në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë vitit 2021


Vepra Penale	Me aktgjykim fajësues								Aktgjykim lirues	Të liruar me aktgjykim lirues	Aktgjykim refuzues	Të liruar me aktgjykim refuzues	Përfundime tjera	Persona sipas përfundimeve tjera	Asete të konfiskuara
	Dënim me burgim	Të dënuar me burgim	Dënim me gjobë	Të dënuar me gjobë	Dënim me kusht	Të dënuar me kusht	Dënime tjera	Persona me dënime tjera							
Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	6	8	3	3	2	2	0	0	8	24	1	1	6	12	0
Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Keqpërdorimi i informatës zyrtare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Konflikti i interesit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përvetësimi në detyrë	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	2	2	0
Mashtrimi në detyrë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përdorimi i paautorizuar i pasurisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Marrja e ryshfetit	1	2	1	1	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0
Dhënia e ryshfetit	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0
Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Ushtrimi i ndikimit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Zbulimi i fshehtësisë zyrtare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Falsifikimi i dokumentit zyrtar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, të ardhurave, dhuratave, dobisë tjetër ose detyrimeve financiare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Gjithsej	8	11	5	5	2	2	0	0	9	25	1	1	9	15	0
----------	---	----	---	---	---	---	---	---	---	----	---	---	---	----	---

Burimi: (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022).

Nga 34 rastet e zgjidhura të korrupsionit zyrtar gjatë vitit 2021 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, 15 raste apo 44.11% kanë përfunduar me aktgjykim fajësues, 9 raste apo 26.47% kanë përfunduar me aktgjykim lirues, 1 rast apo 2.95% kanë përfunduar me aktgjykim refuzues ndërsa 9 raste apo 26.47% kanë përfunduar në mënyra tjera respektivisht në procedura penale alternative (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022).

Fig. 12. Epilogu i rasteve të korrupsionit zyrtar gjatë vitit 2021




Burimi: (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022).

Përmes 15 rasteve që kanë përfunduar me aktgjykim fajësues janë dënuar gjithsej 18 persona për shkak të veprave penale të korrupsionit zyrtar (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022). Nëse kemi parasysh se gjatë vitit 2021 janë gjykuar 59 persona për korrupsion zyrtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kjo nënkupton se 30.51% e tyre janë gjykuar me aktgjykim fajësues (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022). Në anën tjetër, përmes 9 rasteve që kanë përfunduar me aktgjykim lirues, janë liruar nga akuzat për korrupsion zyrtar gjithsej 25 persona apo 42.37% (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022).

Tutje, përmes 1 rasti që ka përfunduar me aktgjykim refuzues është refuzuar akuza për korrupsion zyrtar për 1 person apo 1.7% (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022). Ndërsa përmes 9 rasteve që janë zgjidhur në mënyra tjera, janë gjykuar për korrupsion zyrtar 15 persona apo 25.42% (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022).


Fig. 13. Numri i personave të gjykuar për korrupsion zyrtar gjatë vitit 2021



Burimi: (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022).

Nga 15 rastet e korrupsionit zyrtar që kanë përfunduar me aktgjykim fajësues gjatë vitit 2021, në vetëm 8 raste apo 53.34% është shqiptuar dënim me burgim (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022). Në 5 raste apo 33.33% është shqiptuar dënim me gjobë. Ndërsa në 2 rastet tjera apo 13.33% është shqiptuar dënim me kusht për shkak të veprave penale të korrupsionit zyrtar (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022).


Fig. 14. Llojet e dënimeve për shkak të korrupsionit zyrtar gjatë vitit 2021



Burimi: (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022).

Përmes 8 aktgjykimeve fajësuese ku është shqiptuar dënim me burgim, gjithsej 11 persona janë dënuar me burgim për shkak të korrupsionit zyrtar gjatë vitit 2021 në Gjykatën Themelore në Prishtinë (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022). Nëse marrim parasysh se gjithsej 18 persona janë dënuar me aktgjykim fajësues për korrupsion zyrtar gjatë vitit 2021, kjo nënkupton se 61.11% janë dënuar me burgim (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022). Përmes 5 aktgjykimeve fajësuese tjera ku është shqiptuar dënim me gjobë, janë dënuar gjithsej 5 persona apo 27.78% (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022). Të dënuar me kusht përmes 2 aktgjykimeve fajësuese janë 2 persona apo 11.11% (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022).

Fig. 15. Llojet e dënimeve për korrupsion zyrtar gjatë vitit 2021



Burimi: (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022).

Vlen të potencohet se nga 15 rastet që kanë përfunduar me aktgjykim fajësues ku janë dënuar 18 persona për korrupsion zyrtar gjatë vitit 2021 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, nuk është konfiskuar asnjë aset si i kundërligjshëm nga personat e dënuar (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022). Rrjedhimisht vlera e aseteve të konfiskuara nga veprat penale të korrupsionit zyrtar gjatë vitit 2021 në Gjykatën Themelore të Prishtinës është zero (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022). Njëkohësisht duhet cekur se gjatë këtij viti nuk është parashtruar asnjë aktakuzë për shkak të të korrupsionit në sektorin privat (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022). Prandaj as në vitin 2021 nuk ekziston asnjë aktgjykim për shkak të veprave penale të marrjes apo dhënies së ryshfetit në sektorin privat (Gjykata Themelore në Prishtinë, 2022).

KAPITULLI X – ASPEKTE KRAHASUESE

1. Lufta kundër veprave penale të korrupsionit në Republikën Federale të Gjermanisë

Gjermania e ka nënshkruar Konventën Penale kundër Korrupsionit më 27 janar 1999 ndërsa ratifikimin e konventës, Gjermania e ka bërë më 10 maj 2017, për të hyrë në fuqi më 1 shtator të po atij viti (GRECO, 2017).

Me rastin e ratifikimit të Konventës Penale kundër Korrupsionit, Gjermania ka përcaktuar dy (2) rezerva lidhur me nenin 12 dhe nenin 26 paragrafin 1 të Konventës Penale kundër Korrupsionit (ETS No. 173 - Treaty Office, 2022).

Në përputhje me nenin 37 paragrafin 1 të Konventës Penale kundër Korrupsionit, Republika Federale e Gjermanisë ka rezervuar të drejtën për të mos përcaktuar si vepër penale *“ushtrimin e ndikimit”* përmes legjislacionit të vet të brendshëm sipas inkriminimit nga neni 12 i konventës (ETS No. 173 - Treaty Office, 2022) ku përcaktohet se:

- *“Çdo shtet anëtar duhet që përmes masave legislative apo masave të tjera që janë të nevojshme për të përcaktuar si vepër penale përmes legjislacionit të vet, situatat kur me qëllim të drejtpërdrejtë, premtohet, jepet ose ofrohet, direkt ose indirekt, të ndonjë avantazhi të kundërligjshëm për këdo që pohon ose konfirmon që ai ose ajo janë të aftë për ushtruar një ndikim të paligjshëm lidhur me vendimmarrjen e një personi zyrtar, pavarësisht nëse ushtruar ose jo ndikimi apo nëse është arritur ose jo qëllimi i caktuar”* (Criminal Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 12).

Në përputhje me nenin 37 paragrafin 3 të Konventës Penale kundër Korrupsionit, Republika Federale e Gjermanisë ka deponuar edhe një rezervë lidhur me dispozitat e kësaj konvente. Me këtë rast Republika Federale e Gjermanisë ka rezervuar të drejtën e saj për të refuzuar çdo formë të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar nëse kërkesa mund të ndërlidhet me cilëndo vepër penale të natyrës politike.

Rezerva e deponuar nga shteti gjerman në këtë rast ndërlidhet në kontekst të nenit 26 paragrafit 1 të konventës (ETS No. 173 - Treaty Office, 2022) ku përcaktohet si në vijim:

- *“Shtetet anëtare duhet të përkrahin njëra tjetrën në masën më të gjerë të bashkëpunimit mes tyre duke proceduar kërkesat nga autoritetet përkatëse në mënyrë efikase, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm, duke përfshirë edhe autorizimet për të hetuar dhe ndjekur penalisht veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë konventë”* (Criminal Law Convention on Corruption, 1999, p. art. 26 par. 1).

Veprat penale kundër korrupsionit në Republikën Federale të Gjermanisë janë të inkriminuara në Kodin Penal Gjerman (Deutsches Strafgesetzbuch), kryesisht përmes kapitullit XXX të pjesës së dytë (II) me titull *“Veprat penale kundër shtetit”* si dhe kapitullit 26 të pjesës së dytë me titull *“Veprat penale kundër konkurrencës”*.

Marrja e ryshfetit në sektorin publik (*Bestechlichkeit*) është inkriminuar përmes nenit 332 të Kodit Penal të Gjermanisë ku përcaktohet se:

- *“Personi zyrtar apo personi me autorizime të caktuara publike i cili me qëllim që të krijojë një përparësi për vete apo tjetrin si kompensim kërkon, pranon premtimin apo merr, në mënyrë që ai të kryej një veprim që e ka marrë përsipër apo që në të ardhmen do të merr përsipër, me ç’rast ai do të lëndojë apo do të kishte lënduar detyrën e tij zyrtare, do të dënohet me dënim me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vite. Në rastet më pak të rënda, dënimi është dënim me burgim deri në tre (3) vite apo me dënim në të holla. Tentativa është e dënueshme”* (Strafgesetzbuch, 1871, p. neni 332).

Dhënia e ryshfetit në sektorin publik (*Bestechung*) është inkriminuar përmes nenit 334 të Kodit Penal Gjerman ku përcaktohet se:

- *“Personi zyrtar apo personi me autorizime publike i cili me qëllim që të krijojë një përparësi për vete apo tjetrin si kompensim ofron, premtton apo jep, në mënyrë që ai të kryej një veprim që e ka marrë përsipër apo që në të ardhmen do të merr përsipër, me ç’rast do të lëndojë apo do të kishte lënduar detyrën e tij zyrtare, do të dënohet me dënim me burgim prej pesë (5) muaj deri në pesë (5) vite. Në rastet më pak të rënda, dënimi është dënim me*

burgim deri në dy (2) vite apo me dënim në të holla” (Strafgesetzbuch, 1871, p. neni 334 par. 1).

Termi „person zyrtar“ (amtsträger) përkufizohet përmes nenit 11 paragrafit 1 pikës 2 të Kodit Penal Gjerman, ku përcaktohet se sipas të drejtës gjermane me termin person zyrtar nënkuptojmë (Strafgesetzbuch, 1871, p. neni 11 par. 1.2):

- a)** *Zyrtarin apo gjyqtarin;*
- b)** *Personin i cili në ndonjë formë tjetër bart autorizime publike – gjyqësore;*
- c)** *Personin që në formë tjetër është autorizuar që në ndonjë autoritet apo vend tjetër apo si përfaqësues i tyre të kryej detyra të caktuara publike pa dëmtuar format e caktuara organizative të zgjedhura për të kryer këto detyra.*

Vlen të theksohet po ashtu se Kodi Penal Gjerman ka inkriminuar gjithashtu në mënyrë të veçantë marrjen e ryshfetit dhe dhënien e ryshfetit edhe nga personat që ushtrojnë pozita me mandat me afat të caktuar (Mandatsträgern). Në këtë grup të subjekteve përfshihen personat siç janë deputetët e Parlamentit Gjerman, deputet gjerman në parlamentin evropian si dhe personat në pozita tjera të ngjashme (Strafgesetzbuch, 1871, p. neni 108e).

Kodi Penal Gjerman ka inkriminuar edhe veprën penale “Marrja e ryshfetit në sektorin privat” (*Bestechlichkeit im geschäftlichen Verkehr*) ashtu që përmes nenit 299 paragrafit 1 është përcaktuar si në vijim (Strafgesetzbuch, 1871, p. neni 299 par. 1):

- *“Me dënim me burg deri në tre (3) vjet apo me dënim me gjobë do të dënohet kushdo që në një veprimtari biznesi në cilësinë e të punësuarit apo të kontraktuarit të një ndërmarrje:*
 - a)** *kërkon, pranon premtimin apo merr me qëllim të krijimit të një përparësie për vete apo tjetrin në formë kompensimi ashtu që ai përmes përvetësimit të mallrave apo shërbimeve një personi të tretë në një konkurrencë brenda apo jashtë shtetit i krijon një përparësi të palejuar, ose*
 - b)** *pa pëlqimin e ndërmarrjes, me qëllim të krijimit të një përparësie për vete apo tjetrin, në formë të një kompensimi kërkon, pranon premtimin apo merr, ashtu që ai përmes*

përvetësimi të mallrave apo shërbimeve, e ndërmerr një veprim apo një mosveprim të caktuar dhe në këtë mënyrë i lëndon detyrat e tij që i ka ndaj ndërmarrjes”.

Më tutje, përmes paragrafit 2 të nenit 299 të Kodit Penal Gjerman ka inkriminuar edhe veprën penale “Dhënia e ryshfetit në sektorin privat” (*Bestechung im geschäftlichen Verkehr*) ashtu që ka përcaktuar se (Strafgesetzbuch, 1871, p. neni 11 par. 2):


- *“Po ashtu do të dënohet, kushdo që në sektorin privat, një punonjësi apo një personi të kontraktuar në një kompani:*
 - a) ofron, premtan apo mundëson një përparësi për atë person apo një person të tretë, ashtu që gjatë ofrimit të mallrave apo shërbimeve brenda apo jashtë shtetit, në një konkurrencë të lirë do të ofrohet një përparësi për këtë person, ose*
 - b) pa autorizimin e kompanisë, për këtë person apo personin e tretë në këmbim ofron, premtan apo mundëson, që me rastin e ofrimit të mallrave apo shërbimeve, do të ndërmerr një veprim ose nuk do të ndërmerr atë veprim ashtu që do të lëndoje detyrat e tij si përfaqësues në atë kompani”.*

Nëse krahasojmë nenin 299 paragrafin 1 dhe nenin 332 të Kodit Penal Gjerman mund të konstatohet se marrja e ryshfetit në sektorin publik dhe marrja e ryshfetit në sektorin privat, janë mjaft të ngjashme për nga figurat ligjore. Megjithatë, marrja e ryshfetit në sektorin privat ka për objekt të mbrojtur konkurrencën e lirë të tregut si dhe besueshmërinë në veprimtari ekonomike. Ndërsa marrja e ryshfetit në publik për objekt mbrojtës e ka administratën publike. Dallimi tjetër konsiston në faktin se te marrja e ryshfetit në sektorin privat, kryes është personi i lidhur me shoqërinë e caktuar tregtare ndërsa te marrja e ryshfetit në sektorin publik është vetëm personi zyrtar sipas kontekstit të sqaruar më sipër.

Në aspektin fenomenologjik, vlen të thuhet se në vitin 2020 në Gjermani janë proceduar penalisht 2.171 të dyshuar për 5.510 vepra penale të korrupsionit (BKA, 2021, p. 2). Dëmi i përgjithshëm i shkaktuar nga korrupsioni vlerësohet të jetë rreth 81.2 milion euro (BKA, 2021, p. 2). Në këtë mënyrë, numri i veprave penale të korrupsionit në vitin 2020 krahasuar me vitin

paraprak është rritur për +1.5% përderisa vlera e dëmit të shkaktuar nga korrupsioni vlerësohet të jetë rritur për +72.3% (BKA, 2021, p. 2). Në anën tjetër, është evidentuar se numri i kryesve të dyshuar për korrupsion për periudhën përkatëse është zvogëluar për -14.5% (BKA, 2021, p. 2).

Fig. 16. Veprat penale dhe të dyshuarit për korrupsion në Gjermani gjatë viteve 2016-2020



Burimi: (BKA, 2021, p. 5).

Nëse analizohet trendi i korrupsionit në Gjermani gjatë periudhës 2016-2020, mund të vërehet se niveli i korrupsionit nuk ka qenë asnjëherë më i lartë në Gjermani sesa në vitin 2020 që nga viti 2016 (BKA, 2021, p. 5). Përndryshe viti 2018 ka evidentuar numrin më të vogël të rasteve të korrupsionit gjatë kësaj periudhe me vetëm 3804 raste të proceduara penalisht (BKA, 2021, p. 5).

Megjithatë trendi i njëjtë nuk shpërfaqet edhe në numrin e kryesve të dyshuar të korrupsionit. Kjo për arsye numri më i madh i kryesve të korrupsionit në Gjermani gjatë kësaj periudhe është evidentuar në vitin 2017 me 3681 kryes përderisa numri më i vogël është regjistruar në vitin 2019 me vetëm 1324 kryes (BKA, 2021, p. 5).


Diferenca në trendin e korrupsionit nga viti 2019 në vitin 2020 është manifestuar më së shumti në veprat penale të marrjes së ryshfetit nga neni 332 i Kodit Penal Gjerman si dhe veprës penale të dhënies së ryshfetit nga neni 334 i Kodit Penal Gjerman.

- Në vitin 2019 janë regjistruar 1107 vepra penale të marrjes së ryshfetit ndërsa në vitin 2020 janë regjistruar 1617 raste apo +31.53% më shumë vepra penale të marrjes së ryshfetit sesa në vitin paraprak (BKA, 2021, p. 6).
- Në vitin 2019 janë regjistruar 1116 vepra penale të dhënies së ryshfetit ndërsa në vitin 2020 janë regjistruar 1862 raste apo +40.06% më shumë vepra penale të dhënies së ryshfetit sesa në vitin paraprak (BKA, 2021, p. 6).
- Duhet theksuar po ashtu se në vitin 2019 janë regjistruar 1120 forma të rënda vepra penale të marrjes së ryshfetit dhe të dhënies së ryshfetit. Ndërsa në vitin 2020 janë regjistruar vetëm 139 raste të tilla apo -87.58% më pak forma të rënda vepra penale të marrjes së ryshfetit dhe të dhënies së ryshfetit sesa në vitin paraprak (BKA, 2021, p. 6).

Sa i përket veprave penale të marrjes së ryshfetit dhe dhënies së ryshfetit në sektorin privat sipas nenit 299 të Kodit Penal të Gjermanisë, mund të thuhet se është evidentuar një trend neutral nga viti 2019 në vitin 2020 (BKA, 2021, p. 6).

Në këtë drejtim, në vitin 2019 janë proceduar penalisht 729 raste të marrjes së ryshfetit në sektorin privat dhe të dhënies së ryshfetit në sektorin privat (BKA, 2021, p. 6). Prej tyre, 10 raste kanë pasur karakter ndërkombëtar dhe pasi që janë manifestuar jashtë Gjermanisë (BKA, 2021, p. 6). Ndërsa në vitin 2020 janë evidentuar 748 raste apo 2.54% më shumë raste të këtyre veprave penale prej të cilave vetëm 5 kanë pasur karakter ndërkombëtar (BKA, 2021, p. 6).

Fig. 17. Vlera e dëmeve nga korrupsioni në Gjermani gjatë viteve 2016-2020



Burimi: (BKA, 2021, p. 19).

Sa i përket dëmeve që janë shkaktuar nga korrupsioni gjatë periudhës 2016-2020, mund të thuhet se dëmi më i madh nga korrupsioni gjatë kësaj periudhe është shënuar në vitin 2017 kur është vlerësuar të jetë mbi 291 milionë euro (BKA, 2021, p. 19). Gjatë periudhës së njëjtë, dëmi

më i vogël nga korrupsioni konsiderohet të jetë shkaktuar në vitin 2019 kur është vlerësuar të jetë vetëm rreth 47 milionë euro (BKA, 2021, p. 19).

Mesatarja vjetore e dëmeve që janë shkaktuar nga korrupsioni gjatë viteve 2016-2020 vlerësohet të jetë rreth 133 milionë euro (BKA, 2021, p. 19). Përndryshe nga viti 2019 kur dëmet e korrupsionit janë vlerësuar me rreth 47 milionë euro dhe në vitin 2020 kur dëmet nga korrupsioni janë vlerësuar rreth 81 milion euro, trendi i dëmeve të korrupsionit për këtë periudhë është trend rritës dhe vlerësohet të jetë rreth +42% (BKA, 2021, p. 19).

2. Lufta kundër veprave penale të korrupsionit në Republikën e Austrisë

Republika e Austrisë ka nënshkruar Konventën Penale kundër Korrupsionit me 13 tetor 2000 (Council of Europe Treaty Office, Austria, 2022). Ratifikimin e Konventës Penale kundër Korrupsionit, shteti austriak e ka bërë më 25 shtator 2013 ndërsa konventa ka hyrë në fuqi me datë 1 janar 2014 (Council of Europe Treaty Office, Austria, 2022).

Përndryshe shteti austriak nuk ka deponuar ndonjë rezervim lidhur me dispozitat e Konventës Penale kundër Korrupsionit (Council of Europe Treaty Office, Austria, 2022). Rrjedhimisht mund të konstatohet se për dallim nga rasti i Republikës Federale të Gjermanisë, dispozitat e Konventës Penale kundër Korrupsionit janë në tërësi të zbatueshme në Republikën e Austrisë pa ndonjë kufizim që nga data 1 janar 2014 (Council of Europe Treaty Office, Austria, 2022).

Veprat penale të korrupsionit janë të inkriminuara në Kodin Penal të Austrisë apo *Österreichisches Strafgesetzbuch*, kryesisht përmes kapitullit XXII me titull “*Veprat penale kundër detyrës zyrtare, korrupsionit dhe veprime tjera të ngjashme*” (Strafgesetzbuch, 1974).

Vepra penale “Marrja e ryshfetit” (*Bestechlichkeit*) është inkriminuar përmes nenit 304 të Kodit Penal Austriak (Strafgesetzbuch, 1974, p. neni 304 par. 1). Figura ligjore e përcaktuar në Kodin Penal Austriak sipas të cilës mund të kryhet kjo vepër penale konsiston si në vijim (Strafgesetzbuch, 1974, p. neni 304):

- *“Personi zyrtar apo referi, i cili përmes një veprimi apo mosveprimi të paligjshëm në kuadër të detyrës zyrtare, kërkon apo pranon apo lejon që t’i premtohet ndonjë përparësi për vete apo personin e tretë, do të dënohet me dënim me burgim deri në tre (3) vjet (Strafgesetzbuch, 1974, p. neni 304 par. 1).*

Po ashtu do të dënohet, përfaqësuesi i ndonjë gjykate apo ndonjë autoriteti tjetër zyrtar, i cili në procesin përkatës me qëllim të përfitimit të paligjshëm, kërkon, pranon apo lejon që t’i premtohet një përparësi për vete apo tjetrin” (Strafgesetzbuch, 1974, p. neni 304 par. 2).

Vepra penale “Dhënia e ryshfetit” (*Bestechung*) është inkriminuar përmes nenit 307 të Kodit Penal Austriak (Strafgesetzbuch, 1974, p. neni 307 par. 1). Figura ligjore e përcaktuar në Kodin Penal Austriak sipas të cilës mund të kryhet kjo vepër penale konsiston si në vijim:

- *“Personi zyrtar apo referi, i cili përmes një veprimi apo mosveprimi të paligjshëm në kuadër të detyrës zyrtare, ofron, pranon apo mundëson që t’i premtohet ndonjë përparësi për vete apo personin e tretë, do të dënohet me dënim me burgim deri në tre (3) vjet” (Strafgesetzbuch, 1974, p. neni 307 par. 1).*

Sa i përket termit „person zyrtar“ të cilit i referohen dispozitat më sipër, përkufizimi përkatës mund të evidentohet përmes nenit 74 paragrafit 1 pikës 4a të Kodit Penal Austriak ku përcaktohet se me termin person zyrtar nënkuptohet (Strafgesetzbuch, 1974, p. art. 74 par. 1.4a):

- *“Kushdo që për federatën (“Bund-in”), njësinë federative (“Land-in”) apo njësinë tjetër administrative (“Gemeindeverband-in”), në emër të së drejtës publike, me përjashtim të Kishës apo komunitetit tjetër religjioz, apo në emër të shtetit apo organizatës ndërkombëtare, kryen detyra ligj zbatuese, administrative apo gjyqësore”.*

Ndërsa termi “refer” apo *Schiedsrichter* të cilit i referohet po ashtu dispozita më sipër, përkufizimi përkatës mund të evidentohet përmes nenit 74 paragrafit 1 pikës 4c të Kodit Penal

Austriak ku përcaktohet “Çdo vendimmarrës në kuadër të një gjykate referuese në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës Austriake” (Strafgesetzbuch, 1974, p. art. 74 par. 1.4c).

Ngjashëm sikurse në Kodin Penal të Gjermanisë, korrupsioni në sektorin privat është inkriminuar edhe në Kodin Penal Austriak. Rrjedhimisht marrja e ryshfetit në sektorin privat respektivisht *Geschenkannahme von Bediensteten oder Beauftragten* është inkriminuar përmes nenit 309 paragrafit 1 të Kodit Penal të Austrisë si në vijim:

- “Personi i autorizuar apo i kontraktuar nga një ndërmarrje, i cili në marrëdhëniet e biznesit kërkon, pranon apo pranon premtimin për shkak të një privilegji apo përparësie për vete apo tjetrin në mënyrë që të kryen një veprim apo një mosveprim të caktuar, dënohet me dënim me burgim deri në dy (2) vite” (Strafgesetzbuch, 1974, p. neni 309 par. 1).

Dhënia e ryshfetit në sektorin privat respektivisht *Bestechung von Bediensteten oder Beauftragten* është inkriminuar përmes nenit 309 paragrafit 2 të Kodit Penal të Austrisë ku është përcaktuar se (Strafgesetzbuch, 1974, p. neni 309 par. 2):

- “Po ashtu do të dënohet, personi i autorizuar apo i kontraktuar nga një ndërmarrje, i cili në marrëdhëniet e biznesit ofron, premtion apo lejon, për shkak të një privilegji apo përparësie për vete apo tjetrin në mënyrë që të kryen një veprim apo një mosveprim, dënohet me dënim me burgim deri në dy (2) vite”.

Tab. 12. Veprat penale të korrupsionit në Austri gjatë vitit 2020

Vepra penale	Neni	Numri
Keqpërdorimi i detyrës zyrtare	302	617
Marrja e ryshfetit	304	9
Pranimi i avantazhit	305	6
Pranimi i avantazhit për të ushtruar ndikim	306	6

Dhënia e ryshfetit	307	7
Ofrimi i avantazhit për të ushtruar ndikim	307b	1
Marrja e ryshfetit dhe dhënia e ryshfetit në sektorin privat	309	2
Zbulimi i fshehtësisë zyrtare	310	48
Veprat penale tjera të korrupsionit	•	19
Gjithsej	•	715

Burimi: (Inneres Bundesministerium, 2021, p. 47).

Në vitin 2020 janë proceduar penalisht 715 vepra penale të korrupsionit, ku dominon “Keqpërdorimi i detyrës zyrtare” nga neni 302 i Kodit Penal të Austrisë me 617 raste apo 86.29% (Inneres Bundesministerium, 2021, p. 47). Për veprën penale “Zbulimi i fshehtësisë zyrtare” nga neni 310 të Kodit Penal të Austrisë janë regjistruar 48 raste apo 6.71% (Inneres Bundesministerium, 2021, p. 47). Për “Marrje të ryshfetit” nga neni 304 janë evidentuar 9 raste apo 1.25% ndërsa për “Dhënien e ryshfetit” nga neni 307 janë regjistruar vetëm 7 raste apo 0.97% (Inneres Bundesministerium, 2021, p. 47).


Tab. 13. Veprat penale të korrupsionit në Austri gjatë vitit 2019

Vepra penale	Neni	Numri
Keqpërdorimi i detyrës zyrtare	302	637
Marrja e ryshfetit	304	9
Pranimi i avantazhit	305	3
Pranimi i avantazhit për të ushtruar ndikim	306	3
Dhënia e ryshfetit	307	9

Ofrimi i avantazhit	307a	1
Marrja e ryshfetit dhe dhënia e ryshfetit në sektorin privat	309	2
Zbulimi i fshehtësisë zyrtare	310	48
Veprat penale tjera të korrupsionit	•	24
Gjithsej	•	736

Burimi: (Inneres Bundesministerium, 2020, p. 50).

Fig. 18. Trendi i korrupsionit në Austri gjatë viteve 2018-2020



Burimet: (Inneres Bundesministerium, 2021, p. 47) (Inneres Bundesministerium, 2020, p. 50)
(Inneres Bundesministerium, 2019, p. 72).

Vlen të theksohet se në periudhën tri (3) vjeçare gjatë viteve 2018-2020, trendi i korrupsionit në Republikën e Austrisë është trend rritës. Konkretisht, nga viti 2018 në vitin 2019, trendi i korrupsionit në Austri vlerësohet rreth +7.55%. Ndërsa nga viti 2019 në 2020, trendi i

korupsionit në Austri vlerësohet rreth +2.85%. Mesatarja e trendit të rritjes së korupsionit në këtë periudhë vlerësohet të jetë rreth +5.2%. Një konstatim i ngjashëm raportohet edhe nga Grupi i Shteteve kundër Korupsionit (GRECO), përmes raportit të tyre mbi korupsionin për vitin 2020. Në këtë drejtim, raporti nga Grupi i Shteteve kundër Korupsionit kishte konstatuar se Austria kishte dështuar që të zbatonte në 70% kërkesat që dalin nga GRECO me qëllim të luftës kundër korupsionit (GRECO, 2021, p. 26). Rreth 25% të kërkesave konsiderohet se janë zbatuar pjesërisht nga Austria ndërsa vetëm 5% janë zbatuar plotësisht nga Republika Austriake (GRECO, 2021, p. 26). Përndryshe sipas këtij raporti, në luftën kundër korupsionit në vitin 2020 prijnë Finlanda dhe Norvegjia (GRECO, 2021, pp. 27, 30). Ndërsa në shkallën më të ulët të luftës kundër korupsionit në vitin 2020, sipas raportit të GRECO, përveç Austrisë ndodhen po ashtu Andorra, Çekia, Hungaria, Irlanda dhe Turqia (GRECO, 2021, pp. 26, 27, 28, 31).

3. Mbrojtja juridike civile e viktimave të korupsionit në Republikën e Francës

Kompensimi është institut i së drejtës civile. Në anën tjetër korupsioni dhe viktimat e korupsionit janë lëndë të së drejtës penale. Në këtë drejtim mund të shpërfaqet dilema lidhur me statusin juridik të kompensimit për viktimat e korupsionit. Për të adresuar këtë situatë mjaft komplekse në përputhje me përcaktimet e Konventës Civile kundër Korupsionit, janë konsoliduar sisteme të ndryshme ligjore përmes të cilave janë adresuar zgjidhje të ndryshme ligjore.

E drejta civile franceze nuk trajton në vetvete kompensimin për viktimat e korupsionit si të tillë. Megjithatë mjeti juridik civil që mund të përdoret për kompensimin e viktimave të korupsionit do të varet nga vendimi i marrë sipas ligjit penal. Në bazë të nenit 2 të Kodit të Procedurës Penale në Francë (Code de Procédure Pénale) “viktima mund të marrë kompensim civil nga një gjykatë penale nëse plotësohet disa kushte të caktuara” (Criminal Procedure Code of the French Republic, 2006, p. art. 2).

Ky rregullim në këtë mënyrë njihet si “*action publique*” apo “veprimi publik” i cili nënkupton se veprimi civil i subordinohet vendimit penal. Me fjalë të tjera, vendimi penal trajtohet si çështje paraprake pasi që vetëm në rastet kur nevoja për kompensim konfirmohet nga gjykata penale,

mund të kërkohet dhe të realizohet kompensimi civil nga gjykata civile (Jaluzot & Michaela, 2017, pp. 227-228). Kuptohet se pretendimet për kompensimin civil duhet të argumentohen nga parashtruesi me prova të ligjshme në atë mënyrë që dëmi i pësuar nga korrupsioni është “personal dhe i drejtpërdrejtë” (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 233).

Shteti Francez e ka ratifikuar Konventën Civile kundër Korrupsionit në vitin 2008. Prandaj, mund të konstatohet se korniza juridike në Francë për kompensimin e viktimave të korrupsionit përmes mjeteve juridike efektive, parimisht janë në përputhje me dispozitat përkatëse në Konventën Civile kundër Korrupsionit.

Megjithatë, në shtetin Francez aktualisht janë konstatuar së paku tri (3) sfida juridike me rëndësi për të cilat ekzistojnë debate në mes të profesionistëve francez, lidhur me mbrojtjen juridike civile të viktimave të korrupsionit.

Debati i parë respektivisht sfida e parë për të cilën debatohet në Francë lidhur me mbrojtjen juridike civile të viktimave të korrupsionit, ka të bëjë me faktin nëse një person i cili është përfshirë si kryes i dyshuar në një vepër penale të korrupsionit, a ka të drejtë i njëjti që edhe në cilësinë e viktimës në të njëjtin rast të korrupsionit, përmes padisë civile të kërkojë dhe të realizoj shpërblimin e dëmit të pretenduar nga korrupsioni (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 234).

Në një rast të trajtuar në vitin 1978, të dyja palët ishin përfshirë në korrupsion aktiv respektivisht pasiv. Më vonë mes palëve kishte lindur një mosmarrëveshje mes tyre. Njëra nga palët e cila dyshohej për korrupsion aktiv, fillimisht kishte parashtruar padi për pagesën e komisioneve të dakorduara dhe më pas kërkoi kompensimin për humbjet e tij. Gjykata Civile Franceze e kishte hedhur poshtë kërkesëpadinë në fjalë duke arsyetuar se për të realizuar kompensimin civil duhet të provohej se ka ekzistuar një humbje personale dhe e drejtpërdrejtë (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 234).

Lidhur me këtë rast, në vitin 1992 gjykata penale franceze kishte konstatuar që dëmi nga korrupsioni parimisht duhet t’i vishet interesit të përgjithshëm shoqëror. Megjithatë korrupsioni pasiv në rastin konkret i ka shërbyer edhe interesit të personave privat të cilët për këtë arsye njëkohësisht u janë ekspozuar edhe rrezikut për dëmtim personal dhe të

drejtpërdrejtë pasi që kanë qenë të detyruar që të ofrojnë dhurata apo shpërblime tjera (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 234). Në këtë mënyrë Gjykata Penale Franceze ka lënë të nënkuptohet se një person i përfshirë në korrupsion pasiv përkundër faktit që ka kryer veprime të dënueshme penalisht, përtej përgjegjësisë së tij penale ai ka të drejtën që të parashtroj edhe padi civile për shpërblimin e dëmit që ka mundur të pësoj nga afëra korruptive në të cilën është përfshirë.

Sidoqoftë, Gjykata Penale Franceze nuk arriti që të sqaroj plotësisht pozicionin e saj lidhur me të drejtën e kompensimit të dëmit nga korrupsioni përmes rrugëve juridike civile nga personat që kanë qenë edhe subjekte aktive të veprës penale përkatëse të korrupsionit. Rrjedhimisht ky debat lidhur me këtë çështje vazhdon ende pasi që ka mbetur e paqartë se kush ka të drejtë të kërkojë kompensim për dëmin nga korrupsioni në rastet e këtilla në Republikën Franceze (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 234).

Debati i dytë respektivisht sfida e dytë për të cilën debatohet në Francë lidhur me mbrojtjen juridike civile të viktimave të korrupsionit, ka të bëjë me përgjegjësinë civile për tjetrin siç është rasti me përgjegjësinë e punëdhënësit për punëmarrësin (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235).

Në vitin 2003 Republikën Franceze në një bankë komerciale, njëri nga punonjësit e bankës ishte përfshirë në korrupsion ashtu që kishte pranuar ryshfet në mënyrë që i njëjti të realizoj dy pagesa përmes dy kambialeve për një subjekt ekonomik i cili ishte në procedurë të falimentimit dhe nuk kishte të drejtë të realizonte këto pagesa pasi që asetet e këtij subjekti ekonomik është dashur të jenë të ngrira në këtë bankë (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235). Për këto arsye, administratori i subjektit ekonomik në këtë procedurë të falimentimit kishte parashtuar padi përmes të cilës e kishte paditur bankën kur ka punuar personi i përfshirë në marrje të ryshfetit (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235).

Përmes padisë, administratori kishte kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga banka duke u thirrur në përgjegjësinë civile për tjetrin respektivisht përgjegjësinë e punëdhënësit që në këtë rast është banka për veprimet e punonjësit që në këtë rast është personi që ka pranuar ryshfet dhe ka kryer veprën penale të korrupsionit (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235).

Cour d'appel respektivisht Gjykata e Apelit në Republikën Franceze me rastin e gjykimit të këtij rasti kishte konstatuar se personi që ka pranuar ryshfetin duke qenë edhe punonjës në bankë ka kryer veprën penale me dashje të drejtpërdrejtë duke qenë në dijeni të plotë për paligjshmërinë e veprimit të tij (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235). Rrjedhimisht ai përkundër se ka shfrytëzuar pozitën e tij si punonjës në bankë, veprën penale e ka kryer pa autorizim nga banka si punëdhënës dhe për këtë arsye duhet të konsiderohet që veprimet e tij kanë qenë jashtë punës dhe detyrave të tij ligjore si punonjës në bankë (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235).

Në këtë kontekst përgjegjësia e plotë penale i takon punonjësit të bankës si kryes të korrupsionit por jo edhe bankës si punëdhënës të tij (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235). Prandaj kryesit të veprës penale përtej përgjegjësisë penale i takon edhe përgjegjësia për dëmet civile që janë shkaktuar nga vepra penale e korrupsionit që ka kryer punonjësi i bankës (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235).

Gjykata Franceze në këtë rast ka konstatuar se nga banka nuk mund të kërkohet as përgjegjësi penale për korrupsion dhe as përgjegjësi civile për dëmet e korrupsionit (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235).

Ky vendim i Gjykatës Franceze të Apelit ishte goditur përmes mjeteve juridike edhe në *Cour de Cassation* respektivisht Gjykatën e Kasacionit të Francës (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235). Me këtë rast Gjykata Franceze e Kasacionit vetëm e kishte konfirmuar gjykimin nga Gjykata e Apelit lidhur me këtë rast (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235).

Debati i tretë respektivisht sfida e tretë për të cilën debatohet në Francë lidhur me mbrojtjen juridike civile të viktimave të korrupsionit, ka të bëjë me llojet dhe natyrën e lëndimeve që mund të kualifikohen si dëme nga korrupsioni (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235).

Në vitin 2007 qyteti i Kanës në Francë kishte parashtruar padi kundër kryetarit të Komunës së Kanës për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale e korrupsionit për të cilën ishte dënuar me vendim të prerë Kryetari i Kanës nga gjykata penale në Francë (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235).

Rrethanat faktike me rëndësi të kësaj afere të korrupsionit janë si në vijim (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235):

- Kryetari i Komunës së Kanës në Republikën Franceze kishte miratuar dhënien e një licence për një kompani private (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235);
- Licenca i ka mundësuar kompanisë që të zhvilloj aktivitete të lojërave të fatit në Komunën e Kanës në Francë (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235);
- Procedura për dhënien e licencës nuk ishte në përputhje me normat juridike në fuqi (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235);
- Kryetari i Komunës së Kanës për të kryer këto veprime kishte pranuar ryshfet nga kompania private e cila kishte përfituar licencën në fjalë (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235);
- Ministri i Punëve të Brendshme në Francë përmes autorizimeve të tij ligjore, kishte anuluar licencën për kompaninë në fjalë duke i revokuar asaj autorizimet për aktivitetet e lojërave të fatit si dhe duke refuzuar të kërkesën e tyre për autorizimin e veprimeve në shërbim të publikut (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235);
- Si rezultat i procedurave ligjore në Ministrinë e Punëve të Brendshme për revokimin e licencës së kompanisë në fjalë, për shkak të aferës korruptive të Kryetarit të Kanës, qyteti i Kanës nuk kishte arritur që të përfitoj nga taksat komunale që do të duhej të paguheshin nga kompania private nëse Ministri i Punëve të Brendshme do të konfirmonte licencën e saj për veprimtarinë e lojërave të fatit (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235).
- Si shembull, disa nga taksat komunale që kanë dështuar të mblidhen nga Komuna e Kanës do të kishin për të qenë taksa vjetore për mbështetjen e aktiviteteve artistike, pastaj taksa me vlefshmëri dyvjeçare për të drejtën në realizimin e veprimtarisë së lojërave të fatit në Komunën e Kanës, si dhe disa taksa të tjera komunale (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235).

Duke marrë parasysh rrethanat faktike të rastit më sipër, Komuna e Kanës duke vepruar si person juridik në cilësi të palës së dëmtuar nga korrupsioni kishte parashtruar padi për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga korrupsioni, kundër palës së paditur Kryetarit të Komunës

së Kanës në cilësi të kryesit të veprës penale të marrjes së ryshfetit (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235).

Me rastin e shqyrtimit të këtij rasti, gjyqtarët kompetent në Gjykatën Civile Franceze kanë konstatuar që dëmi i pretenduar nga korrupsioni në këtë rast nuk paraqet dëm të drejtpërdrejtë nga korrupsioni që ka kryer Kryetari i Kanës mirëpo përbën pasojë të shkaktuar nga vendimi i Ministrit i Punëve të Brendshme për të refuzuar licencën e kompanisë së lojërave të fatit (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235).

Gjykata Franceze në këtë çështje ka konstatuar se dëmi i pretenduar nga pala paditëse në këtë rast nuk mund të kualifikohet si dëm i shkaktuar nga vepra penale e korrupsionit dhe aq më pak si dëm i drejtpërdrejtë nga korrupsioni sikurse është pretenduar nga pala paditëse (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235).

Në anën tjetër gjykata e ka njohur humbjen e reputacionit të shkaktuar në këtë rast si dëm të cilin e ka pësuar pala paditëse. Kontestuese për gjykatën ka qenë vetëm natyra juridike e humbjes dhe kualifikimi i dëmit si të tillë (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235).

Ky konstatim i gjykatës përbën një fakt shumë të rëndësishëm pasi që pala paditëse si palë që ka pësuar dëmin përkatës për shkak të humbjes së reputacionit nga Kryetari i Kanës (pala e paditur) në fakt është vet Komuna e Kanës (pala paditëse) e cila si palë në procedurën kontestimore ka vepruar në cilësi të personit juridik.

Tutja Gjykata Franceze në këtë çështje civile juridike ka konstatuar se dëmi i pretenduar nga pala paditëse ka konsistuar në humbjen e reputacionit të Komunës së Kanës në të gjithë botën, në kontekstin e rolit të këtij qyteti si nikoqir i festivalit prestigjioz të filmit në Kanë të njohur botërisht (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235). Si i tillë, ky dëm ishte kuantifikuar nga gjykata në vlerën 100.000 Euro ndërsa kryetari i Komunës ishte ngarkuar me dëmin jo për shkak të marrjes së ryshfetit por për shkak të shkeljes së procedurave ligjore që kanë pasur si pasojë refuzimin e licencës nga Ministri i Punëve të Brendshme (Jaluzot & Michaela, 2017, p. 235).

Ballafaqimi efikas dhe efektiv me korrupsionin mund të realizohet vetëm përmes respektimit kumulativ të standardeve ndërkombëtare kundër korrupsionit, duke pasur në qendër të vëmendjes instrumentet juridike të Këshillit të Evropës lidhur me këtë fushë.

Sa i përket Konventës Civile kundër Korrupsionit, për të siguruar mjete efektive juridike për viktimat e korrupsionit duke përfshirë edhe mundësinë për kompensimin e dëmeve të korrupsionit, është e domosdoshme që Republika e Kosovës, në përputhje me Konventën Civile të Korrupsionit, të përcaktoj me ligj se kush ka të drejtë të parashtroj këtë lloj të padisë për kompensim, pastaj në cilat raste ekziston përgjegjësia civile për tjetrin të rastet e korrupsionit si dhe kriteret për natyrën e lëndimeve që mund të kualifikohen si dëme nga korrupsioni. Përvojat e shtetit Francës lidhur me këto tema duhet të shërbejnë për shtetin e Kosovës me rastin e adresimit të këtyre çështjeve. Pikërisht mbi këtë argument konsiston edhe rëndësia e studimit krahasues në këtë kapitull me shtetin Francez lidhur me Konventën Civile kundër Korrupsionit.

4. Mbrojtja juridike civile e viktimave të korrupsionit në Mbretërinë e Bashkuar

Britania e Madhe e ka nënshkruar Konventën Civile kundër Korrupsionit më 8 qershor 2000, por ende nuk e ka ratifikuar atë. Përndryshe Britania e Madhe është një nga shtetet anëtare edhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit që nga viti 2006.

Britania e Madhe ka marrë një rol proaktiv në promovimin ndërkombëtar të çështjes së kompensimit të viktimave e korrupsionit përmes mjeteve efektive juridike, në përputhje me përcaktimet e Konventës Civile kundër Korrupsionit dhe Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit. Ky rol proaktiv konsiston në faktin se përtej promovimit të mbrojtjes së viktimave të korrupsionit përmes mjeteve efektive juridike duke përfshirë edhe të drejtën për kompensimin e dëmit prej korrupsionit, Britania e Madhe ka konsoliduar një kornizë juridike përmes të cilës ka mundësuar edhe mbrojtjen e viktimave të korrupsionit me element të huaj ndërkombëtar. Elementi i huaj në këtë kontekst nënkupton situatat kur korrupsioni manifestohet në së paku dy (2) shtete, njëra prej të cilave është Britania e Madhe (Serious Fraud Office, United Kingdom, 2018).

Zyra kundër Krimeve të Rënda (*Serious Fraud Office*) në Britaninë e Madhe së bashku me Shërbimin Prokurorial Mbretëror (*Crown Prosecution Service*) si dhe Agjencia Kombëtare kundër Krimit (*National Crime Agency*), me datë 1 qershor 2018 kanë hartuar dhe publikuar ***“Parimet e përgjithshme për kompensimin e viktimave jashtë shtetit duke përfshirë edhe shtetet e dëmtuara për shkak të ryshfetit, korrupsionit dhe veprave penale ekonomike”*** (Serious Fraud Office, United Kingdom, 2018).

Përmes këtyre parimeve të përgjithshme, agjencitë kompetente në Britaninë e Madhe kanë arritur të krijojnë një kornizë të përbashkët juridike për të identifikuar rastet kur kompensimi është i nevojshëm dhe i përshtatshëm (Serious Fraud Office, United Kingdom, 2018). Njëkohësisht kanë përcaktuar edhe modalitetet përmes të cilave arrihet që të veprohet në mënyrë efikase dhe efektive në ato raste kur duhet të kompensohen shtetet, kompanitë ose njerëzit e prekur apo viktimat tjera të korrupsionit me element të huaj respektivisht që manifestohet jashtë kufijve të Britanisë së Madhe (Serious Fraud Office, United Kingdom, 2018).

Përmes parimeve të përgjithshme për kompensimin e viktimave jashtë shtetit duke përfshirë edhe shtetet e dëmtuara për shkak të ryshfetit, korrupsionit dhe veprave penale ekonomike, agjencitë kompetente në Britaninë e Madhe (*Serious Fraud Office, Crown Prosecution Service and National Crime Agency*) kanë udhëzuar që të ndërmerren masat dhe veprimet si në vijim (Serious Fraud Office, United Kingdom, 2018):

1. *Të merret në konsideratë e drejta për kompensim të viktimave në të gjitha situatat përkatëse të korrupsionit* (Serious Fraud Office, United Kingdom, 2018);
2. *Përdorimi i të gjitha mjeteve ligjore për të arritur kompensimin e viktimave në të gjitha situatat përkatëse të korrupsionit* (Serious Fraud Office, United Kingdom, 2018);
3. *Bashkëpunimi ndërqeveritar me shtetet tjera për identifikimin e viktimave, vlerësimin e rasteve përkatëse dhe marrjen e provave të nevojshme për kompensim të dëmit nga*

korupsioni si dhe identifikimin e mjeteve efektive dhe të përshtatshme përmes të cilave mund të realizohet kompensimi në mënyrë transparente, të përgjegjshme, të drejtë dhe llogaridhënëse ashtu që edhe të evitohet rreziku nga korupsioni në të ardhmen (Serious Fraud Office, United Kingdom, 2018);

4. *Angazhimi dhe bashkëpunimi në mënyrë pro aktive me agjencitë kompetente për zbatimin e ligjit në shtetet e ndikuara nga aferat përkatëse të korupsionit sa herë që kjo është e mundur (Serious Fraud Office, United Kingdom, 2018);*

5. *Publikimi i të gjitha informacioneve të nevojshme për publikun lidhur me rastet që kanë përfunduar (Serious Fraud Office, United Kingdom, 2018).*

Në Britaninë e Madhe janë në fuqi dy (2) akte juridike të rëndësishme të cilat janë në përputhje me përcaktimet e Konventës Civile kundër Korupsionit dhe Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korupsionit lidhur me mbrojtjen juridike civile të viktimave të korupsionit përmes mjeteve efektive juridike duke përfshirë edhe mundësinë e kompensimit të tyre për dëmin që e kanë pësuar nga veprat penale të korupsionit.

Këto akte ligjore janë miratuar në vitin 2000 respektivisht në vitin 2002 dhe janë ende në fuqi në Britaninë e Madhe:

1. Akti për konfiskimin e të ardhurave nga krimi i vitit 2002, i cili njihet si *“The Proceeds of Crime Act 2002 for confiscation”* (UK Public General Acts c. 29, 2002); dhe

2. Akti për përcaktimin e kompetencave të Gjykatave Penale për shqiptimin kompensimit lidhur me dënimet penale e vitit 2000, i cili njihet si *“The Powers of Criminal Courts (Sentencing) Act 2000 for compensation”* (UK Public General Acts c.6 Part VI, 2000).

Parimet e përgjithshme për kompensimin e viktimave të korupsionit përcaktojnë se agjencitë kompetente në Britaninë e Madhe duhet që të bashkëpunojnë ngushtë me dikasteret përkatëse të qeverisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në Departamentin për Zhvillim

Ndërkombëtar, Zyrën e Commonwealth për punë të jashtme, Ministrinë e Brendshme dhe Thesarin Mbretëror (Latham & Watkins Llp, 2018). Duke shfrytëzuar këto parime, ky bashkëpunim ndërinstytucional ka për synim për të identifikuar viktimat e mundshme të korrupsionit jashtë shtetit, për të vlerësuar rastet përkatëse nëse kompensimi i viktimave të korrupsionit është i përshtatshëm dhe nëse po konstatohet që kompensimi është i përshtatshëm dhe i domosdoshëm, atëherë për të krijuar edhe planin për realizimin e kompensimit në mënyrë transparente (Latham & Watkins Llp, 2018).

Vetëm gjatë viteve 2014-2018 agjencitë kompetente në Britaninë e Madhe respektivisht Zyra kundër Krimeve të Rënda (*Serious Fraud Office*), Shërbimi Prokurorial Mbretëror (*Crown Prosecution Service*) si dhe Agjencia Kombëtare kundër Krimit (*National Crime Agency*), kanë arritur që përmes trajtimit të rasteve përkatëse të kompensojnë gjithsej **49.2£ milion funta** për viktimat e korrupsionit jashtë shtetit (Serious Fraud Office, United Kingdom, 2018):

- **349,000£ funte** janë paguar nga Britania e Madhe për Qeverinë e Kenias pas përfundimit të ndjekjes penale nga Zyra kundër Krimeve të Rënda (*Serious Fraud Office*) kundër drejtuesve të lartë në kompaninë e shtypshkronjës “Smith & Ouzman” për shkak të veprave penale të korrupsionit transnacional.

Kompania “Smith & Ouzman” është një kompani e specializuar në printimin e dokumenteve të sigurisë. Atyre u janë paguar fonde lidhur me njëmbëdhjetë (11) autoambulanca të reja për të ofruar shërbime mjekësore për spitalet e ndryshme në të gjithë vendin.

Më 22 dhjetor 2014, zyrtarët menaxhues në “Smith & Ouzman” respektivisht drejtori ekzekutiv z. Christopher Smith dhe menaxheri i shitjeve dhe marketingut z. Nicholas Smith, janë arrestuar dhe më pas janë dënuar në Southwark Crown Court. Kjo për shkak se ishin vërtetuar akuzat kundër tyre për korrupsion në formë të pagesave të realizuara në vlerë të përgjithshme rreth gjysmë milion paund (Serious Fraud Office, Smith and Ouzman Ltd, 2018). Këto pagesa korruptive janë përdorur për të ndikuar në dhënien e

kontratave për kompaninë “Smith & Ouzman” në Kenia dhe Mauritania (Serious Fraud Office, Smith and Ouzman Ltd, 2018).

- **4.9£ milion funte** në vlerë të 7\$ milion dollarëve amerikan janë paguar në formë të kompensimit për Qeverinë e Tanzanisë nga Standard Bank. Kjo për arsye se Standard Bank tani e njohur si ICBC Standard Bank PLC ka dështuar për të parandaluar korrupsionin me ç ‘rast është shkelur seksioni i shtatë (VII) i Aktit të rryshfetit në Britaninë e Madhe i vitit 2010 (Serious Fraud Office, Standard Bank PLC, 2019).
- **28.7£ milion funte** në formë të aseteve të ndryshme janë rikuperuar nga Shërbimi Prokurorial Mbretëror (*Crown Prosecution Service*). Kjo ka ndodhur për shkak të dënimit për vepra penale të korrupsionit të z. Ao Man Long, ish-sekretar i Transportit dhe Punëve Publike në Zyrën Speciale Rajonale Administrative të Makaos (Serious Fraud Office, Standard Bank PLC, 2019).

Asetet e poseduara nga z. Ao Man Long me bazë në Britaninë e Madhe kanë pasur vlerën e përgjithshme prej njëqind (100) milion dollarëve amerikan të fshehura në kompani offshore dhe të shpërndara në më shumë se njëqind (100) llogari të ndryshme bankare (Serious Fraud Office, Standard Bank PLC, 2019).

Shërbimi Prokurorial Mbretëror (*Crown Prosecution Service*) ka mundur që pikërisht nga këto asete të cilat janë konfiskuar të tutje të realizohen me sukses kompensimet proporcionale për autoritetet përkatëse të rajonit në emër të dëmeve të pësura nga veprat e korrupsionit të z. Ao Man Long (Serious Fraud Office, Standard Bank PLC, 2019).

- **4.4£ milion funte** janë konfiskuar dhe rikuperuar nga kompania “Griffiths Energy” pas ndjekjes penale nga Zyra kundër Krimeve të Rënda (*Serious Fraud Office*) për shkak të marrëveshjeve korruptive të ndërlidhura me naftën në Çad (Serious Fraud Office, ‘Chad Oil’ share deal, 2018). Afera korruptive nga Griffiths Energy është manifestuar ashtu që janë nënshkruar kontrata korruptive, përmes të cilave janë korruptuar diplomatët e Çadit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kanada me qëllim që përmes këtyre

marrëveshjeve është siguruar zbritja e aksioneve dhe të ashtuquajturat 'tarifa të konsulencës' (Serious Fraud Office, 'Chad Oil' share deal, 2018). Realizimi i këtyre kontratave korruptive është bërë duke përdorur një kompani fiktive 'Chad Oil' e cila u krijua vetëm pesë ditë përpara nënshkrimit të marrëveshjeve (Serious Fraud Office, 'Chad Oil' share deal, 2018). Përndryshe "Chad Oil" ishte edhe një mjet i përdorur nga diplomatë të lartë në Ambasadën Çadiane në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të mundësuar ashtu që bashkëshortja e ish-zëvendës shefit të zyrës diplomatike Znj. Ikram Saleh të blej rreth 800,000 aksione për më pak se 0.001\$ dollar të cilat më vonë janë shitur për një fitim shumë më të lartë (Serious Fraud Office, 'Chad Oil' share deal, 2018).

- **10.9£ milion funte** janë paguar në formë të kompensimit për viktimat e korrupsionit në një rast tjetër të Zyrës kundër Krimeve të Rënda (*Serious Fraud Office*), që aktualisht nuk është publikuar për arsye ligjore (Serious Fraud Office, 'Chad Oil' share deal, 2018).

Kompensimi për viktimat e korrupsionit as në Britaninë e Madhe nuk është gjithmonë i mundur edhe atëherë kur është i nevojshëm dhe kur shteti ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në fuqi për të realizuar atë (Stephenson, 2018). Prandaj në disa raste publike të korrupsionit në Britaninë e Madhe nuk është arritur të sigurohet kompensimi i nevojshëm (Stephenson, 2018). Një nga këto raste ka përfshirë edhe kompaninë e njohur të veturave "Rolls Royce" (Stephenson, 2018).

Mendohet se ekzistojnë dy (2) arsye kryesore të cilat mund të pamundësojnë realizimin me sukses të kompensimit të viktimave në raste të tilla të korrupsionit (Stephenson, 2018).

- **Së pari**, rastet janë "shumë komplekse" pasi që aty janë përfshirë marrjet dhe dhëniet e ryshfetit në dy ose më shumë juridiksione shtetërore (Stephenson, 2018).
- **Së dyti**, është mjaft e vështirë që të identifikohen se kush janë viktimat (Stephenson, 2018).

Si konstatim mund të thuhet se Britania e Madhe ka arritur të konsolidoj disa praktika të mira në lidhje me kompensimin e viktimave të korrupsionit qofshin ata persona fizik apo juridik, individ, kompani apo shtete tjera (Stephenson, 2018). Megjithatë, mund të thuhet që janë arritur të

identifikohen së paku dy (2) sfida të cilat duhet që të tejkalohen me rastin e trajtimit të kësaj tematike (Stephenson, 2018):

- Sfida e parë ka të bëjë me rastet të cilat përfshijnë aktivitetet e korrupsionit transnacional apo të korrupsionit i cili manifestohet në dy apo më shumë juridiksione shtetërore.
- Sfida e dytë ka të bëjë jo vetëm me vështirësitë në identifikimin e viktimave të korrupsionit por edhe me kualifikimin dhe kuantifikimin (përcaktimin sasior) të dëmit të korrupsionit.

Sfida e dytë manifeston një temë për të cilën mund të evidentohen praktika më të mira sa më shumë raste që trajtohen. Nga ana tjetër sfida e parë apo korrupsioni transnacional manifeston një shqetësim që vetëm sa është në rritje e sipër. Kjo për arsye se korrupsioni transnacional është i lidhur në njërën formë apo tjetrën me globalizimin dhe zhvillimin e përgjithshëm të njerëzimit. Përndryshe korrupsioni transnacional mund të afekton si sektorin publik ashtu edhe atë privat.

Sa i përket Republikës së Kosovës, padyshim se duhet të nxirren mësimë të rëndësishme nga përkushtimi i Britanisë së Madhe për mbrojtjen civile të viktimave të korrupsionit dhe sidomos sukseseve të arritura gjatë viteve 2014-2018. Kuptohet se po aq mësimë duhet të mësohen nga sfidat aktuale të Britanisë së Madhe lidhur me korrupsionin transnacional, identifikimin e viktimave, kualifikimin dhe kuantifikimin (përcaktimin sasior) të dëmit të korrupsionit.

PËRFUNDIMI

Konstatime dhe rekomandime

Lufta kundër korrupsionit në Republikën e Kosovës është monitoruar ndër vite nga shumë subjekte ndërkombëtare duke përfshirë këtu Transparency International, Komisionin Evropian, Departamentin Amerikan të Shtetit si dhe Freedom House. Në përgjithësi këto raporte ndërkombëtare kanë konstatuar se gjatë viteve 2019-2021 në Republikën e Kosovës është bërë një progres i konsiderueshëm në luftën kundër korrupsionit, në raport edhe me shtetet fqinje

në Ballkanin Perëndimor. Megjithatë, korrupsioni vazhdon të mbetet një shqetësim për të gjithë rajonin duke përfshirë këtu edhe shtetin e Kosovës. Për të luftuar me sukses korrupsionin në Republikën e Kosovës është i domosdoshëm harmonizimi i plotë me standardet e Këshillit të Evropës në këtë fushë. Padyshim se Konventa Penale kundër Korrupsionit dhe Konventa Civile kundër Korrupsionit janë dy nga instrumentet juridike kryesore të Këshillit të Evropës ku duhet të përqendrohet vëmendja kryesore në këtë drejtim.

Konventa Penale kundër Korrupsionit ka përcaktuar masat që duhet të ndërmarrin shtetet anëtare për luftimin me sukses të korrupsionit në aspektin penalo juridik. Rrjedhimisht disa përcaktime me rëndësi në këtë konventë i referohen inkriminimit të korrupsionit në sektorin privat. Në vitin 2019 Republika e Kosovës ka përcaktuar si vepra penale marrjen e ryshfetit dhe dhënien e ryshfetit në sektorin privat, të cilat si të tilla janë në përputhje të plotë përcaktimet e kësaj konvente. Mirëpo përtej përputhshmërisë së inkriminimeve në kuptimin juridik material, është e domosdoshme që edhe përvojat e shtetit të Kosovës për këtë formë të korrupsionit të konsolidohen në përputhje me praktikën e mira të Këshillit të Evropës. Bazuar në të dhënat e Gjykatës Themelore në Prishtinë, gjatë viteve 2019-2021 nuk ekziston asnjë aktgjykim për veprat penale të korrupsionit në sektorin privat sipas Kodit Penal të Kosovës. Në anën tjetër, ky punim ka arritur të konfirmoj që Kosova mund të jetë mjaft e rrezikuar edhe nga kjo formë e korrupsionit. Rrjedhimisht mund të konstatohet që *“Republika e Kosovës ka nevojë për rritjen e kapaciteteve për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin në sektorin privat sipas standardeve të përcaktuara me instrumentet juridike të Këshillit të Evropës kundër korrupsionit”*. Në këtë mënyrë mund të thuhet se është vërtetuar edhe hipoteza e parë të këtij punimi.

Një nga format tjera të korrupsionit që janë aktuale sot, manifestohet përmes kriptovalutave dhe teknologjisë ‘Blockchain’. Karakteristikat kryesore të kriptovalutave konsistojnë në mungesën e rregullimit të tyre ligjor, luhatjeve të vlerës së tregut si dhe vështirësitë në gjurmimin e tyre. Pikërisht këto karakteristika bëjnë që kriptovalutat të jenë mjaft tërheqëse si mjete për kryerjen e veprave penale të korrupsionit në shumicën e vendeve të botës duke përfshirë këtu edhe shtetin e Kosovës. Në këtë drejtim, shumica e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës tanimë kanë miratuar ligjet përkatëse përmes të cilave ose kanë rregulluar

përdorimin e kriptovalutave ose e kanë ndaluar në tërësi përdorimin e tyre. Megjithatë, në Republikën e Kosovës edhe më tutje mungon një kornizë ligjore që është në harmoni me standardet ndërkombëtare për parandalimin dhe luftimin e formave të korrupsionit përmes kriptovalutave. Për këtë arsye mund të konstatohet se është vërtetuar edhe hipoteza e dytë e këtij punimi.

Sa i përket mbrojtjes së viktimave të korrupsionit përmes mjeteve efektive juridike duke përfshirë edhe kompensimin e dëmit të korrupsionit, është konstatuar një diskrepancë e konsiderueshme ndërmjet përcaktimeve në Konventën Civile kundër Korrupsionit dhe rregullimit ligjor të këtyre çështjeve në Republikën e Kosovës. Në parim, legjislacioni në Kosovë e mundëson kompensimin e viktimave të krimit në përgjithësi. Megjithatë Konventa Civile kundër Korrupsionit ka promovuar të drejtën në mjete efektive juridike edhe përtej kompensimit të viktimave të korrupsionit. Për më tepër, kjo konventë ka veçuar viktimat e korrupsionit nga viktimat tjera të krimit për shkak të karakteristikave të tyre unike. Megjithatë, ky punim ka konfirmuar se *legjislacioni në Republikën e Kosovës nuk është në përputhje të plotë me përcaktimet e Konventës Civile kundër Korrupsionit për të ofruar mjete efektive juridike për mbrojtjen e viktimave të korrupsionit duke përfshirë këtu edhe kompensimin e dëmit të pësuar nga korrupsioni*. Nga ky këndvështrim, mund të thuhet se është arritur të vërtetohet edhe hipoteza e tretë e punimit.

Konfiskimi i pasurisë së kundërligjshme ka rëndësi të posaçme për luftimin efikas të korrupsionit. Qeveria e Kosovës ka iniciuar një projektligj përmes të cilit synohet përvetësimi i sistemit civil të konfiskimit *in rem* të pasurisë së pajustificueshme. Një hap i tillë është në përputhje me trendin ndërkombëtar për kalimin nga sistemi tradicional në sistemin civil të konfiskimit të pasurisë me qëllim të luftimit më efikas të korrupsionit.

Megjithatë, ky tranzicion i sistemit të konfiskimit në Republikën e Kosovës ka shpërfaqur edhe disa sfida që duhet të tejkalohen në fazën e projektligjit përkatës, në mënyrë që pas hyrjes në fuqi të ligjit të evitohen pengesat eventuale për zbatimin e tij. Duke marrë parasysh kontekstin e popullit në Republikën e Kosovës, ky projektligj duhet të adresoj mbrojtjen e remitencave nga diaspora të cilat janë shumë të rëndësishme për një numër të madh të familjeve në Kosovë.

Njëkohësisht, ky projektligj duhet të rregulloj qasjen edhe ndaj ekonomisë joformale në Kosovë. Ka shumë rëndësi që gjatë fazës tranzicionale, të shmangen kolizionet eventuale ndërmjet sistemit tradicional të konfiskimit i cili është aktualisht në fuqi në Kosovë dhe sistemit të ri civil të konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme. Po ashtu, projektligji duhet të ruaj të gjitha karakteristikat e sistemit civil të konfiskimit duke u bazuar në praktikatat e mira të shteteve që tanimë e zbatojnë me sukses këtë sistem, siç është Britania e Madhe, Irlanda, Italia dhe shumë shtete të tjera. Rrjedhimisht, sistemi civil i konfiskimit mund të manifestohet vetëm përmes procedurës civile ku barra e provës mund të jetë mbi palën e paditur. Në të kundërtën, sistemi *in rem* i konfiskimit nuk mund të zbatohet në procedurë penale për shkak të kufizimeve të prezumimit të pafajësisë duke përfshirë këtu edhe barrën e provës që i takon vetëm prokurorisë.

Duke marrë parasysh të gjeturat dhe konstatimet më sipër, ky punim ka theksuar rekomandimet vijuese për Kuvendin e Republikën e Kosovës, me qëllim të luftimit më efikas të korrupsionit në përputhje me standardet e përcaktuara nga Këshilli i Evropës dhe organizatat tjera ndërkombëtare në këtë fushë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet që në lexim të dytë të rishikoj dhe të ndryshoj dispozitat e caktuara në *“Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme”* si në vijim:

- Në nenin 2 paragrafin 2 nën paragrafin 2.1. të largohet pasuesi *“nga data 17 shkurti 2008”*;
- Në nenin 3 paragrafin 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.4 në vend të termit *“Departamenti Special”* të vendoset *“Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil”*.
- Në kuadër të Kapitullit XIII “Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare” para nenit 68 të shtohet një dispozitë e re si në vijim *“Me hyrjen në fuqi të këtij ligji do të shfuqizohet Ligji nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë”*.

Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të miratoj *“Ligjin për Kriptomonedhat”* përmes të cilit do të përcaktohet statusi juridik dhe mënyra e përdorimit kriptomonedhave. Njëkohësisht, duhet të mundësohet mbikëqyrja e transaksioneve me kriptomonedha me qëllim të

ballafaqimit me korrupsionin si dhe aktiviteteteve tjera të kundërligjshme që mund të manifestohen përmes tyre.

Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të miratoj **“Ligjin për mbrojtjen e personave të dëmtuar nga korrupsioni”**. Ky ligj duhet përshtatshëmrisht të reflektoj të gjitha përcaktimet në Konventën Civile kundër Korrupsionit duke përfshirë por pa u kufizuar në institutet juridike si në vijim:

- **E drejta për kompensim** që nënkupton përcaktimin e kategorive të personave që kanë të drejtë për kompensimin e dëmit nga korrupsioni, në përputhje me nenin 3 paragrafin 1 të KCKK;
- **Format e kompensimit** që nënkupton kompensimin e dëmit material, jo material dhe fitimin e humbur për shkak të korrupsionit, në përputhje me nenin 3 paragrafin 2 të KCKK;
- **Kushtet e kompensimit** që duhet të provohen përmes kërkesës së paditësit për kompensimin e dëmit të korrupsionit, në përputhje me nenin 4 të KCKK;
- **Përgjegjësia e shtetit** që nënkupton përcaktimin e përgjegjësive që kanë institucionet kompetente për të kompensuar dëmin që kanë shkaktuar zyrtarët publik për shkak të përfshirjes së tyre në vepra penale të korrupsionit, në përputhje me nenin 5 të KCKK;
- **Neglizhenca kontribuese** që nënkupton situatat kur paditësi me fajin e vet ka kontribuar në dëmin e pësuar ashtu që dëmshpërblimi i tij do të zvogëlohet në përputhje me neglizhencën kontribuese të paditësit, në përputhje me nenin 6 të KCKK;
- **Afati i parashkrimit** për të kërkuar shpërblimin e dëmit nga korrupsioni që duhet të jetë jo më pak se tri (3) vite nga momenti kur është kuptuar apo është dashur në mënyrë të arsyeshme që të kuptohet dëmi i pësuar, në përputhje me nenin 7 të KCKK;
- **Mbrojtja e sinjalizuesve** në përputhje me nenin 9 të KCKK;
- **Auditimi dhe kontrollimi** i ndërmarrjeve ekonomike, në përputhje me nenin 10 të KCKK;
- **Masat e përkohshme** që nënkupton përcaktimin e urdhrave gjyqësor të nevojshëm për të ruajtur të drejtat dhe interesat e palëve nga rreziku i humbjes apo dëmtimit të tyre të pariparueshëm, në përputhje me nenin 12 të KCKK;
- **Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar** në çështjet civile lidhur me kompensimin e viktimave për shkak të dëmit nga veprat penale të korrupsionit, në përputhje me nenin 13 të KCKK;

BIBLIOGRAFIA

A. LIBRA DHE ARTIKUJ

- Alina Rocha Menocal & Nils Taxell. (2015, January). Why corruption matters: understanding causes, effects and how to address them. *Evidence paper on corruption*, p. 27. Retrieved April 29, 2022, from https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/406346/corruption-evidence-paper-why-corruption-matters.pdf
- Allena, M. (2019). Anti-Mafia Confiscation Against Corruption: The New Frontier of Human Rights. *Italian Journal of Public Law* 196-222 (2019) - *Bocconi Legal Studies Research Paper* 3388398, May 2019, 6.
- Anna Irrera. (2020, December 09). Criminals getting smarter in use of digital currencies to launder money. (J. Stonestreet, Ed.) Retrieved March 18, 2021, from <https://www.reuters.com/article/crypto-currencies-criminals-idUSKBN28J1IX>
- Arifi, Besa. Categorisation of Crime Victims: Comparing Theory and Legislation. In *TEMIDA 2016*, vol.19, br. 3-4 str. 493-515, ISSN 1450-6637, DOI 10.2298/TEM1604493A, *Pregledni rad*, *Primljeni*: 15.3.2016, *Odobreno za stampu*: 28.11.2016, pp. 494-515. 2016.
- Arifi, Besa. Educating Students and University Staff on Whistleblowers' Protection as a Tool for Countering Corruption in Higher Education. Higher education, corruption and whistleblowers: Proceedings of the International Conference on Corruption in Higher Education, 2018, Skopje, Macedonia ISBN 978-608-65157-4-4, COBISS.MK-ID 108488970, pp. 164-172. Institute for Strategic Research and Education, Skopje, 2018.
- Arifi, Besa. Mbajtja e të drejtave të fëmijëve viktimë të veprave penale dhe fëmijëve dëshmitarë në procedurën penale. "Të drejtat e fëmijëve - Sfidat dhe perspektivat e reja". Arifi, B.; Ratkoceri, V.; Selmani, A.; Metaj, A.; Ibish, E. *Recenzues*: Jashari, A.; Zejneli, I. ISBN 978-608-248-049-7, COBISS.MK-ID 57340933, pp. 107-152, Tetovë, 2022.

- Arifi, Besa. The Rights of Victims of Crime - A Comparative Approach. In *Annual of ISPJR 2016, year XL, number 1, UDC 343.122(4-12), pp. 9-19*. 2016.
- Arifi, Besa. The Rights of Victims of Crime – a Comparative Approach to the Legislation in USA and Macedonia. In Cross-border Book Series “New Challenges to Security and Development of the Balkans” Vol. 4, cross-border cooperation and development policies in Bulgaria and on the Balkans, ISSN 2335-0056, ISBN 978-619-205-051-1, Veliko Turnovo, Bulgaria. "St. Cyril and St. Methodius" University of Veliko Turnovo, Bulgaria, Veliko Turnovo, 2017.
- Bhargava, V. (2005). The Cancer of Corruption. (W. Bank, Ed.) *World Bank Global Issues Seminar Series*, p. 1. Retrieved April 29, 2022, from <https://www.coursehero.com/file/73259856/The-aCancer-of-Corruptionapdf/>
- Blackwell, W. (2013). The gift in antiquity. London, England, United Kingdom. Retrieved April 30, 2022, from <https://www.brookings.edu/wp-content/uploads/2016/07/chapter-one-corruption-sh-9780815727910.pdf>
- Cloots, J. W. (2012, July). The fight against corruption in international law. *Leuven Centre for Global Governance Studies Working Paper No. 94, Working Paper No. 94*, 14. Retrieved May 2, 2022, from https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2274775
- Dale, H. (2015, February 14). No guilty men: A history of the presumption of innocence. *NO GUILTY MEN: A HISTORY OF THE PRESUMPTION OF INNOCENCE*. (Libertarianism.org, Ed.) Australia: Libertarianism.org. Retrieved February 01, 2021, from <https://www.libertarianism.org/columns/n-guilty-men-history-presumption-innocence>
- Danilet, C. (2009). *Korrupsioni dhe antikorrupsioni në sistemin e drejtësisë*. (E. C. Beck, Ed., & V. Vasilescu, Trans.) Bukuresht, Rumani: Konrad Adenauer Stiftung. Retrieved from https://www.kas.de/documents/252038/253252/7_dokument_dok_pdf_22459_33.pdf/29de7d7f-7843-8b0c-b439-63528546458e?version=1.0&t=1539659883925

- Draper, H. (1977). Vdekja e shtetit ne Marksine dhe Engelsine. *New Yourk - Revolucioni*. Retrieved from <https://bit.ly/2Prw1F3>
- Eveshnie Reddy, A. M. (2018). Cryptocurrency: A tool and target for cybercrime. *Acta Criminologica*, 31(3), 71-92. Retrieved March 20, 2021, from <https://journals.co.za/doi/10.10520/EJC-14d902942d>
- Fazekas, M. &. (2017). *Corruption risk assessment of the public procurement in Kosovo*. Action against Crime Departament, Economic Crimeand Cooperation Division, Council of Europe. Strasbourg: Council of Europe. Retrieved from <https://rm.coe.int/peckii-4561-tp15-cra-public-procurement/16808ae501>
- Frankenfield, J. (2022, janar 11). Cryptocurrency. (C. Murry, Ed.) *Investopedia*. Retrieved 2022, from <https://www.investopedia.com/terms/c/cryptocurrency.asp>
- Halili Xh., Ibrahim A. (2017). Causes for the Irregular Migration Crises: Case of Kosovo. *Strategos*, 1(2), 79-98. Retrieved June 12, 2021, from https://www.researchgate.net/publication/321757677_Causes_for_the_Irregular_Migration_Crises_Case_of_Kosovo
- Dr. Halili, R. (2016). *Kriminologjia, Botimi i tetë*. Prishtinë.
- Dr. Halili, R. (2011). *E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale*. Prishtinë: AAB University.
- Dr. Halili, R. (2011). *Viktimologjia*. Prishtinë.
- Hawley, S. (2016). *Compensation for victims of corruption: Why does it matter?* . (Corruption Watch and UNCA Coalition Civil Society) Retrieved August 8, 2020, from Corruption Watch and UNCA Coalition Civil Society: <https://uncaccoalition.org/compensation-for-victims-of-corruption-why-does-it-matter/>
- Hill, L. (2013). Conceptions of political corruption in ancient Athens and Rome. Retrieved 2022 https://www.researchgate.net/publication/263155678_Conceptions_of_political_corruption_in_ancient_Athens_and_Rome

- Horwitz, A. X. (2011). *Guide to Latin in International Law*. Oxford University Press.
doi:10.1093/acref/9780195369380.001.0001. Retrieved from
<https://global.oup.com/academic/product/guide-to-latin-in-international-law-9780197583104?cc=us&lang=en&>
- Hume, T. (2013, October 5). How FBI caught Ross Ulbricht, alleged creator of criminal marketplace Silk Road. *CNN*. Retrieved from
<https://edition.cnn.com/2013/10/04/world/americas/silk-road-ross-ulbricht/index.html>
- Ibrahimi Adrianit, Arifi Besa. Defending the Rights of the Victims of Corruption in the Republic of Kosovo: With a Special Focus to the Pandemic Covid-19. In *SEEU Review, Volume 15 (2020): Issue 1 (July 2020)*, DOI: <https://doi.org/10.2478/seeur-2020-0001> pp. 3-23. 2020.
- Ibrahimi Adrianit, Arifi, Besa. "Brain Drain" Migration as a Consequence of Corruption in the Republic of Kosovo. The Migration Conference 2021, Selected Papers, Compiled by Ibrahim Sirkeci, pp. 115-121. Transnational Press, London, 2021.
- Ibrahimi, A. (2020). Legjitimiteti dhe ligjshmëria e rasteve penale të trajtuara nga zyrtarët policor të dënuar për vepra penale të korrupsionit. *Integriteti*, VIII(10), pp. 14-16. Retrieved 2022, from <https://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/03/REVISTA-INTEGRITETI-IPK-shqip-2020.pdf>
- Ibrahimi, B. G. (2020). Harmonizimi i Kodit Penal të Kosovës me Konventën Penale kundër Korrupsionit si nevojë për garantimin e sigurisë nacionale dhe luftimin e krimeve mjedisore. *Policimi dhe Siguria: Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare*. II, pp. 228-245. Tiranë: Akademia e Sigurisë. Retrieved 2022, from
https://issuu.com/policimi.dhe.siguria/docs/policimi_dhe_siguria_19_proceedings_v_ii
- Ismet Salihu, H. Z. (2014). *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës* (Vol. 1). Prishtinë, Republika e Kosovës: GIZ - Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit. Retrieved prill 2022, 30, from <http://ius.igjk.rks-gov.net/485/1/Komentari%20-%20Kodi%20Penal%20i%20Kosoves.pdf>

- Jaluzot , B., & Michaela, M. (2017). Civil Law Consequences of Corruption and Bribery in France. (N. V. O. Meyer (dir.), Ed.) *HAL archives-ouvertes.fr, The Civil Law Consequences of Corruption*. Retrieved from <https://halshs.archives-ouvertes.fr/halshs-01469762/document>
- Jónasson, Á. M. (2005). International Law against Corruption – An Icelandic Perspective. *Univerity of Lund - Faculty of Law - Master Programme*. Retrieved May 2, 2022, from <http://lup.lub.lu.se/luur/download?func=downloadFile&recordId=1554916&fileId=1563486>
- Kane Russell, C. L. (2021, Nov. 09). United States: Is Crypto a Currency Or Security? Litigation Involving The SEC May Provide Guidance. (J. Novel, Ed.) *Mondaq - Connecting knowledge & people*. Retrieved April 18, 2022, from <https://www.mondaq.com/unitedstates/fin-tech/1129220/is-crypto-a-currency-or-security-litigation-involving-the-sec-may-provide-guidance>
- Khaghaghordyan, A. (2014). *International Anti-corruption Normative Framework: the State of the Art pp. 11*. Hertie School of Governance. Berlin: European Union. Retrieved maj 2, 2022, from https://www.againstcorruption.eu/wp-content/uploads/2015/12/D1.1_Part3_International-Anti-corruption-Normative-Framework.pdf
- King, C. (2016). *Konfiskimi civil në Irlandë: Dy dekada të ligjit për të ardhurat nga krimi dhe Byroja e Aseteve Kriminale*. Londër: University of Sussex Press. Retrieved from <https://bit.ly/3gE6mUR>
- Levi, M. (2000). *Reversal of the burden of proof in confiscation of the proceeds of crime: a Council of Europe Best Practice Survey*. Council of Europe, European Committee of Crime Problems . Strasbourg: Council of Europe. Retrieved February 05, 2021, from <https://www.coe.int/t/dg1/legalcooperation/economiccrime/organisedcrime/BestPractice2E.pdf>

- Lindy Muzila, M. M. (2012). *Criminalizing Illicit Enrichment to Fight Corruption*. Washington DC: Stolen Asset Recovery Initiative - The World Bank - UNODC. Retrieved from <https://documents1.worldbank.org/curated/en/958781468339641204/pdf/On-the-take-criminalizing-illicit-enrichment-to-fight-corruption.pdf>
- Lyle Daly. (2022, February 25). *The Motley Fool*. (TMFLyleDaly, Producer) Retrieved April 15, 2022, from <https://www.fool.com/investing/stock-market/market-sectors/financials/cryptocurrency-stocks/how-many-cryptocurrencies-are-there/>
- Mandjee, T. (2015). Bitcoin, its Legal Classification and its Regulatory Framework. *Journal of Business & Securities Law*, 15(2), 158-211. Retrieved from <https://core.ac.uk/reader/228477270>
- Orwell, G. (1949, January). Reflections on Gandhi. *Partisan Review*. Retrieved February 01, 2021, from https://www.orwell.ru/library/reviews/gandhi/english/e_gandhi
- Osborne, C. (2018, August 20). Alleged head of BitConnect cryptocurrency scam arrested in Dubai. *ZDNet*. Retrieved from <https://www.zdnet.com/article/alleged-bitconnect-head-arrested-in-dubai/>
- Pennington, K. (2003). Innocent Until Proven Guilty: The Origins of a Legal Maxim. (C. L. Repository, Ed.) *63 JURIST: STUD. CHURCH L. & MINISTRY*, 106-124. Retrieved February 02, 2021, from <https://scholarship.law.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1169&context=scholar>
- Satoshi Nakamoto. (2008). Bitcoin: A Peer-to-Peer Electronic Cash System. 1-9. Retrieved 2022, from <https://bitcoin.org/bitcoin.pdf>
- Sergi, A. (2015). *Sistemi Italian Anti-Mafia midis Praktikës dhe Simbolizmit: Vlerësimi i Pikëpamjeve Bashkëkohore mbi Modelin e Strukturës Italiane kundër Krimin të Organizuar*. Londër: University of West London. Retrieved from <https://bit.ly/2QCOcbp>
- Thayer, J. B. (1897, March). The presumption of innocence in criminal cases. *The Yale Law Journal* 6(4), 185-212. Ret. Feb. 2021 from <https://www.jstor.org/stable/pdf/780722.pdf>

- Stephenson, M. (2018, June 5). *GAB – The Global Anticorruption Blog (Law, Social Science, and Policy)*. Retrieved August 9, 2020, from GAB – The Global Anticorruption Blog: <https://globalanticorruptionblog.com/2018/07/05/guest-post-the-uks-compensation-principles-in-overseas-corruption-cases-a-new-standard-for-aiding-victims-of-corruption/>
- Vettori, B. (2006). Tough on Criminal Wealth: Exploring the Practice of Proceeds from Crime Confiscation p. 23. Ret. <https://link.springer.com/book/10.1007/978-1-4020-4129-7>
- Vitaly Kasko, Dmytro Kotlyar. (2018). Confiscation of instrumentalities and proceeds of corruption crimes in Eastern Europe and Central Asia. *Confiscation of instrumentalities and proceeds of corruption crimes in Eastern Europe and Central Asia*. Paris, France, Europe: OECD. Retrieved Feb. 2021, from <https://www.oecd.org/corruption/acn/OECD-Confiscation-of-Proceeds-of-Corruption-Crimes-ENG.pdf>
- Weinstein, A. C. (2019). Promoting Innovation Through Education: The Blockchain Industry, Law Enforcement and Regulators Work Towards a Common Goal. *GLOBAL LEGAL INSIGHTS' BLOCKCHAIN & CRYPTOCURRENCY REGULATION 2019*. Retrieved from <https://www.step toe.com/en/news-publications/promoting-innovation-through-education-the-blockchain-industry-law-enforcement-and-regulators-work-towards-a-common-goal.html>
- William Buchanan, S. D. (2018). The Challenges of Investigating Cryptocurrencies and Blockchain Related Crime. *JBBA*, 1(2), 1-6. Retrieved March 20, 2021, from <https://jbba.scholasticahq.com/article/5779-the-challenges-of-investigating-cryptocurrencies-and-blockchain-related-crime>
- Zejneli, Ismail. (2017). *Criminal procedural legislation and respecting of freedom and human rights*. Bulgaria.
- Zejneli, Ismail. (2021). *Determining guilt as an element of criminal offense*. Tetovo.

B. AKTE NORMATIVE

20 Guiding Principles for the fight against Corruption. (1997, November 6). *Council of Europe Committee of Ministers*. Retrieved August 8, 2020, from Resolution no. (97) 24 on the 20 Guiding Principles for the fight against Corruption: <https://rm.coe.int/16806cc17c>

Agjencia Kundër Korrupsionit. (2017). *Strategjia Shtetërore Kundër Korrupsionit 2018-2022*. Prishtinë: Qeveria e Republikës së Kosovës. Retrieved maj 2, 2022, from <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40299>

CLSSCPC. (1990, November 8). *Council of Europe - European Treaty Series No. 141*. Retrieved from Convention on Laundering, Search, Seizure and Confiscation of the Proceeds from Crime: <https://rm.coe.int/168007bd23>

CLSSCPCFT. (2005, May 16). *Council of Europe - European Treaty Series No. 198*. Retrieved from Convention on Laundering, Search, Seizure and Confiscation of the Proceeds from Crime and Financing Terrorism : <https://rm.coe.int/168008371f>

CoE Resolution (97)24. (1997). *OSCE POLIS*. Retrieved from OSCE: <https://polis.osce.org/council-europe-resolution-97-24-twenty-guiding-principles-fight-against-corruption#:~:text=Guiding%20principles%20include%20raising%20public,well%20as%20increasing%20international%20cooperation>

CoE Resolution (98)7. (1998). *Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, Resoluta nr. (98)7, "Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit"*. Retrieved 2022, from Këshilli i Evropës: http://www.bak.gv.at/en/Downloads/files/GRECO/GRECO_Statut.pdf

Criminal Procedure Code of the French Republic. (2006). *Criminal Procedure Code of the French Republic, english version*. Retrieved August 9, 2020, from: <https://www.legislationline.org/documents/section/criminal-codes/country/30/France/show>

Criminal Law Convention on Corruption. (1999, January 27). *European Treaty Series No. 173*. Retrieved from Council of Europe: <https://rm.coe.int/168007f3f5>

Directive 2014/42/EU. (2014, April 29). *Directive 2014/42/EU of the European Parliament and of the Council of 3 April 2014 on the freezing and confiscation of instrumentalities and proceeds of crime in the European Union*. Retrieved from Council of Europe, Document 32014L0042: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32014L0042>

Document 52020PC0593. (2019). *European Commission - Procedure 2020/0265/COD*. Retrieved from COM (2020) 593: Proposal for a REGULATION OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL on Markets in Crypto-assets, and amending Directive (EU) 2019/1937: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/HIS/?uri=COM:2020:593:FIN>

ECHR. (1950, November 4). *European Convention on Human Rights*. Retrieved February 01, 2021, from Council of Europe:
https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdf

ETS No. 173 - Treaty Office. (2022). *Criminal Law Convention on Corruption - Treaty Office*. Retrieved from Council of Europe - Treaty Office ETS No. 173:
<https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=signatures-by-treaty&treaty=173>

ETS no. 174 - Treaty Office. (2022). *Civil Law Convention on Corruption - Treaty Office ETS no. 174*. Retrieved from Council of Europe - Treaty Office :
<https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=signatures-by-treaty&treaty=174>

ICCPR. (1966, December 16). *International Covenant on Civil and Political Rights*. Retrieved February 01, 2021, from United Nations, General Assembly:
<https://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CCPR.aspx>

Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës. (2004, prill 6). *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*. Retrieved prill 30, 2022, from <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8674>

Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës. (1999). *Anexi i Resolutës nr. (99)5, "Statuti i Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit*. Retrieved maj 3, 2022, from Këshilli i Evropës:

http://www.bak.gv.at/en/Downloads/files/GRECO/GRECO_Statut.pdf

KPPRK. (2012, dhjetor 28). *Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës*.

Retrieved February 01, 2021, from Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 37/12:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>

KPRK. (2013, janar 01). *Kodi Penal nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës*. Retrieved from Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 19/2012:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

KPRK. (2019, janar 14). *Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr. 06/L-074*. Retrieved from Kuvendi i Kosovës - Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 2/2019:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

KRK. (2008, prill 09). *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*. Retrieved shkurt 01, 2021, from Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. K-09042008:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

LAKK. (2010, 02 05). *Ligji nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit*. Retrieved from Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 65/2010:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2662>

LAPSK. (2016, 04 14). *Ligji nr. 05/L-059 për administrimin e pasurisë së sekuestruar edhe konfiskuar*. Retrieved from Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 12/2016:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12360>

LDP. (2011, 09 14). *Ligji nr. 04/L-050*. Retrieved from Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 16/2011:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2767>

LGJ. (2018, dhjetor 18). *Ligji nr. 06/L-054 për Gjykatat*. Retrieved from Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 22/2018:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18302>

- Ligji kundër korrupsionit. (2004). *Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë*. Retrieved maj 1, 2022, from <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2441>
- Ligji Nr. 03/L-151 . (2011, shtator 14). *Ligji Nr. 03/L-151 për deklarinimin dhe prejardhjen e pasurisë dhe dhuratave të zyrtarëve të lartë publikë*. Retrieved from Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 16/2011: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2767>
- Ligji nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit. (2016, qershor 15). *Gazeta zyrtare nr. 18/2016*. Retrieved from Kuvendi i Republikës së Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12540>
- Ligji për IPK. (2010, 11 16). *Ligji nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës*. Retrieved from Gazeta Zyrtare nr. 87/2010: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2720>
- Ligji për prokurimin publik. (2004). *Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë*. Retrieved maj 1, 2022, from <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2483>
- LKVK. (2015). *Law no. 05/L-036 on Crime Victim Compensation*. Retrieved August 8, 2020, from Official Gazette of Republic of Kosovo no 17/2015: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10936>
- LKZKP. (2018, dhjetor 26). *Ligji nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë*. Retrieved from Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 23/2018: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18337>
- LMD. (2012). *Law no. 04/L-077 on Obligational Relationships*. Retrieved August 9, 2020, from Official Gazette of Republic of Kosovo No. 16/2012: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2828>
- LPKI. (2018, 04 27). *Ligji nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik*. Retrieved from Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 5/2018: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16314>

LSHT. (2018). *Ligji Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare*. Retrieved from Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9, 24 maj 2018: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16426>

Multidisciplinary Group on Corruption - GMC. (1996). *Programme of Action Against Corruption*. Council of Europe, Committee of Ministers. Strasbourg. Retrieved May 2, 2022 from <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806ccfb6>

Organization of American States. (1996, March 29). *Inter-American Convention against Corruption (B-58)*. Retrieved from Organization of American States: http://www.oas.org/en/sla/dil/docs/inter_american_treaties_B-58_against_Corruption.pdf

PL-BShVKPP. (2022, korrik 14). *Projektligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme*. Retrieved from Qeveria e Republikës së Kosovës - Zyra e Kryeministrit: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41293>

Qeveria e Republikës së Kosovës. (2012, prill 4). *Vendimi nr. 02/110 për themelimin e Departamentit Special Antikorrupsion*. Retrieved from Komunikatë për media: <https://kryeministri.rks-gov.net/komunikate-per-media-22/>

Serious Fraud Office, United Kingdom. (2018, June 1). *General Principles to compensate overseas victims (including affected States) in bribery, corruption and economic crime cases*. Retrieved August 8, 2020, from Serious Fraud Office, United Kingdom: <https://www.sfo.gov.uk/download/general-principles-to-compensate-overseas-victims-including-affected-states-in-bribery-corruption-and-economic-crime-cases/>

Strafgesetzbuch. (1871). *Bundestag von Deutschland, "Strafgesetzbuch"*. Retrieved from <https://www.gesetze-im-internet.de/stgb/>

- Strafgesetzbuch. (1974). *Bundestag von Österreich*. Retrieved from Strafgesetzbuch:
<https://www.ris.bka.gv.at/GeltendeFassung.wxe?Abfrage=Bundesnormen&Gesetzesnummer=10002296>
- UDHR. (1948, December 10). *Universal Declaration of Human Rights*. Retrieved February 01, 2021, from United Nations, General Assembly: <https://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/>
- UK Public General Acts c. 29. (2002). *The Proceeds of Crime Act for confiscation*. Retrieved August 8, 2020, from UK Public General Acts c. 29, Legislation.gov.uk,:
<https://www.legislation.gov.uk/ukpga/2002/29/contents>
- UN Convention against illicit traffic in narcotic drugs and psychotropic substances. (1988). *UN General Assembly*. Retrieved from United Nations:
https://www.unodc.org/pdf/convention_1988_en.pdf
- UK Public General Acts c.6 Part VI. (2000). *The Powers of Criminal Courts (Sentencing) Act for compensation, section 130*, . Retrieved August 8, 2020, from UK Public General Acts c.6 Part VI, Legislation.gov.uk:
<http://www.legislation.gov.uk/ukpga/2000/6/part/VI/crossheading/compensation-orders>
- UNCAC. (2004). *United Nations Convention against Corruption* . Retrieved August 9, 2020, from United Nations Office on Drugs and Crime:
https://www.unodc.org/documents/treaties/UNCAC/Publications/Convention/08-50026_E.pdf
- UNCC. (1979, 12 17). *United Nations Code of Conduct for Law Enforcement Officials*. Retrieved from General Assembly Resolution 34/169: <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/code-conduct-law-enforcement-officials>

UNTOC. (2000, 11 15). *United Nations Convention against Transnational Organized Crime and the Protocols Thereto*. Retrieved from United Nations Office on Drugs and Crime:
<https://www.unodc.org/unodc/en/organized-crime/intro/UNTOC.html>

UNDC. (1997). *United Nations Declaration against Corruption and Bribery in International Commercial Transactions*. Retrieved from General Assembly 51st sess.: 1996-1997:
<https://digitallibrary.un.org/record/233080?ln=en>

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit. (2012, korrik 20). *Vendimi nr. A.nr.131/2012 për caktimin e koordinatorëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës*. Retrieved from Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.

C. VENDIME GJYQËSORE

Agosi v. United Kingdom, Seria A no. 9118/80 (Strasburg, GJEDNJ 1986). Retrieved from
<https://rm.coe.int/16806ebc9d>

Arcuri & Three Others v. Italy, no. 52024/99 (GJEDNJ, Strasburg 2001 - VII). Retrieved from
<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806ebc9b>

Barberà, Messegue and Jabardo v. Spain, Application no. 10590/83 (European Court of Human Rights December 06, 1988). Retrieved February 07, 2021, from
<https://cambodia.ohchr.org/sites/default/files/echrsources/Barber%c3%a0,%20Messgu%c3%a9%20&%20Jabardo%20v.%20Spain%20%5b6%20Dec%201988%5d%20%5bEN%5d.pdf>

Coffin v. United States, 156 U.S. 432 (1895), 156 U.S. 432 (1895), No. 741 (U.S. Supreme Court March 4, 1895). Retrieved February 01, 2021, from
<https://supreme.justia.com/cases/federal/us/156/432/>

Francis Butler v. United Kingdom, no. 41661/98 (GJEDNJ, Strasbourg 2002-V). Retrieved from <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806ebc9c>

Gogitidze & Others v. Georgia, no. 36862/05 (GJEDNJ, Strasbourg 2015). Retrieved from <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22itemid%22%3A%5B%22002-10540%22%5D%7D>

John Murray v. United Kingdom, Application no. 18731/91 (European Court of Human Rights February 08, 1996). Retrieved February 07, 2021, from [file:///C:/Users/DELL/Downloads/Murray%20vs%20UK%20arrest%201996%20\(Engels\).pdf](file:///C:/Users/DELL/Downloads/Murray%20vs%20UK%20arrest%201996%20(Engels).pdf)

Phillips v. The United Kingdom, Application no. 41087/98 (European Court of Human Rights July 05, 2001). Retrieved February 08, 2021, from <https://rm.coe.int/09000016806ebe19>

Raimondo v. Italy, no. 12954/87, Seria A (GJEDNJ, Strasbourg 1994). Retrieved from <https://rm.coe.int/16806ebe1a>

Salabiaku v. France, no. 10519/83 (GJEDNJ, Strasbourg 1988). Retrieved from https://www.stradalex.com/en/sl_src_publ_jur_int/document/echr_10519-83_001-76797

Saunders v. United Kingdom, no. 19187/91 (GJEDNJ, Strasbourg 1996 - VII). Retrieved from https://www.stradalex.com/en/sl_src_publ_jur_int/document/echr_19187-91_001-2794

Serious Fraud Office, 'Chad Oil' share deal. (2018, March 22). *SFO recovers £4.4m from corrupt diplomats in 'Chad Oil' share deal*. Retrieved August 7, 2020, from Serious Fraud Office (United Kingdom), Case Information: <https://www.sfo.gov.uk/2018/03/22/sfo-recovers-4-4m-from-corrupt-diplomats-in-chad-oil-share-deal/>

Serious Fraud Office, Smith and Ouzman Ltd. (2018, October 15). *Serious Fraud Office, Smith and Ouzman Ltd*. Retrieved August 9, 2020, from Serious Fraud Office (United Kingdom), Case Information: <https://www.sfo.gov.uk/cases/smith-ouzman-ltd/>

Serious Fraud Office, Standard Bank PLC. (2019, September 3). *Serious Fraud Office (United Kingdom), Case Information*. Retrieved August 7, 2020, from Serious Fraud Office, United Kingdom: <https://www.sfo.gov.uk/cases/standard-bank-plc/>

Telfner v. Austria, Application no. 33501/96 (European Court of Human Rights March 20, 2001). Retrieved February 07, 2021, from [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-59347%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-59347%22]})

United States vs. Matthew Brent Goettsche et.al., 19-CR-877-CCC, 19CR877 (U.S. Attorney's Office - District of New Jersey March 2022, 31). Retrieved from <https://www.justice.gov/usao-nj/bitclub>

D. RAPORTE, DOKUMENTE DHE BURIME TJERA TË NGJASHME

ASK. (2011). *Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Familjeve*. Prishtinë: Agjencia e Statistikave të Kosovës. Retrieved 2022, from <https://bit.ly/3u0h77Q>

Attorney-General's Department. (n.d.). Presumption of innocence - Public Sector Guidance Sheet. Canberra, Australia, Australia. Retrieved February 07, 2021, from <https://www.ag.gov.au/rights-and-protections/human-rights-and-anti-discrimination/human-rights-scrutiny/public-sector-guidance-sheets/presumption-innocence#:~:text=The%20presumption%20of%20innocence%20is%20a%20fundamental%20principle%20of%20the,been%20pro>

Australian Law Reform Commission. (2015, July 31). Laws that reverse the legal burden. *Laws that reverse the legal burden*. (A. L. Commission, Ed.) Canberra, Australia, Australia: Australian Law Reform Commission. Retrieved February 07, 2021, from <https://www.alrc.gov.au/publication/traditional-rights-and-freedoms-encroachments-by-commonwealth-laws-alrc-interim-report-127/11-burden-of-proof/laws-that-reverse-the-legal-burden/>

- Balkans Policy Research Group. (2020). *Kosova: Trendet e migrimet kërkojnë një qasje të re të politikave*. Pristina: Balkans Policy Research Group. Retrieved June 14, 2021, from https://balkansgroup.org/wp-content/uploads/2020/10/Kosova_Trendet-e-Migrimet-kërkojnë-një-qasje-të-re-strategjike-.pdf
- BAK. (2021). *Korruption: Bundeslagebild 2020*. Wiesbaden: Bundeskriminalamt. Retrieved from <file:///C:/Users/adrianit.ibrahimi/Desktop/Downloads/korruptionBundeslagebild2020.pdf>
- British Embassy Pristina & GLPS. (2020). *Fight against money laundering and the confiscation of illegally obtained assets: A reflection on the current situation*. Retrieved from Justice today - Snapshot Analysis (June 2019 - December 2019): http://www.legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2020/01/Final_Fight-against-Money-Laundering- Anglisht.pdf
- CEU. (2020). *Programi i Reformës Ekonomike të Kosovës 2020-2022*. Retrieved from Këshilli i BE: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-7471-2020-INIT/en/pdf>
- Civil Law Convention on Corruption. (1999, November 04). *European Treaty Series no. 174*. Retrieved April 29, 2022, from Council of Europe: <https://rm.coe.int/168007f3f6>
- CMI U4. (2022). *CMI U4 Anti-Corruption Resource Centre*. Retrieved April 20, 2022, from <https://www.u4.no/publications/are-blockchain-technologies-efficient-in-combatting-corruption/shortversion>
- CoE Impact study on civil forfeiture. (2013). *Impact study on civil forfeiture*. Council of Europe. Retrieved from <https://rm.coe.int/impact-study-on-civil-forfeiture-en/1680782955>
- European Commission . (2021, tetor 19). *European Commission*. Retrieved from Key findings of the 2021 Report on Kosovo: https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/qanda_21_5278
- European Commission. (2019). *Kosovo 2019 Report*. Brussels: European Commission.

European Commission. (2019, May 29). *Key findings of the 2019 Report on Kosovo*. Retrieved from European Commission:

https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/COUNTRY_19_2776

European Commission. (2020). *Kosovo 2020 Report*. European Commission, European Commission. Brussels: European Commission. Retrieved February 03, 2021, from

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf

European Commission. (2020). *Kosovo Report 2020*. Brussels: European Commission. Retrieved from [https://ec.europa.eu/neighbourhood-](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf)

[enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf)

European Commission. (2020, tetor 06). *Key findings of the 2020 Report on Kosovo*. Retrieved from: https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/country_20_1797

European Commission. (2021). *Kosovo Report 2021*. European Commission, Directorate-General for Neighbourhood and Enlargement Negotiations. Strasbourg: European Commission. Retrieved May 09, 2022, from

[file:///C:/Users/DELL/Downloads/Kosovo%202021%20report%20\(1\).PDF](file:///C:/Users/DELL/Downloads/Kosovo%202021%20report%20(1).PDF)

European Court of Human Rights. (2020). *Guide on Article 6 of the European Convention on Human Rights*. Council of Europe, European Court on Human Rights. Strasbourg:

European Court of Human Rights. Retrieved February 07, 2021, from

file:///C:/Users/DELL/Downloads/guide_art_6_criminal_eng.pdf

European Parliament. (2021). *Mapping Fake News and Disinformation in the Western Balkans and Identifying Ways to Effectively Counter Them*. European Parliament, Policy Department for External Relations -Directorate General for External Policies of the Union. Retrieved July 04, 2021, from

[https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/653621/EXPO_STU\(2020\)653621_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/653621/EXPO_STU(2020)653621_EN.pdf)

- European Policy Institute of Kosovo (2019). *The great escape*. Pristina. Retrieved 2021, from <https://cdn.website-editor.net/8a3b242c12494d76b2b60ea75852e5f4/files/uploaded/THE%2520GREAT%2520ESCAPE.pdf>
- Eurostat. (2019). *Eurostat - European Statistics*. (E. Commission, Producer, & European Commission) Retrieved June 23, 2021, from European Commission: <https://ec.europa.eu/eurostat/news/themes-in-the-spotlight/western-balkans-2019>
- Explanatory Report - EUS No. 173. (1999). *"Explanatory Report to the Criminal Law Convention on Corruption" European Treaty Series no. 173*. Council of Europe. Strasbourg: Council of Europe. Retrieved April 28, 2022, from <https://rm.coe.int/16800cce441999#:~:text=Explanatory%20Report%20%E2%80%93ETS%20173%E2%80%93Criminal%20Law%20Convention%20on%20Corruption,it%20had%20always%20been%20present%20in%20the%20history>
- Explanatory Report - EUS no. 174. (1999, Strasbourg). *Explanatory Report to the Civil Law Convention on Corruption*. Strasbourg: Council of Europe. Retrieved from <https://rm.coe.int/16800cce45>
- Explanatory Report - EUS no. 198. (2005). *Explanatory Report to the Council of Europe Convention on Laundering, Search, Seizure and Confiscation of the Proceeds from Crime and on the Financing of Terrorism*. Strasbourg: Council of Europe. Retrieved from <https://rm.coe.int/16800d3813>
- Fondi Monetar Ndërkombetar. (2005). *The IMF's Approach to Promoting Good Governance and Combating Corruption - A guide*. IMF. IMF. Retrieved April 28, 2022, from <http://www.imf.org/external/np/gov/guide/eng/index.htm>
- GAP Institute. (2020). *Emigrimi i fuqisë punëtore të Kosovës në Gjermani - Vlerësim i shkurtër i kthimeve pozitive dhe negative*. Pristina: GAP Institute & The Expert Council of German Foundations on Integration and Migration - Research Unit. Retrieved June 16, 2021, from https://www.institutigap.org/documents/82484_emigrimi_gjermani_.pdf

- GAP. (2022). *Këshilli i Evropës - Procedurat për Anëtarësim dhe Përfitimet*. Retrieved from
 Instituti për Studime të Avancuara GAP - Instituti Gap:
https://www.institutigap.org/documents/32025_keshilli_i_evropes.pdf
- Gjykata Themelore në Prishtinë. (2020). *Raporti vjetor i Gjykatës Themelore në Prishtinë*.
 Prishtinë: Gjykata Themelore në Prishtinë.
- Gjykata Themelore në Prishtinë. (2021). *Raporti vjetor i Gjykatës Themelore në Prishtinë*.
 Prishtinë: Gjykata Themelore në Prishtinë.
- Gjykata Themelore në Prishtinë. (2022). *Raporti vjetor 2021*. Prishtinë: Gjykata Themelore në
 Prishtinë.
- Global Legal Research Center. (2019, June). *Law Library of Congress*. Retrieved from Collection -
 Legal Reports (Publications of the Law Library of Congress):
<https://www.loc.gov/law/help/cryptocurrency/>
- GRECO. (2021). *GRECO Report 2020: Anti-corruption trends, challenges and good practices in Europe & the United States of America*. Strasbourg: GRECO. Retrieved from
<https://rm.coe.int/21st-general-activity-report-greco-2020/1680a2173c>
- Inneres Bundesministerium. (2019). *Jahresbericht 2018*. Wien: Bundesamt zur
 Korruptionprävention und Korruptionsbekämpfung. Retrieved from
https://www.bak.gv.at/501/files/Jahresberichte/BF_Jahresbericht_2018_Homepage.pdf
- Inneres Bundesministerium. (2020). *Jahresbericht 2019*. Wien: Bundesamt zur
 Korruptionprävention und Korruptionsbekämpfung. Retrieved from
https://www.bak.gv.at/Downloads/files/Jahresberichte/Jahresbericht_2019.pdf
- Inneres Bundesministerium. (2021). *Inneres Bundesministerium Österreich, Jahresberisht 2020*.
 Wien: Bundesamt zur Korruptionprävention und Korruptionsbekämpfung. Retrieved from
https://www.bak.gv.at/501/files/Jahresberichte/BAK_Jahresbericht_2020_web.pdf

- Instituti Demokratik i Kosovës. (2021). *Vazhdon Stagnimi në Luftën kundër Korrupsionit në Kosovë. Konferencë për Media - IPK*. Prishtinë: Instituti i Kosovës për Drejtësi. Retrieved maj 10, 2022, from <https://kdi-kosova.org/aktivitetet/vazhdon-stagnimi-ne-luften-kunder-korrupsionit-ne-kosove/>
- Instituti i Kosovës për Drejtësi. (2022). *Korrupsioni në Kosovë: Luftimi apo promovimi i korrupsionit*. Retrieved from Instituti i Kosovës për Drejtësi: <https://kli-ks.org/korrupsioni-ne-kosove-luftimi-apo-promovimi-i-korrupsionit-2/>
- Instituti Riinvest. (2016). *Vlerësimi i Korrupsionit në Kosovës*. Instituti Riinvest. Prishtinë: Instituti Riinvest. Retrieved maj 1, 2022, from https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/September/15/Vleresimi_i_korruksionit_ne_Kosove1473932044.pdf
- Internet World Stats. (2021). *Miniwatts Marketing Group - Usage and population statistics*. Miniwatts Marketing Group - Miniwatts Marketing Group. July 02, 2021 tarihinde Internet World Stats - Usage and population statistics: <https://www.internetworldstats.com/stats4.htm#europe%20adresinden%20al%C4%B1nd%C4%B1>
- Interpol. (2002). *Global Standards to Combat Corruption in Police Forces/Services - the fight against corruption*. Lyon: Amnesty Internation. Retrieved April 29, 2022, from <https://policehumanrightsresources.org/interpol-global-standards-to-combat-corruption-in-police-forcesservices>
- IPK. (2022). *Raporti Vjetor 2021*. Prishtinë: Inspektorati Policor i Kosovës. Retrieved qershor 20, 2022, from <https://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/04/Raporti-Vjetor-2021-IPK-AL.pdf>
- IREX. (2019). *IREX - Media Sustainability Index 2019*. IREX. Retrieved July 03, 2021, from IREX - Media Sustainability Index 2019: <https://www.irex.org/sites/default/files/pdf/media-sustainability-index-europe-eurasia-2019-kosovo.pdf>

Këshilli i Evropës & Unioni Evropian. (2013). *Raport vlerësimi për përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushën e Luftës Kundër Korrupsionit - Cikli 1*. Prishtinë.

Retrieved maj 2, 2022, from [https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/docs/2590 PECK-AC Assessment Report FINAL Cycle I ALB.pdf](https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/docs/2590_PECK-AC_Assessment_Report_FINAL_Cycle_I_ALB.pdf)

Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës. (1994). *Raporti i Sekretarit Gjeneral të Këshillit të Evropës për Konferencën e 19-të të Ministrave Evropian të Drejtësisë*. Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave. Strasburg: Këshilli i Evropës. Retrieved maj 2, 2022, from

<https://rm.coe.int/16804ead6d>

Komiteti Shqiptar i Helsinkit. (2014). *Raport Studimor për veprat penale të korrupsionit dhe formave të shpërdorimit të detyrës*. Tiranë: Shtëpia Botuese Vllamasi. Retrieved prill 30, 2022, from http://www.ahc.org.al/wp-content/uploads/2016/12/RAPORT_STUDIMOR_PR_VEPRAT_PENALE_T_KORRUPSIONIT_DHE_FORMAVE_T_SHPRDORIMIT_T_DETYRS.pdf

Kosovo Agency of Statistics. (2020). *Population Estimation, 2019*. Pristina: Kosovo Agency of Statistics. Retrieved June 20, 2021, from <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/population-estimation-2019>

NDI Kosovo. (2021, June 08). *Monitoring information integrity disorders in Kosovo*. (K. National Democratic Institute, Producer, & National Democratic Institute, Kosovo) Retrieved July 01, 2021, from National Democratic Institute, Kosovo: <https://www.ndi.org/our-stories/monitoring-information-integrity-disorders-kosovo>

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë. (2020). *Studim mbi Përcetimin e Korrupsionit*. Prishtinë: Oda Ekonomike Amerikane & USAID. Retrieved from <https://www.amchamksv.org/sq/ndikimi-negativ-i-korrupsionit-ne-biznese-i-njejte-me-ate-te-pandemise-covid-19/>

OSCE & UNMIK. (2007). *Implementimi i ligjeve të Kuvendit të Kosovës - Sektori i Sundimit të Ligjit*. Prishtinë: OSCE & UNMIK. Retrieved prill 30, 2022, from <https://www.osce.org/files/f/documents/1/e/23824.pdf>

- OECD. (2018). *Confiscation of instrumentalities and proceeds of corruption crimes in Eastern Europe and Central Asia*. Paris: OECD Anti-Corruption Network for Eastern Europe and Central Asia. Retrieved from <https://www.oecd.org/corruption/acn/OECD-Confiscation-of-Proceeds-of-Corruption-Crimes-ENG.pdf>
- Qeveria e RKS. (2019). *Strategjia e luftimit të ekonomisë joformale, parandalimi i shpëlarjes së parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare 2019-2023*. Retrieved from Ministria e Financave: <https://bit.ly/3nxu8Dq>
- Reporters Without Borders. (2021). *World Press Freedom Index*, World Press Freedom Index. Retrieved July 03, 2021, from Reporters Without Borders: <https://rsf.org/en/kosovo>
- Risk&Compliance, GAN. (2020, June). *Kosovo Corruption Report*. Retrieved July 01, 2021, from Risk & Compliance Portal, Powered by GAN: <https://www.ganintegrity.com/portal/country-profiles/kosovo/>
- State Parties to the UNCAC. (2017). Good practices in identifying the victims of corruption and parameters for their compensation <https://www.unodc.org/>. *Conference of the State Parties to the United Nations Convention against Corruption*. Vienna: United Nations.
- Transparency International. (2019). *Corruption Perceptions Index 2019 - Kosovo*. Transparency International - the global coalition against corruption. Retrieved from <https://www.transparency.org/en/cpi/2019/index/ksv>
- Transparency International. (2020). *Corruption Perception Index 2020*. Transparency International - the global coalition against corruption, Transparency International- the global coalition against corruption. Transparency International - the global coalition against corruption. Retrieved February 03, 2021, from <https://www.transparency.org/en/cpi/2020/index/ksv>
- Transparency International. (2022). *Corruption Perception Index 2021, Kosovo*. Retrieved 2022, from Transparency International - The global coalition against corruption: <https://www.transparency.org/en/cpi/2021/index/ksv>

U.S. Department of State. (2019). *2019 Country Reports on Human Rights Practices: Kosovo*.

Retrieved from U.S. Department of State - Bureau of Democracy, Human Rights and Labor: <https://www.state.gov/reports/2020-country-reports-on-human-rights-practices/kosovo/>

U.S. Department of State. (2020). *2020 Country Reports on Human Rights Practices: Kosovo*.

Retrieved from U.S. Department of State - Bureau of Democracy, Human Rights and Labor: <https://www.state.gov/reports/2020-country-reports-on-human-rights-practices/kosovo/>

U.S. Department of State. (2021). *2021 Country Reports on Human Rights Practices: Kosovo*.

Retrieved from U.S. Department of State - Bureau of Democracy, Human Rights and Labor: <https://www.state.gov/reports/2021-country-reports-on-human-rights-practices/kosovo/>

UNODC. (2011). *Model law on In Rem forfeiture*. Retrieved from United Nations Office on Drugs and Crime:

https://www.unodc.org/documents/colombia/2013/septiembre/MODEL_LAW_ON_IN_REM_FORFEITURE_--UNODC--.pdf

World Bank Group. (2018). *Western Balkans Labor Market 2018*. Washington Retrieved from

<http://documents1.worldbank.org/curated/en/565231521435487923/pdf/124354-Western-Balkans-Labor-market-trends-2018-final.pdf>

World Bank. (2022). *GDP growth (annual %) - Kosovo*. Retrieved from

https://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.MKTP.KD.ZG?end=2021&locations=XK&name_desc=false&start=2009&view=chart

E. WEB FAQE

Ahmetxhekaj, Shkumbin. (2019). *BalkanInsight - BIRN*. Retrieved June 27, 2021, from

BalkanInsight - BIRN: <https://balkaninsight.com/2019/12/04/brain-drain-will-the-last-doctor-in-kosovo-turn-out-the-lights/>

- BIRN. (2017). *Enduring the pressure: Kosovo media reporting on organised crime and corruption*. BIRN, German Federal Foreign Office. Retrieved July 02, 2021, from <https://balkaninsight.com/wp-content/uploads/2018/01/kosovo-country-report-eng.pdf>
- Blockchain Alliance. (2020). A Public-Private forum to help combat criminal activity on the blockchain. Retrieved March 19, 2021, from <https://blockchainalliance.org/>
- Blockchain.com. (2022). *Explorer, Wallet Users*. Retrieved from Blockchain.com: <https://www.blockchain.com/charts/my-wallet-n-users/>
- CoinMarketCap. (2022). *All Cryptocurrencies*. Retrieved from Coinmarketcap.com: <https://coinmarketcap.com/all/views/all/>
- Council of Europe Treaty Office, Austria. (2022). *Criminal Law Convention on Corruption*. Retrieved from Council of Europe: <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=declarations-by-treaty&numSte=173&codeNature=3&codePays=AUS>
- Decentralized Dog. (2021). Who Is Satoshi Nakamoto? *Alexandria*. Retrieved 2022, from <https://coinmarketcap.com/alexandria/article/who-is-satoshi-nakamoto>
- Details of Treaty no. 174. (2022). *Civil Law Convention on Corruption (ETS No. 174)*. Retrieved August 9, 2020, from Council of Europe - Treaty Office: <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/174>
- Freedom House. (2021). *Kosovo Country Report*. Retrieved from Freedom in the world 2022: <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2021>
- Freedom House. (2022). *Kosovo Country Report* . Retrieved from Freedom in the world 2022 : <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2022>
- Gallup Research Migration Center. (2018). *www.news.gallup.com*, Potential Net Migration Index. Retrieved June 30, 2021, from [www.news.gallup.com](https://news.gallup.com/migration/interactive.aspx): <https://news.gallup.com/migration/interactive.aspx>

Kallxo.com. (2022). *Korrupsioni në Kosovë* . Retrieved from Kallxo.com:

<https://kallxo.com/tag/korrupsioni-ne-kosove/>

Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit. (2012, shkurt 14). *Përbërja e Këshillit Kombëtar kundër Korrupsionit*. Retrieved from Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës:

<https://president-ksgov.net/?page=1,132>

Koha Islame. (2021, shtator 3). *Koha Islame*. Retrieved from HULUMTIMI: BIZNESI,

KORRUPSIONI DHE KRIMI NË KOSOVË: Ndikimi i ryshfetit dhe i krimit tjetër në

ndërmarrjet private: <https://kohaislame.com/hulumtimi-biznesi-korrupsioni-dhe-krimi-ne-kosove-ndikimi-i-ryshfetit-dhe-i-krimit-tjeter-ne-ndermarriet-private/>

Konrad Adenauer Stiftung. (2020). *Balkanmedia - Media and democracy in South East Europe, Media Outlets in Kosovo*. (L. M.-K. Europe, Editor, K. A. Stiftung, Producer, & Konrad Adenauer Stiftung) Retrieved July 2, 2021, from Konrad Adenauer Stiftung:

<https://www.kas.de/en/web/balkanmedia/media-outlets4>

Latdict. (1982). Latin Dictionary & Grammar Resources. *Oxford Latin Dictionary*. London, England, United Kingdom. Retrieved April 30, 2022, from <http://www.latin-dictionary.net/definition/14433/corumpo-corrumpere-corrupti-corruptus>

Lexico - Oxford. (n.d.). UK Dictionary - Corruption. *Lexico - Powered by Oxford*. London, England, United Kingdom. Retrieved April 30, 2022, from

<https://www.lexico.com/definition/corruption>

Schengen Visa Info. (2014-2020). *schengenvisainfo.com*. Retrieved June 19, 2021, from Schengen Visa Info - Statistics - Specific Schengen Visa Statistics:

<https://statistics.schengenvisainfo.com/>

Transparency International. (n.d.). *What is corruption?* (Transparency international) Retrieved April 29, 2022, from Transparency International - the global coalition against corruption:

<https://www.transparency.org/en/what-is-corruption#define>

- TRT. (2022, maj 09). Moment kyç për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Europës. Prishtinë, Kosovë. Retrieved from <https://www.trt.net.tr/shqip/ballkani/2022/03/21/moment-kyc-per-anetaresimin-e-kosoves-ne-keshillin-e-europes-1799331>
- UNODC Web. (2022). *United Nations Convention against Corruption*. Retrieved from United Nations Office on Drugs and Crime: <https://www.unodc.org/unodc/en/corruption/uncac.html>
- Conotoxia. (2022). *Cryptocurrency features*. Retrieved April 15, 2022, from Conotoxia: <https://conotoxia.com/cryptocurrencies/what-are-cryptocurrencies/cryptocurrency-features>
- UNODC. (2017, May 08). UNODC launches training to tackle cryptocurrency-enabled Organized Crime. (U. N. Crime, Ed.) United Nations Office on Drugs and Crime. Retrieved March 19, 2021, from <https://www.unodc.org/unodc/en/frontpage/2017/May/unodc-launches-training-to-tackle-money-laundering-and-bitcoin-banking-fraud.html>
- GRECO. (2017, May 10). *Council of Europe*. Retrieved from Group of States against Corruption: https://www.coe.int/en/web/greco/home/-/asset_publisher/lxOP5Yph48Zi/content/germany-ratifies-the-criminal-law-convention-on-corruption-and-its-additional-protocol?inheritRedirect=false
- Serious Fraud Office, United Kingdom. (2018, June 1). *New joint principles published to compensate victims of economic crime overseas*. Retrieved August 9, 2020, from Serious Fraud Office (United Kingdom), News Releases: <https://www.sfo.gov.uk/2018/06/01/new-joint-principles-published-to-compensate-victims-of-economic-crime-overseas/>
- Latham & Watkins LLP. (2018, June 18). *UK to Provide Compensation for Overseas Victims of Economic Crimes*. Retrieved August 9, 2020, from Latham & Watkins LLP, Latham.London – Dispute Resolution: <https://www.latham.london/2018/06/Uk-To-Provide-Compensation-For-Overseas-Victims-Of-Economic-Crimes/>

- BBC News. (2019, November 24). Cryptoqueen: How this woman scammed the world, then vanished. *BBC News*. Retrieved from <https://www.bbc.com/news/stories-50435014>
- UNODC. (2019, 12). *E4J University Module Series: Anti-Corruption*. Retrieved from Module 5: Private Sector Corruption: <https://www.unodc.org/e4j/en/anti-corruption/module-5/key-issues/causes-of-private-sector-corruption.html>
- United Nations. (2019, December 9). *United against corruption for development, peace and security*. Retrieved August 7, 2020, from United Nations, International Anti-Corruption Day: <https://www.un.org/en/observances/anti-corruption-day>
- Transparency International. (2020, March 31). *Corruption could cost lives in Latin America's response to the Coronavirus*. Retrieved August 7, 2020, from Transparency International - the global coalition against corruption: [https://www.transparency.org/news/feature/corruption could cost lives in latin americas response to the coronavirus](https://www.transparency.org/news/feature/corruption%20could%20cost%20lives%20in%20latin%20americas%20response%20to%20the%20coronavirus)
- Insajderi. (2020, May). *Kush po e keqpërdor arkën e shtetit në kohë pandemie?* Retrieved August 8, 2020, from Insajderi: <https://insajderi.com/kush-po-e-keqperdor-arken-e-shtetit-ne-kohe-pandemie/>
- Ministry of Health of the Republic of Kosovo. (2020, August 26). *kosovo.health*. Retrieved August 26, 2020, from Ministria e Shëndetësisë: <https://kosova.health/>
- European Commission. (2021, June 11). *European Commission - Migration and Home Affairs, Brain Drain - Definition*. (E. Commission, Producer, & European Commission) Retrieved June 11, 2021, from European Commission - Migration and Home Affairs: https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/networks/european_migration_network/glossary_search/brain-drain_en
- UKEssays. (2020, 02 08). The Legitimacy of Cryptocurrencies. *UKEssays*. Retrieved from <https://www.ukessays.com/essays/finance/the-legitimacy-of-cryptocurrencies.php#citethis>

- Prishtina Insight. (2021, August 4). EU Special Representative for Kosovo: Fighting corruption needs constant attention. Prishtina, Kosovo. Retrieved maj 6, 2022, from <https://prishtinainsight.com/eu-special-representative-for-kosovo-fighting-corruption-needs-constant-attention/>
- PYMNTS.com. (2022, March 01). *PYMNTS.com Section*. Retrieved April 18, 2022, from PYMNTS: <https://www.pymnts.com/cryptocurrency/2022/pymnts-crypto-basics-series-is-bitcoin-really-anonymous-and-how-can-law-enforcement-track-it/>
- TripleA. (2022). *TripleA*. Retrieved April 15, 2022, from <https://triple-a.io/crypto-ownership/>
- Council of Europe. (2022, May 2). *About GRECO - The Fight against Corruption: A Priority for the Council of Europe*. Retrieved from: <https://www.coe.int/en/web/greco/about-greco/priority-for-the-coe>
- Council of Europe Web Site. (2022, May 2). *Administrative entities - Member states*. Retrieved from Council of Europe: <https://www.coe.int/en/web/portal/46-members-states>
- Qeveria e Kosovës - Mbledhja nr. 77. (2022, 05 12). Mbledhja e 77-të e Qeverisë. Prishtinë, Kosovë. Retrieved from <http://kryeministri.rks-gov.net/mbledhja-e-77-te-e-qeverise/>
- European Commission. (2022, June 7). *Shaping Europe's digital future*. Retrieved from: <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/policies/regulatory-framework-blockchain>
- Monitor.al. (2022, shkurt 10). *Emigrantët dërguan 1.44 miliardë euro në Kosovë në 2021*. Retrieved from Monitor.al: <https://www.monitor.al/emigrantet-derguan-1-44-miliarde-euro-ne-kosove-ne-2021/>